



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 23 MARS 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 16.03.2023 (neni 44, pika 2, i Rregullores)

2. Njoftime (neni 44, pika 3, i Rregullores)

3. Interpelancë me Ministren e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, zonjën Ogerta Manastirliu, kërkuar nga deputeti Bujar Leskaj (neni 80 i Kushtetutës dhe neni 96 i Rregullores së Kuvendit)

4. Interpelancë me Ministren e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, zonjën Ogerta Manastirliu, kërkuar nga deputeti Zef Hila (neni 80 i Kushtetutës dhe neni 96 i Rregullores së Kuvendit)

5. Pyetje me Ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi nga deputetja Erisa Xhixho

(nenet 90, 91, 92 dhe 95, pika 4, të Rregullores së Kuvendit)

6. Pyetje me Ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi nga deputetja Erisa Xhixho (nenet 90, 91, 92 dhe 95, pika 4, të Rregullores së Kuvendit)

7. Projektligji “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

8. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve në Shqipëri” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politiken e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

9. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhgueseve për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politiken e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

10. Projektligji “Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore,

çnjerëzore ose poshtëruese” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin European.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

11. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/ 2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

12. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

13. Projektvendimi “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”” *(në mbështetje të nenit 37 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

14. Projektvendimi “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 65/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës në Komisionin e Prokurimit Publik *(në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

15. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’)

Lindita Nikolla – Mirëdita!

Hapim seancën plenare.

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare. Ju lutem, kolegë, ka filluar seanca!

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Fillojmë me çështjet sipas rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 16.03.2023, të cilin e keni marrë në rrugë elektronike.

Ka vërejtje? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te njoftimet. Ju njoftoj se në Kuvend gjatë javës janë depozituar: një akt nga Këshilli i Ministrave dhe propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Titujt e çështjeve të depozituara i gjeni në sistemin këtu në sallë, ndërsa materialet në sistemin “e-parlament” dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Ju njoftoj, gjithashtu, se në Kuvend është depozituar kërkesa me nr. prot 1018, datë 23.03.2023, e një grupi deputetësh për ndryshimin e rendit të ditës së seancës së sotme plenare, përmes së cilës kërkojnë të përfshihet si pikë e parë e rendit të ditës një mocion me debat për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Ju sqaroj se, në bazë të nenit 98 të Rregullores, kërkesa për mocion paraqitet te Kryetari i Kuvendit, i cili brenda tri ditësh duhet të mbledhë Konferencën e Kryetarëve për të vendosur për datën dhe kohën e zhvillimit të mocionit në seancë plenare. Në bazë të nenit 49 të Rregullores, propozuesi i kërkesës diskuton jo më shumë se 3 minuta dhe ka të drejtë të diskutojë një folës pro dhe një folës kundër, jo më shumë se 2 minuta secili.

(Ndërrhyrje pa mikrofoni)

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Të nderuar deputetë, kërkesa jonë për mocion me debat nisët nga fakti që raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit është një nga raportet më të rënda të hartuara ndonjëherë për gjendjen e demokracisë, të korrupsionit, të medias së lirë në Shqipëri. Ju do të thoni se raportet janë të përvitshme. Po, të tilla janë, por rëndesa nuk ka qenë kurrë si e kësaj here, sepse tregon qartazi rrëshqitjen e Shqipërisë drejt një autokracie idiote. Madje, theksi i këtij raporti vendoset kryesisht në gjendjen e lirisë së medias, në situatën korruptive dhe në kapjen e sistemit të drejtësisë, të asaj “reforme” që e keni trumbetuar

prej kaq vjetësh. Cila është situata? Situata është ajo që pasqyron ky raport dhe nuk keni ku të fshiheni pas këtij raporti.

Nuk mjafton kjo, por dje shqiptarët kanë parë në një shfaqje absurde: bllokimin dhe luftën që Rama vazhdon ndaj medias së lirë. Tentativa e tij për të bllokuar dhe sekuestrimi i “Prestige Resort”, është vazhdim i luftës ndaj medias së lirë, ndaj “Hysenbelliu Group” dhe nuk është aspak e rastit, por është një program i mirëdetajuar, që ne e kemi paraqitur si shqetësim për eliminimin e medias, për eliminimin e opozitës, për eliminimin e zërave të lirë.

Është fatkeqësi që raporti dëshmon qartazi se e vetmja dritare e lirë e medias sot janë rrjetet sociale. Më tepër shqetësuese është gjendja e drejtësisë, gjendja e gjyqësorit, që është i kapur nga qeveria, i shantazhuar, i presionuar politikisht.

Po ashtu, ulëritëse është gjendja e korrupsionit, e lidhur ngushtë me inceneratorët. Ka një binom media-incenerator, i cili tashmë është shfaqur, është përshfaqur dhe, në mënyrë eksplicite, raporti përcakton se qeveria ka grabitur 273 milionë euro nga inceneratorët, nga ai i Elbasanit, ai i Fierit dhe ai i Tiranës.

Duke qenë se unë vij nga Elbasani dhe duket sikur është lënë jashtë vëmendjes, inceneratori i Elbasanit ka qenë akti i parë korruptiv më i madh i realizuar, që u ndoq më pas nga ai i Fierit dhe ai i Tiranës. Ama, asnjëri prej këtyre inceneratorëve nuk punon, megjithëse për ta janë hedhur miliona euro. Përpos kësaj, kemi dëshmuar dhe kemi vërtetuar se teknologjia e përdorur atje është një teknologji e vjetër, kontaminuese, vdekjeprurëse!

A e dini çfarë keni ndërtuar në Elbasan?

(Bie gongu.)

Elementi kryesor i inceneratorit, dhe unë dua ta sjell këtu si shqetësim, ose produkti fundor i tij është hiri, që, sipas të gjitha manualeve që disponohen, duhet të futet në tankerë hermetikë dhe duhet të transportohet larg vendit të djegies, larg inceneratorit.

Ja, çfarë ndodh në Elbasan!

(Deputeti Boçi tregon disa pamje.)

Këto foto pasqyrojnë qartë qeset plastike me hirin e inceneratorit. Ky hi është kancerogjen. Ky është një krim njerëzor dhe krim mjedisor! Qesharakja është që jo vetëm se ky hi ekziston dhe, sipas dëshmisë përgjatë komisionit hetimor, shpërndahet në landfill, por ky hi derdhet edhe

pranë lumit Shkumbin në mënyra dhe forma të tjera. Ja, ku i keni fotot! Ja, dëshmitë e krimit tuaj, që u bashkohen dëshmime që solli zoti Këllici për inceneratorin e Tiranës, në bashkëpunimin media-incenerator!

Çfarë ndodh? Ai revolucioni juaj mjedisor, i cili nuk ka qenë asnjëherë i tillë, por veçse një revolucion i korrupsionit tuaj, shoqërohet edhe me një kontratë pune, ku ju shënoni që në incenerator punon një punonjës hiri, sikur të punonte në *Mauthausen* (krematorium), e keni të shënuar këtu! Kjo është një tip kontrate: “Punonjës hiri në epokën moderne të djegies së plehrave”. Madje ata njerëz jo vetëm janë të kontaminuar, jo vetëm kanë rrezikuar jetët e tyre, por kanë rrezikuar edhe jetët e të gjithë banorëve të Elbasanit.

Kjo është e vërteta, kjo është ajo ndërtesa, ai investimi vdekjeprurës që ju keni ndërtuar në Elbasan, që e keni fshehur pas asaj retorikës suaj të bukur për modernizimin, për prodhimin e energjisë që e vodhët 5 vjet rresht!

Sot vërtet ai incenerator nuk punon, por nuk punon për shkak të korrupsionit.

Unë do të doja që ai incenerator të mos punonte kurrë, për atë çka prodhon dhe për atë produkt vdekjeprurës, si dhe për mënyrën artizanale përmes së cilës punohet.

Lindita Nikolla – Zoti Boçi, përfundoni, sepse morët edhe 2 minuta!

Luçiano Boçi – A e kuptoni, punonjës hiri? Lexojeni mirë kontratën këtu!

Ndërkohë, a e dini se çfarë thonë raportet botërore për inceneratorët? Ja “Inceneratori dhe shëndeti – 5 fakte mbi inceneratorët”. Ndikimi i tij është në të gjitha nivelet e shëndetit, efektet shëndetësore, sanitare, kancerët që shkakton. Efektet e tjera janë mbi riprodhimin dhe zhvillimin te fëmijët. Pjesa tjetër, efektet, janë në pjesën respiratore...

Këto janë dëmet reale, faktike, që kanë ndodhur në Elbasan.

Lindita Nikolla – Zoti Boçi, përfundoni, ju lutem, se e morët të gjithë kohën!

Luçiano Boçi – Këtu në sallë kemi mjekë dhe doktorë që vijnë nga Elbasani. Ata e dinë se prevalenca e tumoreve në Elbasan është më e larta se në çdo bashki tjetër.

Kjo, pra, është ajo pasoja e korrupsionit tuaj, e babëzisë suaj për të vjedhur 273 milionë euro, por këto të vërteta i keni gëpusur duke blerë

medien, duke e shantazhuar atë me fakte të dhëna e të paraqitura këtu dhe të nxjerra në komisionin hetimor, për të cilat ju heshtni, ndërkohë që sot ky parlament do të duhej të ishte në këmbë për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Në një vend që nuk ka media të lirë, në një vend ku korrupsioni është kaq galopant, në një vend ku kapet drejtësia pas, gjoja, një reforme, çfarë ka mbetur tjetër? A ekziston më ky parlament, që pretendon të jetë tempulli i fjalës së lirë? Çfarë do të thotë ky për fjalën e medias, kur ajo medie në mes të ditës, në një datë simbolike, është zgjedhur të goditet në mënyrë cinike?

Në datën 22 mars ishte festë fetare, e nderuar drejtuese e këtij parlamenti, por ishte edhe festë politike dhe këtë cinizmin simbolik me datat që kanë emocion brenda, qofshin të karakterit fetar, qofshin të karakterit politik, ju kurrë nuk duhet t'i cenoni. Por ju nuk pyesni më për asgjë, jeni gati të godisni jo vetëm njerëzit në jetët e tyre, jeni gati të godisni edhe shpirtrat e tyre në...

Lindita Nikolla – Zoti Boçi, mbaroi koha.

Ju lutem, mbylljani, se mbaroi koha!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, morët edhe 4 minuta shtesë!

(Deputeti Boçi flet nga foltorja pa mikrofon.)

Jo, nuk trembemi, por të respektojmë Rregulloren!

Morët 4 minuta shtesë, ju lutem! Ju lashë të flisnit edhe 4 minuta të tjera, zoti Boçi.

(Deputeti Boçi flet nga foltorja pa mikrofon.)

Ju lashë të flisni 4 minuta mbi kohën, zoti Boçi, ju lutem!

Kush e kërkon fjalën kundër?

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Ne nuk jemi kundër mbajtjes së çdolloj debati në Kuvend.

E para, e vlerësoj faktin që ka një reflektim të thellë nga propozuesit që, nga sa duket në kërkesë, bëjnë pjesë në grupin e non grata-ve dhe fakti se kanë përfshirur nga firma krye-non grata-ën, tregon një reflektim në raportin me Departamentin Amerikan të Shtetit. Kjo është diçka pozitive që Kuvendi duhet ta vlerësojë, natyrshëm edhe ta shqyrtojë në procedurë.

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk jemi para një kërkesë për mocion me debat, sepse nuk ka ardhur një kërkesë për zhvillimin dhe mbajtjen e një mocioni me debat.

Neni 98 i Rregullores e përcakton qartë se si vjen një kërkesë për mocion me debat dhe cilët janë hapat e shqyrtimit dhe procedurës parlamentare për këtë kërkesë.

Këtu ka një kërkesë për ndryshim të rendit të ditës për të përfshirë në rend dite diçka që nuk ekziston. Prandaj, nëse “ju ka çuar nëna për të larë gojën”, ejani dhe lajeni gojën këtu, por, nëse doni realisht të zhvillojmë një mocion me debat për gjetjet e Departamentit Amerikan të Shtetit, ne jemi të gatshëm. Brenda tri ditëve Kryetarja e Kuvendit, sikurse edhe e citoi, do të thërrasë Konferencën e Kryetarëve për të shqyrtuar një kërkesë të tillë dhe të përcaktojmë kohën, sepse edhe ne, në fakt, kemi shumë kohë që presim të flasim për shumë gjetje të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Në fakt, ky Kuvend që nga 19 maji i vitit 2021, edhe pse kjo pjesë këtej nuk ishte asokohe në Kuvend, duhej të ishte mbledhur për të diskutuar për vendimin e Departamentit Amerikan të Shtetit përmes sekretarit Blinken për shpalljen *non grata* të një prej anëtarëve të Kuvendit.

Këto janë çështje që duhen diskutuar, pa dyshim, dhe ne nuk kemi pse të hezitojmë.

(Bie gongu.)

Meqenëse kolegu e kaloi minutazhin, më lejoni ta mbyll edhe unë arsyetimin.

Këtu nuk bëhet fjalë që do të votojmë, se nuk kemi çfarë të votojmë; këtu nuk ka ardhur kërkesë.

Bazuar në nenin 98 të Rregullores, duhej të vinte një kërkesë për mocion me debat dhe pastaj, pasi ta kishte shqyrtuar Konferenca e Kryetarëve, mund të sillej si kërkesë, nëse nuk ka pasur dakordësi për mbajtjen e mocionit me debat për përfshirjen e tij si pikë e parë e rendit të ditës, sepse publiku na sheh, publiku na gjykon.

(Bie gongu.)

U mbars mali me debatin e ashtuquajtur “për çështjen e McGonigal-it”, por në fund polli një mi, se në fund të debatit, që u kërkua pa limit, pa kohë të kufizuar, ngelëm vetëm ne, se ju kishit ikur të gjithë.

Ju, që kërkuat mocion me debat, ikët, e tradhtuat mocionin me debat!

Jam shumë i sigurt që kështu do të ndodhë edhe për këtë, sapo morët vesh që ne jemi të gatshëm ta zhvillojmë mocionin me debat dhe sapo morët vesh që jemi të gatshëm të diskutojmë çdo gjë që ka thënë mocioni me debat, ndër to edhe vendimin e Departamentit Amerikan të Shtetit, sepse kur nuk na pëlqen, Sekretarin Amerikan të Shtetit, Blinken, e çojmë në gjykatë, e çojmë në Paris dhe, kur na pëlqen diçka nga raporti, marrim një fjali prej tij.

E këtu, Kryetare, kujtoj që është detyrë e Kuvendit të zhvillojmë një debat tjetër. E kam thënë në seancën e kaluar dhe po e ripërsëris natyrshëm (shoh që nuk është në sallë zonja Tabaku, si kryetare e Komisionit për Çështjet Europiane) pas ndryshimeve në ligj që të zhvillojmë një debat edhe për procesin e integritetit. Rregullorja e Kuvendit na detyron që brenda dy muajve të parë të vitit të zhvillojmë një debat edhe për këtë.

Ja, pra, kemi shumë çështje për të debatuar, por këto qoftë në traditën parlamentare, qoftë në frymën e Rregullores, nuk prekin punën normale të Kuvendit, i cili sot ka një sërë çështjesh për të diskutuar dhe për të votuar.

E fundit, që lidhet me fjalën e kolegut, profesor Boçi, hiri nuk ka numër shumë, sepse në numrin shumë del “hired” dhe i përket një fjale tjetër që e dinë të gjithë. Hiri është sasi dhe nuk ka numër shumë. Madje, nuk ju takon juve ta bëni këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I përket gjinisë mashkullore.

Në fund, meqë mora fjalën, jam shumë i sigurt që edhe brenda kësaj sale ka kolegë e kolege të besimit islam që agjërojnë. U uroj agjërim të lehtë, ta kuptojnë muajin e shenjtë të Ramazanit si një muaj shumë të rëndësishëm dhe një kohë shumë të rëndësishme për reflektim, ku, mbi të gjitha, ne politikanët, anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë, ta shohim këtë muaj edhe si muaj reflektimi për të qenë më shumë herë së bashku për të bërë më shumë punë të mira në dobi të Shqipërisë sonë të përbashkët dhe të popullit shqiptar!

Faleminderit!

(Deputeti Boçi kërkon fjalën pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Për çfarë e doni fjalën tani?

Jo, e morët 2-minutëshin, madje 7 minuta!

(Deputeti Boçi kërkon fjalën pa mikrofon.)

Nuk ka replikë tani. Pse duhet të flisni nga vendi? Nuk e kuptoj, madje jepni të gjithë mendje se çfarë duhet të bëj. Unë jam shumë e qartë dhe shumë e ndriçuar në këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, vijoni për replikë.

Luçiano Boçi – Mua më vjen keq për njohuritë e munguara të zotit Balla, sepse shqipja është shumë e pasur në leksik dhe është normale të ketë fjalë që janë të njëjta, por kanë kuptime leksikore të ndryshme, fenomen ky i çdo gjuhe. Por zoti Balla duhet të ketë njohuri edhe për inceneratorët që nxjerrin disa lloje hires dhe prandaj përdoret në shumë. Pra, çdo fjalë ka edhe njëjtesin, ka edhe shumësin.

Hired e inceneratorit janë edhe ato që produktohen, edhe ato që dalin nëpërmjet oxhaqeve në ajër, zoti Balla. Kështu që rri i qetë për njëjtesin dhe shumësin e gjuhës!

Ndërsa, për të dalë te spekulimi juaj për kërkesën tonë për mocion me debat, ja ku është kërkesa e depozituar me firmat përkatëse të deputetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është depozituar dhe mos spekuloni!

Ndërkohë, të lexoj gjetjet e raportit? Po t'i lexoj këtu, meqenëse dëshiron të t'i lexoj, prandaj ne duhej të ishim në alarm: “Presioni politik, frikësimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan gjyqësorin të funksiononte plotësisht në mënyrë të pavarur dhe efikase”. Është ndezur alarmi i kuq për gjyqësorin.

Do gjetje tjetër?

(Deputeti Balla ndërhyr nga vendi pa mikrofon.)

“Qeveria, partitë politike, bizneset dhe grupet kriminale u përpoqën të ndikonin në medie në mënyrë të papërshtatshme dhe jotransparente”.

(Bie gongu.)

Do tjetër? Ja, një gjetje tjetër: “Megjithatë, janë të pakta mediet e pavarura, pasi shumica e tyre janë në pronësi të biznesmenëve me peshë që kanë interesa të mëdha, të cilët përdorin mediet e tyre për të avancuar interesat e tyre, përfshirë përfitimin dhe nxitjen e interesave që kanë me partitë politike”.

(Bie gongu.)

A doni më shumë se kaq? Ky është raporti, e shkruar e zeza mbi të bardhë...

Lindita Nikolla – Mbaroi koha, ju lutem!

Luçiano Boçi – Dhe për këtë raport ky parlament...

Lindita Nikolla – Atëherë, ju bëj me dije se kërkesa ka titullin: “Kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës së seancës plenare, datë 23.03.2023, ora 10:00, duke përfshirë si pikë të parë të rendit të ditës një mocion me debat për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit”.

Ndaj, referuar nenit 98 të Rregullores, ju lutem, zotërinj deputetë, më parë duhet të sillni kërkesën për mocionin me debat dhe të vijojmë sipas nenit 98 të Rregullores. Unë brenda tri ditësh do të mbledh Konferencën e Kryetarëve, e cila do të vendosë ditën dhe kohën e debatit.

Faleminderit!

Vijojmë me rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Bylykbashi, për procedurë.

Oerd Bylykbashi – Zonja Kryetare, kërkesa është kreu e qartë.

Kërkojmë mocion me debat që të jetë sot në rendin e ditës dhe për këtë arsye kemi cituar më pas edhe nenin përkatës për ndryshimin e rendit të ditës.

Çështjet që ngre raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, janë çështje që ulin më gjunjë çdolloj qeverie: korrupsioni, abuzimi me të drejtat e shtetasve shqiptarë nga kjo qeveri, dhunimi i lirisë së medias, koncesionet skandaloze, dhunimi i zgjedhjeve. Të gjitha i keni aty.

A ka çështje më prioritare sesa kaq? Pra, ne kemi kërkuar ndryshimin e rendit të ditës. Është e drejta jonë, e ka Rregullorja. E kemi kërkuar specifikisht për çfarë? Për të bërë një debat në lidhje me këtë çështje, me raportin e DASH-it.

Çfarë duhet të sqarojmë më tepër ne? Debatit e nxjerr. Pra, sot nuk ka asgjë tjetër veçse rikonfirmim të asaj që kemi thënë prej 1 viti e gjysmë rresht: opozitës po i ngushtoni dhe po i zhdukni çdolloj hapësire kontrolli mbi qeverinë, mbi mazhorancën. Kur këtë gjë e thonë edhe raportet ndërkombëtare, ju përsëri doni t’ia mbyllni mundësinë publikut që në debatin që bëhet në këtë sallë, kupton më shumë se cila është gjendja skandaloze e qeverisjes shqiptare.

Pra, ky parlament këtu është vetëm një vulosës.

Folët për një rend dite të zakonshëm. Për çfarë? Për vulosjet e atyre kontratave koncesionare për grabitjen e portit të Durrësit, ku në fund fare dilni me humbje, ndërkohë që

kompania private merr shumëfish dhe e gjitha duke grabitur pasurinë publike me strategjike që ka ky vend?

U hiqni mundësinë qytetarëve të Durrësit që të inkasojnë taksat, duke krijuar edhe pabarazi. Pse? Vetëm e vetëm që të pasurohen ata që keni vendosur ju, praktikisht jeni ju brenda, por nuk e doni këtë lloj debati, edhe pse del në atë raport.

Tani ne sot kërkojmë zbatimin e Rregullores, kërkojmë ndryshimin e rendit të ditës dhe futjen në rendin e sotëm të çështjes të mocionit me debat për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

(Bie gongu.)

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Unë e bëra sqarimin, por po e sqaroj edhe një herë: konform nenit 98 të Rregullores, ju duhet të sillni një herë kërkesën për mocionin me debat dhe unë brenda tri ditësh do të mbledh Konferencën e Kryetarëve për të caktuar ditën dhe kohën e zhvillimit të mocionit në fjalë.

Vijojmë me rendin e ditës së sotme: interpelancë me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonjën Ogerta Manastirliu, kërkuar nga deputeti Bujar Leskaj. Interpelanca kërkohe bazuar në nenin 80 të Kushtetutës dhe në nenin 96 të Rregullores së Kuvendit, si dhe ka për objekt dhënien e informacioneve lidhur me mungesën e përcaktimit zyrtar të minimumit jetik.

Fillojmë duke respektuar minutazhin në dispozicion.

Zoti Leskaj, keni të drejtën për të parashtruar interpelancën deri në 7 minuta.

Keni bërë një kërkesë për të marrë 5 minuta nga 20-minutëshi i kohës tjetër.

Bujar Leskaj – Gabimisht.

Lindita Nikolla – Besoj edhe zonja Manastirliu është dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, 2 minuta dhe 15 minuta...

Bujar Leskaj – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në muajt nëntor-dhjetor të vitit 2022, kur ne diskutuam dhe miratuam projektbuxhetin për vitin 2023, unë paraqita një amendim i cili kishte të bënte me obligimin, detyrimin e qeverisë për të përcaktuar minimumin jetik zyrtar. Konkretisht, në ligjin e buxhetit për vitin 2023, te pjesa për sigurimet shoqërore, unë kërkoja që brenda

gjashtëmuorit të parë të vitit 2023 qeveria të përcaktojë minimumin jetik zyrtar, në bazë të studimeve dhe anketave të deritanishme të kryera nga Instituti i Statistikave.

Duke filluar nga korriku i vitit 2023, gjatë gjithë gjashtëmuorit të dytë dhe për buxhetet e viteve në vijim pagesa për personat me aftësi të kufizuara dhe për familjet në skemën e asistencës sociale të indeksohen, të plotësohen, deri në respektimin e minimumit jetik zyrtar. Fatkeqësisht, propozimi nuk gjeti mbështetje, edhe për efekt të kohës kur u kalua projektbuxheti e të tjera e të tjera dhe mendova, e kërkova që në dhjetor interpelancën, por zhvillimet në Kuvend në muajt janar, shkurt dhe mars, pavarësisht edhe dakordësisë së ministres, nuk e mundësuan që kjo interpelancë të zhvillohej më shpejt.

Për këtë arsye, mund t'ju duket me vonesë kërkesa që unë do të bëj, por nuk është asnjëherë vonë, madje mendoj që ne duhet ta vendosim në fokusin e vëmendjes sonë përcaktimin e minimumit jetik zyrtar dhe ta përcaktojmë atë brenda këtij sesioni, çka nënkupton brenda gjashtëmuorit ose brenda muajit korrik të vitit 2023.

Në teorinë moderne ekonomike, koncepti i minimumit jetik i referohet një sasi të ardhurash të nevojshme për të mundësuar mbijetesën, bazuar mbi një kosto reale jetese. Minimumi jetik është indikator social kryesor i cili përdoret për vlerësimin e varfërisë dhe cilësisë së jetës, si dhe për llogaritjen e pagave minimale, pensioneve minimale dhe pagesave sociale bazë.

Në përgjithësi, minimumi jetik në botë përcaktohet duke u mbështetur në nivelin e të ardhurave kombëtare, i cili garanton që konsumi të përfshijë kërkesat minimale të qenieve njerëzore, fizike dhe sociale. Në këtë mënyrë, minimumi jetik përdoret më pak si referencë në përcaktimin e pagës minimale, pensionit minimal dhe pagesave të tjera sociale.

Aktualisht, në vendin tonë mungojnë të dhënat zyrtare lidhur me treguesin e minimumit jetik. Shqipëria është i vetmi vend në Europë pa një tregues zyrtar të minimumit jetik të përcaktuar, që do të thotë se në vendin tonë mungon niveli bazë i matjes së varfërisë. Sipas raportit të fundit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 32% e popullsisë së Shqipërisë vuan nga pamjaftueshmëria ushqimore, ndërsa sipas

EUROSTAT-it, 74,4% e popullsisë së Shqipërisë, që është në moshë pune, rrezikon varfërinë.

Në Bashkimin Europian, në bazë të studimit të EUROSTAT-it rezulton se 1 ndër 5 persona ka premisa për të rënë në varfëri, ndërsa në Shqipëri ky raport është 1 në 2 persona që rrezikohen të bien në varfëri.

Sipas një studimi të Avokatit të Popullit (është studimi i dytë i vitit 2020), minimumi jetik në Shqipëri duhet të jetë në nivelin 18 mijë lekë të rinj në muaj.

Inflacioni i lartë i periudhës 2022-2023 kuptohet që ka nxjerrë të domosdoshme që kjo shifër të korrigjohet sërish me rritje të ndjeshme, nëse kjo gjë do të mundësohet nga ju si mazhorancë.

Ndër vendet e rajonit tonë, Mali i Zi shfaq vlerë më të lartë, të përkufizuar si minimum jetik, ndjekur nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut, ndërsa Shqipëria, siç e thashë, nuk e ka fare të përcaktuar. Kjo dëshmon qartë se lufta kundër varfërisë ndodhet prej kohësh në një udhë pa krye në Shqipëri.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, e matur në kontekstin e fuqisë blerëse të popullsisë, varfëria në Shqipëri është mbi nivelin 52%.

Minimumi jetik shërben si një udhëzues për politika efektive të qeverisë, pasi po i rendis për të dhënë rëndësinë e përcaktimit të minimumit jetik në një aspekt tjetër të politikave qeveritare.

Së pari, ai tregon dinamikën e ndryshimeve në standardin e jetesës së individëve.

Së dyti, ndihmon në përcaktimin e normës minimale të pensioneve, të ndihmës ekonomike, pagës së papunësisë, pagesës së paafësisë dhe numrit të përfituesve për secilën prej tyre.

Së treti, tregon mënyrat për të orientuar pagën minimale drejt nivelit të minimumit jetik për një të punësuar.

Minimumi jetik shërben për rishikimin e strategjive të rritjes ekonomike dhe për reduktimin e varfërisë. Minimumi jetik krahasohet me pagën minimale për një të punësuar dhe me madhësinë e pensioneve të ndihmave sociale, të pagesës së papunësisë e të tjera. Mungesa e përkufizimit të minimumit jetik zyrtar në legjislacionin për mbrojtjen sociale ndikon negativisht në hartimin e politikave të përshtatshme dhe të mjaftueshme për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të tyre.

Përcaktimi i strukturës së minimumit jetik për artikujt ushqimorë, veshmbathjet, pajisjet dhe orënditë shtëpiake e shpenzime të tjera, si dhe krahasimi i minimumit jetik për frymë me pagën minimale, pensionin minimal, ndihmën ekonomike, pagesën e papunësisë ndihmon në vendimmarrjen publike në nivel të mbrojtjes sociale të nevojshme dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave bazë jetike për qytetarët.

Nëse qeveria do të njihte një minimum jetik, atëherë ajo duhej të ndante shuma më të mëdha nga buxheti për të kompensuar varfërinë ose për të mbuluar programin e të ardhurave të garantuara, sikurse quhet kudo në botë. Politikat mbrojtëse duhej të ishin të tilla që çdo qytetar nën minimumin jetik zyrtar duhej të merrte një kompensim nga shteti, ashtu siç ndodh në vendet demokratike të botës, dhe kjo do të ishte vetëm nëse do të kishim të përcaktuar zyrtarisht minimumin jetik.

Neni 25 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut thotë: “Çdokush ka të drejtë për një nivel të mjaftueshëm jetese për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij”. Po kështu, kjo theksohet në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm 2030, konkretisht në objektivin 1 dhe 7 të tij, të cilët unë nuk po i lexoj për efekt kohe.

Bashkimi Europian ka bërë përpjekje të mëdha që shtetet anëtare të tij, por edhe ato candidate, sikurse është Shqipëria, me gjithë diferencat e tyre, të garantojnë një nivel të caktuar dinjiteti mes qytetarëve, duke e konsideruar arritjen e jetesës dinjitoze për çdo qytetar të botës si kusht të domosdoshëm apo *sine qua non* për qenien vend anëtar në BE. Sot BE-ja zbaton një agjendë të politikave sociale dhe ka në fokus të vazhdueshëm qëllimet e vendosura në kuadër të strategjisë për Europën 2030 dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm, ai i dytë dhe kryesori, është largimi i të paktën 20 milionë njerëzve nga rreziku i varfërisë dhe përjashtimi social.

Po ne në Shqipëri a kemi një numër të përcaktuar? Natyrisht që jo.

Në muajin tetor të vitit 2020 Këshilli i Bashkimit Europian e ftoi Komisionin Europian të fillojë përditësimin e kuadrit ligjor të BE-së, me qëllim mbështetjen efektive dhe plotësimin e mëtejshëm të këtyre politikave në varësi edhe të situatës së krijuar nga Covid-19.

Në këto vite është ushtruar në mënyrë sporadike presion pozitiv mbi qeverinë shqiptare.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Banka Botërore, FMN-ja, Kontrolli i Lartë i Shtetit, sindikatat, Avokati i Popullit dhe Kuvendi i Shqipërisë, si dhe organizatat e shoqërisë civile i kanë adresuar herë pas here sugjerime qeverisë për përcaktimin e treguesit zyrtar të minimumit jetik. Avokati i Popullit ka realizuar dy herë raporte për minimumin jetik në Shqipëri, një në vitin 2016 dhe një në vitin 2021, ka bërë edhe një përlllogaritje, që e thashë, rreth 18 mijë lekë (saktë fare është 17875 lekë). Gjithsesi, edhe kjo vlerë indikative është shumë herë më e ulët me atë çka është në realitet.

Në një raport auditimi performance që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zhvilluar në vitin 2018, ka theksuar që në Shqipëri nuk ka një vlerë të miratuar nga qeveria të minimumit jetik dhe kufirit të varfërisë mbi të cilin të bazohen politikat dhe studimet e përkujdesit social. Skema aktuale e ndihmës ekonomike nuk është efektive në zbutjen e varfërisë, referuar numrit të familjeve që dalin nga skema për shkak të punësimit dhe për mirësisht të kushteve socio-ekonomike të tyre.

Mbështetja e qeverisë me programin e ndihmës ekonomike do të ishte efektive nëse kontributi do të vlerësohej paralelisht me nivelin e përgjithshëm të çmimeve, me produktet e shportës së konsumit dhe me studimet dinamike për riintegrimin e individëve në shoqëri.

Mungesa e një përkufizimi të tillë, të përcaktuar me ligj dhe akte nënligjore, ka prekur thellësisht nivelin e jetesës së familjeve në ndihmë ekonomike, duke e ulur atë. Pikërisht minimumi jetik duhet të jetë baza për llogaritjen e shumë aspekteve, përfshirë ndihmën ekonomike. Mospasja e një shifre të përditësuar bën që vlera, që u kalon familjeve në nevojë, nuk është e saktë, madje shumë herë më e ulët sesa niveli i duhur.

Në fakt, skenarët dhe rekomandimet për llogaritjen e minimumit jetik nuk kanë munguar. Për hir të së vërtetës, ky ka qenë në Kodin e Punës të vitit 1995-1996, pastaj çuditërisht është fshirë detyrimi i qeverisë. Por përpjekja e parë për llogaritjen e minimumit jetik nisi në fillim të viteve 2000 nga Ministria e atëhershme e Punës, ama nisma u la në mes të rrugës për të vazhduar më vonë me ato dy studimet e Avokatit të Popullit dhe një studim i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike me titull “Llogaritja e minimumit

jetik në Shqipëri - nga minimumi jetik si mbijetesë drejt një standardi të arsyeshëm jetese”.

Edhe në vitin 2016 studimi, puna dhe përpjekjet e Avokatit të Popullit apo edhe rekomandimet e KLSH-së më përpara dhe më vonë, që janë publikuar, nuk e kanë tërhequr vëmendjen e qeverisë. Në programin qeverisës të mandatit të parë 2013-2016 qeveria e përcaktoi si objektiv llogaritjen, publikimin dhe kalendarizimin e plotësimit të minimumit jetik të Shqipërisë, por, çuditërisht, në programin e dytë dhe të tretë “Rama 2” dhe “Rama 3” qeveria nuk iu referua më minimumit jetik.

Pse qeveria e ndoqi këtë praktikë dhe pse jemi në këtë gjendje, kur sot që flasim, kur ne, ndoshta edhe deputetë të tjerë të Kuvendit, e kemi shtruar si pyetje, qytetarët shqiptarë më 9 dhjetor të vitit 2022, përmes 21 mijë nënshkrimeve, kërkuan nga KQZ-ja të niste procedurat për përcaktimin e minimumit jetik?

Ne duhet të ngrihemi në nivelin politik, në nivelin qytetar dhe të nisim menjëherë procedurat për hartimin e ligjit “Për përcaktimin e minimumit jetik”, sepse nga analiza e legjislacionit shqiptar në tërësi rezulton se minimumi jetik është një normë ligjore që buron nga të drejtat kushtetuese të qytetarëve shqiptarë.

(Bie gongu.)

Edhe pse koncepti i minimumit jetik është i parashikuar prej më tepër se dy dekadash si një normë kufizuese për mbrojtjen e burimit të të ardhurave, kryesisht të punëmarrësve, mungojnë aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë masën e minimumit jetik zyrtar.

Ndërdisiplinartet e raportit pagë minimale-minimum jetik, duhet të identifikohet dhe të studiohet sa më drejt nga qeveria dhe palët e tjera të interesuara, në mënyrë që të arrihet një ekuilibër legjitim, i cili maksimizon interesat jetikë të shoqërisë shqiptare në tërësi, duke e shmangur fokusin nga trajtimi i minimumit jetik apo pagës minimale si një barrë për ekonominë dhe për buxhetin e shtetit, për shkak se minimumi jetik më tepër sesa pengesë për zhvillimin ekonomik duhet parë si një faktor zhvillimi.

Qeveria e ka jo vetëm detyrë morale, por edhe juridike përpara qytetarëve të vendit, evidentimin e relacionit të pazgjdhshëm dhe simbiotik të minimumit jetik, në raport me pagën minimale të miratuar në rang vendi. Ky relacion do të nxirrte në pah aftësitë e shoqërisë për të

garantuar nëpërmjet ndërhyrjes rregullatore të shtetit, sikurse janë paga minimale dhe përcaktimi i minimumit jetik, mirëqenien e shtresave shoqërore që jetojnë në kufijtë e të ardhurave minimale.

Minimumi jetik, njësoj si paga minimale apo ndihma sociale, janë instrumente që mund të amortizojnë efektet negative të ekonomisë së tregut për shoqërinë në tërësi dhe për pjesën më të pambrojtur të saj në veçanti.

Lindita Nikolla – Ju lutem, përfundojeni, se i morët edhe minutat shtesë.

Bujar Leskaj – Po, edhe 20 sekonda.

Vakuumi normativ i përcaktimit të minimumit jetik duhet të përfundojë sa më parë, në mënyrë që të vendoset një standard normativ me efekte të drejtpërdrejta në politikat sociale dhe ekonomike, si dhe t’u afrohen garanci qytetarëve në lidhje me sigurimin e mjeteve të tyre të jetës. Përcaktimi i minimumin jetik zyrtar mundëson që buxheti i shtetit t’u sigurojë personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve në skemën e ndihmës sociale një jetesë dinjitoze dhe shërbimet bazike. Ai njëkohësisht do t’u mundësojë të gjitha shtetasve të marrin pjesë aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar.

Krahas realizmit të propozimit, është edhe nevoja për përcaktimin e një metodologjie të qartë për llogaritje e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Manastirliu, fjala për ju.

Koha në dispozicion deri në 20 minuta.

Ogerta Manastirliu – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

I nderuar kolegu Leskaj,

Dua t’ju falënderoj, pasi nëpërmjet pyetjeve tuaja dhe ngritjes së kësaj çështjeje më jepni mundësi që t’u drejtohem qytetarëve për t’u shpjeguar politikën mbështetëse dhe programet sociale të qeverisë shqiptare për familjet dhe individët më në nevojë. Në fakt, pak kohë më parë edhe kolegja Çupi ka ngritur disa pyetje për minimumin jetik, për përllogaritjen dhe se çfarë ka bërë qeveria shqiptare për të mbështetur edhe në kohë krizash familjet që kanë më shumë nevojë për të ndierë mbështetjen dhe dorën e shtetit.

Përcaktimi zyrtar i minimumit jetik është një term që merr përkufizime dhe aplikime të ndryshme në vende të ndryshme. Janë një sërë vendesh të Bashkimit Europian që nuk kanë një përcaktim zyrtar mbi minimumin jetik. Disa vende përdorin llogaritje reference të pagës minimale, disa të tjera kanë të përcaktuar programet dhe benefitet që vijnë nga mbrojtja sociale duke përfshirë asistencën sociale në *cash*, duke përfshirë programet e strehimit, duke përfshirë programet e papunësisë, duke përfshirë të gjitha ato programe që lehtësojnë individin në një moment të caktuar të jetës, kur ai ka më shumë nevojë për mbështetje. Në tërësi, edhe pse mund të ketë ngjashmëri midis vendeve për përcaktimin e standardit të minimumit jetik, nuk ka një uniformizim. Shumë vende të Bashkimit Europian kanë programe sociale që adresojnë varfërinë duke siguruar një standard bazë jetese për qytetarët edhe kur ata kanë një standard minimal të përcaktuar të jetesës apo minimumin jetik.

Për shembull, Mbretëria e Bashkuara ka programe sociale të mirëqenies duke filluar nga programet e papunësisë nga ana e punëkërkesve, Gjermani po ashtu, jo për referencë me Gjermaninë, por për të treguar nëse kanë apo jo uniformitetet vendet e BE-së. Franca ka një pagë minimale, por s'e ka të përcaktuar ligjërisht minimumin jetik, pasi ka një program asistence që quhet *Revenu de solidarité active*, i cili mbështet familjet me të ardhura të ulëta apo familjet pa të ardhura. Suedia ka, gjithashtu, një sistem social gjithëpërfshirës. Besoj se këto i dimë të gjithë, dhe unë nuk do të ndalem në këtë pikë. Sigurisht, nuk po kërkoj të bëj asnjë krahasim, por vetëm t'ju them se vende të ndryshme operojnë në mënyra të ndryshme për matjen e minimumit jetik apo për vendosjen e parimeve të solidaritetit dhe ushtrimin e programeve të solidaritetit në funksion të uljes së pabarazive dhe hendekut social.

Shqipëria e ka të përcaktuar pagën minimale në rang në vendi duke u siguruar që rritja e saj të vazhdojë dhe nga 1 prilli paga minimale bëhet 40 mijë lekë ose 352 euro, duke u ngjitur në mesataren e vendeve të rajonit pas Malit të Zi dhe Serbisë. Po kështu, jemi duke punuar për korrektimin e mëtejshëm të skemës së rritjes së pagave pas rritjes së pagës minimale, edhe si reagim për vështirësitë e paparashikuara të

krijuara kudo në botë nga kriza e luftës në Ukrainë.

Për një kontekst statistikor, meqenëse ju referuat statistikave, sepse besoj që është e rëndësishme edhe për qytetarët, për të kuptuar se si përcaktohen të gjitha këto indikatorë, dua të them se prej vitit 2017 është realizuar dhe po realizohet çdo vit anketa e matjes së të ardhurave dhe nivelit të jetesës, ndryshe si SILC në përputhje me përkufizimet e EUROSTAT-it. Ndryshe nga më parë ku statistikave ishin sporadike dhe jashtë çdo standardi, tashmë kemi vendosur një standard sipas metodologjive të EUROSTAT-it. Kështu, sipas të dhënëve të EU SILC-it të vitit 2020 të botuar nga INSTAT-i, rezultojnë se shpërndarja e përfutimit të ndihmës ekonomike (dhe po i referohem vetëm programit të ndihmës ekonomike, meqenëse si ministere e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale përgjigjem dhe kam përgjegjësi për t'u përgjigju për efektivitetin e shpenzimeve të pagesave që shkojnë direkt për mbulimin e atyre familjeve që kanë më shumë nevojë) mbulon 82,5% nga kuintili i parë dhe i dytë ose i dy grupeve të para të popullatës të vlerësuara që konsiderohen edhe më në vështirësi ekonomike.

Ndërkohë, sipas studimit të Bankës Botërore, skema e vjetër e ndihmës ekonomike, ajo që kemi pasur përpara reformimit të saj dhe pilotimit nga viti 2015 deri në vitin 2018, para reformës që u krye në vitin 2018, arrinte të mbulonte vetëm 22% të familjeve të varfra. Pra, sot kemi një targetim shumë të mirë të mbulimit të personave apo familjeve që kanë më shumë nevojë për të pasur benefite nga shteti nëpërmjet programit të ndihmës ekonomike. Patjetër ky target duhet përmirësuar, por sipas INSTAT-it dhe metodologjisë së unifikuar të EUROSTAT-it sot mbulojmë 82,5% të familjeve të varfra me ndihmë ekonomike, ndërkohë që mbulimi ka qenë vetëm 22%.

E them këtë, sepse një prej çështjeve më të rëndësishme është pikërisht efektiviteti i programeve për adresimin e çështjeve që lidhen me varfërinë dhe me pabarazinë. Ky është edhe fakti më domethënës për të kuptuar se si ka evoluar mbështetja dhe rritja e shënjestrimit të familjeve më në nevojë në programin e ndihmës ekonomike. Nëse i referohemi INSTAT-it të dhënat tregojnë se rreziku për të qenë i varfër në Shqipëri, pas transfertave sociale, është 22% nga

23,4% që ka qenë në vitin 2018. Pra, ka progres dhe të mos harrojmë që kanë qenë vite të vështira, vite kur ne jemi prekur nga fatkeqësia e tërmetit, nga pandemia dhe më tej edhe nga impakti i luftës në Ukrainë. Përtej rajonit, në Bashkimin Europian shtetet si Bullgaria e kanë këtë indeks 23,8% apo Rumania 23,4%, pra shfaqin nivele edhe më të larta të popullatës në risk për të qenë të varfër.

Ju përmendët një shifër, nuk e di nëse jam e saktë, por besoj se po, duke thënë se risku për të qenë të varfër tek ata që punojnë në Shqipëri është 70%. Në fakt, risku për të qenë të varfër nuk është 70% tek të gjithë ata që punojnë, por është te grupi i familjeve me intensitet të ulët punësimi. Nëse i referohemi kësaj shifre që ju thatë, Shqipëria këtë shifër e ka 69%, nga më të ulëtat në rajon, pasi Serbia e ka 71%, Maqedonia e Veriut 79%, Kroacia 77%, ndërsa Rumani e ka 84% dhe Bullgaria 80%.

Unë dua të kaloj direkt te mbështetja që shteti ofron për ata që kanë më shumë nevojë. Besoj se është shumë e rëndësishme të flasim me shifra dhe të tregojmë se si është rritur mbështetja sociale për kategoritë në nevojë.

Nëse në vitin 2013 kishim një mbështetje me 96 miliardë lekë, dhe këtu po fus vetëm katër programe të mbështetjes sociale: ndihmën ekonomike, pagesat për aftësinë e kufizuar, pensionin social dhe atë të pleqërisë, në vitin 2022 kjo mbështetje ka ardhur e rritur me 58% apo me 152 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2019, është 20% më shumë. A duhet më shumë? Pa dyshim që po, prandaj gjatë vitit 2022, dhe do të vijojmë ta bëjmë sërish, ne kemi indeksuar dy herë pensionet dhe mbështetja për pensionistët do të vijojë, ashtu sikurse ka lajmëruar edhe Kryeministri. Nëpërmjet rritjes së vazhdueshme të financimit të skemës së ndihmës ekonomike, mbështetja do të vazhdojë edhe për mbi 64 mijë familje dhe individë, të cilët përfitojnë nga ndihma ekonomike e rritur. Vetëm gjatë vitit 2022 kemi rritur me 20% masën e ndihmës ekonomike për gratë dhe familjet me më shumë se 3 fëmijë. Më tej kemi dyfishuar masën e ndihmës ekonomike për të moshuarit pa pension pleqërie dhe pension social, si dhe trefishuar masën e ndihmës ekonomike për fëmijët pa kujdes prindëror, për gratë e dhunuara dhe ato të trafikuar.

Fondi i ndihmës ekonomike për vitin 2023 është 7,2 miliardë lekë dhe do të vijojmë

mbështetjen e targetuar për ata që kanë më shumë nevojë, për ata që në një moment të jetës së tyre kanë nevojë të mbështeten nga programe sociale. Por të mos harrojmë që, kur u referohemi programeve sociale, nuk mund t'i referohemi vetëm mbështetjes së ndihmës ekonomike, por të gjitha programeve që ofrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat janë programet e mbrojtjes direkte të transfertave në *cash*; programet që mbështesin kategorinë e punëkërkuësve të papunë; programet për strehimin e atyre që kanë më shumë nevojë apo transfertat e pakushtëzuara që i shkojnë pushtetit lokal, me të cilat mbështesin familjet në nevojë. Në qoftë se bëjmë një kumulative të të gjitha mbështetjeve, mbështetja është shumë herë më e madhe se ajo që thoni ju, në raport vetëm me ndihmën ekonomike si një asistencë sociale që jepet në *cash*. Dhe të mos harrojmë që në fillim të vitit 2023, edhe për zbutjen e impaktit të pasojave të luftës në Ukrainë, ne kemi mbështetur një milion qytetarë nëpërmjet pakos së madhe, ku vetëm nga familjet me ndihmë ekonomike kanë përfituar 87 mijë familje dhe 6700 gra kryefamiljare. Të mos harrojmë që përveç pagesave në *cash*, po ashtu përfitimet në natyrë kanë një rol shumë të rëndësishëm. Kur flasim për matjen e minimumit jetik, kur flasim për të gjithë komponentët e rëndësishëm që u vijnë në ndihmë qytetarëve për të zbutur efektet e varfërisë apo të parashtrimin social, këtu duhet të përfshijmë edhe shërbimin shëndetësor, kujdesin shëndetësor. Këtu po përmend politikën e fundit (por, sigurisht, do të ndalem edhe më gjatë këtu), rimbursimin e fishave të matjes së diabetit për të moshuarit +65 vjeç, duke zvogëluar shpenzimet nga xhepi, duke u ardhur në ndihmë mbi 50 mijë të moshuarve. Dua të përmend rimbursimin e barnave, ku fondi i përcaktuar në vitin 2023 është 11,4 miliardë i rritur me 400 milionë lekë, i cili mbështet direkt ata që kanë më shumë nevojë, kryesisht pensionistët dhe ata që vuajnë nga sëmundjet kronike.

Po kështu, ka pasur lehtësi në shërbimet publike: përjashtim nga tarifa për fëmijët që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet; përjashtim nga tarifa dhe përfitimin e bursës për shkollimin universitar; përfitim të teksteve shkollore falas për arsimin e detyrueshëm; përfitim nga programet e strehimit social; lehtësim nga tarifa e legalizimit

të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të tjera.

Gjithashtu, janë rreth 8200 studentë, të cilët përfitojnë nga tarifat përjashtuese pikërisht se janë pjesë e familjeve në ndihmë ekonomike.

Kemi nisur një program të ri, ashtu sikurse e kemi premtuar, për nënat e papuna me më shumë se tre fëmijë, ku nga 1 janari, rreth 6200 nëna kanë përfituar (vetëm në këto dy muaj) mbulimin nga shteti të kontributeve shëndetësore dhe shoqërore, ku 45% e këtyre përfituesve janë nëna, të cilat janë pjesë e familjeve në ndihmë ekonomike. Po ashtu, programi i mbështetjes nëpërmjet bonusit të bebes, ka mbështetur që prej fillimit të tij më shumë se 103 000 fëmijë dhe mbështetja financiare e kësaj transferte që shkon në mënyrë universale te çdo familje që gëzohet me një fëmijë, është 2,8 miliardë lekë në vit.

Për sa u përket personave me aftësi të kufizuar, mbështetja sigurohet nëpërmjet transfertave në *cash* dhe ka pasur një qëndrueshmëri të indeksimit të kësaj pagese. Nuk po i referohet këtu se çfarë ka ndodhur më parë dhe se çfarë paguajmë edhe sot e kësaj dite nga vendimet e gjykatave për indeksimin që nuk është kryer nga viti 2005 e më pas, por po i referohem faktit që pagesa për personat me aftësi të kufizuar jo vetëm që indeksohet çdo vit, por vjet në vitin 2022 masa e indeksimit të kësaj pagese ka qenë 7,5% duke marrë vlerën më të lartë të korrikut në raport me inflacionin. Ndërkohë, nga 1 tetori është rritur me 30% mbështetja për shpenzimin e energjisë për personat me status të aftësisë së kufizuar.

Nuk do të ndalem këtu, sepse po ashtu kemi mbështetjen për pagesën e dyfishuar për ndjekjen e arsimit të mesëm dhe formimit profesional; pagesën e trefishuar për ndjekjen e arsimit të lartë për personat me aftësi të kufizuar; kompensimin shtesë të energjisë eklektike dhe të telefonisë; shtesë mbi pensionin për invalidët e punës; paketat higjieno-sanitare në masën 16 000 lekë në muaj për personat që kanë statusin e paraplegjikut dhe tetraplegjiku, si dhe përfitime të tjera si rimbursimi i medikamenteve, fishat e diabetit falas, sigurimin shëndetësor, bursat e studimit, trajtimet me përparësi dhe programin e strehimit.

Gjithashtu, po bëjmë një hap të rëndësishëm në lidhje me punësimin dhe hapësirat për punësim për personat me aftësi të kufizuar. Ministria e Financave e deklaroi edhe pak ditë më parë se

pritet të vijë një ligj, i cili do të përcaktojë që të gjitha ndërmarrjet e mëdha publike edhe ato private do të kenë detyrimin për të punësuar persona me aftësi të kufizuar. Nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë do të duhet të paguajnë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe pagën minimale në një fond social për këta persona. Kjo masë do të vijë me një ndryshim ligjor. Projektligji ka kaluar në qeveri dhe pritet të vijë për t'u diskutuar në komisione dhe më pas të miratohet në Kuvend. Sigurisht që ka ende shumë për të bërë, por ato që përmenda janë aspektet që i përkasin mbështetjes së individëve dhe familjeve më në nevojë, që qeveria shqiptare e bën çdo ditë për t'i mbështetur këto familje.

Për sa u përket llogarive, patjetër që kërkohet më shumë punë, e para në raport me metodologjinë, me unifikimin e metodologjive, me ardhjen në standardet europiane të përlllogaritjes dhe të të dhënave statistikore, në mënyrë që të kemi një qasje holistike, gjithëpërfshirëse edhe për sa u përket të gjitha buxheteve që shkojnë te familjet, të cilat duhet të kuantifikohen në raport me metodologji të përcaktuara, që më pas të na japin të dhëna edhe në cilësinë e vendosjes së minimumeve apo të standardeve të jetesës, si dhe për krijimin e bazave nga ku mund të përmirësohen politikat dhe të ridrejtohen programet.

Megjithatë, indikatorin kryesor që na thotë sot se mbështetja për personat që kanë më shumë nevojë është më e lartë, vjen pikërisht nga të dhënat e INSTAT-it me metodologjinë e EUROSTAT-it. Këto të dhëna thonë që efektiviteti i përdorimit të fondeve që u shkojnë familjeve në nevojë është rritur në masën 82,5% nga 22% që ka qenë më parë. Unë besoj se ky është matësi më i mirë që tregon se shënjestrimi në raport me ndihmën që duhet të shkojë tek ata që kanë më shumë nevojë, është shumë më i lartë. A ka vend për përmirësim? A duhet bërë më shumë? A duhet të jetë më e lartë? Patjetër që po. Ndaj ne kemi filluar me një plan që shkon horizontalisht në të gjithë sektorët, në të gjitha drejtimet, duke filluar nga rritja e pagës minimale. Po ashtu, sikurse Kryeministri është zotuar, paga minimale do të vijojë të rritet deri në vitin 2025 në masën 45 000 lekë. Nga 1 prilli do të kemi pagën minimale të rritur dhe tashmë jemi duke bërë konsultime edhe me sipërmarrësit për lehtësira në raport me siguracionet shoqërore-shëndetësore që

mund të marrë shteti për një afat të përcaktuar, në mënyrë që të mos ndihet shumë barra, në mënyrë që qytetarët të kenë më shumë para për të shpenzuar. Ndërkohë, të dhënat indikative të matjes së nivelit të të ardhurave dhe nivelit të jetesës kanë një përmirësim të dukshëm në referencë me vitet e kaluara. Jam e bindur që të gjitha këto përpjekje, të gjitha këto programe, rritja e buxhetit në një masë dhe një përqindje të lartë, krahasuar me vitet e mëparshme, targetimi tek ata që kanë më shumë nevojë, të gjitha politikat sociale dhe vëmendja që qeveria ka për kategoritë më në nevojë, pa dyshim që përkthehet në një mbështetje më të madhe. Kështu, pra, ata që kanë më shumë nevojë, kanë më shumë përfitime nga programet sociale që shkojnë në mbrojtjen e tyre. Por, sigurisht, e thashë edhe më parë, ka ende shumë për të bërë. Përlllogaritja e minimumit jetik është llogari. Interesi ynë më i madh është që këto përfitime të shkojnë tek ata që kanë më shumë nevojë. Unë besoj se ky është thelbi i diskutimit. A i kemi programet efektive për të ndihmuar në kohën e duhur ata që kanë më shumë nevojë? Për këto jemi duke punuar dhe duke u përpjekur çdo ditë. Ndërkohë, mbështetjen për ata që kanë më shumë nevojë, e kemi treguar dhe do ta tregojmë gjithmonë, e kemi treguar në kohë krizash, e kemi treguar në kohë pandemie, në kohë tërmeti, në kohën e krizës dhe të luftës në Ukrainë, në mbështetjen për energjinë elektrike, si dhe për të gjitha elementet e tjera, që të mos rëndohen xhepat e atyre që janë më në nevojë. Ne do të vijojmë të tregojmë mbështetje duke filluar me ata që janë të punësuar, deri tek ata që kanë vështirësi, të cilët duhet t'ia dalin falë solidaritetit dhe falë programeve të mbështetjes dhe përfshirjes sociale.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Leskaj, keni dhe 15 minuta në dispozicion.

Bujar Leskaj – Në fakt, sot është edhe ditë e shënuar, sepse besimtarët myslimanë fillojnë muajin e madhërisëm të Ramazanit dhe duhet të jemi të kujdesshëm në të folur. Po të jem i sinqertë, zonja Ministre, ju paraqitët, folët, diskutuat për një gamë të sukseseve tuaja, por nuk iu përgjigjët asaj që kërkoja unë. Interpelancat prandaj kanë temë. Unë ju kërkoj, si përfaqësuese e qeverisë, përse qeveria shqiptare nuk e përcakton minimumin jetik? Në diskutimin tim modest, unë dhashë disa konsiderata teorike, disa

të dhëna që qëndrojnë nga EUROSTAT-i dhe nga INSTAT-i. Fola për minimumin jetik, për arsyen pse ai duhet përcaktuar, për politikën, për sinergjinë që duhet të kemi midis minimumit jetik, pagës minimale dhe të tjera, kurse ju vazhduat folët për politika dhe për punën tuaj në ministri. Punën tuaj si ministre e vlerëson Kryeministri, por vlerësuesi më i madh dhe mësuesi më i madh është populli. Do të më lejoni që edhe për ju të them një përcaktim që më erdhi në mendje, gjithmonë duke u kufizuar në vijat e bardha të kësaj seanca dhe të kësaj dite, që e thoshte i madhi Pjetër Arbënor, Mandela i Shqipërisë 20 vjet përpara: “Ju nuk jeni socialistë, ju jeni specialistë”. Por ju nuk jeni specialistë të punës, por jeni specialistë të fasadës, të fjalëve. Ju mund të argumentoni dhe të deklaroni me përgjegjësi që qeveria juaj është për përcaktimin e minimumit jetik, kësaj të drejte kushtetuese të qytetarëve shqiptarë apo jo. Qeveria kërkon që përmes ndihmave ta kompensojë në forma të tjera këtë gjë, por nuk kompensohet, sepse minimumi jetik është baza, është numri një, pastaj vijnë dyshi, treshi, katra dhe kështu me radhë. Megjithatë, është puna juaj, që keni zgjedhur këtë lloj prezantimi.

Në fakt, unë jam i shqetësuar, kam qenë më përpara dhe do të jem, sepse ne jemi vendi i vetëm në Europë që nuk e ka në legjislacion përcaktimin e minimumit jetik zyrtar si një masë të domosdoshme dhe efektive që ndihmon shtetin dhe vendimmarrësit publikë kryesorë të tij për të planifikuar dhe për zbatuar më drejt dhe më duhur politikën sociale në mbështetje të shtresave më vulnerabël të popullsisë. Në rast se ju do të luftoni, do të jeni një luftëtare për të përcaktuar këtë minimum, edhe vetë, në pozicionin si ministre e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, do të ndiheni shumë më mirë, do të ndieni shumë më e përmbushur në realizmin e misionit tuaj. Ju si maxhorancë i kishit gjasat ta miratonit minimumin jetik zyrtar në vitin 2016, kur me nismën e Avokatit të Popullit, të institucioneve të tjera, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, prezantoi studimin me titull “Llogaritja e minimumit jetik në Shqipëri, nga minimumi jetik si mbijetesë, drejt një standardi të arsyeshëm jetese”. Këtu është i gjithë thelbi i problemit, megjithatë ju nuk e bëtë. Pse nuk e përcaktuat atëherë me ligj minimumin jetik zyrtar, meqenëse kishte studime nga aktorë dhe faktorë të ndryshëm

në vend? Pse nuk e përfshitë ISNTAT-in në kërkimin shkencor modern për varfërinë e shqiptarëve, por e detyruat (dhe kur them ju, e kam fjalën për qeverinë, jo për ju personalisht) të numëronte televizorët dhe lavatriçet në shtëpinë e të varfërve për t'i deklaruar të padenjë për ndihmën shtetërore? Lavatriçja dhe televizori janë brenda standardit të arsyeshëm për jetesë dinjitoze dhe jo tregues të mungesës së varfërisë.

Për mendimin tim, po flas si deputet i Partisë Demokratike, ju si qeveri e refuzuat llogaritjen zyrtare të minimumit jetik, ndryshe nga sa vepron çdo qeveri dhe shtet i përgjegjshëm edhe në mandatin tuaj të parë, edhe në të dytin, edhe në të tretin, sepse kishit nisur të ëndërronit që në vitin 2016 për investimet me 1 miliard euro të PPP-ve, të cilat i shumëfishuat në periudhën e artë 2017-2019, kur futët duart në xhepat e shqiptarëve. Për 13 vjet përmes taksave që jeni detyruar të rritni, buxheti i shtetit duhet të përballojë pagesat ndaj kontratave me partneritet publik privat, të cilat pas vitit 2017 po i tejkalojnë rregullisht 100 milionë eurot. Kjo është Thembra e Akilit, faktori kryesor që ju pengon të loboni, të punoni fort dhe të deklaroheni qeveri e një partie të majtë. Për mendimin tim, ju nuk jeni qeveria e një partie të majtë, por jeni qeveria e një sektori. Kjo është arsyeja pse nuk ju mjaftojnë paratë për detyrimet financiare që lindin nga skemat e duhura të kompensimit të varfërisë, që imponon përcaktimin zyrtarisht dhe me ligj të minimumit jetik. Ju duhet dhe e keni të domosdoshme të bëni përcaktimin e minimum jetik, që të angazhoheni më tej në programin social të të ardhurave të garantuara për qytetarin, sikurse quhet dhe zbatohet gjerësisht në botën e qytetëruar dhe humane.

Ju e dini shumë mirë se përcaktimi i minimumit jetik zyrtar ndihmon zbutjen efektive të varfërisë në Shqipëri, e cila është detyrë humane dhe kushtetuese. Ky tregues është lakmuesi që ndan vendimmarrësin publik të përgjegjshëm dhe humanist nga vendimmarrësi që politikë të tij kryesor ka fasadën dhe thjesht i shërben asaj demagogjie që ju e keni ngritur në sistem si qeveri.

Po, e dhëna e INSTAT-it që dhashë unë, është e vërtetë, 74% e popullsisë në Shqipëri rrezikon varfërinë, ndërsa në vendet e BE-së 1 në çdo 5 persona rrezikohet nga varfëria, në Shqipëri pothuajse 1 në 2 persona kërcënohet nga varfëria

dhe përjashtimi social. Është raporti 21,7% me 43%. Ky indikator, ashtu si indikator i 74%-shit korrespondon me numrin e përgjithshëm të personave në rrezik varfërie, të personave që përballen me privim të rëndë shoqëror dhe material, e shprehur nga aftësia e tyre për të përballuar artikuj apo aktivitete të caktuara shoqërore, si dhe persona që jetojnë në një familje me intensitet shumë të ulët pune. Të dhënat e EUROSTAT-it japin edhe përqindjen e fëmijëve që rrezikojnë nga varfëria dhe varfëria e fëmijëve shqiptarë është më thellë. Sipas EUROSTAT-it 51,8% e fëmijëve nën 6 vjeç, 47,8% e fëmijëve ndërmjet 6 dhe 11 vjeç dhe 53 % e fëmijëve të moshës 12 deri në 17 vjeç jetojnë në rrezik varfërie dhe përjashtimi social. Këto dhe shumë të dhëna të tjera flasin vetë.

Të mos bazosh të dhënat e mirëqenies së shtetasve të tu në metodat e studimit të minimumit jetik, sado që ju përpiqeni ta mbuloni, edhe sot dhe e deklaruar shumë bukur, do të thotë të notosh në një det hipokrizie dhe pseudo-politikash sociale. Edhe ndonjë politikë të mirë sociale që ju po zhvillon, po e komprometoni për faktin se nuk keni bazën, nuk keni të përcaktuar minimumin jetik zyrtar. Po komprometoni politikën, zbatimin e saj, por edhe idetë tuaja si ministre.

Duke u përcaktuar në mënyrë rigorozë, shkencore, minimumi jetik zyrtar do të mund të përdoret në themel të hartimit të politikave sociale për shtetas në nevojë. Ai po ashtu, do të përdoret me shumë efektivitet dhe me argumentime të plota shkencore, si referencë për të përcaktuar pensionin minimal urban dhe rural, pagën minimale, ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë. Në favor të minimumit jetik, si një referencë në luftën kundër varfërisë dhe ndërtimin e sistemit të mirëqenies, është edhe modeli i aplikimit të së ardhurës bazë universale. Aplikimi i tij, edhe pse tingëllon si një politikë apo program rishpërndarës, në fakt, është neutral.

Do të citoj këtu disa thënie në lidhje me minimumin jetik, të cilat jam i bindur që ju i dini shumë mirë, por t'i keni parasysh për politikën tuaj në të ardhmen. Unë ju kërkoi të loboni, të reflektoni, të punoni fort për përcaktimin e minimumit jetik në Shqipëri. Sado të llobojmë ne deputetët e opozitës, unë ju bëj thirrje edhe deputetëve të maxhorancës të llobojmë, të ndihmojmë ministren, që edhe në ministri ta kërkoni me forcë përcaktimin e minimumit jetik.

Nobelisti dhe filozofi Bertrand Russell, i njohur për idetë e tij të majta, që para një shekulli ka nënvizuar: “Një e ardhur minimale duhet garantuar për të gjithë qytetarët, pavarësisht nëse punojnë ose jo”. Ndërsa Friedrich Hayek, ekonomisti i njohur botërisht për idetë e tij liberale, ka nënvizuar: “Vendosja e një dysHEMEJE të ardhurash të garantuara, poshtë së cilës nuk duhet të bjerë askush, është një mbrojtje legjitime për qytetarët me të ardhura të pamjaftueshme”. Ky program mund të zbatohet në Shqipëri, zonja Ministre, përderisa ka gjetur zbatim në shumicën e vendeve.

Ky program dhe politikat mbrojtëse tek ne duhet të jenë të tilla që çdo qytetar nën minimumin jetik zyrtar dhe të përditësuar të marrë një kompensim nga shteti. Ne kemi një problem thelbësor, pasi 2/3 e njerëzve janë të punësuar në sektorë si bujqësia, ndërtimi, industrinë e përpunimit dhe shërbimet, ku pjesa dërrmuese e tyre i kanë pagat shumë pranë pagës minimale, pavarësisht ngritjes që ju po i bëni (po kjo kërkon diskutim tjetër), gjë që dëshmon se varfëria tek ne është një dukuri masive dhe po zgjerohet. Zonja Ministre, Shqipëria nuk është vetëm këtu tek ne, në sallën e Kuvendit, nuk është vetëm te rrethi ynë shoqëror, është më e gjerë dhe varfëria po zgjerohet në Shqipëri.

Të mos harrojmë se kemi mbi 260 mijë të punësuar pranë pagës minimale. Unë gjykoj se në kushtet e sotme, është shumë e nevojshme dhe e shëndetshme që ne të vazhdojmë ta thellojmë këtë debat për njohjen e minimumit jetik nga qeveria. Vetëm duke njohur zyrtarisht minimumin jetik, mund të arrijmë t'i fokusojmë politikat sociale te shtresat në nevojë. Vetëm duke u përcaktuar minimumi jetik edhe politikat tuaja si ministre do të jenë lehtësisht të matshme dhe të vlerësueshme nga qytetarët shqiptarë.

INSTAT-i duhet të nisë ta llogarisë varfërinë jo me praninë e televizorit apo frigoriferit në banesë, por me matjen e fuqisë prodhuese të punës, pra produktivitetit, duke nxitur daljen nga rrethi i varfërisë, përmes shkollimit dhe kualifikimeve profesionale. Tek ne programi i arsimit dhe i kualifikimit profesional ka dështuar krejtësisht, kështu që e kemi të domosdoshme një rikonceptim dhe një reformë tërësore në këtë drejtim, por ama nën një qeverisje të përgjegjshme, e cila duhet të ketë në qendër të vëmendjes vetëm familjet dhe qytetarin shqiptar.

Programi i zbatimit të minimumit jetik presupozon tri faza: llogaritjen, publikimin dhe

zbatimin. Është e qartë se llogaritja dhe publikimi i minimumit jetik janë detyra të realizueshme që në këto momente që po flasim. Në kushtet e Shqipërisë, plotësimi i minimumit jetik është një detyrim kushtetues i sistemit të mirëqenies, i cili mund të realizohet në proces dhe në mënyrë graduale, duke llogaritur mirë burimet financiare të vendit. Pra, për këtë mund të diskutonim, për burimet financiare të vendit, për riskun e tyre, por unë mendoj se ne nuk e zgjidhim apo kemi efektivitet në këtë interpelancë, ju si ministre, në radhë të parë, por edhe unë si deputet, në rast se ju kaloni në propagandë për arritjet tuaja.

Gjatë fjalë suaj ju thatë se përllogaritja e minimumit jetik është llogari. Çfarë kuptimi ka kjo fjali? Ju duhet të mbani një qëndrim politik. Qëndrimi politik është duke thënë: “Po, ne nuk kemi pasur mundësi, kemi devijuar”. Unë e theksova, përderisa ju e keni pasur në programin qeverisës të periudhës 2013-2017 dhe e keni devijuar në dy programet e tjera qeverisës, shumë mirë mund të shpreheshit duke thënë: “Do ta shikojmë, do të reflektojmë, do ta studiojmë”. Natyrisht, ju nuk vareni nga interpelancat e deputetëve të pozitës apo të opozitës, keni politikat tuaja, por këto politika mund t'i plotësoni. Këto politika ju si ministre duhet t'i shkoni në sinkron me të gjitha, edhe me objektivat e mijëvjeçarit.

Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm janë 17 dhe e para është eliminimi i varfërisë kudo dhe në të gjitha format e saj. Të tjerat janë: eliminimi i urisë; përmirësimi i ushqyerjes përmes sigurisë ushqimore dhe promovimit të një bujqësie të qëndrueshme; sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë dhe në të gjitha moshat; sigurimi i ujit dhe i higjienës bazë për të gjithë nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të ujit; pakësimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe midis vendeve dhe të tjera që të mos vazhdoj t'i lexoj.

Në misionin për zhdukjen e varfërisë dhe sigurimin e qytetarëve të një jetë dinjitoze, objektivi numër 1 “Eliminimi i varfërisë kudo dhe në të gjitha format e saj”, objektivi numër 3 “Sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë dhe në të gjitha moshat” dhe objektivi numër 8 “Promovimi i një rritje ekonomike të vazhduar, gjithëpërfshirëse të qëndrueshme, si dhe punësim të plotë e produktiv, punë dinjitoze për të gjithë” po i orientojnë dhe po i stimulojnë veprimet e qeverive të zhvilluara dhe në zhvillim kudo sot në botë, jo vetëm përmes mekanizmit të minimumi jetik zyrtar, të cilin e kanë dhe e përditësojnë shumica e dërrmuese e

shteteve të botës, por mbi bazën e tij, përmes programeve të së ardhurës universale të qëndrueshme dhe programeve të garantimit të të ardhurave për një jetë dinjitoze për të gjithë qytetarët është përgjegjësi e qeverisjes sonë që objektivat e Agjendës 2030 të OKB-së t'i përdorë si plan pune dhe t'i përditësojë.

Më besoni, zonja Ministre, nuk kam asnjë qëllim politik apo deklarativ. Unë ju sugjeroj që edhe atë pjesë të suksesshme të punës suaj ta vazhdoni duke e rifilluar nga njëshi, nga baza, nga përpjekja, nga lufta juaj për përcaktimin e minimumit jetik zyrtar. Në rast se ne në Kuvend nuk do t'i bëjmë këto përpjekje, është puna dhe lufta e qytetarëve shqiptarë që do të na detyrojë, në mos sot më vonë, që të përcaktojmë minimumin jetik zyrtar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – E nderuar zonja Ministre, keni edhe tri minuta kohë për t'u shprehur!

Ogerta Manastirliu – Shumë faleminderit, zoti Leskaj!

Në fakt, mendoja se interpelanca juaj do të ishte diçka më shumë xhenuine në raport me atë që shprehët si një nevojë imediate për llogaritjen e minimumit jetik, por ju e cilësuat atë që unë thashë si propagandë apo fasadë, ndërkohë që, për të thënë të vërtetën, unë nuk fola duke u lënduar për sukseset, por fola me fakte duke iu referuar gjërave që kemi bërë ndër vite.

Jua thashë në parantezë që ka nevojë për të bërë ende më shumë. Gjithashtu, iu referova faktit që kemi rritur pagën minimale, dhe nga këtu fillon llogaritja e minimumit jetik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk dua t'ju mbaj leksione, aq më tepër juve që jeni pedagog i ekonomisë, por, për të thënë të vërtetën, ka disa metodologji për të matur minimumin jetik: një matje absolute dhe një matje relative. Matjen relative të minimumit jetik e bëjnë vendet më të zhvilluara, kurse matja absolute lidhet me llogaritjen e të ardhurave minimale.

Gjithsesi, meqenëse edhe koha nuk premtion shumë, se janë vetëm 3 minuta, dua të përsëris edhe një herë atë që ne kemi bërë. Ne kemi rritur vazhdimisht pagën minimale dhe duke filluar nga data 1 prill do ta rritim në 40 mijë lekë (352 euro do të jetë paga minimale në Shqipëri), duke na vendosur në mesataren e vendeve të rajonit. Do të vijojmë t'i indeksojmë pagesat e aftësisë së

kufizuar, ashtu sikurse i kemi indeksuar çdo vit. Gjatë parashtrimit të interpelancës ju thatë se duhet të vijojmë të indeksojmë pagesat e aftësisë së kufizuar, por, në fakt, ne e kemi bërë dhe do të vijojmë ta bëjmë këtë gjë.

Ne kemi rritur masën e ndihmës ekonomike dhe për shkak të konsolidimit të skemës kemi të dhëna reale mbi efektivitetin e saj. Efektiviteti i skemës së ndihmës ekonomike për përfitimet që marrin ata që kanë më shumë nevojë, duke hequr njëherë e përgjithmonë ata të cilët përfitonin në mënyrë abuzive, sot është 82,5%.

Gjithashtu, do të vijojmë të mbështesim pensionistët. Gjatë vitit 2022 i indeksuam dy herë pensionet, duke bërë detyrën tonë për të mbështetur ata që kanë kontribuar më shumë për vendin. Nevoja ishte dhe vijon të mbetet e madhe edhe për shkak të pasojave që solli lufta në Ukrainë, ndaj ne do të vijojmë t'i mbështesim pensionistët. Ashtu sikurse Kryeministri e ka deklaruar, në prill do të mblidhet "*Wind and solar task*" dhe më pas do të vlerësohet edhe mbështetja e vijueshme për pensionistët. Sigurisht, jam dakord në parim me ju që ka nevojë për të përmirësuar për llogaritjen, për të përmirësuar të gjitha metodologjitë, si dhe, përpara se të llogarisim minimumin jetik, duhet të kemi metodologji të unifikuara nga Bashkimi Europian, EUROSTAT-i për të gjithë ata indikatorë, për të cilët jemi duke punuar.

Të mos harrojmë që matja e nivelit të të ardhurave është bërë për herë të parë në vitin 2017. Pra, kemi një konsolidim dhe nxjerrje periodike të këtyre të dhënave.

Sigurisht, edhe në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian (në klasterin 1 janë edhe statistikat e parashikuara si një prej nënkapitujve që ne jemi duke diskutuar), nevoja për të unifikuar metodologjitë, për t'u përgatitur, si dhe për të vlerësuar dhe për të analizuar statistikat do të na çojë edhe në llogaritjen shumë më të mirë të përfitimeve dhe të nevojës për rishikim të politikave. Ndërkohë, ne jemi duke e bërë gjatë gjithë kohës këtë gjë, edhe duke u përshtatur rrethanave kushteve dhe paparishikueshmërisë që kanë sjellë këto vite, por, nga ana tjetër, edhe duke garantuar që qytetarët të mbështeten sa më shumë nga programet e mbrojtjes sociale, të cilat ne i kemi fuqizuar vit pas viti.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Leskaj, kemi edhe ju 3 minuta kohë në dispozicion.

Bujar Leskaj – Në fakt, nuk dua të përsërit veten, por do t'ju sugjeroja, zonja Ministre, të vendosni pikë të parë në planin tuaj të punës bërjen të mundur të përcaktimit të minimumit jetik zyrtar.

Nuk e di sa vite keni në detyrë si ministre, por, më besoni, në rast se do të arrini të përcaktoni minimumit jetik zyrtar, edhe kur qeveria dhe sektori juaj të ikin nga pushteti, ju do të mbaheni mend për mirë, sepse arritët të përmbushnit një iniciativë që duhej të ishte përmbushur në 30 vjet.

Ju duhet të punoni fort për ta vendosur në bazën e politikave dhe të punës suaj këtë çështje, pastaj e miraton apo nuk e miraton qeveria, është atribut i qeverisë, nuk është juaji. Pra, ju duhet të punoni me drejtoritë dhe me specialistët e shumë që keni në varësi. Kjo interpelancë nuk kishte asnjë qëllim tjetër, ndaj dhe ne kemi pritur tre muaj, sa Kuvendi të qetësohej, për ta zhvilluar.

Unë ju falënderoj për përgjigjet! Është e drejta juaj të përgjigjeni si doni në interpelancë, por, në rast se qeveria shqiptare, kjo që është dhe ato që do të vijnë, nuk përcaktojnë në politikën e tyre sociale minimumin jetik zyrtar, nuk do të kenë gjë në vijë dhe gjithmonë do të detyrohen të bëjnë politika për fasadë. Politika fasadë, për të cilën unë fola, nuk ishte vetëm për ju, por ishte edhe për shumicën e qeverive apo ministrave që kanë qenë në atë post, sepse për mendimin tim dhe këtë e them si qytetar, edhe sikur 1 vit të kenë qëndruar në postin e ministrit për Çështjet Sociale, nuk do të ngelen të suksesshëm në punën e tyre për shkak se nuk kanë përcaktuar minimumin jetik zyrtar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Vijojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: interpelancë me ministren e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, zonjën Ogerta Manastirliu, kërkuar nga deputeti...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, zonja Dhurata.

Dhurata Çupi (Tyli) – Duke shfrytëzuar mundësinë që ministrja e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale është e pranishme, përpara se ajo të jetë aktive në interpelancën e dytë, do të doja ta pyesja nëse e ka përpara dosjen e asaj që ka ndodhur dje me pronat e një medie të lirë. Në gjykimin tim si juriste dhe nënkryetare e

Komisionit të Ligjeve, është një veprim i paligjshëm, jokushtetues, që cenon të drejtën e pronës, të lirisë së medias dhe të drejtat e njeriut. Do të doja që ministrja të na thotë se mbi cilën bazë ligjore ka vendosur ditën e djeshme, që ishte edhe ditë feste, sekuestrimin e pronës së një media të lirë ditën.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Vijojmë me interpelancën e kërkuar nga deputeti Zef Hila për shqetësimet e banorëve të zonës së Vaut të Dejës në lidhje me menaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike.

Zoti Hila, keni të drejtën e fjalës për të parashtruar interpelancën, shtatë minuta në dispozicion.

Zef Hila – Faleminderit, Kryetare!

Të dashur qytetarë të Bashkisë së Vaut të Dejës,

Të dashur banorë të njësive administrative Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Shllak dhe Temal,

Në datën 10 shtator të vitit 2021 unë jam betuar si deputet. Nga ajo ditë e deri sot jam përpjekur t'i qëndroj besnik betimit në këtë sallë, duke respektuar dhe duke mbrojtur vetëm të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët i përfaqësoj në Kuvendin e Shqipërisë. E kam kryer këtë detyrë me përkushtim, ashtu siç i kam shërbyer kësaj zone edhe kur kam drejtuar pushtetin vendor. Jam shmangur nga çdolloj debati politik i panevojshëm, nga çdo sherrnajë e stisur, nga fyerjet dhe ofendimet e kolegëve, pasi kam menduar dhe vazhdoj të mendoj se ato nuk ishin detyrat që më kishin ngarkuar bashkëqytetarët e Vaut të Dejës.

Ndihma ekonomike që jepet nga qeveria për ata banorë të varfër dhe me një mijë halle të Bashkisë së Vaut të Dejës është e pamjaftueshme, ndaj unë e kam kërkuar këtë interpelancë për t'i qëndruar besnik dhe korrekt betimit tim ndaj tyre. Paratë e taksapaguesve alokohen për t'u ardhur në ndihmë familjeve në pamundësi ekonomike për të përballuar nevojat bazë të jetesës, por, fatkeqësisht, masa e saj, megjithëse çmimet janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, ka ngelur shumë e ulët dhe është e pamjaftueshme për t'i plotësuar këto nevoja.

Me ndihmën ekonomike që marrin sot qytetarët e Bashkisë së Vaut të Dejës e kanë të pamundur të përballojnë faturën e dritave, faturën e ujit, shpenzimet për shportën bazë të ushqimeve,

librat dhe veshmbathjet e fëmijëve të tyre, ilaçet e të moshuarve, si dhe shumë kërkesa të tjera të domosdoshme. Është e vështirë të thuhet si ia dalin të mbijetojnë këto familje në këto ditë kaq të vështira dhe të kushtueshme, ndërkohë që të ardhurat e tyre janë më të ulëta në raport me nevojat që ata kanë. Përveç kujdesit që tregon Zoti ndaj krijesave të tij, nuk di t'i jap përgjigje tjetër kësaj situatë.

Të nderuar kolegë,

Qeveria dhe pushteti lokal i kanë braktisur familjet në nevojë. Sikur të mos mjaftonte niveli i ulët i ndihmës ekonomike, abuzimet dhe shkeljet me të janë në nivele alarmante, zonja Ministre, qoftë për sa i përket skemës që administrohet nga Shërbimi Social Shtetëror, qoftë për sa i përket fondit 6% që administrohet nga pushteti lokal. Konkretisht, ndihma ekonomike është shndërruar në një mjet shpërblimi për mbështetësit e Partisë Socialiste në zonë, duke i përfshirë padrejtësisht në këtë skemë dhe në një mjet presioni dhe ndëshkimi për familjet në nevojë, të cilat, pavarësisht se plotësojnë të gjitha kushtet ligjore, përjashtohen nga skema e mbështetjes sociale.

Kaq e pamëshirshme është kjo qeveri dhe kaq e pashpirt është Bashkia e Vaut të Dejës, sa edhe familjet e varfra kërkojnë t'i ndajnë në të majtë dhe të djathtë, ku të parët duhen shpërblyer, me të drejtë ose jo, kurse të dytët duhen ndëshkuar thjesht dhe vetëm se zgjedhin të votojnë të lirë, një e drejtë bazike në një shtet me shoqëri demokratike.

Në vend që të përfitojnë familje me vështirësi ekonomike, me kryefamiljarë të papunë, nënat e vetme, familje me fëmijë të vegjël, me anëtarë të familjes të sëmurë apo prindër të moshuar, përfitojnë persona dhe familje që nuk jetojnë prej muajsh në Shqipëri, zonja Ministre; familje që nuk kanë aplikuar asnjëherë të vetme në skemën e ndihmës ekonomike, në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 597/2019 të Këshillit të Ministrave; familje, pjesëtarët e së cilës janë mbi moshën 18 vjeç dhe ndodhen jashtë shtetit prej muajsh të tërë; familje të punonjësve të administratës apo edhe të këshilltarëve bashkiakë; pjesëtarë të familjes së kryetarëve të fshatrave, zonja Ministre.

E kuptoni çfarë ndodh?

Të nderuar kolegë,

Këta abuzojnë edhe me lëmshën e varfërisë, veçanërisht në këtë periudhë ky

aktivitet antinjerëzor bëhet, me qëllim që ndihma ekonomike të përdoret për blerjen e votave.

Secili prej nesh në këtë sallë, por në veçanti qytetarët që po na ndjekin, mund të pyesë me të drejtë kush e ka për detyrë të ushtrojë kontrolle periodike në mënyrë që të mos ndodhin shkelje kaq të rënda. Aktet ligjore dhe nënligjore ngarkojnë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë të ushtrojnë kontrolle të rregullta, me qëllim parandalimin dhe ndëshkimin e çdo lloji abuzimi në kurriz të qytetarëve.

Unë kam ftuar sot ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në këtë interpelancë që t'u japë përgjigje pyetjeve të qytetarëve dhe familjeve në nevojë në Bashkinë e Vaut të Dejës, sepse ajo dhe institucionet në varësi të saj nuk kanë reaguar për t'i dhënë fund veprimtarisë korruptive të pandalshme në Bashkinë e Vaut të Dejës. Të gjitha këto janë lehtësisht të verifikueshme, mjafton të jetë dëshira dhe vullneti juaj, zonja Ministre.

Institucionet në varësinë tuaj e kanë detyrë ligjore të ushtrojnë kontrolle të paktën dy herë në vit pranë pushtetit vendor, por çfarë bëhet dhe çfarë shkruhet e dinë vetëm letrat tuaja. Kjo nuk është hera e parë që unë bëj një interpelancë me ju, por e vërteta është kjo dhe vetëm kjo.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Ministre, fjala për ju, 20 minuta.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit, e nderuar Kryetarë!

Përpara se të fillojë koha për interpelancën e kërkuar, dua t'i përgjigjem pyetjes që bëri zonja Çupi. Ajo iu referua një ngjarjeje, të cilën kërkon ta politizojë, por unë besoj se nuk është mirë që procedurat administrative dhe të gjitha procedurat ligjore të politizohen për arsye që zonja Çupi mund t'i dijë, meqenëse përmendi edhe mediet këtu.

Nuk besoj se ka nevojë që zbatimi i ligjit dhe i të gjitha procedurave standarde, të cilat punonjësit e institucioneve i zbatojnë në çdo ditë të punës së tyre, të përkthehet në ngjarje që politizohen dhe u jepen ngjyrimet për qëllime që vetëm ju mund t'i dini, sepse në dosjen që ju më thatë se kisha mbi tavolinë, unë nuk kam një procedurë të tillë. Pra, nuk kam asnjë dosje me ngjyrë për të zbatuar ligjin dhe të gjitha

procedurat, të cilat janë vetë procedura administrative, e cila mund të politizohet.

Për çështjen që ju ngritët, ka pasur reagime nga institucionet dhe ministritë e linjës. Qëllimi ynë i vetëm është përmbushja e standardeve sa më të mira për marrësit e shërbimeve të ofruara në institucionet e përkujdesit social, mbështetja e grupeve në nevojë, mbështetja e kategorive të personave me aftësi të kufizuara, sigurimi i mjediseve sa më të mira të infrastrukturës, në zbatim dhe vetëm në interesin më të lartë të qytetarëve dhe të atyre që kanë më shumë nevojë, në zbatim dhe vetëm në zbatim të ligjit.

Shërbimi Social Shtetëror, me qëllim sigurimin e hapësirave shtesë për institucionet rezidenciale për ofrimin e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara apo për kategoritë e tjera vulnerabël, ka propozuar mundësinë për të pasur hapësira shtesë, ndaj, në bazë të ligjit dhe vendimit të qeverisë, janë kryer të gjitha proceset administrative duke zbatuar procedurat standarde.

Nuk e di ku qëndron shqetësimi dhe pyetja juaj këtu, sepse zbatimi i ligjit dhe i procedurave administrative është një ndër kriteret dhe kushtet bazë që punonjësit e administratës duhet të plotësojnë, në mënyrë që të bëjnë detyrën e tyre.

Kështu që, unë nuk besoj se punonjësit e administratës duhet të intimidohen nga politika dhe nga ju për të bërë detyrën e tyre. Mos i intimidoni njerëzit, mos i intimidoni punonjësit e administratës, mos intimidoni institucionet, mos intimidoni ata që punojnë çdo ditë për të bërë detyrën e tyre funksionale në bazë të ligjit, por, ju lutem shumë, nëse keni interes direkt për çështjen në fjalë, mund të shikoni të gjitha dispozitat dhe aktet nënligjore, sepse janë bërë të gjitha publike. Unë nuk e di pse nga foltorja e parlamentit apo nga karrigia juaj intimidoni me tagrin që ju jep kjo karrige punonjësit që shkuan për të bërë detyrën, duke u thënë pse bëtë detyrën, por nuk besoj se ju jeni nga ato kolege që intimidoni nëpërmjet votëbesimit që ju kanë dhënë njerëzit.

Kaq kisha për këtë pikë.

Lindita Nikolla – Tani fillon koha 20 minuta për interpelancën.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit!

I nderuar zoti Hila,

Faleminderit që më jepni edhe një herë mundësinë për të komunikuar me qytetarët e Vaut të Dejës dhe me të gjithë qytetarët shqiptarë për mbështetjen dhe përkrahjen që u kemi dhënë në

kohë të vështira, por edhe për mbështetjen që familjet në nevojë marrin nëpërmjet programeve sociale!

Ju i referoheni programit të ndihmës ekonomike, i cili synon të mbështesë familjet dhe personat në nevojë në një moment të caktuar të jetës së tyre, kur ata kanë më shumë nevojë për përkrahjen e shtetit. Ky program ka lidhje direkte me mbështetjen ekonomike në *cash* të kësaj kategorie. Ju keni qenë katër herë drejtues i Njësisë Administrative të Bushatit, një mandat 4-vjeçar kryetar i Bashkisë së Vaut të Dejës dhe e dini shumë mirë si funksionon bashkia në raport me programet e mbështetjes sociale për personat përfitues të ndihmës ekonomike, ata me aftësi të kufizuara apo edhe programet e shërbimeve sociale. Pra, ju keni një informacion të zgjeruar për këto programe dhe, mbi të gjitha, për mënyrën e përfitimit të këtyre programeve, sepse bashkë kemi bërë seanca pyetje-përgjigje, interpelanca, si dhe kemi diskutuar për shërbimet sociale në qendrën rezidenciale “Besa”.

Në fakt, ju kenë qenë kryetar në kohën kur reforma e ndihmës ekonomike filloi të shtrihej në të gjithë vendin. Kjo reformë siguroi që të hiqeshin kriteret përjashtuese, të cilat nuk lejonin familjet të përfshiheshin në skemën e ndihmës ekonomike, shmangu abuzivitetin dhe nxori nga skema përfituesit abuzivë në kurriz të atyre që kishin më shumë nevojë, si dhe mundësoi që më shumë se 16 mijë familje në të gjithë Shqipërinë, të cilat nuk aplikonin dot për arsye të kriterëve të vendosura në atë kohë (po i referohem si kohë e shkuar), të kishin mundësi të aplikonin, duke u lehtësuar i gjithë procesi i aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Ç’do të thotë që është lehtësuar aplikimi? Nuk do të thotë që bëhet si në kohën tuaj, me dosje që i vlerësonte vetë administratori social në bashki. Në momentin që bëmë reformën e ndihmës ekonomike, ne krijuam një sistem elektronik automatik, ku çdo vlerësim i familjes i bërë nga administratori social kalon në një filtër kontrolli që realizohet në mënyrë automatike në të gjithë regjistrat publikë, duke filluar nga regjistri i pronave, regjistri i automjeteve dhe nga regjistrat e taksave apo pagave të qytetarëve. Këto vlerësime bëhen në mënyrë automatike edhe nëpërmjet një sistemi pikëzimi, që u ndërtua me ekspertizën e Bankës Botërore. Të gjitha familjet përfituese në skemë janë të listuara dhe të

verifikuara në mënyrë automatike. Pra, siç e shpjegova edhe më parë, targetimi i atyre që kanë më shumë nevojë për skemën është në masën 82,5%, në krahasim me 22% që ishte në kohën tuaj.

Pse e them këtë gjë? E them, sepse në vitin 2018, nuk e di nëse ju kujtohet e shkuara, por për të ecur përpara duhet të referojmë gjithmonë ato që kanë qenë më parë fakte, më shumë se 400 familje u nxorën nga skema e ndihmës ekonomike, sepse u konsideruan abuzivë në dhënie e masës së ndihmës ekonomike. Ju e mbani mend shumë mirë se si kryetarët e bashkive (sigurisht, jo të gjithë) e shfrytëzonin ndihmën ekonomike duke e dhënë në mënyrë të pjesshme, në mënyrë që të kishin sa më shumë familje në skemë për t'i përdorur më pas politikisht për t'u kërkuar votën e të tjera.

Nëse ju e nxirrni veten nga kjo përgjegjësi...

Unë kam disa pyetje për ju, por do t'ju bëj në fund, sepse dua t'u shpjegoj njerëzve çfarë bëjmë ne për të mbështetur familjet në ndihmë ekonomike. Sot janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike 64 mijë familje. Për familjet me më shumë se dy fëmijë është dyfishuar masa e ndihmës ekonomike, për të moshuarit pa pension pleqërie dhe pa pension social është dyfishuar masa e ndihmës ekonomike, në tërësi është rritur me 20% masa e ndihmës ekonomike.

Përveç kësaj, sistemi i pikëzimit, që është elektronik dhe automatik, ka edhe një aspekt komplementar. Pra, pa përfshirë disa elemente, që nga pikëpamja sociale mund ta kërkojnë ndihmën ekonomike edhe përtej sistemit, kemi vendosur që bashkive, dhe ju e dini shumë mirë këtë gjë, nga 3% të transfertës që u jepnin, t'u japim 6%, në mënyrë që të kenë fonde të rritura, por edhe familjet të përfitojnë maksimalisht. Ju mund të jeni i vetmi deputet në këtë sallë që më ka çuditur me kërkesën për interpelancë duke më thënë pse në Vaun e Dejës janë shtuar familjet me ndihmë ekonomike nga njëri vit në tjetrin apo nga njëri muaj në tjetrin. Unë do jua tregoj me fakte këtë gjë.

Për sa u përket familjeve në Bashkinë e Vaut të Dejës, nga skema e ndihmës ekonomike përfitojnë 1049 familje në nevojë, kurse 130 familje përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%. Ndërsa, 719 familje marrin masë të ndihmës ekonomike të rritur me 20%, kurse 330 familje marrin pagesë të dyfishuara. Në kuadër të

programit tonë për mbështetjen e nënave të papuna me më shumë se tre fëmijë duke u subvencionuar kontributet shoqërore dhe shëndetësore, nga më shumë se 6200 në rang vendi, vetëm në dy muajt e parë të vitit janë 46 nëna të papuna, të cilat përfitojnë nga politika e subvencionimit të kontributeve sociale dhe shëndetësore për 5 vjetët e parë të rritjes së fëmijëve të tyre.

Nga ana tjetër ka edhe një proces kontrolli, sepse kjo nuk do të thotë se nuk mund të verifikohesh, pasi je zgjedhur përfitues në skemën e ndihmës ekonomike. Verifikimi dhe kontrolli bëhet nga administratorët socialë dhe Shërbimi Social Shtetëror. Nga kontrollet e bëra, 68 familje kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike për shkak se nuk janë paraqitur për të bërë deklarinimin mujor. Po jua shpjegoj këto, sepse ju keni hedhur përsëri disa akuza. I keni akuza, se, po t'i kishit fakte, jam e bindur që nuk do të hezitoni të shkonit në organet kompetente, ku unë ju sugjeroj të shkoni, sepse këtu nuk është vendi për të folur në përgjithësi apo për të bërë akuza. Ju keni hall se po afrohen zgjedhjet (ndoshta e keni herën e fundit që flisni në Kuvend) dhe me të drejtën që ju përcakton ligji kërkonit interpelancë për arsye të interesit tuaj politik, por ne kemi bërë dhe do të vijojmë të bëjmë detyrën.

Për sa i përket shqetësimit për bërjen pjesë të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, ju informoj se sot përzgjedhja e tyre bëhet nëpërmjet një sistemi të automatizuar, ku ndikimi i përkatësive politike, fatmirësisht ka marrë fund njëherë e përgjithmonë.

Këtu ka një problem: kur i ke bërë vetë këto gjëra, kujton se ajo gjë do të ndodhë edhe me të tjerë që vijnë në vendin tënd.

Te pyetjet që keni shtruar, nuk keni denoncuar asnjë rast nominal. Të paktën te kërkesa për interpelancë nuk ka asnjë referencë që ju keni bërë denoncim në organet kompetente.

Patjetër, ju keni të drejtë të vini këtu dhe të kërkonit interpelancë, por zakonisht, kur ngrihen akuza, aq më tepër nga një ish-kryetar bashkie, aspirant për të qenë sërish, është e nevojshme të paraqiten fakte, emrat e personave që nuk e kanë bërë detyrën, si dhe duhet të paraqitesh tek organet kompetente dhe në institucionet respektive që e bëjnë këtë kontroll.

Ju lutem shumë, nuk mund të përdorni edhe një herë mundësinë që u jep foltorja e parlamentit

dhe ligji për të bërë një interpelancë thjesht në tym, pa fakte, me paragjykime apo edhe ngjarje që mund t'i keni jetuar në të shkuarën duke i vendosur në kontekstin aktual! Deri më tani nuk ka asnjë fakt.

Ndërkohë, unë ju them me përgjegjësi të plotë që përzgjedhja e familjeve përfituese në skemën ndihmës ekonomike (janë 1049 familje në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Vaut të Dejës) bëhet *online* nga një sistem transparent i lidhur me të gjitha sistemet dhe regjistrat publikë që verifikojnë të ardhurat, pamundësinë, mënyrën dhe kushtet e jetesës së familjeve, duke përfshirë edhe administratorin social të bashkisë, i cili ka për detyrë të verifikojë prezencën e qytetarëve një herë në tre muaj, në mënyrë që të bëhet deklarimi tremujor dhe që të verifikojë që kushtet për përfitimin e ndihmës nuk kanë ndryshuar.

Duke qenë se kjo ka ndodhur, për shkak të mosparaqitjes në zyrën e administratorit social në Bashkinë e Vaut të Dejës për të bërë deklarimin, 68 familje janë nxjerrë nga skema. Kjo nuk i përjashton përgjithmonë, sepse mund të riaplikojnë. Gjithashtu, nga skema janë përjashtuar edhe tri familje që jetonin jashtë vendit, të cilat janë evidentuar nga administratorët socialë.

Pra, unë po u përgjigjem pyetjeve një për një. Më pyetët nëse kemi bërë kontrole. Po, kemi bërë. A janë marrë masa për të bërë verifikimin? Po, janë marrë. Sa janë familjet, të cilat nuk kanë zbatuar kontrollin periodik dhe nuk janë verifikuar me dokumentacion? Janë 68. Sa familje kanë rezultuar që nuk jetojnë në vend dhe janë verifikuar? Janë tri.

Pra, këto që unë po ju jap janë shifra dhe fakte, nuk janë opinione. Jua sqarova edhe një herë, edhe pse besoj se ju e dini shumë mirë, pikërisht këtë element që ka të bëjë me të gjithë sistemin automatik të pikëzimit, që nuk mund t'i vlerësojë dot familjet në bazë të bindjeve politike, siç ju thatë.

Dua t'ju bëj një parantezë. Në kohën kur ju keni qenë kryetar bashkie, pas zbatimit të skemës së re të ndihmës ekonomike, sistemi ka nxjerrë nga skema si përfitues të padrejtë 419 familje për mospërputhje dhe fiktivitet në të dhëna. Kjo do të thotë që këto familje kishin përfituar nga skema në kundërshtim me dispozitat dhe aktet normative. Në të gjitha vlerësimet që janë bërë në

atë kohë nga Shërbimi Social Shtetëror për administrimin e fondeve të ndihmës ekonomike për ekzaktësisht 186 familje, 98 prej të cilave ishin përfituese të 6%-it, ka rezultuar se kanë përfituar në mënyrë të padrejtë dhe, sipas raportimit të përcjellë, vlerësohet se ka pasur një dëm ekonomik në masën 2 milionë lekë. Gjatë kësaj periudhe janë konstatuar shkelje në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë së Vaut të Dejës dhe për këtë arsye janë vendosur masa për shlyerje dëmi dhe masa disiplinore, për të cilat unë do të doja të kisha një përgjigje nga ana juaj. A janë zbatuar masat e kontrollit në atë kohë? A janë shlyer dëmet e shkaktuara? Cila është përgjegjësia juaj këtu? Sigurisht, besoj se ju do ta keni një përgjigje për këtë pjesë.

Gjithashtu, unë jam e bindur që do të mundim t'u japim edhe qytetarëve një përgjigje për atë që ka ndodhur dhe atë që po ndodh. Të shqetësohesh pse skema e ndihmës ekonomike mbështet familjet në nevojë, të shqetësohesh pse është rritur mbështetja për familjet në ndihmë ekonomike, të shqetësohesh për 37 qytetarë që kanë përfituar nga skema, të shqetësohesh pse janë rritur nga njëri muaj në tjetrin familjet përfituese në skemë dhe të shqetësohesh pse skema është transparente, vetëm ju mund t'ju kem parë. Ju jeni të shqetësuar pse qytetarët marrin ndihmë ekonomike, pse qytetarët përfitojnë shërbime sociale dhe rezidenciale në qendrën sociale "Besa", pse qytetarët mbështeten nga bashkia me fondin 6% të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për momentet e vështira që kalojnë në jetën e tyre.

Për të thënë të vërtetën, nuk e kuptova shqetësimin tuaj dhe thirrjen në interpelancë. Nëse do të kishte një akuzë, duhej ta kishit denoncuar në organet kompetente. Nëse kjo interpelancë do të ishte një kërkesë për informacion për qytetarët, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe mënyrën se si sistemi aprovon mbështetjen, unë isha shumë shtruese për këtë gjë duke ju shpjeguar si funksionon procesi i përfitimit të ndihmës ekonomike, se në çfarë sistemesh elektronike kalon, si bëhet verifikimi periodik tremujor nga administratorët socialë dhe me numra konkretë sa është mbështetur dhe se sa mbështetet Bashkia e Vaut të Dejës për mbështetjen sociale nëpërmjet ndihmës ekonomike që u jep këtyre familjeve.

Pra, me pak fjalë, shqetësimi juaj në raport me ato që ju kërkoni nuk qëndron, sepse nuk keni asnjë fakt që të tregojë se këtu ka diçka që ka lidhje me një shkelje apo me një abuzim. Të vetmet shkelje dhe abuzime, të cilat janë verifikuar nga Shërbimi Social Shtetëror në kohën kur ju keni drejtuar Bashkinë e Vaut të Dejës janë ato që unë ju thashë: përfitime të padrejta nga më shumë se 160 familje; përfitime të padrejta nga fondi 6% i bashkisë; përfitimet që jepnit me masa të pjesshme nga 800 lekë - 1400 lekë për familje, në mënyrë që të mbushnit skemën e ndihmës ekonomike si skemë lëmoshe dhe pa asnjë proces verifikimi. Kur i ke bërë vetë si procedura, kujton se janë duke i bërë edhe këta të tjerët.

Ndërkohë, do të vijohet puna e institucioneve për të bërë verifikimet dhe përmirësuar shërbimet, sepse nuk ka asnjë institucion perfekt dhe patjetër që mund të ketë problematika, por ama, nëse kemi një fakt, duhet ta denoncojmë me emër, për shembull, administratori social, personi iks apo ipsilon, dhe patjetër që ne do të marrim masa, sepse jemi këtu për të zbatuar ligjin dhe për të garantuar që reformat e ndërmarra zbatohen në terren.

Reforma e ndihmës ekonomike, që është zbatuar në vitin 2018, ka garantuar sistem transparent të ndihmës ekonomike. Fakti që nga viti 2018 e deri më sot kjo është interpelanca e parë që kërkohet për mënyrën e ekzekutimit të pagesave të ndihmës ekonomike, do të thotë që ju si deputet nuk keni marrë ankesë nga familjet që u është hequr apo nuk u jepet ndihma ekonomike, sepse të gjitha familjet që kanë nevojë për mbështetje sociale, aplikojnë në programin e ndihmës ekonomike vetëm nëpërmjet një formulari të administratorit social, duke i shmangur të gjitha ecejaket dhe burokracitë. Në fund bëhet verifikimi në mënyrë automatike dhe ata bëhen pjesë e skemës nëse plotësojnë kriteret. Pra, prej vitit 2018 është një procedurë tërësisht transparente. Sigurisht, nuk ka pse ta dinë të gjithë kolegët këtu procedurën, por, kush ka qenë në Kuvend, e di shumë mirë çfarë reforme është bërë. Merrnin ndihmë ekonomike familje me dy makina, vila dhe prona, duke u marrë hisen atyre që kishin më shumë nevojë. Kur ne filluam reformën, Banka Botërore tha që mbulimi dhe targetimi i familjeve të varfra me ndihmë ekonomike ishte 22%, kurse sot është 82,5%. A duhet të jetë 100%. Patjetër. A duhet bërë më

shumë? Patjetër që duhet bërë më shumë. Prandaj, puna e administratorëve në bashki është shumë e rëndësishme për të bërë identifikimin e familjeve në nevojë, për të bërë verifikimet për ndryshimin e statusit dhe kushteve social-ekonomike të familjeve, si dhe për punësimin e familjeve me ndihmë ekonomike. Ajo që ne kemi bërë dhe po e bëjmë intensivisht, është fokusimi te punësimi i anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve me ndihmë ekonomike. Mbi 3600 persona përfitues të ndihmës ekonomike janë punësuar dhe vazhdojnë sot formimin profesional, në mënyrë që të dalin nga skema e ndihmës ekonomike. Skema e ndihmës ekonomike nuk është që ti të jesh pjesë e saj gjithë jetën dhe të ngelesh i varfër, por duhet të aftësohesh profesionalisht dhe të futesh në tregun e punës. Këto janë ato që ne po bëjmë, kurse ju keni mendësinë që të ketë sa më shumë familje me ndihmë ekonomike, sa më shumë njerëz që kanë mundësi dhe aftësi për të qenë aktivë të fuqizohen ekonomikisht, sepse ju duhen, se i përdorni më mirë pastaj për politikën, kur vjen dita e kërkimit të votës. Por kjo kohë ka ikur njëherë e përgjithmonë dhe besoj se këtu jemi të qartë të gjithë, edhe ju, madje.

Lindita Nikolla – Zoti Hila, fjala për ju. Keni të drejtë të shprehni deri në 15 minuta.

Zef Hila – Faleminderit, zonja Kryetare!

Së pari, dua të sqaroj ministren, por, gjithashtu, edhe qytetarët e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe të gjithë kolegët se unë zonjës ministre herën tjetër në seancë i bëra thirrje publike, në praninë e medieeve, të shkonim te qendra sociale.

Zonja Ministre, ju po dezinformoni! Nuk keni asnjë lloj informacioni të saktë. Meqë e doni me emra, unë po jua them emrat konkretë: punonjësit dhe institucionet tuaja të varësisë në qendrën sociale “Besa”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po gënjeni këtu para qytetarëve! Po ju them që po gënjeni! Unë po jua jap me emra konkretë, që të mos marr më kohë. Sot në qendrën sociale “Besa”, ju keni në listëpagesë: kujdestar, shofer, që nuk shkojnë asnjë edhe një ditë të vetme në qendrën sociale “Besa”, sepse punojnë në një kompani private. Institucionet e varësisë ju kanë gënjyer ju. Qytetarët e dinë shumë mirë se aty ju keni infermier që bën punën e kujdestarit dhe 15% e stafit nuk paraqitet në punë. Ju po bëni lojë politike. Çfarë janë këto që thoni: “Drejttojuni me akuza!”? Çfarë akuzash doni, kur këto janë

konkrete? Hajdeni të shkojmë bashkë atje, kur të duash ti! Gjeje kohën të shkojmë dhe të ballafaqohemi bashkë aty! Atje është e vërteta. Aty, në qendrën sociale, sot nuk ka kuzhinier. Është skandal i vërtetë. Kaq për këtë pjesë. Këto janë faktet, ndërsa të gjitha informacionet dhe aktet e kontrollit të inspektimit, që janë bërë, janë vetëm gënjeshtër, se ashtu ju pëlqen juve. Kjo është e vërteta. Hajdeni të shkojmë bashkë në prani të medias! Ngrehu dhe deklaro sot këtu: po, shkojmë atje! Atje shihet e vërteta, jo këtu me deklarata.

Ju dëgjova me vëmendje, zonja Ministre, dhe si unë, besoj edhe shumë qytetarë të Bashkisë së Vaut të Dejës. Ne po diskutojmë për një kategori qytetarësh që përballet me vuajtjen, me sfidat dhe me vështirësitë e përditshme, dhe unë prisja që ju të kërkonin ndjesë publike për nivelin e ulët të pagës së ndihmës ekonomike dhe për padrejtësitë që u bëhen atyre qytetarëve, por ju nuk e bëtë këtë, po vazhduat të shpalosnit sukseset e punës suaj dhe sesa mirë ka performuar administrata juaj.

Qytetarët e dinë shumë të mirë të vërtetën dhe jam i bindur se nuk i kanë besuar fjalës suaj, sepse qytetarët e Bashkisë së Vaut të Dejës jetojnë aty me të vërtetën e kësaj çështjeje. Ministria e Shëndetësisë ka një drejtuese që nuk bashkëjeton me hallet dhe me shqetësimet e bashkëqytetarëve të saj. Madje unë besoj se më shumë se interesin e qytetarëve, ju konsideroni prioritet interesin e propagandës suaj politike.

Në pjesën e parë të fjalës sime unë i ngrita problematikat vetëm në parim, por përgjigjja juaj më detyroi që në këtë pjesë t'i analizoj konkretisht me fakte, me dokumente, me të dhëna zyrtare dhe me shkresa zyrtare. Zonja Ministre, siç tashmë është e ditur, një familje e varfër për të përfituar ndihmën ekonomike duhet të aplikojë në skemën e pikëzimit (këtë duhet ta dëgjosh mirë), më pas drejtoritë rajonale bëjnë përzgjedhjen e familjeve, sipas kritereve që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 të vitit 2019, sipas të cilit familjet që mbeten jashtë sistemit të pikëzimit, mund të përfshihen nga këshilli bashkiak në skemën e ndihmës ekonomike nëpërmjet fondit të 6%-shit. Por ju atë informacion që na dhatë, e keni marrë mbrëmë në orët e vona. Përfaqësuesit tuaj kanë shkuar me porosinë tuaj në dyert e Bashkisë së Vaut të Dejës, por ju kanë dezinformuar.

Pra, fondi 6% është një mundësi që ligji u jep bashkive, që t'u gjenden pranë familjeve në nevojë, në rast se ato nuk e përfitojnë mbështetjen në skemën kombëtare. Por, çfarë ka ndodhur në Bashkinë e Vaut të Dejës, zonja Ministre? Me vendimin nr. 1 të këshillit bashkiak të datës 26 janar të vitit të kaluar, këshilli bashkiak i Vaut të Dejës ka miratuar kriteret, ku do të bazohet për të trajtuar me ndihmë ekonomike, nëpërmjet fondit 6%, familjet të cilat nuk janë shpallur përfituese në skemën e pikëzimit kombëtar.

Zonja Ministre, këtu keni të gjitha vendimet e drejtorisë suaj, të institucionit të varësisë. Pra, familjet, që do të trajtoheshin me ndihmë ekonomike nga bashkia, duhej të ishin nga familjet që kishin aplikuar në sistemin e pikëzimit, dhe ju këtë e thoni me fjalë, por e vërteta është krejtësisht ndryshe. Të gjitha familjet që janë trajtuar me këtë vendim, nuk janë shpallur përfituese sipas VKM-së nr. 57 të vitit 2019, duke përcaktuar madje se këto familje duhet të kishin aplikuar tre muajt e fundit.

Këto janë faktet, zonja Ministre, jo ato që lexoni ju nga të dhënat që ju sjellin pa ditur gjë fare për këtë punë. Do t'ju jap dhe do t'ju dorëzoj unë të gjitha. Vendimi nr. 597 i datës 04.09.2019 i Këshillit të Ministrave, ligji dhe aktet nënligjore kanë përcaktuar dy kushte për trajtimin me ndihmë ekonomike nga bashkitë.

Së pari, për familjet që kanë aplikuar, por nuk janë shpallur përfituese nga skema kombëtare, është krejtësisht e kundërta nga ajo çfarë thoni ju. Ju po i dezinformoni shqiptarët. Banorët e Bashkisë së Vaut të Dejës e kanë shumë të qartë, sepse ata përballen çdo ditë me hallet dhe me problemet e kësaj çështjeje. Ndaj thoni të vërtetën, se është në të mirën tuaj dhe të qytetarëve.

Së dyti, këshilli bashkiak nuk mund t'i trajtojë me ndihmë ekonomike pa këto dy kushte familjet që kanë aplikuar në tre muajt e fundit, por vendimi i drejtorisë rajonale është këtu me emra dhe me fakte. Unë nuk do të marr kohë për t'ju mbushur mendjen juve, por këtu është vendimi i këshillit bashkiak, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave. Këtu është shprehja e ligjshmërisë së prefektes së Qarkut të Shkodrës, në kundërshtim të plotë me vendimmarrjet e shërbimit social shtetëror, zonja Ministre, nga të cilat rezultojnë se familje nga Bashkia e Vaut të Dejës kanë aplikuar në skemën kombëtare të

pikëzimit, por nuk janë shpallur fituese. Shumë nga këto familje nuk përfshihen në skemën e 6 % -shit të këshillit bashkiak.

Zonja Ministre, unë jam banor i asaj zone, jam votuar disa herë dhe i njoh mirë problemet dhe hallet e tyre, ndaj ju them se ju po dezinformoni. Unë ju ftoj publikisht nga kjo sallë, të shkojmë atje dhe t'i shohim në vend, se të gjitha ato, që ju thoni këtu, janë të pavërteta. Unë jua them me shumë përgjegjësi, ashtu siç ju thashë për qendrën sociale, ndaj ju ftoj të shkojmë atje bashkë!

Kemi verifikuar vendimet e këshillit bashkiak të Vaut të Dejës, nga ku rezulton se këshilli i Vaut të Dejës, me propozimin e administratorëve shoqërorë ka përfshirë në skemën e trajtimit me ndihmë ekonomike shumë familje, të cilat janë shpallur përfituese sipas vendimit të këshillit bashkiak, por në kundërshtim, zonja Ministre, me vendimin e Këshillit të Ministrave. Heshtin institucionet tuaja të varësisë, heshtni edhe ju, madje arrini deri aty sa vini në sallën e parlamentit e painformuar për çfarë ndodh dhe thoni të kundërtat e asaj që ndodh aty, por unë do t'jua jap të gjitha vendimet e këshillit bashkiak, shprehjen e paligjshmërisë së prefekturës së Qarkut të Shkodrës, dhe ju e dini shumë mirë se çdo vendim i këshillit bashkiak, në momentin që merr shprehjen e ligjshmërisë, kthehet në ligj lokal.

Kush janë këto familje që kanë përfituar? Jua them unë, por ju nuk duhet të më thoni këtu, që t'u drejtohem organeve të akuzës. Zonja Ministre, ju paguheni nga taksat e qytetarëve shqiptarë, ju keni institucionet e varësisë, që duhet të bëjnë punën e tyre, ndaj atyre duhet t'ua drejtoni gishtin dhe jo të vini këtu e të drejtoni gishtin nga opozita. Ky është një gabim fatal juaji dhe nuk do t'ju shërbente aspak as kjo interpelancë dhe as kjo përgjigje, sepse ato që ju them unë janë të vërtetat.

Pra, për të shpërblyer njerëzit e tij, këshilli bashkiak shkel haptazi ligjin për ndihmën ekonomike, madje ka prej tyre, që jetojnë dhe punojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, që janë të punësuar në administratën e bashkisë apo janë familjarë të kryetarëve të fshatrave. Çfarë kërkoni më nga ne?! Çfarë akuze doni ju?! Kujt i thoni ju që në të shkojmë dhe të depozitojmë kërkesat?! Vërin njerëzit në punë, sepse paguhen nga taksat e qytetarëve! Ata nuk plotësojnë asnjë kriter

ligjor, përveçse të qenit patronazhistë dhe të mbështetur direkt nga ana juaj, përderisa ju flisni me këtë gjuhë në parlament.

Në vend që të ndihmonte familjet e varfra, me shumë anëtarë, me fëmijë jetimë, të moshuarit, gratë kryefamiljare, njerëzit që nuk kanë një strehë ku të fusin kokën, Bashkia e Vaut të Dejës e përdor fondin e ndihmës ekonomike duke abuzuar haptazi me vendimin e Këshillit të Ministrave, aty ku edhe ju jeni anëtarë. Si nuk ju bën përshtypje?! Çfarë bëjnë institucionet e varësisë suaj? Unë kam këtu të gjithë dokumentacionin dhe flas me fakte, nuk flas në përgjithësi si puna juaj, por ju ftoj, dhe po e përsëris disa herë, hajdeni të shkojmë bashkë atje! Më thua, më jep fakte, por unë t'i dhashë faktet. Ka punonjës që nuk dalin as edhe një ditë të vetme në punë dhe paguhen nga taksat e shqiptarëve.

Do të ishte mirë që paligjshmëria të ndalej vetëm në kaq, por të tjera fakte me akte zyrtare e bëjnë edhe më flagrante paligjshmërinë e këtyre njerëzve. Prefektja e Qarkut të Shkodrës, e cila duhet të jetë garante e ligjshmërisë së pushtetit lokal, në të gjitha rastet është shprehur dakord për miratimin e vendimeve të këshillit bashkiak. Është e vërtetë, që unë kam qenë kryetar bashkie, është e vërtetë që e njoh shumë mirë dhe pretendoj se jam një ekspert i mirë i pushtetit vendor, por kurrë ndonjëherë në historinë e asaj bashkie nuk ka ndodhur një menaxhim kaq i mbrapshtë. Kjo është një skemë e mirorganizuar, duke filluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, nga institucionet e vartësisë së saj dhe deri në këshillin bashkiak. Kjo skemë që përfshin administratorët, kryetarin dhe sekretarin e këshillit, por dhe prefekten e Qarkut të Shkodrës ka vetëm një qëllim: të abuzojnë nëpërmjet përdorimit të fondeve publike.

Do të ishte fat i madh që institucionet vendore të kishin këtë lloj koordinimi kur vjen puna për të ofruar zgjidhje për ndonjë hall apo për ndonjë shqetësim, por qytetarët e dinë se kjo nuk ndodh kurrë. Këto institucione vendore bashkohen, bashkëpunojnë dhe koordinojnë me njëra-tjetrën, vetëm kur është puna për të abuzuar dhe për të mbajtur pushtetin me paligjshmëri. Këto janë dokumente zyrtare, këtu është shprehja e ligjshmërisë, këtu është vendimi i këshillit, vendimi i drejtorisë rajonale të Shkodrës, institucion i vartësisë direkt nga ju.

Detyra për të mos lejuar që të ndodhin paligjshmëri të tilla, sipas VKM-së nr. 512/2006, është pikërisht e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, pra, të ministrisë që drejtoni ju dhe mbani përgjegjësi, por edhe Inspektorati, edhe Ministria duket që kanë mbyllur sytë përpara këtij rasti, duke u bërë bashkëpunëtorë në një shkelje flagrante të ligjit. Qytetarët i kanë ngritur herë pas herë këto shqetësime dhe këto problematika, që janë në shkelje flagrante të ligjit.

Unë shpresoj shumë, zonja Ministre, që pas kësaj interpelance, ju duhet të gjeni kurajën, të gjeni forcë dhe të reflektoni, sepse ju kurrë nuk mund të dilni përballë institucioneve tuaja. Kjo është lista e të gjitha familjeve në Bashkinë e Vaut të Dejës, që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, dhe janë edhe shumë familje të tjera, zonja Ministre. Merrini dhe lexojini vetë dhe mos u besoni shumë institucioneve të vartësisë! Ky është një ndër vendimet tuaja. Te kjo listë nuk ka asnjë familje që ka aplikuar për pikëzim, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Zonja Ministre, ky është vendimi i Këshillit të Ministrave, ku është shumë e shumë të qartë se çfarë duhet bërë. Ky është vendimi i këshillit bashkiak, që nga lista e institucioneve të vartësisë suaj ka me dhjetëra familje që nuk kanë aplikuar në sistemin e pikëzimit, por janë futur në listën e përfituesve të fondit të 6%-shit. Këtu është shprehja e ligjshmërisë e prefektes të Qarkut të Shkodrës. Është detyrim ligjor që inspektoratet e vartësisë suaj duhet të kontrollojnë minimumi dy herë në vit, zonja Ministre.

Zonja Ministre, këto që them unë janë vetëm fakte dhe të vërteta, por dua të sqaroj edhe qytetarët, se mbrëmë në orët e vona ju keni marrë informacione të gabuara, ashtu siç i kishit dhe për ndihmën sociale. Ju ftoj këtu publikisht, hajdeni të shkojmë bashkë aty, se janë fondet e buxhetit të shtetit, por ju i mbyllni sytë përballë këtyre abuzimeve! Me thatë të them emra, emrat konkretë t'i them unë, por merri mediet dhe hajde të shkojmë bashkë atje, kur të doni ju, në varësi të kohës suaj, vetëm për një qëllim: të bëni detyrën tuaj, atë për të cilën paguheni nga taksat e qytetarëve!

Faleminderit!

Jam i gatshëm të shkojmë bashkë, kur të duash!

Lindita Nikolla – Zonja Ministre, keni 3 minuta në dispozicion.

Ogerta Manastirliu - Tani, për t'ju kthyer përgjigje, unë mendoj se isha shteruese në interpelancën që kemi bërë bashkë, për sa i përket qendrës sociale “Besa”, por unë e kuptoj që fushata elektorale ka afruar dhe kjo është seanca e fundit, të cilën, ju, si çdo herë, po e shfrytëzoni përsëri për fushatë. Jam e bindur se njëra nga gjërat që do t'i mungojë Kuvendit janë këto interpelancat e përsëritura që ju keni kërkuar, edhe pse, të them të vërtetën, nuk ka pasur ndonjë nevojë, sepse jeni shumë i qartë për atë që ndodh me ndihmën ekonomike.

Ju nuk më kthyet një përgjigje për atë që ju kërkova, sepse në njërin prej raporteve të Shërbimit Social Shtetëror të vitit 2018 rezulton se ju keni pasur 186 familje, të cilat i keni përfshirë në ndihmën ekonomike pa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zonja Kryetare, unë e dëgjova me shumë respekt!

Lindita Nikolla – Ju lutem, zoti Hila, mos flisni nga vendi!

Ogerta Manastirliu – Zonja, Kryetare, ju lutem, dua edhe pak minuta shtesë.

Pra, ju kur ishit kryetar bashkie, me vendimin e bashkisë, keni nxjerrë 186 familje dhe 98 prej tyre i keni përfshirë në fondin e 6%-shit, ku është vlerësuar një dëm ekonomik në masën 2 milionë lekë. Kjo shkelje është konstatuar gjatë asaj periudhe, kur e keni drejtuar ju bashkinë. Çfarë masash keni marrë ju? A janë shlyer dëmet e shkaktuara ndaj qytetarëve, taksapaguesve shqiptarë dhe atyre të Vaut të Dejës nga këto shkelje dhe abuzime që ju keni bërë për ndihmën ekonomike?! Unë i dëgjova akuzat tuaja, por këtu nuk dhatë asnjë fakt, sepse ato bazohen vetëm dhe vetëm mbi një eksperiencë tuajën personale, pasi kush i ka bërë disa gjëra vetë, ua hedh akuzat të tjerëve, sepse ai i di.

Vetëm sot që flasim, ndryshe nga koha kur e keni drejtuar ju bashkinë, dhe po marr përsëri çështjen e ndihmës ekonomike, ka ndodhur një ndryshim rrënjësor, në bashkëpunim edhe me ekspertizën e Bankës Botërore, dhe kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike janë të përcaktuara, ju i lexuat vetë. Kriteret e përfitimit të transfertës së kushtëzuar 6% vendosen nga bashkitë, që familjet që janë më shumë në nevojë dhe që mbeten të papikëzuara nga një sistem, që

është i ftohtë, që është sistemi i pikëzimit elektronik, të mundet të mbështeten me fondin e transfertës së kushtëzuar. Ndryshe nga koha kur e drejtonit ju bashkinë, kur mjaftonin vetëm disa letra bakalli për të qenë përfitues në mënyrë të padrejtë, sepse e dimë shumë mirë se çfarë ka ndodhur për të fryrë ushtrinë e votuesve tuaj, ndonjëherë kanë qenë edhe biznese fitimprurëse, ndihma ekonomike sot nuk jepet fare mbi preferenca politike dhe, aq më pak, të jepet mbi procedura abuzive, sepse është çdo gjë elektronike dhe automatike. Ju duhet të thoshit sot çfarë po bëjmë ne më shumë për të mbështetur 1049 qytetarët, familjet e Vaut të Dejës, që të përftojnë ndihmën ekonomike dhe jo të thoshit se pse qytetarët në Vuan e Dejës përfitokan ndihmë ekonomike.

Sa u përket institucioneve, të jeni të bindur se Ministria, inspektoratet dhe bashkia kanë disa filtra monitorimi dhe verifikimesh, ku nuk mundet dot që këto, që përmendni ju dhe që i quani abuzime, të mos jenë të verifikuara në 4-5 hallka. Nëse ju keni një akuzë konkrete, ju lutem shumë, dërgojeni në organet kompetente, këtë jua thashë edhe më parë. Nëse keni emra konkretë, çojini, por asnjë emër nuk thatë, asnjë familje abuzive nuk përmendët, asnjë vendim të bashkisë nuk referuat, që është në kundërshtim me ligjin. Më falni, por për çfarë jemi këtu? Jemi për të folur në përgjithësi për ato që ke bërë vetë dhe për të na i dhënë këtu si eksperiencë?! Na vjen keq, ajo kohë ka ikur. Ndihma ekonomike është një program që përfitohet nga familjet në vështirësi sociale; ngjyrat politike dhe preferencat partiake nuk kanë të bëjnë fare dhe nuk bëjnë pjesë në kriteret e përfitimit të këtij programi të mbrojtjes sociale. Me kohë i kemi hequr të gjitha kriteret përjashtuese, me kohë e kemi bërë transparente, me kohë kemi bërë të mundur që të gjitha sistemet të lidhen me njëra-tjetrën dhe verifikimi të bëhet automatik. Tashmë që kjo skemë është e konsoliduar dhe mbështetja me ndihmën ekonomike u jepet qytetarëve pa asnjë dallim, dhe këtë e tregon fakti se në këtë Kuvend asnjë koleg që përfaqëson zonat (se prandaj është deputeti për të përfaqësuar zonat dhe për të sjellë shqetësimet e qytetarëve), nuk ka ardhur të thotë se kësaj apo asaj familjeje nuk i është dhënë ndihma ekonomike, apo se është përjashtuar për arsye të preferencave politike.

Kështu që, unë besoj se kjo është përpjekja juaj e fundit. Duke qenë se futeni në fushatë për kryetar partie, nuk e di se cilën sigël dhe cilin fjalëkryq do të zgjidhni për të bërë fushatë, por kjo nuk ka rëndësi, sepse për ne më të rëndësishëm janë qytetarët. Ne do të vazhdojmë t'u shërbejmë atyre. Shpresojmë që ju të mos u bëni dëm, duke u futur në mendje ato që keni bërë ju, ato padrejtësi që keni bërë dhe që mendoni se i bëjnë edhe ata të tjerët, që po punojnë për t'u siguruar atyre më shumë mbështetje dhe më shumë përkujdes social.

Faleminderit!

(Duartrokitje në sallë)

Lindita Nikolla - Zoti Hila, keni 3 minuta në dispozicion.

Zef Hila – Pse duartrokisni?

Zonja Ministre, anëtare e kabinetit qeveritar, më vjen shumë keq, por po e them publikisht: merre dhe lexo vendimin nr. 597 të Këshillit të Ministrave, që ju vetë e keni votuar! Këshilli bashkiak, zonja Ministre, ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Nuk është e vërtetë, ju e citoni gabim vendimin dhe unë nuk kam fjalë për të thënë më. Ju e citoni gabim vendimin e Këshillit të Ministrave dhe i jepni tagrin këshillit bashkiak, që të dalë mbi Këshillin e Ministrave. Kjo mua më lë pa fjalë. Është në pikën 2 të këtij vendimi, merre dhe lexoje! Ndërsa në pikën 3 thuhet se familjet në nevojë, në momentin që do të përzgjidhen nga lista e familjeve, duhet të kenë aplikuar brenda 3 muajve të fundit nëpërmjet regjistrat elektronik kombëtar për ndihmë ekonomike, por edhe nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit. Ajo që ju thoni është shumë e rëndë dhe me lë për të dyshuar. Me gjithë respektin që kam për ju personalisht, por ju nuk keni njohje fare për këtë pjesë që po diskutojmë, ndaj edhe institucionet e vartësisë suaj paskan plotësisht të drejtë dhe unë absolutisht nuk ju vë faj. Ju bëni shumë mirë që lexoni, por ju dilni këtu në Kuvendin e Shqipërisë para qytetarëve dhe citoni gabim edhe vendimin e Këshillit të Ministrave, duke u dhënë të drejtë institucioneve tuaja të vartësisë, duke i dhënë të drejtë këshillit bashkiak, atë që nuk ia jep ligji, atë që nuk ia jep vendimi i Këshillit të Ministrave.

Me këtë më lë pa fjalë dhe të falënderoj për përgjigjen, sepse qytetarët po dëgjojnë! Ju merreni me opozitën dhe ty të shqetëson fakti se ku do të kandidoj unë, por kjo është e drejta ime, nuk keni të drejtë të merreni me këtë punë, sepse, duke u marrë me këtë punë, ju po dhunoni qytetarët, duke u marrë me këtë punë, ju po dezinformoni edhe vendimin e Këshillit të Ministrave, duke i dhënë kompetencë vetes suaj dhe institucioneve të vartësisë suaj.

Së fundi, e ftoj ministren publikisht, meqenëse e përsëriti disa herë qendrën sociale “Besa”, dhe ia kam thënë se çdo informacion i marrë nga institucionet e vartësisë së saj është dezinformim në masën 100%. Aty ka punonjës që nuk dalin asnjë ditë të vetme në punë. Është turp i madh t’i dalësh në mbrojtje një realiteti të tillë kaq të hidhur, kaq të trishtë. Më ke lënë pa fjalë! Me gjithë respektin që kam për ju, sinqerisht, këtë nuk e prisja, por dua ta besoj se ju nuk keni folur si ministre. Nëse e pranoni këtë, unë jam i zhgënjyer nga ky parlament, por unë do ta marr si një thënie nga një njeri me bindje politike dhe, absolutisht, jo në rrugë institucionale.

Të falënderoj për përgjigjet! Kam se çfarë t’u them qytetarëve që nga ky moment, sapo të përfundojë kjo seancë.

Të falënderoj shumë!

Lindita Nikolla - Këtu mbyllet interpelanca.

Vijojmë me pyetjet për ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi, nga deputetja Erisa Xhixho.

Seanca e pyetjeve kërkohet bazuar në nenin 80 të Kushtetutës dhe nenit 95 të Rregullores së Kuvendit dhe ka për objekt dhënien e informacionit lidhur me përjashtimin e studentëve nga paketa e rezistencës sociale dhe pakoja e madhe në fund të vitit 2022, duke mos parashikuar asnjë mbështetje për ta, ndërkohë që kostoja e jetesës u është rritur.

Fillojmë duke respektuar minutazhin e përcaktuar në nenin 95, pika 4 të Rregullores.

Zonja Xhixho, keni të drejtën për të parashtruar pyetjen deri në 2 minuta.

Erisa Xhixho – E nderuar Kryetare e Kuvendi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi sot këtu plot 6 muaj pasi kam kërkuar një seancë pyetje-përgjigje me ministren e Arsimit. Kërkesa e depozituar që në tetor të vitit

2022 është neglizhuar duke shkelur, në fakt, Rregulloren e Kuvendit që parashikon brenda 3 javëve zhvillimin e kësaj seance. Pa dyshim që as unë dhe as qytetarët nuk mund të mendojmë se kjo është e qëllimshme, që të largohet vëmendja nga ky shqetësim madhor që, në fakt, duhet të kishte marrë përgjigje me kohë.

Studentët janë përjashtuar në mënyrë sistematike nga të gjitha paketat e rezistencës, të sjella nga kjo qeveri në Kuvend. Ata u përjashtuan sërish edhe nga pseudolëmusha që Kryeministri e quajti “Pakoja e madhe”.

Studentët përballen sot me rritje të çmimeve dhe të kostos së jetesës. Të paktën 500 euro i duhen një studentit në muaj, pa llogaritur këtu tarifën e studimeve. Kostoja e jetesës është dyfishuar, karta e studentit nuk ia doli kurrë të bëhet realitet, por mbeti thjesht një tallje me 1%-2% ulje në markete. Studentët praktikisht janë lënë jetimë nga kjo qeveri. Në mungesë të shpresës, tragjikisht ata po marrin gomonet e rrezikojnë jetën në La Mansh.

Peticioni me 6 mijë firma i adresuar institucioneve kërkonte që ata të mbështeteshin sa studentët në Kosovë. Kjo e fundit, edhe pse me një buxhet më të vogël se Shqipëria, i mbështet me 100 euro në muaj studentët. Por kjo qeveri, përveçse i injoroi hapur, vazhdon të tallet me studentët duke zvarritur edhe pagesën e bursave. Bursat sociale dhe ato të ekselencës vonohen 4-6 muaj, sepse për qeverinë e inceneratorëve nuk kanë rëndësi as studentët që vijnë nga familjet në nevojë dhe as ata që shkëlqejnë.

71% e të rinjve nuk e shohin të ardhmen në Shqipëri, 1 në 3 maturantë do të studiojë jashtë vendit dhe 95% e të rinjve që studiojnë jashtë nuk duan të kthehen në atdhe. Vetëm në këtë vit akademik në auditore mungojnë 8 mijë studentë.

Ndaj sollëm në Kuvend amendamentet për buxhetin e vitit 2023, për t’i mbështetur financiarisht studentët për periudhën janar-qershor, por ju as nuk denjuat ta shqyrtoni, aq më pak të arsyetoni dhe me forcën e kartonit e hodhët poshtë.

I jam drejtuar ministres së Arsimit me pyetjen: përse studentët u përjashtuan nga paketa e solidaritetit, e ashtuquajtura “Pakoja e madhe”? Pse nuk u parashikua asnjë mbështetje për ta, ndërkohë që kostoja e jetesës është rritur?

Faleminderit!

Lindita Nikolla- Zonja Ministre, keni fjalën. Mund të jepni shpjegimet tuaja lidhur me pyetjet. Koha është 5 minuta.

Evis Kushi - E nderuar Kryetare e Kuvendit, Të nderuar kolegë,
E nderuar zonja Xhixho,

Unë nuk i jam shmangur për asnjë moment kësaj seance, madje ju falënderoj që e përsëritët edhe një herë kërkesën tuaj, por ju them se në seancën kur ishte parashikuar kjo çështje, opozita e bllokoj foltoren dhe ishte e pamundur të zhvillohej interpelanca. Ju e mbani mend shumë mirë, por edhe qytetarët e mbajnë mend shumë mirë. Kështu që ju falënderoj vërtet, sepse kjo seancë është një mundësi shumë e mirë për të informuar jo vetëm ju, kolegët, studentët, por të gjithë opinionin publik që studentët, ashtu sikurse nxënësit e arsimit parauniversitar, janë në vëmendjen tonë prioritare. Nuk ka asgjë më të rëndësishme për ne, në MAS, sesa mirëqenia dhe mbështetja për studentët dhe nxënësit.

Meqenëse koha është e kufizuar, po u përgjigjem menjëherë pyetjeve dhe nuk po merrem me akuzat, që ju, sigurisht, i keni pjesë të ligjëratës politike; po merrem drejtpërdrejt me çështjen.

Pikërisht falë vëmendjes që kemi për studentët, ne kemi ndryshuar qasjen e mbështetjes studentore, madje e kemi reformuar fondin e ekselencës. Deri para një viti fondi i ekselencës ishte për studentët që studionin jashtë vendit në universitetet më të mira, të rankuara më të mirat në Europë dhe në botë, ndërsa nga viti i kaluar ne kemi nisur një politikë të re për t'i mbështetur me bursa sa paga minimale dhe përjashtim nga tarifat të gjithë ata studentë që plotësojnë disa kriteret.

Së pari, të gjithë ata që janë ekselentë sot marrin 40 mijë lekë në muaj dhe janë të përjashtuar totalisht nga tarifat, po kështu edhe studentët që kanë fituar olimpiada. Mbi të gjitha, risia që ne sollëm me këtë politikë të re, ishte mbështetja për studentët që ndjekin programet "Prioritet kombëtar". Pra, të gjitha ato programe që lidhen me mësuesinë, apo me bujqësinë, apo me shërbimet, me turizmin, që të rinjtë dhe të rejtat i preferojnë më pak në tregun e punës, ne i mbështesim me bursa sa paga minimale.

Për sa i takon inflacionit të luftës dhe paketës së madhe të solidaritetit, natyrisht që qeveria dhe Ministria e Arsimit kanë marrë një sërë masash dhe mbështetje direkte, por edhe

mbështetje indirekte për studentët, e theksoj këtë, edhe mbështetje indirekte, sepse të gjitha masat që janë marrë për familjet shqiptare, natyrisht, janë edhe për studentët. Mund të mos jenë drejtpërdrejt për ta, por mbështetja që qeveria shqiptare u ka dhënë familjeve, rritja e pagës minimale, kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, rritja e pagave për mësuesit, për infermierët, për policët, për administratën publike, rritja e ndihmës ekonomike për gratë kryefamiljare, mbështetja për personat me aftësi të kufizuar, mbështetja për fermerët, nafta pa taksa, e po ashtu "Pakoja e madhe" për Vitin e Ri, janë mbështetje që u jepen familjeve, përfshirë edhe familjet e studentëve.

Por, ndërkohë, ka edhe mbështetje që është e drejtpërdrejtë, eksplicite për studentët: karta e studentit nuk është një mashtrim, përkundrazi, është një mbështetje për ta nga Bashkia e Tiranës. Së fundi, ne nënshkruam një marrëveshje me Bashkinë e Durrësit, dhe për studentët ka edhe një sërë mbështetjesh që jepen për ata që qëndrojnë nëpër konvikte, por edhe për shumë shërbime të tjera në qytet.

Dhe për sa u takon konvikteve, ju e dini shumë mirë që Bashkia e Tiranës në fillim të këtij viti akademik, që në muajin shtator, me vendim të këshillit bashkiak ka vendosur përgjysmim e tarifave për të gjithë studentët që akomodohen në konvikte. Po kështu ka ofruar që prej muajit shtator të vitit të kaluar abone falas, pra, transport falas për të gjithë studentët.

Ndërkohë, pikërisht për të mbështetur më shumë studentët, ne së fundi kemi draftuar edhe një VKM për kreditë studentore. Për herë të parë, studentët do të kenë të drejtë të marrin një kredi. Ne jemi drejt përfundimit, pra draftin e kemi gati. Javën e ardhshme do t'ua nisim edhe universiteteve për mendim, dhe më pas edhe Ministrisë të Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, dhe besoj që për një periudhë maksimumi 2-mujore, të gjithë studentët do të kenë të drejtë të marrin kredi.

Gjithashtu, të gjitha investimet tona për infrastrukturën jo vetëm të universiteteve, por dhe të kampuseve universitare, të konvikteve, të rezidencave, janë mbështetje e drejtpërdrejtë për studentët. Mund ta filloj që me kampusin e ri të Universitetit Bujqësor të Tiranës, që është një nga kampuset më moderne jo vetëm në Shqipëri, por

në të gjithë rajonin, janë tetë godina sipas standardeve më të mira.

Së fundi zhvilluam një takim në Qytetin Studenti, ku janë 19 godina të rehabilituara dhe 3 godina të reja me standardet më të mira. Madje me një mbështetje dhe të bankës KfW dhe të qeverisë gjermane do të ketë edhe eficiencë energjetike. Po kështu në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës kanë përfunduar dy rezidenca të rehabilituara sipas standardeve më të mira, e kështu edhe në universitetet e qyteteve të tjera jashtë Tiranës. Mbështetja jonë do të vazhdojë pa diskutim. Edhe politika jonë bazë, ndërkombëtarizimi, në thelb ka pikërisht mbështetjen për studentët.

Studentët, falë ndërkombëtarizimit, falë programeve të përbashkëta dhe të dyfishta të studimit me universitetet më të mira europiane, por edhe botërore, do të kenë cilësi më të lartë të arsimit, do të kenë vlera më të larta të tyre në treg, e natyrisht do të kenë një barrë më të ulët financiare për familjet e atyre, që deri më sot i dërgonin studentët jashtë vendit për të studiuar në universitetet më të mira. Së shpejti edhe shumë universitete të tjera, ne i kemi në proces, do të kenë degët e tyre në Shqipëri. Vitin e kaluar filluan 19 programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta, që sigurisht janë një mbështetje e madhe për studentët, për familjet e tyre, por edhe për të gjithë shqiptarët, sepse, në fund të fundit, ata studentë që deri dje shkonin studionin jashtë vendit për të pasur cilësi më të lartë, largoheshin nga Shqipëria. Ndërkohë që duke i mbajtur këtu, ne kemi rininë që studion në Shqipëri, punon në Shqipëri dhe jep kontribut për vendin.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Xhixho, keni të drejtën për t'u shprehur deri në 3 minuta.

Erisa Xhixho – Zonja Ministre, e kuptoj shumë mirë vështirësinë tuaj, sepse në këtë vend, fatkeqësisht, për çdo gjë vendos vetëm Kryeministri. Ai është përgjegjësi kryesor për largimin e të rinjve, për mungesën e shpresës, për korrupsionin galopant në çdo qelizë të kësaj qeverie; kjo e thënë qartë edhe në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Normal që ju nuk keni si të keni prioritet të rinjtë dhe studentët, të cilët kërkonin një mbështetje sa studentët e Kosovës, 100 euro në muaj për të përballuar koston e lartë të jetesës.

Në këtë situatë dramatike për vendin, kjo qeveri vendos t'i injorojë të rinjtë duke dhënë

mesazhin e qartë se nuk i ka aspak prioritet, duke vazhduar agjendën e shpopullimit të vendit. Po jap disa shifra. Të rinjtë shqiptarë të grupmoshës 16-34 vjeç kanë të ardhurat e disponueshme më të ulëta në raport me shtetet e tjera të rajonit. Në Serbi, të ardhurat e të rinjve të krahasueshme sipas fuqisë blerëse janë 52% më të larta sesa të ardhurat e të rinjve shqiptarë, në Mal të Zi 43% më të larta, ndërsa në Maqedoninë e Veriut 28% më shumë sesa në Shqipëri. Një qeveri e përgjegjshme, në këto kohë të vështira për të rinjtë, të cilët nuk shohin rrugë tjetër veç ikjes, duhej të merrte vendime të përgjegjshme me masa konkrete, duke rritur buxhetin për arsimin. Një qeveri e përgjegjshme duhej ta kishte shndërruar në kryeprioritet të qeverisë buxhetin dhe investimin në arsim, t'i mbështeste studentët financiarisht, të rriste pagat dhe të orientonte edukimin drejt sektorëve të zhvillimit të ekonomisë për t'u mundësuar punësim dinjitoz të rinjve. Lekët janë, por ato shkojnë për PPP-të dhe për koncesione.

Në fakt, ky Kryeministër duhet të japë llogari përpara drejtësisë edhe për megaaferën e inceneratorëve dhe milionat e lekëve të shqiptarëve që shkojnë për inceneratorët fantazmë. Sot shqiptarët e paguajnë 29 euro tonin për një shërbim që nuk e marrin, kur ndërkohë të gjithë e kanë parë se çfarë po ndodh në Sharrë. Të rinjtë po largohen masivisht dhe përgjegjës për këtë jeni ju, sepse me politikën tuaj dhe me asnjë vendimmarrje për t'i ndihmuar, nuk u keni dhënë të rinjve një mesazh të qartë që ata janë në vëmendjen e këtij shteti.

Shqiptarët janë në krye të kërkesave për azil në Britaninë e Madhe. Sipas shifrave të Ministrisë së Brendshme Britanike, pamjet e të rinjve që largohen me gomone dhe kalojnë kanalin anglez janë bërë të zakonshme në mediet europiane. Jemi të parët në Europë për largimin e trurit, sipas "The Global Economy". E vetmja gjë që kjo qeveri ka bërë për ta dhe për ta frenuar këtë fenomen është të kërcënojë dhe të mbajë peng diplomat e studentëve të mjekësisë. Largimi i të rinjve ka marrë përmasa të frikshme.

Po ju bëj vetëm një krahasim me vitet 2010-2011, kur ne kishim 134 877 studentë të ulur nëpër auditore, ndërkohë që një vit më parë u regjistruan 123 880 studentë, pra gati 11 mijë studentë më pak, praktikisht aq sa strehonte Qyteti Studenti shumë vite më parë. Kjo kabanë

alarmi, e cila është artikulluar shumë gjatë këtyre viteve, është një mundësi për të reflektuar dhe për të marrë vendime të guximshme për studentët.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Viojmë me pyetjen tjetër të bërë për ministren e Arsimit, Evis Kushi, nga deputetja Erisa Xhoxhi, e cila ka si objekt dhënien e informacionit lidhur me mosplotësimin e kërkesave të drejta të Sindikatës së Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë.

Zonja Xhixho, keni të drejtën për të parashtruar pyetjen.

Ju lutem, respektoni kohën që keni deri në 2 minuta!

Erisa Xhixho – Faleminderit, Kryetare!

Në fillim të vitit akademik pedagogët shqiptarë u ngritën në protesta dhe hartuan një peticion me kërkesa minimale për rritjen e cilësisë së arsimit në vend dhe trajtimin financiar dinjitoz të tyre. Çfarë parashikonte ky peticion? Rritjen e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor të paktën me 0,3% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që edhe me buxhetin e vitit 2023 mbetemi në shifrat qesharake 0,04% të prodhimit të brendshëm bruto.

Së pari, në progresraportin e fundit të Bashkimit European theksohet fakti se arsimiti është i ulët për nga buxheti dhe mbështetja për kërkimin shkencor duhet të ishte të paktën 1% e prodhimit të brendshëm bruto.

Së dyti, u kërkua pagë dinjitoze, aq sa i kanë kolegët e tyre në Kosovë, të cilët paguhën sa dyfishi i pedagogëve tanë, por përsëri, duke qenë të ndjeshëm për krizën që po kalojmë, ata kërkuan që kjo rritje të vihej në dispozicion për ta gjatë 2 vjetëve. Pedagogët vijnë në protestojnë, sepse rritja me 7%, që parashikoi qeveria, ishte e pamjaftueshme. Kërkimi shkencor vijon të mos financohet sa duhet dhe kërkesat e tjera të lidhura me vjetërsinë e punës dhe vlerësimin e orëve mësimore janë neglizhuar tërësisht nga kjo qeveri. Pedagogët tanë sot përballen me rritjen e çmimeve, kostot e rritura të jetesës, rritjen e karburantit, për të mos folur për shpenzimet që u duhen për rritjen e tyre profesionale, pagesat për artikuj dhe për konferenca shkencore, që shkojnë më e pakta nga 300 deri në 1000 euro, të cilat i mbulojnë vetë pa asnjë mbështetje.

Alarmi që ata ngritën për mundësinë e largimit të intelektualëve nga vendi jo vetëm që nuk u dëgjua dhe nuk iu dha përgjigje, por u

kërcënuan. Pagat në Shqipëri janë 40% më të ulëta sesa në rajon, vendi me çmimet më të shtrenjta ka pagesat më të ulëta, ndërkohë që buxheti për arsimin vazhdon të jetë më i ulëti në rajon, 2,2% të prodhimit të brendshëm bruto për vitin 2023, shifër kjo shumë larg premtimit të kësaj mazhorance dhe standardit të Bashkimit European, me 5% të prodhimit të brendshëm bruto, që duhet të ketë buxheti për arsimin. Ndaj, unë i kam kërkuar zonjës Ministre një kërkesë për informacion mbi hapat që po ndiqen për realizimin e kërkesave të drejta të pedagogëve.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zonja Kushi, për të dhënë përgjigje.

Koha që keni në dispozicion është 5 minuta.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Faleminderit, zonja Xhixho!

Unë dua t'ju theksoj që në fillim se nuk jam aspak në vështirësi për t'ju kthyer përgjigje, përkundrazi jam krenare për politikën që kemi ndërmarrë deri tani, ashtu sikurse jam edhe e përlulur për të gjitha detyrimet që kemi ende, sepse jemi të vetëdijshëm që ka ende problematika dhe ne jemi të angazhuar fort që t'i trajtojmë ato një më një. Siç jemi të përgjegjshëm për studentët dhe për nxënësit e arsimit parauniversitar, po njësoj jemi shumë të përgjegjshëm edhe për mësuesit, edhe për pedagogët.

Meqenëse koha është e kufizuar, po përpiqem t'i marr një më një të gjitha kërkesat e pedagogëve, sepse janë shumë, por do të fokusohem tek ato që janë më të rëndësishme. Menjëherë pas peticionit të pedagogëve kam thirrur në një takim përfaqësuesit e sindikatës, kemi zhvilluar një takim të gjatë dhe më pas kemi zhvilluar takime të përbashkëta edhe me komitetin e përbashkët të rektorëve, me të cilët ne hartojmë në mënyrë të vazhdueshme politikën tona, si dhe kemi ngritur grupe pune të posaçme për secilën prej kërkesave të pedagogëve.

Kërkesa kryesore e tyre ishte rritja e pagave. Kjo ka qenë një kërkesë së cilës ne i jemi përgjigjur në mënyrë të menjëhershme. Me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave ne i kemi rritur pagat jo 7, por 15%, ku 7% mbulohet nga buxheti i shtetit dhe 8% nga të ardhurat e vetë universiteteve. Të gjitha universitetet iu përgjigjën këtij vendimi të Këshillit të Ministrave dhe me strukturat, organet kolegjiale dhe bordet e tyre të administrimit morën vendimin dhe sot

pedagogët paguhen 15% më shumë. Jemi të vetëdijshëm që meritojnë edhe më shumë, prandaj jemi të angazhuar t'i mbështesim ata në mënyrë të vazhdueshme.

Madje edhe për "Pakon e madhe" të fundvitit ne miratim një vendim të Këshillit të Ministrave, ku edhe për ta të kishte një shpërblim dhe një mbështetje për zbutjen e impaktit të krizës së luftës në Ukrainë.

Një tjetër kërkesë e pedagogëve ishte vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për marrjen e gradave shkencore "Doktor" dhe titujve akademikë "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar". Edhe për këtë çështje ne e kemi filluar punën menjëherë.

Si hap i parë, u kërkuam mendim vetë universiteteve që të na sillnin sugjerime se si mund ta përmirësonim këtë vendim të Këshillit të Ministrave. Na kanë ardhur shumë sugjerime, madje na kanë ardhur edhe draftet e gatshme si sugjerime, kanë qarkulluar edhe mes pedagogëve, të cilët, në fakt, janë shqetësuar, sepse disa nga këto draftet që na kanë ardhur nga vetë sindikatat, nga konferenca e rektorëve apo nga fakultete të ndryshme kanë qenë draftet që i vështirësonin më shumë kriteret dhe procedurat. Ndërkohë që qëllimi ynë nuk është t'i vështirësojmë, përkundrazi qëllimi ynë nuk është as t'i vështirësojmë dhe as t'i lehtësojmë, por thjesht t'i sjellim këto kriteret e procedura në kushtet normale dhe t'i përshtatim me kushtet e reja.

Kështu që, pasi kemi marrë sugjerimet e tyre, ne tashmë kemi hartuar një draft, i cili shumë shpejt, brenda kësaj jave, do t'u dërgohet edhe një herë universiteteve, sikurse dhe ministrive të tjera dhe shumë shpejt do të jetë gati për të gjithë pedagogët. Po e theksoj, nuk është asnjë nga draftet që ka qarkulluar mes pedagogëve, të cilët shpeshherë edhe janë alarmuar, sepse disa kriteret kanë qenë vërtet shumë të vështira për kushtet tona, që të realizoheshin nga pedagogët.

Sa i takon kërkimit shkencor, mund t'ju them se është jo thjesht një prioritet me fjalë, siç thuhet shpesh, por ne kemi ndërmarrë nisma dhe angazhime shumë ambicioze. Pra, jo 0,3%, siç thate ju që kërkohet, por ne jemi angazhuar që për kërkimin shkencor të kemi 1% të PBB-së në vitin 2030, këtë e kemi të dokumentuar në strategjinë e kërkimit shkencor dhe të inovacionit që tashmë është publike. Mund t'i referoheni faqes zyrtare të

ministrisë dhe që nga data 10 mars strategjia e re është për konsultim publik. Madje, do t'ju kërkoja të gjithëve, pra të gjithë deputetëve që janë pedagogë apo që janë të angazhuar me kërkim shkencor, të na japin mendime rreth kësaj strategjie dhe se si mund ta përmirësojmë atë më tej.

Jo vetëm kemi rritur buxhetin nga viti në vit, madje shifrat mund t'ju vë në dispozicion, por përveç strategjisë ne po punojmë edhe për ligjin. E kemi në përfundim edhe ligjin për shkencën, sepse, për fat të keq, Shqipëria për shumë vite ka qenë me një ligj shumë të vjetruar, ligji i vitit 1993 apo i vitit 1994, i cili është komplet jashtë aktualitetit, sepse përmenden institucione që as nuk ekzistojnë më. Falë një pune intensive të përbashkët me Akademinë e Shkencave dhe me vetë universitetet ne tashmë kemi draftin e ligjit për shkencën, i cili shumë shpejt do të jetë për konsultim publik. Unë përsëri ju ftoj të na jepni mendimet tuaja.

Po në lidhje me shkencën, për herë të parë ne kemi hartuar rregulloren me procedurat dhe kriteret e revistave shkencore, që do të jenë pjesë e regjistrimit shtetëror të revistave të kërkimit shkencor, të cilat nuk i kemi pasur asnjëherë. Çdo universitet, çdo qendër apo institucion i kërkimit shkencor mund të nxirte apo të botonte një revistë, e cila nuk kishte asnjë filtër, asnjë kontroll dhe asnjë monitorim, ndërkohë që tani për herë të parë do të kemi regjistrim shtetëror të revistave të kërkimit shkencor.

Ndërkohë, Agjencia e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit tashmë ka publikuar thirrjen për projekte të kërkimit dhe të zhvillimit, ku buxheti është rritur me 75%, gjë që do të thotë se do të kemi edhe më shumë projekte fituese dhe çdo projekt do të ketë një fond më të lartë mbështetjeje. Së shpejti, do të shpallim thirrjen për projektet e përbashkëta midis universiteteve dhe bizneseve që kanë munguar gjatë gjithë këtyre vite. Për herë të parë do të financojmë edhe projekte të këtij lloji ku universitetet bashkëpunojnë me bizneset. Po kështu, do të kemi së shpejti prapë (kur them së shpejti, bëhet fjalë për harkun kohor të një muaji), thirrjen për mbështetje të infrastrukturës së kërkimit shkencor, ku të gjitha universitetet aplikojnë me projektet e tyre për t'u mbështetur me laboratorë të rinj kërkimorë-shkencorë apo aparatura që u duhen në punën e tyre të përditshme.

Po ashtu, javën e ardhshme unë do të kem një tjetër takim me ministren e Kosovës, ku do të shpallim edhe thirrjen për projektet e përbashkëta kërkimore-shkencore midis universiteteve shqiptare dhe universiteteve të Kosovës.

Pra, janë kaq shumë nisma, për të mos u ndalur pastaj edhe te programi i madh i Bashkimit Europian “Horizont Europa”, ku Shqipëria paguan një tarifë vjetore pikërisht për t’u dhënë të drejtën universiteteve tona që të aplikojnë me projekte. Për këtë unë i falënderoj sepse është rritur niveli i suksesit nga 8% që ishte në programin e mëparshëm “Horizont 2020” në 38%!

Universitetet dhe kërkuesit tanë i kanë rritur kapacitetet dhe tashmë janë më të suksesshëm në aplikimet e tyre, madje në shumë raste universitetet tona janë lider të projekteve të përbashkëta, çka nuk ka ndodhur kurrë në vitet e kaluara. Universitetet tona ishin të lumtura kur bëheshin pjesë e një projekti si partnerë...

Lindita Nikolla – Ju lutem, zonja Ministre, përfundojeni fjalën!

Evis Kushi - ...por kurrë nuk ndodhte që të ishin lider të këtyre projekteve. Ndërkohë që për disa nga pikat e tjera të kërkesave të pedagogëve janë vetë universitetet përgjegjëse për t’i realizuar, siç është, për shembull transparenca. Ne si qeveri me një vendim të Këshillit të Ministrave u kemi vënë në dispozicion universiteteve një portal *transparenca.al* ku universitetet duhet të publikojnë sa më shumë informacione edhe sa u takon pasqyrave financiare, buxheteve, por edhe për shumë çështje të tjera. Ne u kemi nisur një shkresë universiteteve ku u kërkojmë që të jenë më aktivë dhe t’i pasqyrojnë të gjitha aktivitetet për pedagogët dhe studentët për të gjithë opinionin publik.

Një çështje tjetër është edhe ajo që lidhet me tatimin 23% të pagesës për orët suplementare. Këtu u kemi kërkuar universiteteve që të mos i akumulojnë këto pagesa në fund të vitit, sepse duke u akumuluar të gjitha në fund të vitit, atëherë detyrohen që tatimi të jetë 23%. Nëse universitetet i paguajnë pedagogët për orët suplementare në mënyrë të vazhdueshme, siç parashikohet në aktet nënligjore, atëherë pedagogët nuk do ta paguajnë këtë.

Ndërkohë, për disa kërkesa të tjera jemi ende duke punuar, sepse kanë përlogaritur të efektive financiare dhe kërkohet bashkëpunimi me vetë

universitetet, siç është, për shembull, shtesa mbi pagë për dëshmërinë e shëndetit në punë dhe ku neve na duhet nga çdo universitet të dimë se cilat janë pozicionet e punës që paraqesin dëshmëri, ashtu sikurse edhe shtesa mbi pagë për vjetërsinë në punë, të cilën nga 0,5%, që është në vit, pedagogët e kërkojnë 1% për 25 vjet. Edhe për këtë ne jemi shumë të gatshëm, por na duhet të përlogarisim efektet financiare, çka do të thotë se nga universitetet na duhet...

Lindita Nikolla – Zonja Ministre, e dyfishuat kohën.

Evis Kushi – Ja mbarova.

...një informacion i plotë dhe i detajuar për të gjithë pedagogët, moshën që kanë dhe vjetërsinë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Xhixho, fjala për ju për t’u shprehur në lidhje me përgjigjen e dhënë nga ministrja.

Koha që keni në dispozicion është 3 minuta.

Erisa Xhixho – Zonja Ministre,

Unë jam shumë e ndërgjegjshme se këtu ai që i ka çelësat e buxhetit dhe që firmos pa lexuar fare është Kryeministri Rama. Por unë pres që ne si deputetë, si pedagogë dhe si kolegë t’u dalim në krahë kolegëve tanë, sepse kauza që ata ngrënë është e drejtë. Prisja që shumica prej nesh t’i mbështesnin dhe jo të pranonin kërcënimet dhe përçmimin e tyre nga Kryeministri, i cili fjalën dhe mendimin e lirë në këtë vend e ka problem shumë të madh. Ata pedagogë duhet të mbrojnë të drejtat e tyre përpara se të japin leksione, duke u bërë model për studentët dhe të rinjtë, të cilët më së pari duhet të dinë të ngrënë zërin dhe të luftojnë për të drejtat e tyre.

Ju vendosët të mos i dëgjoni dhe t’u jepni lëmoshë, duke përcjellë për këtë mesazhin se arsimit dhe pedagogët nuk janë aspak prioritet, pasi prioritet pa buxhet nuk ka. Në fakt, kjo është thënë në rezolutën e Parlamentit Europian, që flet konkretisht për buxhetin e Arsimit në Shqipëri, i cili është nga më të ulëtit. Nëse nuk doni të dëgjoni opozitën, dëgjoni projektrezolutën e Parlamentit Europian dhe progresraportin e Bashkimit Europian. Në politikë ato që flasin janë më shumë vendimmarrjet dhe këto tregojnë se cili është prioriteti juaj, si dhe ku i çoni paratë e vendit më të varfër në Europë. Edhe në këtë kohë të rëndë krize ju nuk i dërgoni paratë për qytetarët, por u jepni thërrime sa për të mbijetuar.

Me buxhetin e vitit 2023 qeveria tregoi edhe një herë se çfarë ka si prioritet, ndërkohë që shifrat flasin vetë. Kjo qeveri që injoron arsimin ka parashikuar 950 milionë euro për koncesione e PPP, si dhe 11 milionë euro për inceneratorin e Tiranës. Kjo qeveri ka hedhur poshtë me arrogancën e pushtetit amendamentin tonë për rritjen e financimit të kërkimit shkencor, pasi edhe sot na u parashtrua se në vitin 2030 Shqipëria do të mund të arrijë 1% të standardit të Bashkimit Europian të prodhimit të brendshëm bruto, gjithashtu edhe për pagat e pedagogëve.

Nga rritja e çmimeve të ardhurat në buxhet janë shtuar 500 milionë euro më shumë, por qeveria, që nuk paska lekë për rritjen e pagës së pedagogëve, nuk i kursen ato për pagesat e inceneratorëve fantazmë. Të gjithë e pamë me dronin e të vërtetës se çfarë ndodh në inceneratorin e Tiranës.

Së fundi, qeveria ka miratuar një VKM që u jep goditjen e radhës universiteteve, duke i shndërruar ato në fondacione. Me këtë VKM pronat publike do të ndryshojnë statusin e tyre juridik duke u bërë pronë e fondacionit, pra lehtësisht të tjetërsueshme. Në përpjekjen për mbijetesë koston do t'i shtohen edhe tarifat e studentëve që rrezikohen të rriten. Kjo është një VKM e paqartë dhe që lë mundësi për abuzim nga qeveria e inceneratorëve.

Sot universitetet po zbrazen me shpejtësi. Në Universitetin e Tiranës dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës sivjet janë regjistruar 10 studentë në degën e Fizikës, 12 studentë në degën e Kimisë, sepse drama e shpopullimit që po i ndodh vendit i ka kaluar edhe përmasat e Ukrainës për kërkesat për azil në Bashkimin Europian. Në fakt, kjo kërkon që ju ta njihni këtë realitetet, por ju nuk e njihni dhe nuk merrni masa konkrete për rritjen e pagave, për mbështetje direkte e të qenësishme për shtresat në nevojë dhe për hapjen e vendeve të reja të punës. Shqipëria nuk mund të jetë vendi i mundësive për disa, por duhet të jetë vendi i mundësive për të rinjtë, për intelektualët, dhe në radhë të parë për qytetarët e thjeshtë dhe të ndershëm të këtij vendi.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Vijojmë me çështjen tjetër të rendit të ditës.

Po, zonja Çupi. Për çfarë e kërkon fjalën?

Dhurata Çupi – Për procedurë.

Lindita Nikolla – Po.

Dhurata Çupi – Ne njoftohemi me *e-mail* për urdhrin tuaj mbi zhvillimin e seancës dhe për rendin e ditës, por në *e-mail* nuk na vijnë asnjëherë materialet që do të diskutohen dhe as projektligjet. Këtu, seancën e kaluar, u bë një diskutim i gjerë si është ligji, si është diskutuar në komision dhe nëse i ka reflektuar komisioni përgjegjës mendimet e komisioneve të tjera. Të gjithë deputetët e të dyja palëve ishin totalisht të paqartë për projektligjin që po miratohej këtu, respektivisht për Kodin Rrugor.

Zonja Kryetare,

Dua t'ju kërkoj që t'i jepni urdhrë administratës që, në momentin kur ne na vihet në dispozicion urdhri juaj për rendin e ditës, të kemi edhe materialet bashkëlidhur. Ju mund të thoni që i keni materialet këtu, në këtë mroklën këtu. Për kuriozitet unë e hapa dhe asgjë nuk lexohet në materialet që janë bashkëlidhur.

Në respekt, besoj se shpreh mendimin edhe të deputetëve të tjerë, në *e-mail*-in ku ne njoftohemi për rendin e ditës, do të ishte mirë të na vinin bashkëlidhur edhe projektligjet për të parë edhe reflektimet e ndryshme. Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, zonja Bushka mund ta konfirmojë këtë, kur ne bëjmë pyetje, nga stafi na thuhet se do t'ju njohim, nga administrata që mbron projektligjin ose nga ministria përkatëse na thuhet se do të na kthejnë përgjigje me *e-mail*, por ndërkohë nuk na vjen asnjë përgjigje për pyetjet që kemi bërë e për pasojë nuk shohim as reflektimet që kemi propozuar, amendime apo ndryshime të projektligjeve.

Zonja Kryetare, do të doja që këtë çështje ta merrni seriozisht në mënyrë që ne të njihemi me projektligjet, pasi një përqindje e mirë e deputetëve nuk dinë se çfarë votojnë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Në *e-mail*-in që ju vjen për rendin e ditës vjen edhe linku përkatës dhe po të klikoni në të, do të dalë dokumenti në faqen e internetit, pra raporti dhe projektligji. Megjithatë, kërkesën tuaj do ta kem parasysh.

Kalojmë te projektligji “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Ka pyetje? Nuk ka.

Fillojmë me diskutimin e projektligjit.

Si fillim do të kemi paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja, zëvendëskryeministrja Balluku.

Koha është e pakufizuar.

Belinda Balluku - E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sektori i energjisë, ndoshta, është një nga sektorët që ka pësuar një ndryshim rrënjësor dhe më të madhin në këtë 10-vjeçar, si dhe pa dyshim është një nga sektorët me të cilin ne krenohemi sot. Nga viti 2013 trashëguam një sektor energjetik të rrënuar, me një performancë jashtëzakonisht të dobët teknike dhe financiare. Furnizimi me energji elektrike ishte i paparashikueshëm dhe ndërprerjet e gjata ishin një fenomen dhe dukuri normale në atë kohë. Furnizimi me energji elektrike është një kërkesë bazike për çdo qytetar, për çdo biznes, për zhvillimin e një vendi, kështu që për qeverinë “Rama” sektori i energjisë elektrike ka qenë një sektor prioritar me të cilin jemi marrë nga dita e parë, si dhe vazhdojmë sot e kësaj dite që ta kemi në fokus të plotë.

Unë nuk do të rresht së përsërituri dhe as nuk do të mërzitem ndonjëherë kur dëgjoj nga pala opozitare të thotë “vazhdoni të krahasoheni me ne”, sepse, me thënë të drejtën, ne nuk kemi më kë të krahasohemi tjetër. Pavarësisht se nxitemi për të qenë më të mirë çdo ditë në punët që bëjmë, sërish do të krahasohemi me ata që ishin para nesh, sepse nuk ka se si të jetë ndryshe, pavarësisht se unë e di që është vështirë të dëgjosh se ku e kishin lënë vendin dhe si ka evoluar sot.

Në vitin 2013 sektori energjetik kishte 45% humbje teknike, pra rreth gjysma e energjisë që prodhohej apo që blihej me import humbte në mënyrë të paditur, por e njëjta situatë ndodhte edhe me parametrat financiarë. Pa dyshim, në atë kohë mbledhja e të ardhurave nga faturimi ishte një abstraksion, sepse përdorej sipas dëshirës së liderëve supremë të kohës, duke vendosur që do të përdorej për fushatë, pra vendosej një zonë e tërë që nuk duhej të paguante për disa muaj apo për politika sociale të çuditshme, që vetëm e rëndonin sektorin energjetik.

Gjithashtu, varësia nga importet ishte e lartë, sepse sërish u vendos që një pjesë e mirë e hidrocentraleve të jepej në shkëmbim të TVSH-së në atë kohë. Kështu që sot, ndërkohë që blejmë në import, energjinë e prodhuar nga një pjesë e hidrocentraleve të ndërhuara për t’i shërbyer këtij vendi e përdorin kompani që i kanë privatizuar

totalisht pa të drejtë. Plani i madh konsistonte vetëm në privatizimin e hidrocentraleve shtetërore dhe në ngritjen e hidrocentraleve të vogla pa studim, duke u hequr ujën e pijshëm apo ujën që përdorej për bujqësi të gjithë fshatrave dhe duke u hyrë në hak shqiptarëve, si zakonisht, nga mëngjesi deri në darkë.

Por qeveria “Rama” i ka bërë të gjitha ndryshe. Pikë së pari, ne kemi një strategji të mirëfilltë të zhvillimit të sektorit energjetik dhe mbi të gjitha një strategji që 4 vjetët e fundit tashmë ka marrë jetë, që është diversifikimi i burimeve të energjisë elektrike. Për të gjitha këto ne nuk bazohemi as te vërejtjet e portaleve të paguara, as tek insinuatat e opozitarëve të përfshirë në sektorin energjetik “me kokë dhe me këmbë”, por bazohemi në studime të mirëfillta, në direktivat e Bashkimit Europian, në direktivat e Sekretariatit të Energjisë, por mbi të gjitha ne bazohemi në të mirën e vendit.

Viti 2022 na ka treguar edhe një herë se sot siguria energjetike është prioritare, që energjia po përdoret si një armë kundër Europës, kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe këtë e kemi parë qartazi, siç kemi parë dhe diçka tjetër qartazi në vitin 2022. Qeveria shqiptare përmes një mirëmenaxhimi të kaskadës së Drinit, pavarësisht një viti shumë të thatë, përmes një mirëmenaxhimi edhe të importeve, ia doli që të ofronte një shërbim të pandërprerë për të gjithë qytetarët tanë, por mbi të gjitha të ofronte një shërbim, i cili nuk njohu as edhe një qindarkë rritje. Pavarësisht se çfarë u tha gjatë gjithë vitit 2022, që do të rritej çmimi, do të ndodhte kjo apo ajo, si gjithmonë dezinformime për të krijuar panik te njerëzit, asgjë nga të gjitha këto nuk ndodhi, sepse ne treguam edhe një herë se jemi një qeveri që dimë t’i menaxhojmë krizat, ashtu siç bëjmë me tërmetin, Covidin apo edhe me krizën energjetike.

Po kthehem te projektligji. Ne, me anë të një strategjie të mirëstuduar, synojmë që në vitin 2029 të krijojmë kapacitete të reja shtesë të prodhimit me 4 terravat nga prodhimi i sotëm, duke e bërë kështu Shqipërinë një vend eksportues neto dhe jo një vend importues siç është sot. Pavarësia energjetike e Shqipërisë është një prioritet i qeverisë “Rama”, por mbi të gjitha pavarësia energjetike e Shqipërisë do të jetë edhe një pavarësi energjetike për rajonin, ndaj prej kohësh ne kemi nisur të punojmë jo vetëm për

projektet e rëndësishme të energjisë së rinovueshme, por edhe për një projekt të rëndësishëm rajonal, i cili zhvillohet në Triportin e Vlorës, me një *hub* të shpërndarjes së LNG-së, një tub, i cili do ndërlidhë portin e Vlorës me pikën dalëse të Fierit dhe mbi të gjitha rivënien në punë të termocentralit të Vlorës, një termocentral i dështuar, të cilin opozita në atë kohë e trumbetoi si një arritje shumë të madhe dhe pasi u morën me qindra miliona euro kredi, të cilat vazhdojmë ende t'i paguajmë sot, nuk u vu asnjë ditë në punë. Për këtë askush nuk ka një përgjigje, për të thënë të drejtën, as ekspertët e jashtëzakonshëm të radhëve të opozitës në termat e energjisë.

Niveli i humbjeve sot në Republikën e Shqipërisë, nga 45% që ishte në 2013-n, është vetëm 19,7%. A kemi përpara punë për të bërë? Patjetër! Kemi edhe shumë punë për të bërë përpara, për ta ulur këtë nivel akoma edhe më shumë dhe për ta çuar në nivelin e humbjeve teknike europiane. Kemi shumë zona në Shqipëri që tashmë për shkak të ndërtimit të nënstacioneve të reja dhe të linjave të shpërndarjes, që janë totalisht të automatizuara dhe moderne, e kanë arritur atë nivel të përcaktuar, sipas të gjithë parametrave të Bashkimit European, por ne do të punojmë që në shkallë vendi ta arrijmë atë parametër.

Nga ana tjetër, sot që po flasim ne kemi nisur realizmin e disa projekteve shumë të rëndësishme për të vendosur në të gjitha nënstacionet dhe në kabinat e shpërndarjes matësit inteligjentë. Matësit inteligjentë, të cilët pasi të vendosen në mbi 26 mijë e 500 kabina dhe nënstacione, do të vazhdojmë t'i vendosim më pas edhe në çdo abonent familjar apo biznes, për të përmbyllur kështu një etapë shumë të rëndësishme, e cila do të ndikojë direkt në uljen e humbjeve teknike.

Po ashtu, sa i përket rrjetit të transmetimit, ne tashmë kemi një projekt në proces që lidh Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut përmes pikës së daljes në Bitola dhe ku të dyja shtetet po ecin paralelisht me ritme të kënaqshme. Nga ana tjetër, tashmë kemi një marrëveshje të miratuar me shtetin fqinj grek për rritjen e kapaciteteve të transmetimit, pasi linja me të cilën operojmë sot shpeshherë është e mbingarkuar. Ndërkohë, një lajm i shkëlqyer për sektorin energjetik është që në fund të këtij muaji bursa energjetike shqiptare do të jetë aktive dhe kjo do të shënojë një etapë të re për sektorin energjetik, që garanton kështu

transparencë, konkurrencë dhe përdorim efikas të kapaciteteve të transmetimit.

Energjia ka qenë dhe vijon të jetë një nga prioritetet tona kryesore dhe ne po punojmë intensivisht për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit si me investime, ashtu edhe me politikën e nevojshme ligjore dhe rregullatore për të nxitur rritjen dhe për të akomoduar të gjitha zhvillimet e reja politike dhe teknologjike.

Në këtë frymë kemi sjellë sot për miratim projektligjin e ri për burimet e rinovueshme të energjisë. Ky projektligj vjen si një përmirësim dhe plotësim i ligjit të vitit 2017 dhe të kuadrit të përgjithshëm rregullator, duke transpozuar direktivën europiane përkatëse. Po ashtu, kemi marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e ndryshme të organizmave, siç janë Komisioni European apo Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe IRENA, madje duke adresuar çështje, të cilat janë evidentuar gjatë dialogut të vazhdueshëm që ne mbajmë me investitorët dhe shoqatat e biznesit dhe kjo është diçka për të cilën Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka investuar ndër vite. Ne kemi një tryezë të hapur dialogu me të gjitha bizneset dhe shoqatat për të dëgjuar propozimet e tyre, sugjerimet, problemet me të cilat ata ndeshen dhe pa dyshim për t'i zgjidhur dhe adresuar ato në mënyrën më të mirë.

Konkretisht, projektligji synon nxitjen e diversifikimit dhe të përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme kundrejt konsumit energjetik final bruto në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë në masën 59,4% deri në vitin 2030, duke zvogëluar kështu importin e lëndëve djegëse fosile, emetimin e gazeve dhe efektin serrë, sigurisht duke rritur edhe sigurinë e furnizimit me energji në vendin tonë.

Gjithashtu, projektligji përcakton edhe masat mbështetëse në bazë të ankandeve konkurruese, si dhe tipologjinë e tyre bazuar në format e marrëveshjes për blerjen e energjisë, kontratës për diferencë dhe kontratës për prim. Diçka tjetër e rëndësishme, që adresohet përmes këtij projektligji, është kërkesa e grupeve të interesit lidhur me skemën e matjes së energjisë së gjeneruar nga vetë prodhuesit, duke kaluar nga bilanci mujor në një bilanc vjetor. Kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme, siç ka qenë edhe kërkesa e rritjes së kapaciteteve të autoprodhuesve. Nuk

është hera e parë që unë e sqaroj, prandaj do ta përdor edhe një herë foltoren e sotme për të thënë që Shqipëria ka nivelin më të lartë në Europë, së bashku me Greqinë, sa u përket kapaciteteve të autoprodhimit. Ne lejojmë një autoprodhim prej 500 kilovat-orësh, ndryshe nga shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor që e kanë disafish më të ulët, për të mos thënë që ka edhe disa prej tyre që deri më sot nuk e kanë aplikuar fare si procedurë. Por kërkesa për një faturim vjetor ishte një kërkesë që bënte sens, pasi do të arrijë që të rrisë eficiencën e të gjithë aktorëve, të cilët kanë marrë një iniciativë të shkëlqyer për të prodhuar energjinë që ata konsumojnë, të paktën një pjesë të saj.

Parashikime të tjera përfshijnë masa nxitëse dhe promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në sektorin e transportit, si dhe në të ngrohjes dhe të ftohjes. Sektori i transportit në Shqipëri është aktualisht ndotësi më i madh. Ne tashmë ofrojmë stimuj, si përjashtimi i TVSH-së, për pronarët e automjeteve që zgjedhin të kalojnë në automjete elektrike, si dhe kemi një strategji të tërë së bashku me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë për të krijuar në të gjithë vendin *facilitete* për karikimin e automjeteve elektrike. Duke qenë se kjo është një nga problematikat që na vjen sot nga tregu, ne duam që të kthehemi në përdorimin e automjeteve elektrike, por patjetër duhet të kemi edhe *facilitete* se ku do karikohen ato gjatë një trajektoreje të gjatë për të kaluar nga një qytet në tjetrin apo nga një krahinë në tjetrën.

Gjithashtu, ne po strukturojmë një strategji të re për sektorin e eficiencës së energjisë, e cila përmban disa hapa të rëndësishëm, siç jua thashë, për krijimin e infrastrukturës sa i përket karikimit të automjeteve elektrike, por edhe një sërë masash të tjera që do të ndihmojnë eficiencën. Siç jua kam thënë gjithmonë, por po e përsëris dhe një herë, eficientia e energjisë nuk ka të bëjë vetëm me uljen e konsumit, por edhe me edukimin e qytetarëve për të kuptuar se ata janë një pjesë integrale e të gjithë këtij procesi të rëndësishëm të sektorit energjetik.

Ne jo vetëm prodhojmë energji të rinovueshme, jo vetëm diversifikojmë burimet tona, siç është rasti i ankandeve që kemi pasur dhe i kemi dorëzuar me sukses në rastin e parqeve fotovoltaike, apo siç kemi ankandin hibrid të parqeve të erës, i cili do të mbyllet në qershor, por,

nga ana tjetër, është i nevojshëm bashkëpunimi i qytetarëve për kursimin e energjisë, për të kuptuar që eficientia energjetike është një nga çelësat e suksesit, siç treguam në bashkëpunimin që patëm së bashku në vitin 2022.

Me të gjitha masat e ndërmarra, ky projektligj mundëson edhe mbështetjen që mund t'u jepen tashmë edhe iniciativave për depozitimin e energjisë elektrike, që deri më sot nuk e kemi pasur të parashikuar në ligj, dhe ankandeve. Pra, sot e tutje, me miratimin e këtij ligji gjithçka do të bazohet tek ankandet transparente. Republika e Shqipërisë ka një eksperiencë shumë të mirë të krijuar dhe kuotohet nga BE-ja si një nga vendet me suksesin më të lartë sa i përket ndërtimit të parqeve fotovoltaike dhe eolike, përmes procedurave që janë kthyer në model, që, duhet ta themi, i kemi bërë së bashku me BERZH-in, që gjej rastin ta falënderoj sërish!

Sektori i energjisë elektrike është dhe do të mbetet prioritet i qeverisë shqiptare. Ky sektor është ai që e ka bërë Shqipërinë të jetë krenare për të gjitha avancimet që kemi bërë që nga viti 2013 e deri sot. Sektori i energjisë elektrike kërkon një vëmendje të shtuar jo vetëm nga qeveria, jo vetëm nga institucionet, jo vetëm nga bizneset, por edhe nga vetë qytetarët, pasi të gjithë së bashku mund t'ia dalim që ta bëjmë Shqipërinë një nga vendet më të rëndësishme të Ballkanit për sa i përket prodhimit, shpërndarjes, transmetimit dhe, pse jo, politikave të reja në fushën e sektorit energjetik.

Ndaj, sot do të kërkoja nga ju që ta mbështesim dhe ta votojmë të gjithë së bashku këtë projektligj shumë të rëndësishëm për qytetarët tanë, për bizneset, për zhvillimin ekonomik dhe, pa dyshim, për të gjithë rajonin.

Shumë faleminderit, për vëmendjen!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Hapim diskutimet për projektligjin.

Fjala për zotin Shalsi.

Të përgatitet zoti Xhelal Mziu.

Eduard Shalsi – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në pamundësi për të folur në seancën e kaluar, do të doja të shprehja falënderimet për të gjithë ata që luajtën një rol në miratimin e ndryshimeve të Kodit Rrugor!

Në fakt, një nga gjërat e mira të opozitës ishte pjesëmarrja në debatet parlamentare në lidhje me përmirësimet e dukshme që iu bënë Kodit. Është një dëshmi, në fakt, se si, kur mund

t'i thirret arsyes, mund të bëhen ndryshime, të cilat, larg politikës së rëndomtë, hera-herës banale, sjellin gjëra pozitive për qytetarët. Debat ka qenë shumë profesional, ndaj edhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, së bashku me deputetët e opozitës meritojnë falënderime për ndryshimin e sjellë!

Nga ana tjetër, do të doja të falënderoja qeverinë dhe ministren e Energjisë jo thjesht dhe vetëm për këto ndryshime të fundit të ligjit, por për politikën dhe vizionin e qartë që kanë sjellë, për atë se ku duhet të jetë Shqipëria në vitin 2030!

Sistemin energjetik e morëm në kolaps në vitin 2013, ishte një gropë e madhe jo thjesht energjetike, por edhe ekonomike. Ku jemi sot? Sot është bërë një progres i jashtëzakonshëm, në fakt. Në vitin 2017 u miratua ligji për energjinë e rinovueshme, më tej disa akte nënligjore filluan të bënin të mundur zbatimin e tij.

Për shkak se nuk u diskutua në Komisionin e Ekonomisë, dëgjova debatin në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, ku disa nga deputetët e opozitës ishin të habitur apo të shastisur për faktin se si ishte e mundur që nuk kishte komente në *web-in* ku ishin publikuar ndryshimet ligjore për konsultë. Në fakt, ministria ka bërë diçka: nuk ka pritur të shkruanin të gjithë ata që mund të kontribuonin, por i ka ftuar paraprakisht, ashtu sikundër bëri edhe me aktet nënligjore në zbatim të ligjit të energjive të rinovueshme. Kjo është ajo që ne duhet të inkurajojmë. Pra, pjesë e suksesit të këtij ligji është pikërisht hapja e dyerve të ministrisë për të lejuar cilindo ekspert të fushës, apo edhe grup interesi, të kontribuonte dhe, për rrjedhojë, sot kemi një ligj të përmirësuar.

Sigurisht që Shqipëria ka vendosur raporte jashtëzakonisht të mira me partnerët tanë të pazëvendësueshëm, me Komunitetin e Energjisë në Vjenë, por edhe me donatorët. Së bashku me BERZH-in janë organizuar ankande, të cilat sot po shërbejnë si modele për vendet e tjera, siç ishin ankandet e impianteve fotovoltaike, ndërkohë që ka një impiant eolik, që po i nënshtrohet një gare.

Gjej rastin të falënderoj jo thjesht institucionet financiare, në rastin konkret BERZH-in, por edhe donatorët, të cilët janë pjesë përbërëse e një strategjie, e cila në vitin 2030 synon që konsumi i energjisë nga burimet e rinovueshme të jetë në masën 54%! Nuk besoj se nuk kuptohet arritja e objektivit të mëparshëm, madje tejkalimi, do të thosha, që ishte 38% e

konsumit nga burimet e energjisë së rinovueshme dhe u bë në masën 40% në vitet 2021-2022. Janë disa politika, të cilat e kanë futur më në fund Shqipërinë drejt një shtrati të qëndrueshëm dhe, në fakt, këto duhet të jenë debatet, që në vendet e tjera gëlojnë qoftë në qeveri apo në parlamente. Shpesh më vjen ndot nga disa lloje debatesh, të cilat as nuk u shërbejnë qytetarëve, që na kanë sjellë në parlament, dhe as nuk i shërbejnë Shqipërisë, ndërkohë që debatet për diversifikimin e burimeve të energjisë, për mundësinë e jashtëzakonshme dhe të pashfrytëzuar të Shqipërisë për shumë e shumë vite me radhë për burimet e energjisë, kanë zënë dhe zënë shumë pak nga pesha që duhet të zënë në parlament apo në debatin publik.

Ligji ka disa risi dhe, në fakt, një nga problemet me vetëprodhuesit, ku, sot që flasim, Shqipëria ka zhvilluar një shtresë të qenësishme investitorësh, që po kontribuojnë thelbësisht në sektorin e energjisë, ka të bëjë me llogaritjen mbi bazën mujore, ndërkohë që ky ligj e korrekton "mbi bazën vjetore". Në fakt, kjo është një arritje për t'u përshëndetur, dhe është përshëndetur nga grupet e interesit.

Ka pasur edhe një kërkesë të dytë, për hir të së vërtetës, që ka pasur të bëjë me shtimin e kapacitetit mbi 500 kilovatë (atë të lejuarin), por analizat treguan qartë që Shqipëria ishte në pararojë në rajon dhe ishin një ose dy vende që e kishin mbi 500. Ndërkohë, për sipërmarrësit që duan të përballojnë kërkesat e tyre (ishte një numër shumë i kufizuar) dyert e ministrisë janë të hapura për të marrë në konsideratë kërkesat mbi 500 kilovatë, por pa qenë domosdoshmërisht si vetëprodhues (mund ta marrin si prodhues).

Pra, kuadri ligjor po përmirësohet. I rëndësishëm është edhe kuadri institucional. Do të kemi një ent më vete, për të cilin, me të drejtë, u pyet nga kolegët deputetë nëse ka kosto ekonomike apo jo për agjencinë që do të menaxhojë burimet e rinovueshme. Në fakt, kemi një kalim nga një drejtori, në mos gaboj, pranë AKBN-së, në një institucion më vete, çka do të thotë se kostot ekzistuese thjesht do të transferohen në rimodelimin dhe në krijimin e kësaj agjencie.

Po e shohim se ka pasur politika mbështetëse për këtë sektor; të gjithë e dimë (këtu ka të bëjë edhe një risi, e cila është për t'u përshëndetur në këtë ligj), se ka pasur një kontratë

feed-in, fikse, pra me një çmim dysHEME të përcaktuar. Sot me këtë ndryshim, kompanive prodhuese u jepet mundësia që të firmosin një kontratë me autoritetin përkatës për diferencën, që do të thotë se, nëse energjia shitet më lirë se në bursë, do të kompensohet për diferencën. Në fakt, është një vendim i drejtë dhe i shumëpritur.

Nga ana tjetër, ne jemi të vetëdijshëm për politikën kaotike të viteve 2000, ku u dha pa kriter shfrytëzimi i lumenjve për të ndërtuar HEC-e edhe aty ku nuk duhej, pa një politikë dhe pa një strategji të qartë. Sot sfida është diversifikimi i portofolit për të mos u mbështetur vetëm në reshje. Ndaj, nëse Shqipëria sot 98% e prodhon nga burime hidrike dhe 2% po shtohet me shpejtësi, politikën duken të qarta, edhe në bazë të ankandëve që po zhvillohen, të atyre që janë zhvilluar dhe që do të zhvillohen, që të diversifikohet portofoli. Jemi jashtëzakonisht optimistë që Shqipëria do të shndërrohet nga një vend importues, në një vend eksportues të energjisë.

Faleminderit, edhe një herë, gjithkujt që e bëri të mundur këtë ndryshim!

Le të fokusohemi te debate të tilla, të cilat dukshëm ndikojnë në ekonominë dhe në jetën e qytetarëve, që na kanë zgjedhur pikërisht për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zotin Xhelal Mziu.

Të përgatitet zonja Enslëmvera Zake.

Xhelal Mziu – E nderuar Kryetare,

Të dashur qytetarë,

Duke marrë shkas edhe nga komunikimi i parafolësve, që Shqipëria në vitin 2013 kishte qenë si në vitin 1938, në fakt, kjo më duket pak absurde, sepse vitin e kaluar, për herë të parë, energjia që prodhohet nga privatët e tejkaloi 50-përqindëshin, dhe kjo për shkak të liberalizimit, nxitjes dhe prodhimit të energjisë nga privatët.

Së dyti, pavarësisht se abuzohet me humbjet e atyre viteve, duhet t'ju them se jo vetëm që nuk është ajo shifër që ju pretendoni, se ka qenë shumë herë më pak, por me mijëra familje në nevojë nuk e paguanin energjinë elektrike e, në fakt, me ardhjen tuaj në pushtet, në vitin 2013, përdoret çdo instrument ligjor dhe antiligjor dhe me mijëra kryefamiljarë u penalizuan dhe shkuan në burg, madje pati nga ata që varën edhe veten për shkak

të mospagesës, qoftë edhe për 3500 lekë, si debitorë të energjisë elektrike.

Për të shkuar më tej, sot OSHEE-ja nuk është sektori më i suksesshëm, por është debitori më i madh i buxhetit të shtetit, dhe jo vetëm atë, por po të shohësh Universitetin Bujqësor të Tiranës, jo pak herë gjatë kohës së leksioneve detyrohemi të hapim perdet e sallave, sepse ikën energjia elektrike. E, për të shkuar në Kodër-Kamzë apo në zona të tjera, edhe sot, në vitin 2023, nuk ka energji elektrike, pavarësisht se janë shpenzuar me miliona e miliarda euro për të krijuar këtë lloj standardi. Nuk ishte normale të mos nxitej energjia elektrike në vitin 2013 e në vazhdim, por, përkundrazi, në vitin 2014 u ndërmor një iniciativë e qeverisë për uljen e çmimit të prodhuesve, duke i demoralizuar dhe duke mos i nxitur, madje jo vetëm atë, por për shkak të ndërrimit të ministrave në mënyrë permanente, sa herë që vinte ministri i radhës, i bllokonte ata të mëparshmit e, për pasojë, sot e kësaj dite më shumë se 100 HEC-e nuk funksionojnë. Imagjinoni nëse do të kishin qenë ato!

Nuk është koha për t'u bërë thirrje qytetarëve dhe abonentëve që ne të kthehemi në eksportues të energjisë elektrike, por i duhet bërë thirrje qeverisë, që ta liberalizojë, ta heqë monopolin dhe t'i krijojë të gjitha mundësitë dhe rrethanat, sepse i kemi të gjitha potencialet e nevojshme hidrike, por edhe të energjisë së rinovueshme, për të pasur një eksport dhe për të qenë konkurrues jo vetëm për të mbuluar nevojat tona, por për të mbështetur me furnizim me energji elektrike vendet e rajonit e më gjerë.

Projektligji për të cilin po flasim sot është shumë i rëndësishëm, në fakt, duhet të kishte qenë i kahershëm. I njëjti projektligj, por me ndryshime, është bërë edhe në vitin 2017, por edhe sot, pas 6 vjetësh, është i paaksesueshëm, për shkak të vakumeve që ka pasur në këta 6 vjet.

Për të ardhur te projektligji i sotëm, do të thosha se ka mjaft defekte, që e bëjnë atë jo vetëm të paaksesueshëm, por do të krijojnë të tjera barriera për ta liberalizuar këtë sektor shumë të rëndësishëm, për të krijuar diversifikimin dhe për të ndaluar importin e lëndëve të para për prodhimin e energjisë dhe, ajo që është më e rëndësishmja, për t'u dhënë mundësinë edhe zonave të thella, që jo vetëm të prodhohet energji,

por të shfrytëzohen edhe potencialet e zonave rurale.

Po të shohësh projektligjin, thuhet se në vitin 2030 do të prodhohet 54,4% e energjisë nga burimet e rinovueshme. Se ku e kanë gjetur këtë kalkulim me presje dhjetore për vitin 2030, më duket absurde!

Një tjetër instrument, i cili më bën të jem skeptik është kur thuhet se do të ketë projekte demonstruese dhe do të përdoret sistemi i pikëzimit, çka do të thotë se do të krijohet mundësia e abuzimit në këtë sektor shumë të rëndësishëm. Po ta lexoni projektligjin, emri i ministrit përmendet 46 herë dhe jo vetëm aq, por ka plot 38 kompetenca. Unë jam i sigurt që kjo do ta bëj telef ministrin, për t'u marrë vetëm me zbatimin e këtij ligji! Do ta ketë të pamundur që ta justifikojë. Duke marrë shkas nga kjo, ky nuk do të jetë një ligj, por do të jetë një akt normativ, që do të varet vetëm nga ministri. Në fakt, nuk është vetëm kaq, por do të përdoret primi, një element abuziv për kompani të caktuara, që do të rrisë jo vetëm klientelizmin, abuzimin, por edhe korrupsionin në këtë sektor mjaft të rëndësishëm. Madje, meqenëse do të përdoret elementi demonstrativ i ngritjes së këtij sektori, druaj se do të përdoret si skema e inceneratorëve, ku do të lidhen kontrata 15-vjeçare, që në fund jo vetëm nuk do të jenë produktive, si inceneratorët, por do të jetë një skemë abuzive për këtë sektor mjaft të rëndësishëm, për të mos u marrë me pjesën tjetër, që do të ngrihet Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER), e cila bëhet dhe auditohet nga ministria, si dhe shumë elemente të tjera, që të bëjnë të dyshosh. E me shumë gjasa, në fakt, ngritja e kësaj drejtorie shumë të rëndësishme do t'i shtohet vargut të OSHEE-së, ERE-s, FTL-së apo OST-së, që do t'i kushtojë me miliona euro buxhetit të shtetit, madje do të kemi edhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo drejtorët e mëdhenj, të cilët do ta tejkalojnë masën 10 milionë lekë në muaj. Pra, kjo do të jetë një tjetër barrë e rëndë për abonentët shqiptarë dhe për pasojë produkti nuk do të jetë ai që kërkohet.

U fol shumë se është komunikuar edhe me grupet e interesit. Në fakt, kemi pasur rastin që të ishim me grupet e interesit dhe i kemi dëgjuar kur kanë shprehur pakënaqësitë e tyre edhe për këtë projektligj.

Për të mos folur për shumë gjëra të tjera, mjafton të shohësh vetëm transportin, ku edhe sot

ka disa prodhues të energjisë elektrike, të cilët nuk mund ta transmetojnë energjinë elektrike, sepse nuk ka rrjet, apo për shkaqe burokratike, siguresa apo shkaqe të tjera, dhe nuk transmetohet energjia elektrike apo nuk përballohet ngarkesa.

Nëse shkojmë edhe më tej, projektligji ka jo pak, por 16 akte nënligjore, pra kthehet tamam si një vendim i Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ka edhe mjaft probleme të tjera, të cilat e bëjnë të pazbatueshëm ose joliberalizues këtë sektor shumë të rëndësishëm. Midis pretendimeve, të cilat nuk janë realizuar, është edhe kompensimi i disbalancës. Ministrja tha se do të ketë subvencionim ose do të jepet për diferencë dhe urojmë që të realizohet.

Një problem tjetër, që nuk ka gjetur zgjidhje dhe është ngritur me të madhe nga prodhuesit e energjisë elektrike, janë taksat vendore dhe taksa e ndikimit në mjedis, ku te disa prodhues vlera e tyre shkon sa xhiroja vjetore, pra një tjetër element, i cili e ndrydh këtë sektor shumë të rëndësishëm.

Elementi tjetër, që do të ndikonte, ishte kërkesa për të rritur tavanin për prodhuesit jo në 0,5 mega, por në 1 mega, sepse do të ishte një mundësi më e mirë, që do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve jo vetëm për nevojat e këtyre subjekteve private, por edhe për sektorë të tjerë mjaft të rëndësishëm.

Kërkesa tjetër ishte që për kuota të vogla të mos ishte ministria ajo që duhet të japë autorizimin, por të ishin bashkitë, madje duke dhënë vetëm thjesht një deklaramë e më pas për ta çliruar këtë sektor shumë të rëndësishëm.

Shqipëria i ka të gjitha kapacitetet e nevojshme për të qenë agresive në këtë treg dhe mjafton vetëm që qeveria të heqë monopolin, të liberalizojë prodhimin e energjisë hidrike, prodhimin e energjisë diellore dhe atë të erës dhe të mos u japë prona shtetërore klientëve të lidhur me pushtetin, por të bëjë liberalizimin, sepse është i vetmi element i rëndësishëm, i cili do ta kthejë Shqipërinë jo vetëm në një vend që përballon vetëm nevojat e tij, por në një vend vërtet konkurrues në treg.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zëvendëskryeministren.

Belinda Balluku – Për të thënë të drejtën, si prezantimi im i mëparshëm, si prezantimi i kryetarit të Komisionit të Ekonomisë ishin

shterues. Megjithatë, po kërkoj vëmendjen tuaj dhe ndoshta e kthejmë dhe në lodhje këtë bashkëbisedim, por nuk mund të thuhen vazhdimisht të pavërteta, se ato nuk janë vetëm të tilla, po nganjëherë kthehen dhe në fakte gesharake.

U kërkuva kuota për bashkitë. As nuk e kuptoj fare si nocion se ç' do të thotë që të jepen kuotat e vogla, që t'i shpërndajnë bashkitë, sepse këtu nuk është Pazari i Korçës, që t'i japim meqë janë të vogla, t'i marrin bashkitë dhe të bëjnë çfarë të duan, por këtu flitet për sektorin energjetik. Por kuptova që ju as nuk e njihni sektorin energjetik, as nuk e dini se çfarë është, sepse referuat që OSHEE-ja, pra sektori energjetik, është në ditë të zezë.

I nderuar deputet,

OSHEE-ja është thjesht dhe vetëm Operatori i Shpërndarjes, një nga komponentët e kompanive që operojnë në sektorin energjetik. Kështu që, për dijeninë tuaj, nëse OSHEE-ja ka sot e kësaj dite probleme, janë probleme të bartura, sepse e thatë dhe vetë që, po, faturimi ishte në ditë të zezë, por kur erdhët ju vendosët ligjin dhe aplikuat ligjin. Ne vetëm këtë dimë të bëjmë, i nderuar deputet, ne dimë të zbatojmë ligjin. Kështu që kur ofrohet një shërbim dhe ai shërbim nuk paguhet, atëherë duhet vendosur ligji. Ju nuk mund ta ktheni këtë në një dramë, në një melodramë, jo po u futën në burg, jo po varën veten e të tjera, se nuk është lojë kjo, që të luani ju çdo herë këtu, në foltore, me jetët e njerëzve.

Kur paguan energjinë elektrike dikush paguan një shërbim, siç duhet paguar uji dhe siç duhet paguar gjithçka. Por, siç e thashë edhe në fjalën time, ju e kishit kthyer faturën e energjisë elektrike në një premtim elektorale dhe e kishit gënjyer popullin shqiptar, duke e tërhequr në një lojë të rrezikshme, sepse u thoshit votuesve të zonave të tëra: "Mos paguani këta 6 muaj, sepse s'ka problem", dhe ndërkohë nuk ua paguanit ju nga xhepi, por ia linit atje OSHEE-së, që t'i bëheshin palë-palë dhe të krijoheshin këto borxhet e këqija, për të cilat flisni ju, që vazhdojnë dhe barten sot e kësaj dite. Ka qenë një lojë juaja kjo; ka qenë një lojë që e përdornit për arsye elektorale dhe krijuat atë gropë që krijuat, por që sot nuk ka asnjë krahasim me çfarë latë.

Erdhe këtu dhe fole që ne ia futkemi kot që humbjet teknike kanë qenë 45%! Ne gjithçka flasim e kemi të bazuar mbi fakte e mbi shifra. Ti,

që thua që ia fusim kot, sa kanë qenë këto humbje në 2013-n dhe mbi cilat fakte dhe shifra flet ti sot, që nuk ke asnjë ekspertizë për sektorin energjetik dhe, për më tepër, vjen dhe tregon se si duhet ta marrin bashkitë dhe ta përdorin? Për të cilët ministra që ndryshohen herë pas here flet ti?! Se kjo ka ndodhur në kohën tuaj. Qeveria "Rama" njihet për stabilitet. Para meje, për 5 vjet ka qenë kolegu im Damian Gjijknuri, i cili e nisi të gjithë reformën e sektorit energjetik, dhe unë kam katër vjet në detyrë. Vjen këtu dhe flet për diversifikimin! Dy ministra ka pasur qeveria "Rama": Damian Gjijknuri dhe unë. Kur jemi ndërruar ne dhe paskemi ndërruar politika, që e ditke ti dhe s'e ditkemi ne?! Del këtu në foltore dhe nuk thua asnjë të vërtetë, por unë nuk e di: janë gënjeshtra ato që thua apo thjesht je i painformuar? Për cilin diversifikim flet ti që duhet të ndodhë, kur sot në Republikën e Shqipërisë kemi diversifikuar burimet e rinovueshme? Ke qenë nëpër komisione, vjen këtu sot dhe shiko çfarë thua, se ishte shumë e bukur kjo: "54,4%, e paskeni nxjerrë dhe me presje dhjetore", se ty të duket shumë e çuditshme si mund të dalin presjet dhjetore! Dalin! Dalin dhe presjet dhjetore, dhe thua se do të jetë në 2030-n prodhimi. Jo prodhimi, jo! Prodhimi është sot 100% energji e rinovueshme, s'e paske marrë vesh vetëm ti, se këtë e di e gjithë bota. Flitet jo për prodhimin, por për përdorimin, sepse sot është 40% dhe në 2030-n duam ta çojmë 54,4%, sepse, siç ti e di, ne shesim, blejmë, importojmë, eksportojmë energji, dhe kur importojmë, nuk importojmë energji të rinovueshme, siç ti e kupton, sepse importojmë në kulmin e krizës energjetike, kur zakonisht nuk ka ujë asnjë nga vendet e rajonit. Pra, importojmë energji që prodhohet nga fosilet, dhe për këtë arsye ne sot kemi 40% energji të rinovueshme në përdorim, jo në prodhim. Unë nuk e kuptoj sesi mund të të sqaroj ty këtu në seancë, ndërkohë që ti ke qenë nëpër komisione për javë të tëra!

Flet për grupe interesi të mërzitura. E tha shumë bukur kryetari i Komisionit të Ekonomisë. Çuditërisht ju vetë jeni habitur që nuk kishte asnjë koment! Dhe e dini pse nuk kishte? Se është ulur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me të gjitha grupet e interesit për muaj të tërë dhe i kemi adresuar kërkesat e tyre.

Më dëgjo, se merresh vetëm me Butrintin! Më dëgjo, se Butrinti ka energji elektrike, gjithashtu!

Kini parasysh se kjo është diçka e rëndësishme, me të cilën nuk mund të bëni propagandë të mbrapshtë. Sektori energjetik shqiptar sot është kthyer në një shembull për të gjithë Ballkanin. Diversifikimi i burimeve energjetike të rinovueshme ka ardhur përmes ankandeve transparente, të cilat BERZH-i dhe Sekretariati i Energjisë i marrin për shembuj suksesi dhe i përmendin në çdo tryezë. Është detyra juaj të fajësoni qeverinë për gjithçka, është detyra juaj (se kështu bëhet opozitë ditët e sotme) të thonit që ne nuk po bëjmë asgjë, por në sektorin energjetik ka një problem: nuk ka propagandë, ka shifra dhe fakte, të cilat nuk i kontestoni dot ju. Për më tepër, faktet që sillni ju janë dhe qesharake dhe, për të thënë të drejtën, na vënë dhe ne në pozitë të sikletshme që të dalim këtu dhe të sqarojmë se çfarë është 54,4%-ëshi, që është përdorimi i energji të rinovueshme.

Sa e turpshme të vish sot këtu dhe të thuash që krijimi i Operatorit të Energjisë së Rinovueshme qenka një vendim abuziv! Jo, i nderuar deputet, është një kërkesë shumë e hershme e Komisionit Europian, është kërkesë shumë e hershme e Sekretariatit të Energjisë, për të cilën ne kemi punuar që nga 2013-a dhe deri më sot, dhe me këtë ligj, që do ta aprovojmë të gjithë së bashku (shpresoj dhe besoj shumë), do të arrijmë të krijojmë Operatorin e Energji të Rinovueshme, për të cilin Shqipëria është dhe krenare, sepse është vend që prodhon 100% energji të rinovueshme dhe targetet do t'i kapë më përpara se të gjitha vendet e tjera të Bashkimit Europian.

Shumë faleminderit!

Lindita Nikolla - Dy minuta replikë.

Xhelal Mziu – Në projektligj thuhet se deri në vitin 2030 objektivi kryesor kombëtar është që 54,4% e energjisë të vijë nga burimet e rinovueshme. Uroj që ministrja ta rilexojë!

Së dyti, ajo çfarë i djeg ministres është se unë përmenda një ndër problemet që kishim në takimin me grupet e interesit për prodhimin e energjisë, që kanë një prodhim shumë të vogël, personal apo jo me kapacitet të madh, që të mos ishte ministrja ajo që duhet të jepte autorizimin për këtë prodhim, por të ishte në autoritetin e pushtetit vendor. E, në fakt, ministrja, gjatë gjithë fjalës në replikën e saj, foli për heqjen e kësaj kompetence, dhe jo vetëm kaq, por ajo e harron edhe një herë situatën në të cilën ndodhet sot.

Ngritja e kësaj strukture të re, ka patjetër një kosto shtesë. Një projektligj, që ka 38 kompetenca të ministres, është abuzim. Fakti që një ministre e ka nën varësi këtë strukturë dhe auditimin e saj, është korruptiv, dhe jo vetëm kaq, por ngritja e kësaj strukture të re do t'i kushtojë buxhetit të shtetit, njësoj si OSHEE-ja, OST-ja, TPL-ja apo KESH-i, të cilat janë kthyer në një gangrenë edhe për shkak të patronazhistëve, edhe për shkak të pagave, sidomos të këshillit mbikëqyrës, që marrin deri në 10 milionë lekë, gati 8 herë më shumë se paga e një deputeti apo 5 herë më shumë se paga e një ministri. Kjo është shqetësuese.

Një tjetër instrument dhe më kryesori është jo për t'u kthyer në eksportues, por për të krijuar standardin në Shqipëri...

Lindita Nikolla - Përfundojeni, se ju mbaroi koha!

Xhelal Mziu – ...dhe, në fakt, për shkak të kësaj ministreje, sot në terren kemi një situatë për të ardhur keq, ku nuk ka energji elektrike ose ku sistemi i shpërndarjes është në ditën më të keqe që nga viti 1970.

Lindita Nikolla - Ju mbaroi koha, zoti Mziu!

Vijojmë me fjalën e zonjës Enslemvera Zake.

Të përgatitet zoti Sali Berisha.

Enslemvera Zake - E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” ka për qëllim të nxisë rritjen e sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të diversifikuara, siç mund të jenë era, dielli e të tjera, duke i lehtësuar të gjithë të interesuarit për procedurat që duhet të ndiqen, duke i vendosur në një kuadër rregullator ligjor.

Risitë e projektligjit janë sqaruar në mënyrë të detajuar nga zëvendëskryeministrja, dhe unë nuk po ndalem tek to, por do të ndalem vetëm te dy propozimet e bëra nga zoti Vasili, që kanë kaluar edhe në Komisionin e Ekonomisë, dhe tek arsyet pse këto dy propozime nuk janë miratuar dhe nuk janë bërë pjesë e këtij projektligji.

Sipas propozuesit, kërkohet të rritet kapaciteti nga 500 kilovatë në 2 megavat të kapacitetit total të instaluar të lejuar për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose nga dielli, nga një shoqëri e vogël dhe e mesme ose nga një klient familjar.

Sugjerimi i propozuesit është që energjia e tepërt të futet në rrjetin e shpërndarjes me pagesë dhe sugjerohet që të subvencionohet ndërtimi i impianteve fotovoltaike familjare, për të nxitur rritjen e tyre.

Gjithashtu, propozohet që bilanci vjetor neto i energjisë të përgatitet në bazë vjetore, nga mujore që është aktualisht.

Sa për informacion, aktualisht, një shoqëri e vogël dhe e mesme, ose një klient familjar, ka të drejtë të instalojë një kapacitet total deri në 500 kilovat për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose nga dielli, për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë për plotësimin e nevojave të tij dhe për ta injektuar në rrjetin e shpërndarjes energjinë elektrike të prodhuar.

Gjithashtu, momentalisht, bilanci neto dhe faturimi bëhen në baza mujore për secilën pikë matëse dhe ky dokument do të shërbejë si bazë për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike që do t'i shitet furnizuesit të shërbimit universal.

Duke u bazuar në argumentet e mëposhtme, jemi të mendimit që këto dy propozime kanë rënë dhe nuk janë votuar në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.

Së pari, lidhur me rritjen nga 500 kilovatë në 2 megavat të kapacitetit të instaluar të vetëprodhuesve, në raport edhe me qëllimin e kërkuar për aplikimin e kësaj skeme, sqarojmë se ky kapacitet ekzistues i lejuar prej 500 kilovatesh, për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, i plotëson nevojat e vetëprodhuesve dhe është më i larti në rajon, kjo duke u krahasuar edhe me skemat e ngjashme të aplikuara, si dhe në raport me sigurinë dhe kapacitetin e rrjetit të shpërndarjes. Një vetëprodhues është një person që prodhon energji elektrike, e konsumon kryesisht për nevojat e veta personale dhe pjesën e tepërt e derdh në rrjet pa pagesë.

Për dijeni, Maqedonia e Veriut lejon për familjarët 6 kilovatë dhe për bizneset deri në 40 kilovatë kapacitete për t'u instaluar nga ky lloj prodhimi energjie. Aktualisht, në vendin tonë janë instaluar 100 megavat kapacitete fotovoltaike të subjekteve për vetëprodhim. Nga këto, rreth 80% janë instaluar nga bizneset dhe 20% nga familjarët. Pra, ka një sasi shumë të lartë të instalimit të paneleve fotovoltaike për vetëprodhim, për shkak të skemës incentivuese shumë të gjerë që ka vendi ynë.

Për sa i përket planit të klimës së energjisë, vendi ynë deri në vitin 2020 ka pasur një targetim që 38% e konsumit bruto final të sigurohet nga burime të rinovueshme. Këtë target ne e kemi tejkaluar, sepse në vitin 2020 është arritur që nga burimet e rinovueshme të sigurohet 45% e konsumit, ndërsa në vitin 2021 është siguruar 40% e konsumit. Deri në vitin 2030 targeti i energjisë së rinovueshme në Shqipëri është 54% e konsumit. Ky tregues është më i lartë se rajoni.

Çështja e dytë kryesore, tek e cila duhet të ndalemi, lidhet me efektet financiare të propozimeve që janë bërë. Në relacionin e propozuesit nuk janë përcaktuar efektet financiare shtesë që do t'i kushtojnë buxhetit të shtetit. Pra, propozuesi nuk ka bërë një studim apo parashikim, referuar këtij neni që ka propozuar, se sa do të jetë kërkesa nga individë apo biznese të vogla për shtimin e kapacitetit nga 500 kilovatë në 2 megavatë dhe sa do t'i kushtojë buxhetit të shtetit shitja e tepicës për kufirin nga 500 kilovatë në 2 megavatë. Pra, sa është parashikimi i tepicës së energjisë që do të derdhet në rrjet dhe sa do t'i kushtojë kjo buxhetit të shtetit për të rimbursuar klientët familjarë apo bizneset e vogla?

Lidhur me propozimin që bilanci neto të bëhet në bazë vjetore, ndërsa faturimi të mbetet mujor, kjo është pjesë e projektligjit të plotë, të cilën e ka sqaruar edhe zëvendëskryeministrja dhe nuk po ndalem.

Për sa i përket propozimit tjetër, lidhur me sektorin e energjisë elektrike, që dhënia e lejes për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë, të cilat nuk janë objekt koncesioni, të bëhet nga agjencia përgjegjëse për burimet natyrore, bie në kundërshtim me fushën e veprimtarisë së kësaj agjencie, kolegu Mziu. Kjo agjenci ka funksion zhvillues e monitorues dhe kryen oponenca lidhur me projektet e reja të energjisë dhe nuk mund të japë leje për ndërtimin e tyre. Ndërsa për propozimin për dhënie të lejes nga Operatori i Shpërndarjes për vetëprodhuesit, që prodhojnë energji elektrike nga dielli deri në 2 megavatë, sërish e theksoj se ky kapacitet deri në 500 kilovatë për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli është i mjaftueshëm për çdo shoqëri të vogël dhe të mesme apo ndonjë klient familjar dhe të gjithë mund ta instalojnë me të njëjtën procedurë siç bëjnë aplikimin për kontratat pranë OSHEE-së.

Lidhur me rritjen deri në 2 megavatë të kapacitetit të instaluar të vetëprodhuesve, siç e kërkon edhe kolegu Mziu, bie në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 49 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, duke dhënë dy përkufizime të ndryshme për aplikuesit deri në 2 megavatë. Për këto arsye këto dy propozime janë rrezuar në komisionin tonë dhe nuk janë bërë pjesë e këtij projektligji.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Falja për zotin Sali Berisha.

Të përgatitet zoti Ismet Beqiraj

Sali Berisha – Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Këtu kanë sjellë dhe diskutojnë për një ligj për energjinë ata të cilët e kanë shndërruar energjinë, kaskadën, digat dhe investimin në një mallkim për ju, duke e realizuar këtë vetëm e vetëm duke vjedhur. Sjellin këtu një ligj qesharak, ku zotohen se pas kaq vitesh do të arrijnë që 54% e burimeve energjetike të jenë të rinovueshme, në një kohë kur ato sot janë 99% energji e rinovueshme.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Vijnë. Fjala “vijnë” është burim, fjala “konsum” është konsum, por ju edhe gjuhën e përdorni për të vjedhur, Damian. Kjo është e vërteta juaj. Edhe foljet i vendosni sipas xhepit.

Pra, flasin për energji këta, të cilët zbrazin digat në verë. Dy vjetët e fundit kanë qenë vitet ndër më të lagështat në histori. Dy vjetët e fundit, falë një strategjie të ndërtimit të HEC-ve, HEC-et private kanë prodhuar 58% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë. Dy vjetët e fundit organizata kriminale, që drejton energjinë çdo verë, ka zbrazur digat, duke ua shitur energjinë me 30-40 euro kilovatin sekserëve të tyre, të cilët këtë energji, pasuri tuajën, të dashur qytetarë, e rishesin në bursë, në tregun rajonal dhe europian me 5-6 fishin dhe paratë i ndajnë me këta që shihni mbrapa shpinës sime, me në krye Edi Ramën. Kjo është historia e energjisë së këtyre zotërinjve: vjedhje, vjedhje dhe vetëm vjedhje.

Por unë jam këtu sot për t’i informuar qytetarët lidhur me Arben Ahmetajn, i cili është vendosur nën hetim. Theksoj se kam mbështetur dhe do të mbështes në çdo kohë çdo zbatim të ligjit. Theksoj se Arben Ahmetaj është përgjegjës,

ndër më kryesorët, në aferën e tmerrshme të djegësëve; Arben Ahmetaj ka firmën në transferimin e fondit të emergjencës në djegësit e Elbasanit dhe të Fierit; Arben Ahmetaj ka miratuar me siglim dhe me firmë të gjitha procedurat antiligjore të ndjekura në këtë proces; Arben Ahmetaj ka qenë i lidhur si mishi me thoin me Mërtirin dhe Zoton, ku njëri prej tyre ka punuar edhe në “Hermes”, në kompaninë e tij, ku vidhte impulset e Albtelecom-it. Duhet të themi këtu se kryeautori i djegësve është një dhe vetëm një dhe e ka emrin Edi Rama. Afera 600-700 milionëshe në total apo afera 420 milionë e djegësit të Tiranës kurrë nuk mund të realizohej me firmën, me insistimin e Arben Ahmetaj. Arben Ahmetaj në daljen e tij të fundit u shpreh se qeverinë nuk mund ta lëvizja unë, por unë dua t’ju them këtu, si ish-Kryeministër, që kurrë një ministër nuk e lëviz dot qeverinë, qeverinë e lëviz Kryeministri, i cili ngarkon punonjësit e aparatit të Këshillit të Ministrave. Në këtë mënyrë e lëvizi Edi Rama, duke firmosur 17 shkresa në 24 orë, në një kohë rekord. Arben Ahmetaj ka përgjegjësi të plotë, sepse me inspektoratin e tij financiar nuk mbikëqyri financimet, grabitjet dhe plaçkitjen e parave dhe tani del e thotë publikisht: “*Follow the Money* (ndiq paranë)”. Ndjek paranë, por edhe ti do të mbetesh në atë vorbull, Arben, sepse jep këshilla tani pasi t’u kujtuan. Edi Rama është përgjegjësi numër një, sepse ai është autori i firmës, pasi Enti Kombëtar i Prokurimeve i tha se kjo procedurë është antiligjore. Edi Rama dhe Agaçi firmosën për prokurime me negociata të mbyllura.

Edi Rama është përgjegjësi numër një, sepse kompanisë “Intergrated Energy” i dha bonusin 8 pikë, në një kohë kur ajo nuk ekzistonte mbi sipërfaqen e tokës, në një kohë kur një ministër (nuk është këtu ajo zonja) e parlamentit i shkruante se kjo kompani nuk ekziston. Pavarësisht kësaj shkrese, Edi Rama në muajin dhjetor të vitit 2016 firmosi për kompaninë bonusin prej 8 pikësh, për një kompani fantazmë që nuk ekzistonte, ndërkohë që kjo kompani u krijua vetëm në gusht të vitit 2017. Edi Rama është koka e krimit, është koka e organizatës kriminale, sepse edhe “Eko parkun” e Porto Romanos Edi Rama e njofton si një novitet, në një kohë kur sekserët e Edi Ramës kishin krijuar kompaninë për “Eko parkun” e Porto Romanos 6 muaj më parë se Edi Rama ta shpallte publikisht

se i kishte lindur ideja për një eko park. Edi Rama është i lidhur këmbë e krye edhe në këtë rast, sepse thjesht e Edi Ramës në kompaninë “I RI” ishte përfituese e projektit të “Eko parkut”, sikundër, thjesht në kompaninë “I RI” është fituese e tenderit prej 30 milionë eurosh të rindërtimit të muzeut. Po ti, more, ministër Drejtësie, çfarë bën që firmos çdo firmë të tij? A e kupton, apo jo?! Ka pasur para teje ministra që nuk i firmosën, por ti, edhe kur nuk firmos, vjen e bën avokatin këtu.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Shko dhe arrestoje Lefterin për t’i bërë qejfin Belindës.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Absolutisht, ti e arrestove!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Më dëgjo mua ti këtu! E arrestove Lefterin për t’i bërë qejfin Belindës, sepse Belinda është bërë kryeministre tani. Nuk të shkojnë këto intriga, more intrigant. Pra, kjo është e vërteta, është reale, e di e gjithë Dibra. Ndaj edhe Arben Ahmetaj le të shkojë atje, por “SKAP-i” i partisë nuk mund t’u hedhë hi syve shqiptarëve, sepse kreu i Meduzës janë Edi Rama, Engjëll Agaçi dhe Erion Veliaj.

A e morët vesh që u gjetën 20 milionë euro tek ai Tapalone, si quhet ai, mafiozi, i cili ka firmosur se disponojnë 141 milionë euro për djegësin e Tiranës, dhe tani merr paratë e taksapaguesve shqiptarë, të cilat i fsheh nëpërmjet Erion Veliajt? Ndaj, mos mendoni ju se do të mbyllet kjo aferë me Arben Ahmetajn. Megjithatë, thirrja ime drejtuar Arben Ahmetajt është: të bëhesh i penduari i drejtësisë. Ke vjedhur për të vjedhur, mos e diskuto, sepse nuk je ti nga ata që nuk vjedhin, por ke vetëm një rrugë: të pendohesh dhe të zbërthesh para kombit dhe popullit tënd të gjithë veprimtarinë e organizatës kriminale.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, në Petersburg ishe ti...

Lindita Nikolla – Zoti Berisha, përfundojeni fjalën, sepse mbaroi koha.

Sali Berisha – Kur të thashë unë që je përfaqësuesi i rusëve në ekonomi, fillove të turfullosh.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

A do të ta tregoj datën kur ke qenë në Petersburg dhe takimet që ke bërë?

Lindita Nikolla – Zoti Berisha, mbaroi koha.

Sali Berisha – Ja, urdhëro!

Të lutem, mbaroi?

Lindita Nikolla – Jo, zoti Berisha, ju lutem! Fjala për zotin Taulant Balla.

Taulant Balla – Jozefina thoshte mos e pyet Lulin sa është ora, sepse gënjen, por, më duket, i paska ngelur Saliut vesi i Lulit.

Do të kisha kthyer disa përgjigje për ato që tha katrani me bojë, por, në fund të fundit, koha në dispozicion të qytetarëve është shumë më rëndësishme sesa koha që duhet menaxhuar me dikë që vjen nga e shkuara.

Bie dakord me këshilltarët e fushatës së Belind Këlliçit në Tiranë, të cilët i thonë: “Mos dil në asnjë fotografi, mos u shfaq asgjëkund me Saliun, sepse, po dole me Saliun, je i humbur”. Bie shumë dakord, sepse është një strategji që, do apo s’do, duhet ta zbatojë dhe Belindi i shkretë, sepse, të shfaqesh me këtë, që sapa u shfaq këtu, natyrshëm është si t’i thuash avenirit tënd politik: “Ik”.

Sali Berisha është një e keqe, nga cila, të gjithë biem dakord, ky vend duhet të shpëtojë. Por le të kthehemi e të flasim për gjëra të mira për Shqipërinë, sepse jemi edhe në muajin e Ramazanit dhe të merresh e të flasësh për Saliun, ndoshta është gabim.

Zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderur kolegë,

Reforma në sektorin e energjisë elektrike është një prej atyre reformave që unë mendoj se kemi shumë arsye për të qenë krenarë ne, si mazhorancë, por, natyrshëm, edhe ministria përkatëse dhe e gjithë qeveria shqiptare.

Sot mund të bëjmë një bilanc edhe për vitin 2022. Në 10, 20, 30 vjetët e fundit vitin 2022 ishte viti më i vështirë për sa i përket sfidës së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve. Në të gjithë Europën, edhe në vendet fqinje, qeveritë përkatëse u detyruan të marrin vendime për të rritur çmimin e energjisë së faturuar tek abonentët, por Shqipëria nuk e bëri një gjë të tillë dhe përgjegjësinë apo të gjithë barrën buxhetore të përballimi të kësaj situatë e mori buxheti i shtetit. Sot mund t’i themi çdo qytetari shqiptar që na ndjek se qeveria bëri gjënë e duhur. Do të vazhdojmë ta bëjmë dhe ta mbajmë këtë faturë, për sa kohë të vazhdojë lufta dhe efektet e luftës të vazhdojnë, sepse, në fund të fundit, kjo ishte një

mbështetje e drejtpërdrejtë për çdo familje shqiptare.

Viti 2029, tha zëvendëskryeministrja Balluku, do të jetë viti kur Shqipëria do të arrijë në 4 terravat kapacitet prodhues të energjisë elektrike. Kjo do të thotë jo vetëm që i mbulojmë të gjitha nevojat tona, por kemi kapacitet edhe për të eksportuar. Kjo kohë nuk është larg, 5 vjet, duke filluar nga viti buxhetor i ardhshëm. Në fakt, kjo është një arritje shumë e madhe e Shqipërisë, që në një kohë të shkurtër të arrijmë të jemi një prej eksportuesve të rëndësishëm të energjisë elektrike në rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor, por jo vetëm.

Zotëria që sapo foli këtu, në fakt, duhej të ishte para drejtësisë për shumë çështje që lidhen edhe me energjinë elektrike. Kemi termocentralin e Vlorës, një investim që, edhe po të pyesësh sot ministren apo drejtuesit e Korporatës Energjetike, nuk e dinë sa ka qenë fatura finale e ngritjes së atij termocentrali, i cili nuk u vu kurrë në punë, por me parimin e drejtësisë, të investosh me para publike në një termocentral, i cili mos vihet kurrë në punë, ky minimalisht është shpërdorim detyrë. Do të duhen disa para të tjera, shumë para të tjera...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Pusho ti, Mondit, se nuk e di ti këtë punë!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Gjëja më e thjeshtë që di të bësh, është t'ia fusësh kot, por këtë pjesë e di fare mirë: e nisi Saliu, e bitisi Saliu dhe e la jashtë funksionit. Zotëri, unë po të them që u investua në termocentral dhe nuk u vu në punë, pastaj, kush e ka bërë, të mbajë përgjegjësinë.

Meqenëse hyre në këtë lëmë, sepse kemi qenë të dy dhe kemi drejtuar dy komisione hetimore parlamentare, të cilat vazhduan paralelisht, e di fare mirë, çdo shqiptar e di fare mirë, që privatizimin e kompanisë shtetërore OSSH e bëtë ju në qeverisje. Ju bëtë një privatizim, e mbajtët dy apo tre vjet të privatizuar dhe, në fund, përpara se të iknit nga qeverisja, anuluat privatizimin dhe e rishtetëzuat, sikurse të gjitha paudhësitë që keni bërë edhe me rafinerinë e Ballshit, mos harro. Privatizuat rafinerinë dhe sot e kësaj dite nuk ka në Shqipëri njeri që të thotë se sa para hyjnë në buxhetin e shtetit nga ai privatizim, duke e shkatërruar përfundimisht sistemin, ose le të themi të gjithë atë rafineri atje dhe duke lënë një qytet si Ballshi pa një industri,

sepse shkatërruat edhe teknologjinë, shkatërruat edhe rafinerinë. Këto janë çështje, për të cilat një gjë duhet ta keni të qartë: drejtësia vonon, por nuk harron.

Unë jam i bindur se për atë kallëzim, për të cilin mbaj përgjegjësinë që e kam bërë, për privatizimin e kompanisë OSSH, për 418 milionë euro dëm shkaktuar taksapaguesve shqiptarë, do të jepet një ditë drejtësi. Në raportin e komisionit hetimor parlamentar, të votuar në këtë sallë në mars të vitit 2017, thuhet qartë se cila është përgjegjësia e secilit, nga Sali Berisha, i pari, tek të tijtë, përfshirë edhe rastin më flagrant në 30 vjet të politikës shqiptare: kemi rastin më të qartë sesi një politikan është korruptuar, ka marrë rryshfetin në mes të ditës, plot 6,8 milionë euro ka qenë *fee-ja* e suksesit të privatizimit të kompanisë OSSH te kompania CEZ, një transfertë bankare e bërë më 14 qershor të vitit 2009, vetëm dy javë para zgjedhjeve.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Për sa u përket çështjeve që kemi sot, reforma do të vazhdojë, investimet e qeverisë shqiptare dhe mbështetja e sektorit privat në atë që quhet autoproduhim dhe eficiencë energjetike duhet të vazhdojnë. Unë mendoj se ligji që kemi sot, duhet të marrë edhe mbështetjen e secilit prej kolegëve të opozitës. Është gjëja e duhur që ne të përafrojmë legjislacionin tonë në fushën e përdorimit të energjisë ndaj burimeve të rinovueshme me legjislacionin e Bashkimit Europian, sepse, së pari, është një prej detyrave të shtëpisë që ka Shqipëria dhe, së dyti, më shumë se kaq, na krijon mundësi që të kemi të njëjtin legjislacion, në mënyrë që çdo investitor i huaj që vjen në Shqipëri për të investuar në energji të rinovueshme të ketë të njëjtat rregulla, sikurse kanë edhe vendet e Bashkimit Europian.

Shqipëria sot është një prej vendeve që po shërben si model edhe për vendet e rajonit, qoftë në ndërtimin e parqeve të energjisë solare, qoftë në ndërtimin e parqeve të energjisë eulike. Në këtë kontekst, unë mendoj se, përtej krahëve politikë, që natyrshëm na ndajnë, sikurse bëjnë te Kodi Rrugor, duhet të bëjmë edhe për miratimin e këtij ligji sot në këtë seancë.

Dua t'ju falënderoj, sepse nuk pata mundësi ta thosha në seancën e kaluar, për mbështetjen që u bëtë ndryshimeve në Kodin Rrugor!

Besoj që secili prej nesh ka marrë të gjitha falënderimet nga ata, të cilët na kanë sjellë në këtë

sallë, për ndryshimet që kanë të bëjnë me rregulla të reja, qoftë në pajisjen me leje drejtimi, qoftë edhe për disa kushtëzime që kemi vendosur për ata që sapo pajisen me leje drejtimi, sepse, në fund të fundit, jeta e njerëzve, jeta e çdo qytetari shqiptar është më e rëndësishme se gjithçka tjetër.

Faleminderit dhe ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj!

(Drejtimin e seancës e merr zëvendëskryetarja e Kuvendit, zonja Ermonela Felaj)

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zoti Shehi. Të përgatiten zoti Braçe dhe zonja Ulliri.

Dashamir Shehi – Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja drejtuese,

Së pari, ligji i sotëm është i vonuar dhe, së dyti, është gjysmëkopje e atij që ishte bërë në vitin 2017. Megjithatë, unë them le të bëhet dhe ta shohim se deri ku mund të shkojë dhe çfarë do të çojë përpara, duke u nisur nga dëshira e mirë që i gjithë ky proces, i cili ka vite që ka filluar në idenë e biznesit dhe në kokën e shqiptarëve, që, në fakt, realisht nuk përfaqëson ndonjë gjë, sepse këtu po dëgjojmë shifra sikur ne i japim mend Ballkanit për energjinë e rinovueshme dhe për parqet eulike. Në qoftë se ndonjëri ka parë ndonjë paletë atje që rrotullohet me erë, le të na thotë se ku janë këto parqe, por unë mendoj se këto janë ide në letër dhe nuk shoh asgjë të keqe në këtë mes. Mirë do të ishte, por unë them që duhet të kthehemi pak me këmbë në tokë dhe të gjykojmë se për çfarë po flasim, çfarë duam të bëjmë dhe ku jemi deri sot, në mënyrë që të dalim pak edhe nga niveli i propagandës.

Unë po e përsëris edhe një herë, edhe në Komisionin për Ekonominë në njëfarë mënyre kemi rënë dakord me kritikën tona, që do t'i përmend më poshtë, se ligji në vetvete ka një dyshim dhe një pikëpamje të madhe, që e kanë pothuajse të gjitha ligjet e kësaj qeverie: për çdo situatë specifike, që ka një problematikë brenda vetes, bëhet një ligj *ad hoc* dhe krijohen institucione *ad hoc*, pastaj funksionojnë, ose nuk funksionojnë. Kjo punë ka ndodhur në 10 vjet të kësaj qeverisjeje. Të njëjtën gjë ka edhe ky ligj brenda. Çfarë bën ky ligj?! Ngre një agjenci, që e kishte edhe ligji i vitit 2017, i cili, meqenëse nuk iu bënë fare aktet ligjore e nënligjore, vendimet e qeverisë e të gjitha këto, ngeli në vend. Ndërsa te ky ligj e marrim trupën e vjetër të asaj agjencie, së

cilës i kemi vënë një emër të ri, dhe rrimë me shpresën që ky institucioni, që mburret kaq shumë, do ta zgjidhë këtë punë, por unë gjykoj që situata nuk është kështu, sepse në një institucion, siç ishte Enti Rregullator i Energjisë, e kishim dhe ai kishte kompetenca të plota në këtë fushë. Por çfarë bëjmë?! Ia marrim atij kompetencat dhe ia japim qeverisë, e cila, nëpërmjet kësaj agjencie, delegon një aneks të saj, por që nuk ka as mjetet teknike, ndoshta as ato financiare (pavarësisht se kanë vënë një *fee*, që do ta paguajnë përsëri prodhuesit e energjisë), as eksperiencën dhe ne nuk kemi as sigurinë që kjo agjenci do t'i bëjë këto punë, të cilat nuk i bëri për 5 vjet, sepse aty ishte. Dyshimi kryesor që kam është që do të bëhet një agjenci tjetër, një burokraci tjetër. Kjo po ndërtohet, gjoja, që të bëhet më i rrjedhshëm dhe të mos jetë viskoz procesi burokratik, por kush e garanton këtë?! E thashë që kishim një Ent Rregullator dhe do të ishte më mirë që tek ai ent të bënim disa ndryshime, të hiqej një pjesë e burokracive dhe institucionet, të cilat kanë një traditë, të qëndronin në vend.

Po i marr me radhë kritikën për këtë ligj.

Së pari, pretendimi kryesor i kompanive, që do të merren me këtë punë, ka qenë që niveli, çatia, me të cilin mund të prodhohet, është relativisht i vogël, 500 mijë. Unë jam dakord me shumë që thonë këtu se nuk është i vogël, sepse për çdo prodhues individual ka një mundësi, por, në qoftë se duam t'u lëmë shteg edhe prodhuesve më të mëdhenj, fabrikave të mëdha apo të gjithë prodhuesve të tjerë, le të shkojnë edhe deri në një, sepse nuk ka ndonjë hata të madhe në këtë mes. I njëjti proces kontrolli burokratik që është për 500 mijë, le të shkojë deri në një dhe nuk do të pucemi përsëri pas dy vjetëve të tjerë të fillojmë të korrigjojmë po të njëjtin ligj dhe po të njëjtën agjenci.

Së dyti, shteti shqiptar duhet të përcaktojë se kush i blen tokat bujqësore që janë të qëndrueshme dhe kush mund të hyjë në hartën e këtyre tokave, në të cilat mund të vendosen fotovoltaiqet, në mënyrë që të mos prishim bujqësinë dhe në tokat inproduktive të hapet ky treg dhe njerëzit të bëjnë garë për këtë punë e të mos rrinë te dera e ministrisë, kush ka mik për këtë çështje.

Së treti, këtu dëgjuam ministrat dhe të tjerët që Europa ka vënë një plan (sigurisht Europa është me kilometra larg në këtë punë) deri në vitin

2025 që të gjitha godinat publike dhe qendrat e mëdha urbane të jenë autonome në këtë punë, por ne këtu ku jemi me këtë lloj procesi, çfarë taveni do të vëmë, sepse Europa e ka vënë në 2025?! Unë e di që kjo është një ëndërr kot, por ne, të paktën ta vëmë deri në 2035. A do të vëmë një afat, një tavan për këtë punë, në mënyrë që të bëhen edhe projekte specifike dhe të gjenden incentivat për këtë fushë?! Deri sot kjo nuk është caktuar.

Në këtë formë është bërë ky ligj (unë do ta kisha bërë ndryshe, e thashë, nuk jam për këtë punë), por unë uroj që agjencia që po bëhet tani (agjencia që nga viti 2017 nuk bëri asgjë, është bosh), e cila është, gjoja, më e madhe dhe më e fuqishme, që i është vënë brenda ligjit edhe një *fee* vetëfinansimi, t'i bëjë këto akte nënligjore, sepse, në qoftë se do të duhen edhe 2-3 vjet të tjerë për t'u mbyllur kjo burokraci, gjysma e atyre prodhuesve që janë në treg tani po humbin para, pasi nuk e dinë çmimin e investimit deri sot.

Qeveria ka për detyrë të përcaktojë edhe çmimin, sepse nuk mund t'i lërë në hava këto, siç i ka lënë deri tani, pasi disa kanë 1 vit apo 2 vjet punë dhe deri tani nuk është përcaktuar çmimi. Ju mund të pyesni: a e ka qeveria në dorë çmimin?! Sigurisht që nuk e ka, e ka Enti Rregullator, por, kur do qeveria, e bën propozimin e saj, siç bëri atëherë për dyshtet, tavanin 800 kilovatë, mbi 800-900, domethënë i ka të gjitha instrumentet në dorë.

E fundit, për ta zgjeruar hapësirën dhe të mos mbetemi vetëm te ky ligj dhe te kjo çështje teknike, që pak nga qytetarët do ta kuptonin, unë dua të them se ideja e eficientës energjetike është shumë më e gjerë se këto. Unë do të prisja nga kjo qeveri, meqenëse ka pasur mjaftueshëm kohë që të bënte planet urbanistike, të caktonte se cila është godina më efiçente për të kursyer energji dhe të na tregonte a do të vihen normativa për këtë punë, a do t'i riveshim qytetet e Shqipërisë me kapotë, a do t'i pajisim me panele diellore, a do t'i bashkojmë ujësjellësit poshtë të njëjtit pallat e të tjerë. Domethënë, do të bëjmë një fushë shumë më të gjerë se kjo.

Për sa u përket investimeve, unë shikoj këtu mburrje të madhe, sepse dëgjova edhe zotërinë, i cili foli për TEC-in e Vlorës, dhe është e vërtetë që është një katastrofë nga ana ekonomike për ata që e kanë bërë, është një balenë (këtej nga ne nuk vijnë balena, është një fokë që rri e ngordhur buzë detit), por nuk duhet të harrojmë që kjo qeveri ka

10 vjet që e sheh atë balenën që po kalbet atje dhe nuk ka bërë kurrë gjë dhe i vetmi justifikim moral, ekonomik, shkencor, organizativ, quajeni si të doni, është: "E kanë bërë ata", e dëgjuat zotërinë. Dakord, e kanë bërë ata, kanë gabuar ata dhe, nëse duhet të dënohen, le të dënohen, por ju çfarë bëtë në 10 vjet, ku është eficienta për këtë punë, kush u kujtua që këtu kanë humbur 120 milionë nga paratë e shtetit shqiptar?! Kështu që, duhet të kujtoheni edhe ju. Prandaj, unë jam dakord që ai të shikohet dhe uroj të vihet në punë, edhe pse me ato që unë kam dëgjuar deri tani, nuk shikoj ndonjë ndryshim të madh, as ndonjë zgjidhje të madhe për këtë punë. Uroj që të mos rrimë me mburrjen e kotë boshe se ne qenkemi (tani po e mësoj pas 30 vjetëve) model për Ballkanin, sidomos në fushën energjetike! Çfarë modeli jemi ne, kur kompania shtetërore ka ende 600 milionë për të mbledhur, nuk e mbyll kurrë bilancin dhe nuk e ka mbyllur kurrë pozitivisht në këto vite?! Ky është modeli ynë?! Për çfarë jemi model?! Një nga nëpunësit na tha në Komisionin për Ekonominë se ne kemi energjinë më të pastër, 93% të rinovueshme. Donte të na kujtonte hidrocentralet e Enver Hoxhës, por atë e dimë të gjithë ne, për atë po mburremi në këto vite, se e prodhojmë energjinë me ujë?!

Prandaj, dua t'ju ftoj, sepse kjo është tema më e madhe që ka Shqipëria dhe e gjithë Europa për dekadën që vjen, të mos e bëjmë objekt propagande, pasi shifrat janë aty, vitet janë aty dhe, kush do të punojë, e ka të gjithë mundësinë për të bërë ndryshimin!

Ne, si opozitë, këtij ligji, duke mbyllur sytë dhe hundën, i dhamë një leje të kalojë, sepse mendojmë që do të bëjë një kërcim përpara për interesat e këtij sektori, të biznesit, por jo se ky është ligji më i mirë në botë. Ky ligj i ka të gjitha defektet brenda, por unë uroj që ky lloj debati të shërbejë, që gjatë akteve nënligjore të korrigjohet një pjesë e këtyre boshllëqeve të mëdha që ka ligji!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehi!

Zoti Gogu ka ndërruar radhën me zotin Braçe.

Fjala për zotin Gogu.

Toni Gogu – E nderuar drejtuese e seancës, Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Jam dakord me kolegun parafolës se ligji që kemi sot përpara, është një nga pjesët më të rëndësishme të strategjisë së zhvillimit energjetik të vendit, që zëvendëskryeministrja, ministrja e Energjisë, shpalosi pak më parë. Besoj se kjo është një strategji, tashmë, afatgjatë dhe, me zgjidhjen strukturore dhe projektligjin që do të miratojmë së bashku (siç u tregua edhe oguri i mirë edhe nga përfaqësuesit e opozitës, hiq ata që janë të shqetësuar se nuk udhëtojnë dot drejt Britanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, le të hyjnë në zyrën e Kryeministrit britanik), tregon që ne po bëjmë hapat e duhur për zhvillimin energjetik të vendit.

Tre objektiva realizon ky projektligj dhe kjo lëvizje e radhës në zbatimin e strategjisë së zhvillimit energjetik të vendit:

Së pari, forcon sigurinë e ofertës. U tha nga të gjithë këtu, nga zëvendëskryeministrja, nga kryetari i Komisionit për Ekonominë, nga anëtarë të Komisionit për Ekonominë, nga kolegë deputetë dhe kolegë të opozitës, që ne rritim ofertën, pra forcojmë ofertën në treg. Zëvendëskryeministrja tha që në vitin 2029 ne shtojmë edhe 4 terra të tjerë në prodhimin vendas, duke e bërë vendin tërësisht të pavarur nga energjia që prodhohet jashtë vendit tonë. Pra, jo vetëm që forcojmë ofertën, por, gjithashtu, forcojmë dhe fuqizojmë pavarësinë dhe sovranitetin energjetik të vendit.

Së dyti, nxit përmeshjen e atyre targeteve, që u thanë më parë, që janë targete europiane. Pra, ne tashmë jemi bërë pjesë e sfidës europiane për pavarësinë energjetike dhe ato janë vendosur, janë ankoruar të gjitha, pritjet janë vendosur në vitin 2030. Kryetari i Komisionit të Ekonomisë e tha që ne më 2030-ën do të arrijmë ta çojmë konsumin nga burimet e energjisë së rinovueshme mbi 50%, pra 54%. Pra, nga 38%, ne do ta çojmë në 54%, që besoj se është një kapërcim mbresëlënës.

Së treti, rrit eficiencën strukturore të sistemit. Pra, tashmë sistemi rrit eficiencën e tij, por edhe garën, edhe konkurrencën. Ligji siguron që të gjithë operatorët të mund të vazhdojnë udhëtimin e tyre qoftë për të konkurruar me njëri-tjetrin, qoftë për t'u zgjeruar e kështu me radhë.

Duhet thënë si erdhëm këtu, zëvendëskryeministrja e përmendin disa herë, por edhe kolegët e tjerë. Ne sot fillojmë të flasim për projektligjin sikur të mos këtë ndodhur asgjë. Unë e kuptoj që kolegët e opozitës kanë qenë të zënë

me çështjet e tyre të brendshme, pra me ato brenda forcës së tyre politike, dhe ndoshta nuk e kanë parë, por ne sot jemi në një situatë, që nuk e ka parë kontinenti ynë të paktën në 70 vjetët e fundit. Pra, lufta që Putini nisi në Ukrainë shkaktoi krizën energjetike të brezit, kështu konsiderohet nga ekspertët, e cila e ka çuar inflacionin në ato nivele, që nuk i keni parë më parë. Pra, qytetarët shqiptarë u përballën me një gjë të pamenduar më parë, paaftësinë për të paguar faturën energjetike. Nëse qeveria nuk do të kishte ndërhyrë dhe të ndërtonte atë mburojë energjetike mbi qytetarët shqiptarë sot, për këtë jemi koshientë të gjithë, do të kishin shkuar në një falimentim financiar familjar. Çmimi i energjisë nuk ka ndryshuar, ndërkohë që vende të zhvilluara të BE-së e lanë në gjendje të lirë dhe u ballafaquan më vonë, pra më pas.

Kështu që, gjëja e parë që duhet të themi është se sfidat monumentale që solli kjo kohë, në të cilën ne po jetojmë, kërkuan edhe ndërhyrje monumentale, të cilat e veçojnë Shqipërinë jo vetëm në rajon, por unë besoj në të gjithë kontinentin tonë, qoftë për atë ndërhyrje emergjence, qoftë edhe për atë çka po bëjmë për vitet e ardhshme.

Kështu, si do të vazhdohet të ecet përpara? Si do të shkohet më para? Projektligji ka fjalën kyçe, burimet e rinovueshme, nuk ka asnjë rrugë tjetër për të shkuar përpara, nuk ka rrugë tjetër që Europa të shkojë para, nuk ka rrugë tjetër që të shkojnë përpara edhe vende të tjera, kontinente të tjera të zhvilluara, veçse nëpërmjet burimeve të rinovueshme të energjisë. Këtë bën edhe projektligji, por e bën me disa ndërhyrje.

Ndërhyrja e parë është nëpërmjet bursës energjetike, e cila, siç e lançoi edhe zëvendëskryeministrja, ul kostot. Pra, tashmë kostot e energjisë nuk janë ato që shkakttoheshin nga kontratat që lidheshin aty për aty, por ne mund t'i ulim kostot e energjisë për shkak të garës që bëhet në bursën energjetike, bursën vendase.

Ndërhyrja e dytë që bën ligji është që ndërton një ekosistem të burimeve të rinovueshme. Pra, është e qartë që ne kemi një, le të themi, tejkalim të energjisë, mbizotërim të energjisë së krijuar nga uji, por tashmë ne kemi mundësi, dhe po ndodh teksa ne po flasim, që të ndërtojmë parqe energjetike solare, diellore, qoftë parqe energjetike që janë në planifikim dhe në zbatim e sipër të prodhimit të energjisë përmes erës, të cilët do të rritin prodhimin vendas, duke e

diversifikuar dhe duke ndërtuar tashmë një ekosistem të balancuar të energjisë.

Së fundi, ne mund të themi që ndërhyrjet në rrjetin e transmetimit do të bëjnë të mundur që të gjitha investimet që aktorët privatë do të nxitin në ekonominë shqiptare, pra në prodhimin e energjisë përmes burimeve të rinovueshme, do të jenë në gjendje që të hyjnë jo vetëm në tregun vendas, por, gjithashtu, edhe në tregun rajonal.

Të dyja marrëveshjet që përmendi zëvendëskryeministrja, qoftë ajo me Maqedoninë e Veriut, qoftë ajo me Greqinë, sigurojnë që ne të mund të shkëmbejmë në rrjetin rajonal energjinë që po riprodhohet.

Kështu, në përfundim, i nxis të gjithë kolegët që të mos kenë asnjë lloj dyshimi, sepse ne po bëjmë gjënë e duhur për të fuqizuar edhe një herë sovranitetin energjetik të vendit tonë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gogu!

Zonja Ulliri? Konsiderohet që ka hequr dorë nga fjala.

Zonja Zhupa? Nuk është në sallë. Po ashtu konsiderohet që ka hequr dorë nga fjala.

Zonja Bushka keni fjalën.

Të përgatitet zonja Vokshi.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zonja kryesuese e seancës!

Të nderuara kolege, kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sektori i energjisë elektrike, fuqizimi i tij, eficientia, diversifikimi i burimeve për prodhimin e energjisë elektrike, ulja e çmimeve, plotësimi i nevojave, ulja e humbjeve në rrjet sa i takon shpërndarjes janë sfidat e Shqipërisë prej kohësh, por në kohët që ne po jetojmë janë sfida të të gjithë rajonit, të gjithë Europës, të gjithë botës, aq më tepër pas krizës energjetike botërore, e cila u intensivikua edhe më shumë pas konfliktit në Ukrainë.

Në fakt, e shoh që nuk ju pëlqen ta përmendim si ka qenë sektori energjetik në Shqipëri dhe si është sot, por ne duhet t'i themi disa shifra, duhet t'i themi të vërtetat për të kuptuar se ku ishim dhe ku jemi. Nëse nuk nxjerrim mësim nga e kaluara, jemi të destinuar të bëjmë të njëjtat gabime, që mund të jenë bërë në të kaluarën.

Nuk është fare e nevojshme që unë të bëj një panoramë, sepse faktet dhe statistikat flasin vetë, po ashtu edhe të gjitha raportet përkatëse se si

ishite sektori energjetik më 2013-ën. Ai si sektor ishte në atë gjendje të rëndë, që po e çonte vetë ekonominë e vendit në kolaps. U bë një reformë për ta ringritur këtë sektor, që të mos dëmtonte ekonominë e vendit dhe për ta rimarrë veten. Ndërkohë, u bënë një sërë politikash dhe strategjish për të rritur prodhimin, për të ulur humbjet në rrjet, për të bërë investime në rrjetin e shpërndarjes, që ne të mos kishim aq shumë humbje, dhe për të rritur arkëtimet në OSHEE, sepse rritja e arkëtimeve do të sillte më shumë të ardhura, do të ulte nivelin e humbjeve dhe do të rriste mundësinë e investimeve.

E thënë kështu, me dy fjali, duket diçka e thjeshtë, por në praktikë ishte një sfidë më vete, ishte një nga detyrat më të vështira që ka pasur kjo mazhorancë për të realizuar, dhe ia ka dalë. Po të merrni dhe të krahasoni shifrat e vitit 2013 vetëm me ato të vitit 2015, do ta vini re që sektori filloi ta merrte veten dhe vit pas viti filloi të kishte përmirësime, edhe pse ende larg asaj që duhet të jetë. Por e vërteta është që sektori po mirëmenaxhohej, u rrit eficientia, u rrit prodhimi, u ulën humbjet; filluan të rriteshin arkëtimet, u rritën edhe investimet.

Nga ana tjetër, Shqipëria është pjesë e Traktatit të Energjisë në BE dhe ne quhemi pothuajse në një nivel me ta në të drejta dhe detyrime, me mundësinë që gradualisht të jemi pjesë e tregjeve rajonale dhe europiane të energjisë. Kjo jo vetëm na detyron që të përfaqësojmë me standardet më të mira të tyre, por edhe na ndihmon që ne të ecim me hapin e tyre dhe të mësojmë nga më të mirët. Thënë këtë, nëse nuk do të ishin bërë të gjitha këto gjëra që ka bërë kjo mazhorancë qeverisëse, po, nuk kemi bërë mrekulli, por jemi ku e ku më mirë seç kemi qenë, nuk do t'ia kishim dalë dot të përballonim faturën e energjisë elektrike për familjet shqiptare dhe për bizneset e vogla. Këtë duhet t'jua kujtojmë. Vjet është rritur çmimi i energjisë elektrike nga 52 euro për megavat në 550 euro për megavat. Fatura e familjarëve dhe e bizneseve të vogla nuk ndryshoi, sepse qeveria shqiptare arriti të mbulonte diferencën e çmimit që vinte nga rritja e çmimit të energjisë në tregjet ndërkombëtare. Qeveria shqiptare nuk do t'ia kishte dalë dot të bënte këtë politikë (vetëm me paketën e parë të rezistencës sociale pagoi 28 miliardë lekë financim për mburojën e çmimit të energjisë për familjarët dhe biznesin e vogël), nëse që nga viti

2013 e deri në momentin e krizës nuk do të ishin ndërmarrë ato reforma dhe të ishin kryer ato veprime, që e bënë pak më të shëndetshëm sistemin dhe rritën eficiencën e tij. Këto janë fakte.

Ne sot, falë këtyre përpjekjeve konkrete të qeverisë shqiptare, me analiza dhe me studime, duke marrë për bazë ekspertizën më të mirë dhe analizat reale, jo populizmin, kemi mundur të prodhojmë rreth 70% të energjisë nga burimet e brendshme. Kemi sfidën për të plotësuar këtë 30%-sh, i cili, në fakt, mund të realizohet nga burimet tona. Ky projektligj që vjen sot është një nga ato mekanizma të qeverisë shqiptare për të arritur drejt këtij objekti.

Qeveria ka marrë edhe shumë masa të tjera në këtë drejtim. Për këtë dua t'ju kujtoj vetëm dy dokumente, ku bazohet edhe projektligji që kemi sot për shqyrtim, bëhet fjalë për Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030 dhe për Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030. Këto janë bazat, të bëra me analiza të sakta, me këmbë në tokë dhe me objektivitet nga qeveria shqiptare, për të krijuar mjete efikase, me qëllim realizimin e synimeve. Një nga synimet është që ne të kemi sa më shumë diversifikim të burimeve nga ku e prodhojmë energjinë elektrike. Rritja e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të ndryshme të rinovueshme dhe nxitja e përdorimit të tyre në vend ndikon edhe në arritjen e objektivave ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Vetë ligji parashikon mekanizma për të krijuar një sistem të përgjegjshëm efektiv dhe transparent të shfrytëzimit të burimeve energjetike dhe mirëmenaxhimit të tyre, me qëllim rritjen e eficiencës dhe uljen e kostos së energjisë. Nga ana tjetër, do të na duhet të orientojmë edhe përdoruesit të burimeve e rinovueshme të energjisë. Qëllimi i veçantë i këtij projektligji, që nuk thuhet, por që duhet thënë, ka të bëjë edhe me ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse dobia e madhe që sjell për mjedisin dhe për shëndetin përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë është, gjithashtu, një nga qëllimet e projektligjit dhe adresohet atje me mekanizma konkretë.

Ajo që dua të theksoj, pa rënë në përsëritje të asaj çka tha edhe vetë zëvendëskryeministria, e cila bëri një ekspozitë shumë të mirë të asaj që synon të sjellë ky projektligj, por edhe kolegët e

tjerë, e rëndësishme është që ky projektligj vjen si një ligj i ri. Ne kemi pasur një ligj më 2017-ën, i cili edhe ai është bërë në kuadër të konsultimeve me partnerët tanë ndërkombëtarë, sipas standardeve të BE-së, të Traktatit të Energjisë, por ky sektor evolon. Ne kemi nevojë të ecim me hapin e evolucionit të sektorit në rajon dhe më gjerë. Ligji i sotëm është një përmirësim i ligjit të 2017-ës dhe i adreson të gjitha çështjet.

Unë nuk e shoh problem krijimin e një agjencie, siç tha këtu kolegu Shehi, sepse krijimi i agjencisë nuk merr rolin ERT-së, apo të një autoriteti tjetër ekzistues, ai krijohet *ex novo*, me detyra të qarta, për të rregulluar blerjen, shpërndarjen dhe mekanizma të tjerë për ta disiplinuar tregun, në mënyrë që ne të kemi eficiencë në këtë sektor.

Risiti e projektligjit janë të shumta, por unë do të ndalem në dy prej tyre, të cilat mendoj se kanë rëndësi.

Së pari, janë masat mbështetëse për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe përgjegjësitë e lidhura me balancimin, fleksibilitetin, skemat mbështetëse; hapat që lidhen me procesin konkurrues; masat mbështetëse për projektet demonstruese; dispozita konkrete, rregulla konkrete, që lidhen me kontratën për mbështetje; aksesin në rrjete; kostot për lidhjet me rrjetin dhe zgjerimin e kapaciteteve për vetë konsumatorët e rinovueshëm; komunitetet e energjisë së rinovueshme; garancitë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme. Të lexuara në këtë formë nga unë për publikun ndoshta janë të paqarta, por të gjitha këto që lexova, për ta kuptuar qartë qytetarët, garantojnë eficiencën e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike, të cilat do të rritin konkurrencën në treg, do të ketë më shumë energji të rinovueshme, që do të sjellë edhe ulje të çmimeve; do të ketë një transparencë dhe do të ketë më shumë mundësi që ne të mos arrijmë tek ai momenti kur do të duhet të na e mbulojnë financat publike faturën financiare, por me një mirëmenaxhim, me një studim të mirë, me një transparencë dhe me ekspertët më të mirë do të duhet që ta prodhojmë energjinë së brendshmi, brenda një afati të shpejtë, siç e parashikon edhe projektligji, 4-5 vjet nuk janë shumë, dhe të mos jemi të varur nga importi. Ky është qëllimi, por

nuk është mekanizimi i vetëm që qeveria shqiptare përdor në përmirësimin e këtij sektori.

Dëgjova këtu të flitet edhe për eficiencën e energjisë. Ne kemi legjislacion për eficiencën e energjisë, ne kemi legjislacion sesi duhet të ndërtojmë, në mënyrë që të ruajmë konsumin e energjisë nga materialet e ndërtimit, nga mënyra sesi ndërtojmë. Ne kemi autoritete që merren me këto çështje, ne kemi tashmë edhe rregulla sesi ta përdorim ujin e ngrohtë nga energjia diellore.

Kemi bërë hapa para, ato që janë bërë nuk janë të gjitha dhe mbarojnë këtu, do të ketë ende incentiva, masa dhe mekanizma ligjorë, që do të merren në konsideratë, nëse u referoheni strategjive që ka qeveria shqiptare, siç është ky ligj, por edhe ligjeve të tjera, por gjithçka që bëhet efektet do t'i tregojë në kohë. Ne jemi këtu, do t'i monitorojmë, qytetarët do t'i ndiejnë, por ajo që duhet të themi është se nuk keni pse të jeni skeptikë për masa të tilla, sepse këto masa po i merr i gjithë rajoni, e gjithë bota, të koordinuar me njëri-tjetrin, sepse sfida për energjinë nuk mund të jetë një luftë politike, por një qëllim në vetvete i të gjitha qeverive të përgjegjshme dhe i të gjitha shteteve, ku përfshihen bashkë opozitat dhe mazhorancat.

Faleminderit, edhe për votën pro që do t'i jepni këtij projektligji!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka zonja Zhupa, sepse nuk isha në dijeni që ishte koordinuar më parë me Kryetaren.

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Shumë faleminderit për mirëkuptimin!

Në fakt, sfida e energjisë është e rëndësishme, por më e rëndësishme për Shqipërinë sot janë liritë dhe të drejtat e njeriut. Nëse nuk kemi liritë dhe të drejtat tona, çdo gjë tjetër kthehet në një nevojë dytësore; nëse nuk garantojmë dot të drejtën e pronës private; nëse nuk garantojmë dot të drejtën e jetës; nëse nuk garantojmë dot të drejtën e fjalës; si parimet bazë të Kushtetutës, mbi të cilat ngrihet një shtet ligjor, të gjitha të tjerat janë në radhë të dytë.

E nisa kështu fjalën tim, sepse ky Kuvend, në mënyrë të vazhdueshme, shkel çdo të drejtë të opozitës për të diskutuar dhe për të marrë kohën e nevojshme, sipas Rregullores, për çështje të qytetarëve, për çështje të zhvillimeve politike, për çështje të raporteve ndërkombëtare, si raporti i

Departamentit Amerikan të Shtetit. Ne nuk kemi ndër mend që, pavarësisht shkeljeve tuaja, t'i lëmë pa përmendur, të rrimë pa ngritur zërin, ndaj do ta përdorim këtë foltore si një moment për të ndërgjegjësuar këdo për shkeljet dhe mosreagimin e kësaj mazhorance ndaj këtyre shkeljeve që bëjnë qeveria dhe organet qeveritare me të dyja këmbët.

Raporti i DASH-it ishte një skaner i qeverisjes së dështuar, ishte një skaner sesi sot demokracia është shumë larg të qenit reale, por jemi ende në një demokraci hibride; ishte shumë larg pritshmërive dhe retorikës që krijoni ju me ERTV-në dhe aktivistët me realitetin e tryezave shqiptare, familjeve shqiptare dhe jetën e shqiptarëve.

Në fakt, ndodhi një akt i paprecedentë, ju urdhëruat, në shkelje të ligjit, në ditë paqeje dhe pushimi zyrtar, në ditën e Sulltan Novruzit, në natën e parë të Ramazanit, u sulmua prona private, u sulmua Prestigj Resort. Ku këtë e përdorni si metodë kërcënuese ndaj pronarit të medias, që ende nuk keni arritur ta fusni në thesin tuaj të propagandës. Me metoda tipike mafioze, me kërcënime hap pas hapi, duke i lënë afate dymujore për të reflektuar, ju arritët deri aty sa konfiskuat pronën private, as diktaturat fashiste dhe naziste nuk i kanë përdorur këto metoda që po përdorni ju sot. Ju, pasi i shkatërruat të gjithë pjesën e jashtme të resorit, duke vendosur tritol në godinat ekzistuese të resorit (kuptohet, duke i lënë një periudhë kohore për të reflektuar), tani konfiskuat edhe godinat e tjera të resorit, pra konfiskuat pronën private.

Çfarë në pret pas kësaj? Keni përgatitur arrestime? Keni përgatitur plaçkitje të banesave private? Drejt kësaj ruge po shkoni, në rrugën e hyrjes në shtëpinë private të pronarëve të medias, vetëm e vetëm për t'i kërcënuar që të kthehen në mekanizma dhe në vegla të propagandës! Atë që nuk e fshihni dot nga raporti i DASH-it, doni ta fshihni nga sytë e shqiptarëve nëpërmjet medieve të kapura apo nëpërmjet ERTV-së.

Raporti i DASH-it thotë: “Korrupsioni është i pranishëm në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, përfshirë këtu PPP-të dhe prokurimin publik”. Kur thotë “korrupsioni në të gjitha degët”, asnjë nga ministret nuk ka imunitet. Ndaj, ligjet që bëni ju, sado që mund të duken bukur në të shkruar, janë ligje që do të zbatohen nga një qeveri e korruptuar, janë ligje që do t'u gjendet

ana për të privilegjuar një grup dhe për të sulmuar një grup tjetër; janë ligje që lidhen drejtpërdrejt me interesa klienteliste. Kjo thuhet në raportin e DASH-i.

Mos e prisni votën tonë pro që ju të vazhdoni të vidhni, që ju të vazhdoni klientelizmat, që ju të vazhdoni të sulmoni mediet, të sulmoni pronën private, që ju të vazhdoni, nëpërmjet keqpërdorimit të fuqisë shtetërore, të sulmoni individë të lirë.

Krerët e atyre institucioneve që kanë ndërmarrë atë aksion në një ditë pushimi zyrtar, pa letra dhe pa ligj, sot duhen dënuar për shpërdorim detyre. Kryeministri këtu, sa herë që firmos, ka dikë për ta bërë kokë turku; ka dikë që mund ta arrestojë kollaj për paratë që merr si burim final. Shumë nga kolegët tuaj sot janë në qelitë e burgjeve, madje edhe disa të tjerë po përgatiten për atje, sepse, nëse kapeni dhe nëse ju dalin në treg, atëherë jeni fajtorë personalë; ndërsa kur bashkëndani privilegjet dhe paratë me Ramën, atëherë jeni ekip i suksesshëm. Siç po del këto ditë, ndonjëherë edhe dalja e lakrave në pazar bëhet me porosi të vetë Kryeministrit për të sulmuar anëtarët e kabinetit të tij. Kjo nuk është dëgjuar ndonjëherë, por vetëm në këtë Shqipërinë tonë të Zululand-it ndodhin këto gjëra, ku Kryeministri sulmon ministrat e tij.

Raporti i DASH-it u referohet në mënyrë eksplicite institucioneve, të cilat mbrojnë territorin, Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, duke thënë që ka shkelje të rënda të ligjeve të vendit. Në këtë raport përmendet pikërisht i njëjti pronar dhe i njëjti hotel që ju e sulmuat edhe dje. Mendoni se i bëni dëm personal apo po kërcënoni pronarin, por nuk e kuptoni që mjafton ky raport i DASH-it që ai të fitojë çdo gjyq në Strasburg, sepse është goditur për arsye politike dhe është goditur për presion ndaj medias së lirë. Sigurisht, shqetësimi im nuk është fati personal i një individit, që është i aftë ta mbrojë veten edhe kundër jush, por shqetësimi im është se çfarë i pret qytetarët; çfarë i pret banorët e Ksamilit, që sot po përballen njësoj si pronari i medias, me prishje të paligjshme; çfarë i pret banorët e Sarandës; çfarë i pret banorët e Durrësit; çfarë i pret banorët e Lezhës, sepse ju përdorni metodën e presionit politik, sidomos në prag të fushatave elektorale, për të bërë prishje selektive, për të legalizuar në mënyrë selektive, për të

shembur në mënyrë selektive, sipas preferencave politike dhe partiake.

Shtetin e keni barazuar me partinë dhe e keni vënë në funksion të partisë. Këtë e thotë edhe DASH-i: “Vota e lirë është e cenuar. Të gjitha mekanizmat e shtetit punojnë për të ndryshuar preferencat e njerëzve dhe për të ndikuar te preferencat politike të njerëzve”. Këtë ju, sigurisht, nuk pranoni ta diskutoni. Kur këtu duhet të flitet për hallet dhe problemet e qytetarëve, ju jo vetëm që nuk pranoni të diskutoni, por anuloni edhe seancën. Rekord sesi arrini të anuloni seancën për çështjet e qytetarëve dhe nuk e zëvendësoni, pavarësisht se nuk e kishit kuorumin atë ditë, e keni sot, e kishit një ditë tjetër. Por është vullneti i hekurt për të mos iu përgjigjur nevojave të qytetarëve, për të mos folur për problemet e qytetarëve, për t’u fshehur si struci dhe për të ngritur kultin e individit, kultin e në qeverisjeje që punon.

Së fundi, të jeni të sigurt se realiteti është ai që do të vendosë edhe për votën e qytetarëve më 14 maj, ku të gjithë bashkë ne do të fitojmë, sepse ju e meritoni ndëshkimin nga qytetarët shqiptarë!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Shehu keni fjalën.

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, ndiqni radhën e diskutimeve!

Ermonela Felaj – Atë po ndjek.

Ismet Beqiraj – Jo.

Ermonela Felaj – Kolegët kanë të drejtë ta ndryshojnë radhën me njëri-tjetrin dhe zoti Shehu ka ndërruar radhën me zonjën Vokshi. Kështu që, ju do të flisni në radhën tuaj.

Ju kërkoi ndjesë nëse nuk e bëra të ditur që ka një ndryshim radhe të zonjës Vokshi me zotin Shehu! Për këtë arsye po flet më parë, jo sepse nuk po ndiqet radha për të gjithë.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Pa dyshim, të falsësh për energjinë nuk është e lehtë, është një element shumë i rëndësishëm, por unë do ta ndërroj pak muzikën e këtij diskutimi, do të flas për një energji tjetër; do të flas për energjinë njerëzore, energjinë politike, energjinë që duhet të transmetojë ky parlament dhe ky Kuvend për vendime të rëndësishme që merren në vendin tonë. E marr këtë spunto nga

propozimi i Kryeministrit, nga kërkesa e Kryeministrit për të emëruar në drejtim të SHISH-it një zonjë nga Kosova, pa pyetur dhe pa u konsultuar me parlamentin, pa u konsultuar me Komisionin e Jashtëm; pa u konsultuar me Komisionin e Sigurisë, pra në mënyrë thjesht personale.

Unë personalisht këtë veprim e konsideroj një gabim politik, e konsideroj një shprehje të një vullneti, që nuk sjell elementë pozitivë, por negativë. Nuk është thjesht çështja se çfarë paraqet ajo zonjë, nuk kam ndër mend të hy në këtë çështje, por, së pari, lind pyetja: cili është mesazhi politik që Kryeministri do të japë me këtë gjë? Çfarë përmban në vetvete një veprim i tillë, i cili, të jemi realistë, nuk është normal, është anormal!? A ka një mesazh politik? Le t'i ndajmë dhe t'i shikojmë me radhë. Cili mund të jetë mesazhi politik i një veprimi të tillë për Kosovën? Është tërësisht i gabuar. Së paku, është një paternalizëm paradoksal ndaj Kosovës, që vetëm e dëmton atë dhe krijon efektin e kundërt për shtetin e ri të Kosovës, në një kohë kur i duhet të forcojë identitetin e saj si shtet, sovranitetin e saj si shtet i pavarur, për të qenë realisht fitimtare në betejat në skakierën botërore dhe në organizmat ndërkombëtare. Nuk është interesi i Kosovës të tregojë varësinë ndaj Shqipërisë, të tregojë që është në ombrellën e Shqipërisë, jo, është e kundërta. Duhet të jemi realistë për këtë gjë dhe politikisht shumë të qartë për këtë gjë, sepse me veprime të tilla vetëm dëmtohet Kosova.

Një veprim i tillë ndodhi edhe para disa kohësh me atë djaloshin, që e emëruan ministër të Jashtëm, por që nuk u bë ministër i Jashtëm; një veprim absolutisht i dëmshëm dhe përfundoi ashtu siç përfundoi, një eksperiment i dështuar, siç ishte edhe ministrja e Arsimit. Atëherë, përse vazhdojmë me këmbëngulje në këtë rrugë? Pse transmetojmë këto mesazhe negative? Pse kërkojmë të krijojmë idenë se Kosovën e kemi në xhepin tonë, ku Kosova është një shtet i pavarur? Ne duhet të ndihmojmë dhe forcojmë pikërisht idenë që ai është një shtet i pavarur dhe duhet të jetë anëtar i OKB-së, duhet të jetë në organizmat ndërkombëtarë, por ne edhe këtu bëjmë lojën e Vuçiqit, të jemi realistë.

Pse duhet të krijojmë konsullata të përbashkëta me Kosovën jashtë, në vende të ndryshme? Kosova duhet të ketë vetëm flamurin e saj atje ku e ka, ne duhet të kemi tonin. Kështu

konsolidohet si shtet. Ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet tona për ta konsoliduar Kosovën si shtet sovran. Ky është patriotizmi dhe ky është shërbimi më i madh që i bëjmë ne Kosovës.

Nga ana tjetër, unë mendoj se një veprim i tillë dëmton jo vetëm Kosovën, por dëmton edhe Shqipërinë? Së paku, tregon se Shqipëria është një rrëmpallë e vërtetë, sepse edhe për çështje kaq të rëndësishme merren mendime fluturimthi. Ne kemi burimet tona njerëzore, kemi shërbimin tonë të konsoliduar, kemi karrierën tonë. Përse duhet të bëjmë aventura të tilla dhe të tregojmë pozicionime të tilla? Pra, në këtë mënyrë po veprojmë gabim, por po veprojmë gabim edhe në një pikë tjetër. Ajo zonja ka qenë për pak muaj këshilltare e Kryeministrit tonë, por ka qenë edhe nënkryetare Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, por më pas e largoi qeveria aktuale. Çfarë duam të tregojmë me këtë mënyrë? T'i bëjmë karshillëk qeverisë së Kosovës?! Të jemi një element, i cili kërkon të shtojë, të forcojë dhe të thellojë përçarjen në Kosovë? Pse duhet të bëjmë veprime të tilla politike, sepse veprime politike janë këto, nuk janë veprime të tjera, të thjeshta, janë mesazhe politike që jepen?

Pra, unë mendoj se në këtë prizëm është një veprim i gabuar, dikush mendon se është bërë për të dhënë shenja patriotizmi. Nuk është ky patriotizmi, ky është patriotizëm i shtrembër, primitiv. Nuk është ai që i duhet Shqipërisë dhe Kosovës, është një patriotizëm primitiv, i cili nuk tregon dashurinë për Kosovën, është si paku një dashuri joreale kjo gjë. Dashuria duhet të tregohet ndryshe, edhe mbështetja e Kosovës; dashuria duhet të tregohet në Nish te mospranimi i marrëveshjes me Vuçiq atje, ku Kosova lihej në hije dhe ku ishte edhe zanafilla e Ballkanit të Hapur. Një ngrehinë serbe për të anashkalur Kosovën, për të krijuar supremacinë dhe kontrollin serb në rajonin politik dhe ekonomik, për ta vënë Vuçiqin në krye të tavolinës. Këto janë elemente që tregojnë patriotizmin dhe jo veprime si Ballkani i Hapur, i cili kërkon të na çojë në lindje, por për qafimi që ditën e parë i procesit të Berlinit, i cili na çon në perëndim.

Patriotizmi ynë është një patriotizëm evropian, patriotizmi ynë i ka fillimet që nga Europa, nga perëndimi, nuk i ka nga lindja. Ky është patriotizmi i shqiptarëve. Ai që mendon dhe gjykon se mund të ketë patriotizëm me drejtim nga lindja, do të na kthejë në perandorinë e

dikurshme Otomane apo komuniste, pra është antipatriotizëm.

Për të mos folur pastaj për shkëmbimin e territoreve, veprime që janë realisht në kundërshtim me interesat tona; për të mos folur për shumë marrëveshje të porealizuara me Kosovën, por vetëm të firmosura në letër; për të mos folur edhe për një qëndrim ambig, shumë ambig, shumë të çuditshëm, që është mbajtur së fundi nga mazhoranca për takimin Kurti-Vuçiç që u zhvillua në Ohër. Ky është një qëndrim shumë ambig, shumë i paqartë, shumë i papozicionuar. Pse? Që të mos mërzhitim Vuçiçin?! Pra, realisht unë mendoj se ky është antipatriotizëm. A është patriotizëm edhe moslejimi dhe mospranimi për të diskutuar në këtë sallë të Kuvendit mocionin për gjenocidin serb në rajon, për ta bllokuar atë në mënyrë krejtësisht të parregullt, antikushtetuese dhe kundër Rregullores, gjë që i duhet Kosovës pikërisht në këto momente, në këto betejat politike ndërkombëtare që po bën Kosova? Pra, këto janë elemente që kanë dëmtuar dhe dëmtojnë rëndë Kosovën dhe, për vendimin e tij, siç e thashë në fillim, duhej involvuar Kuvendi. Është thënë se janë pyetur shërbimet e huaja. Cilat janë këto shërbime? Çfarë janë këto shërbime? Në radhë të parë, për vendime të tilla duhet të pyetet Kuvendi i Shqipërisë, komisionet përkatëse të Kuvendit të Shqipërisë. Çfarë janë këto parulla të përgjithshme: “Kemi pyetur shërbimet e huaja”?! Akoma do të vazhdojmë me këto gjëra; me këto komplekse, me këto mjegullnaja?! Jo, nuk është kështu.

Pse nuk është diskutuar një gjë e tillë në Komisionin e Jashtëm? Çfarë diskutohet në Komisionin e Jashtëm? Asgjë nuk diskutohet atje, nuk ekziston Komisioni i Jashtëm. Po në Komisionin e Sigurisë? Po në këtë seancë plenare? Pra, a e kuptoni që kemi të bëjmë me një veprim, i cili për mua bie ndesh, po përsëritni gabimin që bëtë me ministrin e Jashtëm, që përfundoi si përfundoi, dhe po vazhdoni përsëri me të njëjtat gjëra, të cilat dëmtojnë Kosovën, dëmtojnë seriozitetin e Shqipërisë, dëmtojnë marrëdhëniet tona, dëmtojnë pozicionin tonë dhe, pa dyshim, krijojnë disa veprime rrëmpallë, që janë jashtë sensit, që nuk përputhen me realitetin, me potencialet e mëdha që ka Shqipëria sot, me marrëdhëniet korrekte me Kosovën, si dy shtete sovraane dhe të pavarura, që jemi, nëse duam realisht që Kosova të zhvillohet dhe të ketë, në

ketë mënyrë, sovranitetin e saj, të njihet nga sa më shumë vende dhe të bëhet anëtare e OKB-së.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehu!

Në fakt, kam detyrimin t’ju tërheq vëmendje kolegëve që t’i përmbahen thelbit të diskutimeve, por, sigurisht, nuk mund t’i imponohem askujt në fjalën e tij.

Fjalën e ka kërkuar ministrja e Jashtme, zonja Olta Xhaçka.

Olta Xhaçka – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Marrëveshja e arritur në Ohër më 18 mars mes Kosovës dhe Serbisë është një lajm shumë i mirë për qytetarët e Kosovës, por edhe për të gjithë rajonin tonë. Prandaj, unë dua të marr një moment që të përgëzoj Kosovën, qeverinë e saj, për seriozitetin e treguar, por edhe për guximin e treguar, pasi, natyrisht, arritja e një marrëveshjeje të tillë nuk ishte e lehtë.

Po ashtu, dua të shpreh mirënjohje për Bashkimin Europian, posaçërisht për përfaqësuesin e lartë Borrelli dhe përfaqësuesin e posaçëm Miroslav Lajcak për të gjithë angazhimin, pse jo për durimin dhe këmbënguljen, me të cilën punuan për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Pa dyshim, një mirënjohje të posaçme shkon edhe për Shtetet e Bashkuara dhe Zëvendësndihmëssekretarin Escobar, që dhanë një kontribut të pazëvendësueshëm në këtë proces.

Marrëveshja e arritur në Ohër është një lajm i mirë. Puna konkrete për zbatimin pritet të nisë afërsisht për 1 muaj, ndërkohë që shpresa është që gjithçka të jetë dakordësuar deri në fund të vitit.

Sigurisht, finalizimi do të kërkojë shumë punë. Djalli fshihet në detaje dhe mjafton të marrësh në konsideratë faktin që kjo marrëveshje u miratua përmes një procesi krejt *sui generis*, pa u firmosur, për të kuptuar se finalizimi nuk do të jetë aspak i lehtë. Duke thënë këtë, nuk dua të jap shkas për pesimizëm. Unë personalisht jam shumë optimiste që, me angazhimin konstruktiv dhe serioz të qeverisë së Kosovës, asaj të Serbisë, me mbështetjen dhe monitorimin e Bashkimit Europian, veçanërisht të SHBA-ve gjatë procesit delikat të implementimit, ekzistojnë të gjitha kushtet që kjo marrëveshje t’i çojë me sukses drejt normalizimit marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

Ajo që dua të them, është se puna që duhet bërë deri në finalizimin e zbatimit të marrëveshjes do të jetë komplekse, me sfida dhe do të kërkojë shumë përkushtim, seriozitet, por edhe mbështetje nga partnerët dhe aleatët për të qenë e suksesshme.

Është koha për hapa të vendosur, jo për ambiguitet. Marrëveshja dhe aneksi duhen zbatuar në tërësinë e tyre, siç parashikon pika 2 e aneksit, jo duke zgjedhur disa dispozita dhe duke injoruar disa të tjera. Nuk duhet të pengohet anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë OKB-në; duhet të njihen dokumentet dhe simbolet kombëtare të Republikës së Kosovës, ndaj kjo marrëveshje duhet vlerësuar dhe duhet mbështetur nga të gjithë, edhe nga ne këtu, pavarësisht përkatësive politike.

Shqipëria ka qenë vazhdimisht në mbështetje të dialogut. Shqipëria ka qenë që në krye të herës në mbështetje të të ashtuquajturit plan franko-gjerman, i cili shërben si një pikënisje e mirë për dialogun. Pa dyshim, ashtu siç kemi bërë në çdo moment, edhe në luftë, edhe në paqe, ne do të vazhdojmë ta mbështesim Kosovën me të gjitha mundësitë që kemi. Përpjekjet tona sot do të vazhdojnë të fokusohen te procesi i anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe te procesi i njohjeve. Me arritjen e kësaj marrëveshjeje unë pres që këto procese të bëhen deri diku më të lehta dhe që rezistenca të zbehet, pavarësisht se jemi të vetëdijshëm për pengesat që mund të krijohen gjatë këtij procesi nga vende si Rusia apo ndonjë vend tjetër, që nuk e mbështesin dialogun dhe arritjen e një normalizimi të plotë mes Kosovës dhe Serbisë. Por ajo që mund të them, është që, falë performancës vërtet të suksesshme që ka pasur diplomacia shqiptare, veçanërisht në vitet e fundit, duke filluar me Presidencën e OSBE-së, me performancën vërtet dinjitoze në Këshillin e Sigurimit, me progresin në procesin e integritit evropian, me rritjen e angazhimit tonë proaktiv në favor të paqes, të stabilitetit dhe të bashkëpunimit në rajon, por edhe me fuqizimin e intensifikimit të marrëdhënieve bilaterale me një sërë vendesh, Shqipëria ka sot mundësi më të mëdha dhe më konkrete për ta mbështetur Kosovën, çka, pa dyshim, që do ta bëjmë në një koordinim të ngushtë me Kosovën.

Mbështetja e Kosovës është sot, siç ka qenë jetë e mot, një prioritet kombëtar. Por sot më shumë se kurrë, në kontekstin e agresionit të paligjshëm rus kundër Ukrainës, normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë është një prioritet për sigurinë dhe stabilitetin e mbarë rajonit edhe më gjerë, në mbarë Europën. Rajoni ynë, sidomos situata si ajo mes Kosovës e Serbisë apo ajo në Bosnje Hercegovinë janë në shënjestër të përpjekjeve ruse për të shkaktuar tensione dhe konflikte në Ballkanin Perëndimor, përpjekje, të cilat duket tashmë qartë se kanë ndodhur edhe në Shqipëri përmes injektimit të fondeve ruse në politikë. Arritja e kësaj marrëveshjeje, normalizimi eventual i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë do të shuajë një nga vatrat e mundshme të konfliktit në rajon. Pa dyshim, duke i hapur rrugën avancimit të të dyja vendeve në procesin e integritit evropian, do të ndikohet ndjeshëm në konsolidimin e paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit në rajonin tonë, në Ballkanin Perëndimor.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhaçka!

Fjalën e ka zoti Ismet Beqiraj.

Të përgatitet zoti Petrit Vasili.

Ismet Beqiraj – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si specialist i fushës, sot në këtë seancë parlamentare dua të mbaj një leksion, pasi energjia nuk është vetëm një sfidë, që ka vënë përballë edhe shtete të fuqishme, por një domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik dhe standardet gjithnjë në rritje të mbarë botës.

Nga ana tjetër, sfida qëndron në faktin se energjia fosile është në shterim dhe do të vijë ora që do të shkojmë te vija e kuqe. Rezervat biologjike të naftës të vërtetuara deri tani nuk i kalojnë 50 vjet, të gazit natyror 70-80 vjet dhe qymyret, më gjatë, 200-250 vjet. Duam apo nuk duam ne, burimet e energjetike të rinovueshme nuk janë vetëm shpresë, por janë një sfidë e madhe dhe shoqëria duhet të përgatitet në aspektin e kornizave ligjore dhe juridike për t'i menaxhuar me efikasitet, jo vetëm për të kursyer burimet tradicionale fosile, por për të dhënë një kontribut edhe në mbrojtjen e mjedisit, jetës, sidomos për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Ndaj, në respekt të kornizës rregullative të veprimtarisë në Kuvend, nuk do të zgjatet, por dua të kthehem te çështja e ditës që po shqyrtojmë, e cila ka një rendësi shumë të madhe.

Projektligji “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, që po shqyrtojmë sot në këtë seancë, është një vlerë e shtuar në politikën e qeverisë së kësaj mazhorance, e cila, në kontratën elektorale me qytetarët e saj, ka qëllim dhe mision mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në vendin tonë, zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe në rastin konkret incetivimin dhe zhvillimin e përdorimit me efikasitet të burimeve tona natyrore të energjisë së rinovueshme, sepse dora e Zotit nuk është kursyer për vendin dhe popullin tonë.

Ligji nr. 7/2017 në fuqi, i cili rregullon fushën e energjisë së rinovueshme, është miratuar një vit para miratimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018-2030, të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030, si dhe direktivës 2018/2001 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, që udhëheq politikën e Komunitetit Europian për energjinë e rinovueshme. Ndaj, në këto kushte, hartimi dhe miratimi i një politike të re, specifikisht për energjinë e rinovueshme, do të sillte harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Komunitetit Europian, po ashtu edhe përputhshmërinë me Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030 dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030 dhe me synimet e objektivat që kemi në nivel kombëtar e më gjerë. Kjo, rrjedhimisht, çon në një situatë ku legjislacioni vendas nuk përputhet me atë të BE-së, veçanërisht në një fushë kaq të rëndësishme, siç janë politikën pro mjedisit dhe mbrojtjes së planetit dhe për gjetjen e zgjidhjes për të mos shteruar burimet e rinovueshme dhe për të shfrytëzuar ato të rinovueshme.

Ndërhyrja e qeverisë me këtë projektligj është e nevojshme, pasi politikën e qeverisë për diversifikimin dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë kanë përballur aktorët e këtij tregu dhe institucionet përgjegjëse me një sërë sfidash që rrjedhin nga mangësitë e legjislacionit aktual, ku konkretisht me kuadrin ligjor aktualisht në fuqi:

a) Nuk rregullohen në mënyrë specifike llojet e energjisë nga burimet e rinovueshme, sipas përcaktimeve dhe përkufizimeve më të përditësuara bashkëkohore përkatëse, dhe nuk

përputhen me stadin e zhvillimit aktual në aspektin teknik, ligjor dhe institucional.

b) Objektivat kombëtarë detyruar dhe detyrimet raportuese për kontributin e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë nuk përputhen me objektivat e azhornuar ndërkombëtare të Bashkimit Europian.

c) Rregullat për informacion, për statistika, për certifikim, për mekanizmat e bashkëpunimit, për mbështetje, rregullat lidhur me aksesin dhe funksionimin e rrjeteve për burimet e energjive të rinovueshme dhe lidhjen e tyre me rrjetin e energjisë elektrike nuk përputhen me mekanizmat e rinj të BE-së.

d) Rregullat për dhënien, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme nuk përputhen plotësisht me mekanizmat e rinj të Bashkimit Europian.

e) Rregullat për integrimin e vetë konsumatorëve në sektorin e energjisë elektrike nuk janë të përshtatura sipas mekanizmave të rinj të BE-së.

f) Mungonin rregullat për përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në sektorët e ngrohjes, të ftohjes dhe të transportit.

g) Promovimi i burimeve të rinovueshme të energjive kryhej edhe nëpërmjet skemave të mbështetjes financiare “*Feed-in-Tariff*”, të cilat paraqitën kosto për operatorin e shpërndarjes, probleme me balancimin e energjisë në rrjet, si dhe konsiderohen si barrierë për shitjen e energjisë në tregun e ri të liberalizuar së fundi.

Sfidat e sipërcituara përbëjnë risi dhe janë parashikuar në projektligjin “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, që po shqyrtojmë sot në këtë seancë parlamentare. Ky projektligj është një ndër instrumentet kryesore strategjike që ndihmon qeverinë të arrijë objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore nëpërmjet një sistemi të përgjegjshëm, efektiv dhe transparent të shfrytëzimit të burimeve energjetike dhe mirëmenaxhimit të tyre, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe uljen e kostove të energjisë, duke u orientuar te burimet e rinovueshme të energjisë.

Objektivi kombëtar është përcaktuar tashmë në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030, miratuar me vendimin nr. 872/2021 të Këshillit të Ministrave, nëpërmjet të cilit synohet

që pesha e energjisë së rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë në vitin 2030 të jetë në nivelin 54,4%. Ndërsa si objektivi i rëndësishëm dytësor, në funksion të objektivit kombëtar, emetimet e gazeve serrë do të jenë në nivelin 18,7% dhe konsumi i energjisë së rinovueshme për sektorin e transportit minimalisht në nivelin 14%. Domethënë, direkt do të hiqet nga konsumi i karburanteve fosile 14%. Nisur nga objektivi kombëtar i sipërcituar, lind pyetja: sa mund të jenë rezervat e burimeve të rinovueshme? Unë do t'i referohem vetëm njërës prej burimeve të rinovueshme, sepse janë shumë, atij hidrik. Sot shfrytëzohet vetëm 50% e potencialit energjik hidrik nga lumenjtë. Këtu nuk përfshihet e gjithë infrastruktura e ujësjellësve, sistemet e kullimit dhe vaditjes. Vendi ynë ka mbi 620 ujëmbledhës.

Dua të përmend që vetëm për zonën time, sa herë që diskutohet buxheti, kam kërkuar që të rifutet përsëri në punë sistemi i vaditjes, i prodhimit të energjisë dhe shfrytëzimi për ujë të pijshëm i dy rezervuarëve malorë që ka Mallakastra, Lumara 1 dhe Lumara 2, që vaditin jo vetëm kurorën e Bashkisë së Mallakastrës, por edhe të bashkive të Patosit dhe Fierit, e cila është projektuar me një veprim të trefishtë. Ka plot shembuj edhe në investimet lokale për shfrytëzimin e energjisë elektrike, për shfrytëzimin e energjisë të rinovueshme, hidrike, sidomos të asaj solare. Ndaj të gjitha projektet e reja që do të bëhen në të gjithë infrastrukturën ujore, qoftë të ujësjellës-kanalizimeve, por edhe të sistemit vaditës dhe kullimit të jenë projekte të integruara, ku të përfitohet energji e rinovueshme.

(Bie gongu.)

Meqenëse ra gongu për të mbyllur diskutimin, nuk do të zgjatem më tej, por, duke falënderuar edhe kolegun Dashmir Shehi, i cili tha se do të japin votën për këtë projektligj, sepse kjo është një e mirë publike për të gjithë ne, nuk është vetëm për një krah politik, miqtë e mi, them se ne duhet të mobilizohemi dhe të bashkohemi që të ngremë digat pozitive dhe jo diga për t'i fryrë politikës, qoftë në krahun e mjaftë, qoftë në krahun e djathtë.

Ky projektligj që po diskutojmë sot, është një projektligj, i cili na përgatit për të ardhmen, sepse, në mos ne që jemi sot, brezat tanë do të përballen me sfidën e energjisë. Ajo që është e sigurt, e rinovueshme dhe miqësore me natyrën

është vetëm energjia e rinovueshme dhe ne Zoti na i ka dhënë, kështu që duhet ta shfrytëzojmë.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fjalën e ka zoti Petrit Vasili.

Të përgatiten zoti Noka dhe zonja Vokshi.

Petrit Vasili – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është shumë e qartë për këdo edhe proceduralisht se cili është vullneti për të diskutuar për energjinë e rinovueshme, për të diskutuar nismat e opozitës dhe për të pasur një qëndrim objektiv, në të gjitha rastet në emër të së mirës publike.

Siç e shikoni, edhe në seancën e sotme ne po diskutojmë një projektligj të sjellë nga qeveria. Më e pakta një parlament që ka pak sqimë për veten e tij, një parlament që do t'i thotë vetes parlament, që do të thotë se nuk është një pronë politike dhe që në mënyrë të vështirë është rrëmbyer nga një krah, do të kërkonte të ndiqeshin procedurat parlamentare edhe formalisht. Gjithashtu, sot janë edhe nisma, dy projektligje që ia kam propozuar Kuvendit, të cilat do të shqyrtohen më pas. Ta dinë shqiptarët si procedon kjo anë, ta kenë të qartë të gjithë pa përjashtim. Ato nisma janë depozituar më parë se sa projektligji i qeverisë, por në këtë sallë diskuton e para qeveria, sepse thotë: "Ne e kemi Kuvendin. Kuvendi nuk është i përfaqësuesve të popullit, është prona jonë. Ne e kemi rrëmbyer. Ne e futim ligjin, e diskutojmë. Po të duam, nuk e diskutojmë, e zvarritim." Ja ku jemi: nismat për një temë të interesit të përbashkët janë në fund, kurse nisma e qeverisë është e para. Mund të pyesë kushdo: po çfarë thotë rregulli parlamentar? Një nismë e sjellë më parë diskutohet më parë, duke përjashtuar rastet kur kërkohet një procedurë e shqyrtimit me përparësi të veçantë, siç e parashikon procedura e Kuvendit. A jemi në një rast të tillë? Jo. Po çfarë është rasti? "E kemi atë bahçen, të cilën e kemi rrëmbyer, dhe e bëjmë si të duami, se jemi shumë të fortë dhe nuk pyesim për rregulla. Punë e madhe nëse i shkelim i rregullat, vazhdojmë më tutje." Unë nismat që kam paraqitur, do t'i diskutoj më pas. Ato janë shqyrtuar nga tri komisione. Duhet të shqetësohej seriozisht ky krahu, që e zaptoi bahçen dhe që do ta bëjë si të dojë. Merrini, shikojini se i keni

materialet. Tri komisione zbatojnë tri procedura të ndryshme në mënyrën si i shqyrtojnë. Edhe në materialet që sjellin në sallë, një komision vendos vetëm dy rreshta nga propozuesi, protagonistin, ai që i propozon ligjet, që isha unë; një tjetër sjell një shqyrtim më të gjerë, më korrekt, pse jo, do t'ia njoh unë në momentin kur të bëjë diskutimin; një tjetër e çon aty në periferi. I njëjti parlament, që ka të njëjtën Rregullore, paturpësisht bën 3 lloj modelesh, sepse secili është pronar i komisionit të tij. Ne e kemi traditë, -thotë, - njeri në komision. Po çfarë traditë, more lumëzi? - i thua, - këtu ka Rregullore, nuk është punë tradite, por ai vazhdon, - e kemi traditë ne. Tradita është se ai, që ka atë bahçen e tij, e punon si të dojë vetë. Kjo është pamja e parlamentit.

Vijmë te nisma. Cili është raporti me të? Sot kanë sjellë përsëri një ligj. A ka pasur ligj? Po, more, por, kur është miratuar ky ligj, sa vjet ka? Në vitin 2017, minimumi i mundshëm i kohës për të bërë një ligj dhe për të pasur mundësinë për t'u rregulluar. Po çfarë jua mbajti dorën që ne sot, në raport me energjitë e rinovueshme (faktet janë shumë kokëforta) kemi vetëm 0,7% prodhim, pra vetëm 2 ditë energji, kur po me të njëjtin plan, të Planit Kombëtar të Energjisë dhe të Klimës, që është miratuar nga kjo qeveri, duhej të ishte minimalisht 30 apo 40 herë më shumë? Po mirë pyesin shqiptarët, këto mundësi janë, ja edhe ligji paska qenë, çfarë patën këta, pse e mbajtën shtrenguar, pse nuk i bënë?! Përgjigjja është e thjeshtë: nuk do t'i bëjnë, sepse, po të prodhohen këto energji, të prodhohet energji në vend, detyrimisht do ta jetë e gjitha gati, nuk blejnë dot, nuk bëjnë dot tenderë, nga ata tenderë faqezinj, që e shesin energjinë e vendit me 5 lekë dhe e blejnë me 10-fshin. Tani tenderojnë edhe për vitin 2028, mirë që nuk tenderuan edhe për vitin 2128! Këto janë fakte publike dhe janë aty, nuk janë të miat. Kush jua mbajti dorën?! Cila është aftësia e menaxhimit të sektorit, jo vetëm për energjinë e rinovueshme, por për energjinë në tërësi? Sa shkon fuqia e parashikimit? Sa vizion keni?! Vizioni juaj është sa një shi, sepse e kemi dëgjuar Kryeministrin me 1 mijë ulërima, e kataklizmos energjetike e të tjera; u vu edhe fasha, siç e mbani mend, të cilën e kemi dënuar, kemi dhënë plot argumente dhe shumë argumente i kemi dhënë bazuar në konsultimet që kemi bërë me specialistë të njohur të fushës, por ata nuk kanë vlerë në qoftë se nuk thonë atë që duan këta, sepse, po të thonë

të kundërtën e atyre që thonë këta, janë qesharakë, janë të poshtër, janë njerëz që i shërbejnë opozitës, që bëjnë të bardhën të zezë. Ky është kategorizimi klasor, sepse nuk ndahen dot nga karakterizimet klasore, ose të pushtetit, ose të përndjekur; ose të deklasuar, ose të partisë. Kjo është, sepse në mënyrë normale nuk mund të ndodhë të vësh një fashë, pastaj bie shi dhe fasha nuk zbatohet. Nuk mund të jetë një qeveri serioze ajo që i shkon parashikimit deri te një vesë shiu. Është e mbaruar që në themel, nuk ka vizion, nuk ka gjë, por ka një konstante: do të grabisë, ndërkohë që ka këtë situatë. Këto nuk janë të dhënat e mia, janë tuajat. Borxhi i ndërsjellë i ndërmarrjeve lidhur me energjinë elektrike shkon në 1,2 miliardë euro. Kjo nuk është shifra ime, por është shifër zyrtare. Sektorë të tjerë, si ujësjellësit, kanë 200 e ca milionë euro borxhe. Humbjet në rrjet, të cilat ishin parashikuar që në vitin 2019, duhej të kishin qenë në rendin 15% dhe 16%, por vazhdojnë të jenë 21%, 22%, 23% dhe 24%, sipas të dhënave të këtyre. A ka marrë sektori para për t'i ulur humbjet teknike në rrjet?! Po, ka marrë qindra milionë. Si ka mundësi që merr qindra milionë dhe, në vend që këto humbje të shkojnë drejt rënies, jo vetëm që objektivat e vëna vetë nuk i realizojnë, por vazhdojnë të jenë kaq të larta?! Kujt i intereson?! Vetëm në dy vjet janë harxhuar mbi 700 e ca milionë euro për blerje energjie. Këto janë shifrat e tyre zyrtare, jo të miat, sepse kam marrë angazhimin që në këtë Kuvend nuk do të përdor kurrë asnjë shifër tjetër dhe do t'i qëndroj. Cili blen 700 e ca milionë euro energji?! Një vend, i cili mund ta prodhojë totalisht energjinë e tij, të ketë mundësi të eksportojë. Në vitin 2021 është prodhuar më shumë energji se sa janë nevojat e vendit. Është blerë energji me qindra milionë euro, a ka një përgjigje për këtë punë? Çfarë do të bëni, doni bëni budallenjtë e dobishëm dhe të na mbushni mendjen se, megjithëse prodhojmë të gjithë energjinë, ne kemi përsëri shumë merak dhe duhet të blejmë?! Çfarë e ka emrin kjo?! E ka emrin menaxhim korruptiv, e ka emrin menaxhim për të grabitur para dhe për ta kthyer sektorin e energjisë në një sipërmarrje të madhe elektorale, financiare, burimesh njerëzore për punësimin e mijëra njerëzve. Shifrat janë kokëforta, ato nuk lëvizin. Nuk janë përdorur aspak burimet e tjera alternative, e gjithë kjo rezervë e pafund burimesh të energjisë. Kush jua mbajti dorën?! Duhet t'u

themi të gjithë shqiptarëve se e patën ligjin dhe instrumentin, kush jua mbajti dorën?! Hajdeni bëjeni këtë katil të çmendur, bëjeni! Megjithëse patëm ligj, nuk e lejuam, nuk e penguam, nuk patëm asnjë lloj zhdërvjelltësie, nuk patëm asnjë lloj dëshirë ta stimulojmë. Aty është dielli, aty është era, aty janë të gjitha mundësitë e tjera për biofuel dhe mundësi të tjera pafund. Ndërkohë që promovojnë se do të bëhemi eksportues neto të energjisë, pra potencialet janë sheshit, janë aty, ulërijnë, varda miratojnë qindra milionë për të blerë energjinë. Kjo është një logjikë kokëfortë, nuk është logjikë partizane, nuk është logjikë politike. Kjo është një llogari mjaft e thjeshtë. Çfarë avokatie do t'i bëni kësaj gjëje?! Çfarë do të bëjë ligji?! Ligji do ta decentralizojë akoma më shumë në duart e qeverisë, pra do të mbahet aty që pazari të bëhet vetëm nga një dorë. Kjo është. Nismat i kemi kërkuar për decentralizim dhe zhdërvjelltësim, që çdo mundësi që ekziston të stimulohet, që ky turp i padëgjuar që vazhdojmë të blejmë energji, të marrë fund njëherë e përgjithmonë, sepse kemi pafund mundësi (dhe kjo është një çështje e mbyllur) që të përdorim energji shumë të lirë dhe energji të pastër.

Sigurisht, e gjitha kjo është një tjetër letër e sjellë këtu, e shkruar, ku vullneti është zero që ky sektor të qeveriset ashtu siç duhet, në të mirë të këtij vendi dhe të qytetarëve që jetojnë këtu.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vasili! Fjalën e ka zoti Noka.

Flamur Noka – Në fakt, në qoftë se sot këtu do të kishte një mazhorancë normale, siç ndodh në çdo demokraci funksionale dhe do të kishte një qeverisje me vullnetin më minimal dhe përgjegjshmërinë minimale, kryefjala e ditës në këtë parlament do të ishte analiza e raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Ju qeshni, sepse mendoni se kështu do ta kaloni, sikundër u përpoqët me të gjitha mediet që keni nën kontroll, ta kaloni në heshtje këtë raport dramatik për sa u përket zhvillimeve të demokracisë në Shqipëri. Edhe në ditët më të vështira të demokracisë shqiptare, përgjithësisht raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit kanë folur për përmirësime, për hapa pozitivë, për avancime reformash, por kanë folur edhe për defekte e mangësi, por kurrë ndonjëherë, derisa “rilindja” shkeli në krye të shtetit, nuk kanë folur për degradim të hallkave të pushtetit dhe të shtetit.

Ndaj për shqiptarët ky lloj raporti është një kabanë alarmi. Demokracia është në rrezik.

Çfarë thotë raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit? Ne të gjithë këtu kemi votuar reformën në drejtësi. U proklamua me të madhe që do të vijë drejtësia e re. Qindra fjalime janë dëgjuar të mbahen këtu për reformën e re të drejtësisë, e cila do të vinte ta shpëtonte Shqipërinë dhe do të zhduronte çdo të keqe në këtë vend. Madje reforma e re e drejtësisë do të përmirësonte edhe tekstet e shkollës. Kështu thuhej dikur. I thuhej qytetarit që reforma e re e drejtësisë do të përmirësonte edhe gjendjen e xhepit të tij. Këtu në këtë foltore janë mbajtur këto fjalë dhe jo nga kushdo, por nga drejtuesit e mazhorancës. Çfarë thotë pas kaq vjetësh?! Sepse edhe gjatë periudhës së ndërmjetme u fol që ka nevojë të maturohet reforma në drejtësi, që drejtësia duhet lejuar të veprojë, të provohet avash-avash. Tani thuhet se ju, me votimin e 6 ligjeve në mënyrë të njëanshme, me vetingun dhe me gjithçka, e keni shkatërruar drejtësinë dhe nuk po e them unë këtë, por e thotë raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit. Në asnjë raport në 32 vjet nuk është folur për presion politik ndaj drejtësisë. Është folur për ndikim rastesh sporadikesh, por kurrë për presion politik. Për herë të parë në 32 vjet është folur për frikësim të drejtësisë. Jo më larg se në datën 3 mars drejtësia pa terror dhe frikësim për të dhënë vendim. Kush i bën këto presione politike, frikësimin?! Pa diskutim banda që është në pushtet, banda që është e rreshtuar këtu. Ata kanë mundësitë, kanë fuqinë dhe të gjitha akseset për të ushtruar presion dhe për të frikësuar.

Thatë që drejtësia ishte korruptuar dhe do të shpëtonte nga korrupsioni. Raporti thotë: “Korrupsioni është një plagë e rëndë sot në drejtësinë e re të Edi Ramës. Sigurisht, burimet e kufizuara, që varen po nga mazhoranca, e penguan gjyqësorin të funksiononte.” Të gjitha këto shkurt dhe thjesht tregojnë se sot kemi një drejtësi që është në xhepin Edi Ramës dhe të bandës së tij, që quhet qeveri. Kemi një drejtësi që frikësohet, terrorizohet sa herë i duhet dhe ia lyp nevoja qeverisë. Sot kemi një drejtësi të korruptuar. Korrupsioni është përsëri një plagë e rëndë e shoqërisë, kryesisht e qeverisë. Departamenti Amerikan i Shtetit thotë: “Korrupsioni i pranishëm në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, përfshirë këtu prokurimin

publik dhe partneritet publike-private.” Pra, raporti e vendos gishtin te bandat këtu mbrapa. Të gjithë të korruptuar dhe të zhytur në korrupsion, e korruptuar edhe qeverisja lokale që më 14 maj duhet ndryshuar, sepse është e zhytur në korrupsion me të gjitha ato PPP-të e famshme, të cilat për 10 vjet rresht ne si Parti Demokratike dhe si opozitë i kemi atakuar nga kjo foltore apo kudo tjetër, sot po ua atakon Departamenti Amerikan i Shtetit. Pra, partneritetet publike-private tuajat janë korrupsion, prokurimet publike tuajat janë afëra. Prandaj ju bëni gjithçka që t’i kaloni në heshtje, sepse plaga e hapur, po të preket, sigurisht që dhemb dhe askujt më shumë sesa Edi Ramës dhe juve nuk i dhemb.

Raporti flet edhe për medien, gjendjen e medias dhe trysinë ndaj saj nga pushteti. Është për herë të parë: trysia nga pushteti. Thotë se janë të pakta mediet e pavarura, sepse të gjitha varen nga “sulltan-Surreli”. Pa sms-të e “sulltan-Surrelit” asnjë lajm, asnjë kronikë dhe asnjë editorial nëpër media.

Presioni politik ndaj medias, korrupsioni dhe mungesa e fondeve e kufizuan medien e pavarur. Raporti thotë se është praktikuar edhe autocensurë mbi pronarët e medias dhe mediet e tyre. Pse? Raporti thotë: “Pronarët e medias janë të gjithë të lidhur me nevojën për fonde publike nga biznesi.” Çfarë është?! Kjo situatë, ky skaner që i bën Departamenti Amerikan i Shtetit gjendjes së medias në Shqipëri, tregon se këtu nga një demokraci po kalojmë në monizëm, drejtësia degë e ekzekutivit. Mediet janë kthyer në dritare propagande të qeverisë, korrupsioni është mjet i vetëm, me të cilin ju qëndroni në pushtet dhe bëni gjithçka që ta mbani pushtetin, për asgjë tjetër, sepse nuk flitet për zhvillim, as për reforma, për asgjë. Por për herë të parë raporti në 32 vjet flet që shteti në Shqipëri përdoret për mllafe personale, kurrë nuk është thënë kjo gjë në raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit citon edhe mbylljen me forcë të një ambienti biznesi të një deputeti të opozitës. Kjo tregon se ju jeni në një shkallë monstruoziteti të tillë, sa po tentoni të likuidoni opozitën. Kurrë nuk ka pasur sulme të tilla ndaj opozitës. Raporti përmend edhe rastin e “Prestige Resort”, i cili është një alarm për nivelin e lirisë së medias në Shqipëri. Pse? Sepse edhe emisionet pasqyrojnë faktin që përfaqësuesit e lartë të medias i përdorin organet e tyre për të

ushtruar shantazh ndaj bizneseve. Pra, mediet e qeverisë kanë mësuar nga “sulltan-Surreli” dhe nga qeveria dhe kanë filluar gjokat. Kurrë nuk ishte përmendur në raport një situatë e tillë. Sikundër, prisni, në raportin e ardhshëm do t’ju flas edhe për Shërbimin Informativ, që, pasi e morët dhe e keqpërdorët në gjitha këto vite, e degraduat në atë pikë që nuk ka më askush besim nga partnerët te ky shërbim dhe tani...

Ermonela Felaj – Ju lutem, përfundojeni, se ka mbaruar koha!

Flamur Noka – Tani e morët peng duke e shpallur të pavarur nga shërbimet partnere dhe duke e vënë në shërbim të vendeve jomike të Shqipërisë. Kështu që të gjitha këto tregojnë një gjë: degradim, rrënim. Kjo është shenjë që ju duhet të shporreni. Do ta fillojmë me pushtetin vendor dhe më pas do të vazhdojmë me ju.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zonja Vokshi. Këtu mbyllet diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Dua ta pranohet se u mahnita nga fjalët e zëvendëskryeminstres, të cilat më sollën ndër mend fjalimet në plenumet e Partisë Komuniste, ku i thurnin lavde diktatorit Enver Hoxha.

Sigurisht, energjia është një sektor i rëndësishëm, por po aq i rëndësishëm ka qenë edhe për vjedhjet dhe korrupsionet në nivelet më të larta. E keni shndërruar energjinë në sektorin, nga i cili përfitohet dhe abuzohet më shumë dhe pikërisht korrupsioni ishte një ndër problemet madhore të përmendura edhe në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, të publikuar para dy ditësh në lidhje me të drejtat e njeriut në Shqipëri gjatë vitit 2022. Nëse përtoni ta lexoni, e keni të përmbledhur te “Zëri i Amerikës”, medie zyrtare në Amerikë. Çfarë thotë raporti? “Mangësia në pavarësinë e gjyqësorit, mungesa e pavarësisë në medie, korrupsioni, i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes, janë vetëm disa nga problemet kryesore në Shqipëri. Media e kërcënuar, media jo e lirë. Bizneset mbyllet me urdhër dhe me tritol.” Si shembull përmendet mbyllja me forcë e një ambienti biznesi të një deputeti të opozitës. Raporti përmend: “Disa pronarë biznesesh, aktivistë të shoqërisë civile dhe politikanë, akuzuan qeverinë për aplikim selektiv të ligjit “Për sekuestrimin e pronave” për qëllime politike. Në tetor IKMT-ja dhe Policia e

Shtetit mbyllën me forcë ambientet e biznesit të një deputeti të opozitës, gjoja duke përmendur shkeljen e kërkesave të ndërtimit, por deputeti është vënë në shënjestër, pasi ka akuzuar vazhdimisht dhe publikisht zyrtarë të lartë të qeverisë për korrupsion.” Si asnjëherë më parë, në raportin e Departamentit të Shtetit, nëse e krahasojmë edhe me raportet e vendeve të tjera, sulmet ndaj bizneseve përmenden specifikisht. Aty përmendet edhe shembja me tritol në dhjetor e një hoteli nga Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, duke përmendur që pronari i hotelit ishte edhe pronar i disa medieve, i bizneseve të tjera dhe pretendon se hoteli i tij u shkatërrua për të shuar kritikën ndaj qeverisë.

Prej kohësh PD-ja ka denoncuar situatën alarmante të lirisë së medias në Shqipëri. A ka transparencë pa medie të lira? Jo! A ka llogaridhënie pa medie të lirë? Jo! Pa medie të lirë nuk ka informim të publikut, për rrjedhojë nuk ka zgjedhje të duhura, të lira nga qytetarët për qeverisjen e tyre. Medie e lirë ka qenë dhe mbetet kusht i panegociueshëm për hapjen e negociatave. Për situatën e rënduar të medias dhe gazetarëve kanë folur të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare që trajtojnë liritë, të drejtat e qytetarëve dhe lirinë e medias.

Kanë reaguar në të gjitha raportet e viteve të fundit “Reporterët pa kufij”, që kanë ngritur alarmin se në Shqipëri cenohet liria e medias dhe rruga për në Bashkimin Europian është edhe më e gjatë: “Sulmet ndaj medias si nga qeveria, ashtu edhe nga krimi i organizuar arritën në një nivel të paprecedentë. Situata e lirisë së medias paraqitet e rrezikuar nga kërcënimi i pavarësisë editoriale. Shqipëria ka zbritur nga vendi 83 në vendin 103, vetëm në vitin e fundit ka rënë plot 20 vende. Shteti shqiptar (vazhdon raportin e “Reporterët pa kufij”) ka dështuar t’i mbrojë gazetarët edhe nga dhuna policore.

Klasa politike kërcënon pavarësinë e redaksive nëpërmjet institucioneve të politizuara. Gazetarët janë të rrezikuar dhe censura, si pasojë e të gjitha këtyre kushteve, është përhapur”.

Raporti i Komisionit Europian në tetor të vitit 2022 ndalet te cenimi i lirisë së medieve, problemet me korrupsionin, si dhe shoqërinë civile.

Freedom House ndalet, po ashtu, gjatë në rrezikimin e lirisë së medieve në Shqipëri. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh, sepse Kryeministri, Edi

Rama, e urren medien e lirë, urren mendimin e lirë, urren fjalën e lirë, urren opozitën, ndaj i sulmon, i shantazhon në të gjitha mënyrat. Edi Rama është kthyer në një diktator të medias dhe kërkon ta kontrollojë plotësisht atë. Parimi i tij është: atë që nuk e blen dot me tenderë, me koncesione, me licenca e kërcënon, e shantazhon, e fyen, e përçmon, e kallëzon, e padit, së fundi edhe e shkatërron, duke vepruar jo si shtet, por si pushtet, duke vepruar si bandë kriminale që nuk pyet për Kushtetutë, për ligje, për gjykata, për procedura. Liria e shtypit në Shqipëri po humbet terren ditë pas dite. Vetëm pak javë më parë nga kjo sallë e parlamentit Edi Rama iu drejtua me nota kërcënuese dhe përçmuese drejtuesve të medias “Syri.net”. U kujtojmë organizatave të lirisë së shtypit, kombëtare dhe ndërkombëtare, në Shqipëri, në Europë dhe kudo se vetëm para disa javësh u hodh në erë me tritol prona me leje e një prej botuesve më të mëdhenj në Shqipëri, vetëm se mediet e tij kishin filluar të ndryshonin linjën editoriale dhe të ishin kritikë me qeverinë. Edi Rama përbën një kërcënim të hapur, armiku kryesor publik numër një i medias së lirë, i lirisë së fjalës, i pluralizmit dhe i idesë së integritimit europian të vendit.

Kujtojmë “Agon Channel”, që u mbyll dhe u kushtoi taksapaguesve shqiptarë 120 milionë euro, pasi pronari i kësaj TV-je fitoi gjyqin në Strasburg. Jam e sigurt që këtë fat do të ketë edhe rasti i fundit i “*Prestige Resort*”.

“RTV Ora”-ën, e kontrolloi, e intimidoi, e konfiskoi. Me siguri një faturë e ngjashme do të paguhet edhe për të. Por nëse reagimi nuk është i përgjithshëm, nuk është i fuqishëm, nuk është i të gjithë qytetarëve si brenda dhe jashtë vendit, Shqipëria shumë shpejt mund të kthehet në një Kore të Veriut në mes të Europës.

Politika e Ramës “O me mua, ose kundër meje” dhe i përcaktuar për asgjësim, si në rastin e “*Prestige Resort*”, është një metodë staliniste, enveriste diktatoriale. Akti i djeshëm i Edi Ramës për konfiskimin e godinave të “*Prestige Resort*” është një kampanë alarmi që duhet të na zgjojë të gjithë, akt që nuk ka lidhje me zbatimin e ligjit, por bëhet vetëm për ndëshkimin e medieve që nuk i binden Edi Ramës. Po, a ia kemi bërë të gjithë një pyetje vetes, pasi kemi parë ato skena? A mund t’i konfiskojë qeveria pasuritë private? Në cilin vend të Europës apo edhe jashtë saj mund të vijnë si bandë, pa urdhër, vetëm me urdhër të Edi

Ramës, për konfiskim apo për shembje, pa pritur vendimin e gjykatave, pa pasur asnjë dokumentacion?

Jam ndodhur atje kur tentohej të konfiskohej godina e një kompanie të deputetit të Partisë Demokratike, zotit Shehaj. Nuk ishte ndjekur asnjë procedurë, nuk kishte asnjë dokumentacion. Kishin ardhur si bandë dhjetëra policë, dhjetëra makina policie dhe kishin vënë shiritin si skenë krimi. Për çfarë? Vetëm pse Agron Shehaj ka denoncuar rastet skandaloze korruptive të kësaj qeverie.

Akti i djeshëm i Edi Ramës përbën një kërcënim serioz për të gjithë ne. Nuk është vetëm “*Prestige Resort*” i kërcënuar, por është prona e çdo qytetari shqiptar. Tashmë në Shqipëri shteti ligjor ka rënë! Nuk kemi asnjë siguri ligjore. Nuk kemi siguri juridike. Sot mund të të trokasim në derë e të të thonë: “Dil përjashta, se më duhet prona jote!”, ashtu siç kanë bërë më të gjitha pronat në legalizim apo të legalizuara tek Astiri, Bregu i Lumit e shumë të tjera. Sot liria e fjalës është në rrezik, liria e mendimit është në rrezik, liria e veprimit është në rrezik, liria e votimit është në rrezik.

Ndaj, kam një thirrje për çdo qytetar shqiptar: le të bëhemi bashkë, sepse bashkë fitojmë! Bashkë fitojmë ndaj këtij monizmi që ka vendosur Edi Rama duke u mbështetur te banda, krimi dhe korrupsioni. Duke qenë bashkë, mund të fitojë e mira mbi të keqen që Edi Rama na e ka vënë prej vitesh, të cilën vetëm duke u bërë bashkë mund ta largojmë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Vokshi!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”. Referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, a ka pyetje për nismëtarin? Nuk ka.

Atëherë, ftoj zonjën zëvendëskryeministre të bëjë prezantimin e kësaj projektmarrëveshjeje.

Faleminderit!

Belinda Balluku - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministre, pjesëtarë të Këshillit të Ministrave, Të nderuar qytetarë,

Sot është një ditë për t’u shënuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sepse janë dy projektligje të rëndësishme, që mbështesin dy nga sektorët më të rëndësishëm, të cilët ndikojnë direkt në cilësinë e jetës së qytetarëve tanë: atë të energjisë elektrike dhe të furnizimit me ujë.

Megjithatë, nuk mundem dot të mos ndalem te fjalët e zjarra që sapo dëgjuam për raportin e DASH-it. Çuditërisht DASH-i një herë bëhet shumë i dashur për liderët e opozitës: Doruntinën, Kostandinin e të tjerë, pastaj, kur vjen puna te “*non grata*”, DASH-i nuk është i dashur dhe është i gabuar. Kështu që, varet se si na del dielli në mëngjes: na del te “*non grata*”-t apo na del te raportet dhe te liria e medias, për të cilën po na digjet shpirti, por që nuk ka lidhje me lirinë e medias, sepse, për të thënë të drejtën, nuk besoj se DASH-i ju ka lënë ndonjë autorizim që të merrni dhe të interpretoni raportin e prodhuar nga ata, siç jua ka qejfi juve.

Ka një problematikë që shfaqet në raport për sa i takon medias, i cili lidhet me pronësinë e medias dhe jo me qeverinë, duke filluar nga konstatimi se pronarë mediesh po i përdorin mediet për interesat e tyre personale. Nëse ti je pronar mediesh, nuk do të thotë që, nëse ke një linjë ushqimore prodhimi, të mos paguash taksat; nëse ti je pronar mediesh, por je edhe ndërtues, nuk do të thotë të ndërtosh me leje zhvillimi, pa shkuar të marrësh lejen e ndërtimit, siç e marrin të gjithë ndërtuesit e tjerë. Kur ti je pronar mediesh, siç e thotë edhe raporti i DASH-it, nuk do të thotë të mos ua paguash rrogat gazetarëve, ashtu siç janë në të vërtetë, por t’i deklarosh të gjithë me 300 mijë lekë dhe të bësh sikur nuk ka ndodhur asnjë gjë. Të jesh pronar mediesh, do të thotë të jesh pronar mediesh, jo të jesh edhe pronar i linjave ushqimore, ku nuk paguhen taksa, edhe ndërtues që nuk merr leje ndërtimi. Pra, kur ti je pronar mediesh dhe nuk merr leje ndërtimi, nuk ka problem. Ti duhet të ndërtosh, se e thotë Doruntina që duhet të mbrojë fjalën e lirë.

Kjo është një histori që nuk mund të vazhdojë pafund, pra, kur na do qejfi, ta mbrojmë raportin e DASH-it dhe, kur s’na ka qejfi dhe dalim “*non grata*” në mëngjes, ta shajmë Amerikën (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Ju lutem, kolegë deputetë, mos flisni nga vendi! Askush nuk ju ndërhyri gjatë fjalës!

Belinda Balluku – Unë e kam shumë të qartë që nuk të pëlqen të dëgjosh të vërtetën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, fjalën e ka zëvendëskryeministrja.

Belinda Balluku – Por, meqenëse u hap puna e raportit të DASH-it, ka gjetje pozitive në të. “Ka një përparim të dukshëm në luftën kundër pandëshkueshmërisë dhe korrupsionit. Shembull i progresit janë hetimet dhe dënimet e zyrtarëve të të gjitha niveleve. Qeveria implementoi shërbime elektronike për të përmirësuar transparencën dhe për t’i reduktuar ndjeshëm shanset e korrupsionit. Qeveria i konsolidoi agjencitë parandaluese kundër korrupsionit në një drejtori antikorrupsioni në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, e cila raportoi se hetimet kanë rezultuar me 261 masa në administratë ndaj zyrtarëve dhe procedime të tjera penale. Gjithashtu, raporti thotë se qeveria bëri përpjekje më të mëdha për të trajtuar pandëshkueshmërinë në polici. Agjencia e re e Mbikëqyrjes Policore, e pavarur nga Policia e Shtetit, kreu 385 hetime individuale, 106 arrestime dhe 61 pezullime nga detyra të zyrtarëve. Qeveria vazhdoi të zbatojë një proces të monitoruar ndërkombëtarisht për të vetuar gjyqtarët dhe prokurorët. Nga 556 gjyqtarë, prokurorë dhe organe të tjera të vetingut të shqyrtuar që nga viti 2016, 37% kanë kaluar, 43% u pushuan nga puna, 18% kanë dhënë dorëheqjen ose dolën në pension. Qytetarët ishin të lirë ta kritikonin hapur qeverinë në mediet tradicionale dhe ato sociale për çështje që shqetësojnë qytetarët. Për lirinë e internetit nga ana e qeverisë nuk ka asnjë kufizim, as ndërprerje të aksesit në internet, asnjë censurë të përmbajtjes dhe gjithçkaje që mund të pasqyrohet në faqet e internetit.”

Të gjitha këto janë te raporti i DASH-it që ju nuk i lexoni dot, sepse jeni shumë të zënë për t’i lexuar ato, pasi keni hall si do të zhvillohet liria e medias, duke mos paguar taksa, duke mos marrë leje ndërtimi, si të gjithë qytetarët e tjerë dhe duke bërë shumë çudira. Mjafton që ju të jeni komodë.

Ndërkohë që t’i kthehemi sektorit të ujit, furnizimit me ujë, i cili siç thamë është në interes direkt të qytetarëve. Këtë vit ka pasur një vëmendje të veçantë të qeverisë shqiptare, pasi

kemi nisur një reformë të thellë, cila do t’i përmirësojë të gjithë parametrat teknikë, financiarë dhe, mbi të gjitha, cilësinë që ujësjellës-kanalizimet duhet t’i ofrojnë çdo qytetari. Nga një sektor i fragmentuar, i cili operonte në të gjitha bashkitë, por në disa bashki me një eficiencë shumë të ulët për shkak edhe të numrit të ulët të banorëve që kishin zonat, sot përmes një agregimi që ne e kemi nisur prej një viti, kemi arritur të kemi rezultate të prekshme dhe konkrete që do të shtohen në të ardhmen.

Situata e trashëguar në këtë sektor ka qenë diçka që ne e kemi komunikuar shpesh me publikun: ujësjellës të ndërtuar në vitin ‘60, ujësjellës të ndërtuar edhe më pas, por në mënyrën më të gabuar, investime të fragmentuara, diku investohej për shpërndarjen, por nuk investohej për matjen apo për grumbullimin në depot e ujit.

Patjetër, është një sektor që ka pasur problematika, e dëgjova edhe nga deputetët që u përmend tek flitej për energjinë, se si ujësjellësit kanë qenë dhe janë debitorët kryesorë të sektorit energjetik. Kjo është e vërtetë dhe është një nga arsytet pse ne vendosëm të ndërmarrim reformën e agregimit të ujësjellësve, pasi ujësjellësit e vegjël, sigurisht duke konsumuar energji, disa prej tyre nuk e kanë mundësinë e rrjedhjes gravitacionale dhe përdorin sisteme pompimi, krijojnë pafund detyrime ndaj ndërmarrjeve energjetike, duke krijuar kështu një cikël të brendshëm që afektonte edhe sistemin energjetik. Po marr një shembull, si gjithmonë një shembull relevant që tregon sesi sot Korça, e agreguar me të gjitha bashkitë që e rrethojnë atë, ka arritur në këta 12 muaj të ketë rezultate. Ky agregim ka edhe bashki, të cilat konsideroheshin problematike, siç ishin Bilishtit apo Maliqi. Sot të bashkuara janë duke performuar shumë më mirë dhe janë duke u ulur të gjitha debitet dhe problematikat që kanë pasur deri më sot.

Vetëm gjatë vitit të kaluar kemi ndërtuar rreth 600 kilometra linja të reja të furnizimit me ujë dhe rreth 100 kilometra rrjet të ri kanalizimesh. Investimet e kryera, veçanërisht gjatë vitit të fundit në këtë sektor, kanë synuar që përmes zgjidhjeve teknologjike të ulen kostot e shërbimit dhe të rritet përgjegjshmëria në mbledhjen dhe menaxhimin e të detyrimeve të qytetarëve.

Pa dyshim, uji është një e drejtë bazike, por pa dyshim është një sektor që ka kërkuar ndër vite

të ketë shumë investime. Ndaj, për këtë arsye duhet kuptuar nga ana e secilit prej nesh që pagesa e këtij shërbimi është po aq e rëndësishme sa pagesa e energjisë elektrike. Sot në Republikën e Shqipërisë ka një mbledhje të faturimit mbi 99%.

Kështu, për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, ne kemi instaluar pompa me teknologji të avancuar që konsumojnë më pak energji elektrike, tubacione specifike të pacenueshme nga qytetarët e papërgjegjshëm, të cilët ndonjëherë kanë ndërhyrë në këto tubacione në mënyrë të paligjshme, por me tubacionet e reja kjo është pothuajse e pamundur. Kështu do të shmangim edhe faturimin aforfe, i cili nuk është i drejtë as për ndërmarrjet e reja të agreguara, por as për vetë qytetarin.

Ndërkohë, jemi duke punuar për ta detajuar projektin, për t'i pajisur ujësjellësit me panele fotovoltaike. Kemi dy shembuj shumë të mirë: ujësjellësin e Memaliajt dhe ujësjellësin e Belshit. Kanë qenë dy shembujt, dy projekte pilotimi, për të parë sesi një ujësjellës mund të funksionojë në mënyrë të pavarur, duke ulur kostot e produktit, duke e prodhuar vetë energjinë elektrike. Sigurisht, ne kemi ujësjellës, të cilët kanë konsum shumë të lartë të energjisë elektrike për shkak të disa sistemeve të pompimit që kanë, siç është rasti i ujësjellësit të Durrësit, por, duke pasur këto pilotime, sado të vogla, ne tashmë kemi studime të mirëfillta se si duhen mbështetur edhe ndërmarrjet e agreguara për të filluar dhe për t'i nxitur të futen në fushën e eficiencës së energjisë dhe ato vetë të ndërtojnë parqe fotovoltaike, të cilat do të shërbejnë për furnizimin me energji elektrike, duke ulur kështu kostot ndaj OSHEE-së.

Rezultatet, sigurisht kanë qenë të ndjeshme. Rreth 500 mijë qytetarë kanë përfituar vetëm në vitin 2022 nga investimet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Tashmë 33 zona urbane dhe 98 zona rurale furnizohen me ujë të pijshëm me cilësi të lartë, 24 orë në ditë dhe brenda vitit 2023 do të shtohen edhe 7 zona të tjera urbane dhe 164 zona rurale, të cilat do të furnizohen 24 orë me ujë.

Marrëveshja që po shqyrtojmë sot për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në Shqipëri, vjen si një vazhdim i mbështetjes financiare të qeverisë në këtë sektor jetik përmes investimeve në nivel kombëtar, që synojnë

përmirësimin e cilësinë së shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, rritjen e orëve të furnizimit me ujë, rritjen e mbulimit me shërbim deri në 3% më shumë, e cila u përgjigjet 50 mijë banorëve, si dhe përmirësimin e performancës operative dhe financiare të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve.

Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë është një program “për rezultate”, ndaj dhe huaja që e shoqëron, nuk përben një hua klasike, por ndjek logjikën e kushtëzimit. Pra, të gjitha ato ndërmarrje, të cilat do të performojnë, do të mbështeten financiarisht përmes kësaj huaje, duke përmblusur një nga objektivat themelore që qeveria ka vendosur për të siguruar vlerën për paranë publike të investuar në këtë sektor, duke garantuar mirëmenaxhimin e sektorit, si dhe rritjen e aksesit në rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve të shtresave akoma të pashërbyera dhe e gjitha kjo do të ndodhë në rang kombëtar.

Huaja e Bankës Botërore me vlerë 75 milionë dollarë përbën një bashkëfinancim me qeverinë shqiptare, e cila nga ana e saj angazhon 60 milionë dollarë për këtë program, si dhe mbështetjen me një grant nga qeveria zvicerane në vlerën 6,3 milionë dollarë për forcimin e kapaciteteve, për zbatimin e programit, si dhe verifikimin e përmblusjes së indikatorëve të performancës.

Ftoj të gjithë deputetët ta miratojnë këtë marrëveshje, duke i dhënë një mbështetje dhe shtysë sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, si një nga sektorët me rëndësinë më të madhe, jetike në vend.

Faleminderit për vëmendjen!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zëvendëskryeminstre!

Po, zonja Vokshi, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

Albana Vokshi – Replikë.

Ermonela Felaj – Për çfarë?

Albana Vokshi – Për replikë.

Ermonela Felaj – Zonja Vokshi, ju replikuat me zëvendëskryeminstren në fjalën tuaj dhe ajo jua ktheu replikën. Replikë mbi replikë nuk ka.

(Ndërhyrje nga salla)

Po, jua ktheu në fjalën e saj.

Ju e përmendët që në krye të fjalës suaj zonzjën zëvendëskryeministre dhe morët përgjigje për atë që thatë.

(Zonja Vokshi flet pa mikrofon.)

Kështu që nuk ka vend për replikë.

Ju lutem, zonja Vokshi, të mos e pengojmë ecurinë e mëtejshme të seancës. Ju e kuptoni edhe vetë që nuk keni të drejtë për ta marrë fjalën.

(Zonja Vokshi flet pa mikrofon.)

Nuk ka absolutisht asgjë të tillë, por besoj që të gjithë këtu ishin dhe e dëgjuan se çfarë thatë dhe çfarë përgjigje morët.

Fillojmë me listën e diskutimeve.

Zoti Sula e ka fjalën.

Të përgatitet zonja Marnoj.

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Me sinqeritetin më të madh do të doja, meqenëse sot është një ditë e shënuar për të gjithë komunitetin e besimtarëve myslimanë, t'u uroj atyre një agjërëm të lehtë, dhe të gjithë qytetarëve shqiptarë! Sigurisht, do të bëja një apel shumë miqësor edhe për qeverinë, edhe për të gjithë drejtuesit e institucioneve të shtetit shqiptar që këto 40 ditë të muajit të Ramazani, dhe uroj inshallah: të mos vazhdojnë t'i ndyjnë duart e tyre, siç i kanë ndyrë deri tani. Urojmë që të ndalojnë këto 40 ditë, se do t'i bënin nder.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

30 ditë, dakord, Taulant. Po e shtyva 10 ditë, mos fitojnë edhe ditë të tjera.

Një shprehje e gazetarit dhe shkrimtarit *Graham Greene* thotë: "Armiqtë tanë më të këqij në jetë nuk janë njerëzit e paditur dhe të thjeshtë, sado mizorë të jenë, por të zgjuarit dhe të korruptuarit". Mendoj dhe gjykoj se kjo shprehje, që ka thënë shkrimtari *Graham Greene*, ka shumë vlerë për ne dhe është për t'u vlerësuar.

Ajo që ne po diskutojmë sot këtu në këtë sallë për sa i përket borxhit që po marrim përsëri për ujësjellësit, raportimi që bëri zëvendëskryeministrja apo ministrja e Energjetikës dhe falënderimet që bëri ajo, vlejné nëse ato para vijnë këtu, përdoren dhe shpenzohen sipas të gjitha detyrimeve ligjore që ka një kompani apo një bashki, por kjo nuk është e vërtetë.

Para se të dal te Departamenti Amerikan i Shtetit, për të cilin diskutoi zëvendëskryeministrja, me të vërtetë ju intereson dhe e interpretoni raportin e Departamentit

Amerikan të Shtetit kur ju do qejfi juaj, sipas mënyrës suaj, por pa diskutim e zeza mbi të bardhë nga Departamenti Amerikan i Shteti është me raste specifike. Unë nuk doja të përfshihesha fare në këtë debat, por si anëtar, si deputet i këtij parlamenti, më vjen turp kur shkruhet për Shqipërinë me emra konkretë, me raste konkrete, siç është rasti i fundit për medien, që ju dhe qeveria juaj deri dje e mbanit, e respektonit, madje e kishit shumë të afërt, sepse ishte një njeri që nuk po ju bënte dëm, ndërsa në momentin që doli nga rreshti, e sulmuat, e degraduat, doni ta falimentoni. Kjo është e vërteta.

Sa për lejet pa leje dhe për mospagimin e taksave, aty e kishit ju deri dje, ku ishte ai, në Hënë? Ku e bënte aktivitetin ekonomik, ku e bënte aktivitetin ndërtimor? Por, sepse kishte vëllezër këtu midis jush, e quanit vëlla zotin Hysenbelliu. I jepnit shanse për të punuar apo për të ndërtuar. Nëse qenka ashtu siç thoni ju "Në mënyrë të padrejtë", pse e lejuat deri dje? E lejuat, sepse kështu i bëni punët me të gjithë, ka edhe shumë të tjerë, me të cilët i bëni punët në këtë lloj forme, por kur nuk ju intereson, kur vjen momenti dhe grindeni me njëri-tjetrin, bëni gjithçka: sulmet, luftën për ta zhdukur, për ta rrënuar apo për ta varfëruar. Është turp që ta përdorni kur ju intereson dhe, kur nuk ju intereson, të përdorni gjuhë tjetër.

Kam një thirrje për ju, zonja Zëvendëskryeministre, dhe për të gjithë anëtarët e qeverisë dhe të parlamentit: bolla me këtë hipokrizi! Është e turpshme sjellja juaj. Është e turpshme mënyra se si flisni në këtë parlament. A keni pak faqe, pak moral?!

Për sa u përket ujësjellësve, po, zonja Zëvendëskryeministre, folët ju, ujësjellësi të gjithë e dimë që është një gropë e zezë, është vendi i militantëve, pa diskutim për të 7 bashkitë e qarkut të Elbasanit, ku jemi ne. Ujësjellësi i Peqinit ka 24 orë ujë, por është ndërtuar në kohën e Partisë Demokratike. Nuk ka sesi të dalë me humbje, absolutisht, sepse paguajnë qytetarët, por dalin me humbje Peqini, Belshi dhe vende të tjera për një arsye shumë të thjeshtë: keni 3-4-fishuar numrin e punonjësve, të militantëve që janë tek ujësjellësi, si një vend punësimi për militantët. Po ju garantoj dhe ju sfidoj: hapni sistemin TIMS, sepse keni punëtorë apo persona të caktuar, të cilët janë jashtë shtetit dhe marrin rrogën në ujësjellësit në bashkitë e qarkut të Elbasanit! Kjo është e

vërteta, por ju nuk doni t'i besoni dhe mundoheni të jepni justifikime.

Përpara 2-3 javësh miratua këtu 60 milionë euro për ujësjellësin e Durrësit. Sot po thoni 75 milionë dollarë, të jeni të sigurt se përsëri një pjesë e këtyre 75 milionë dollarëve që po marrim këtu, do të firojë, sepse janë tenderë, për të cilët, në vend që të ketë një fond limit, të jeni të sigurt se përdoren më pak ose nuk ekzistojnë. Tubat, që përmendi zëvendëskryeministrja, madje janë bërë tuba floriri, aq shumë kushtojnë kur bëhet tenderi në ujësjellës. Këtë gjë e dinë të gjithë.

Përpara pak kohësh kam denoncuar këtu me prova të qarta për sa i përket ujësjellësit të Belshit, meqë e more si pikë referimi, zonja Zëvendëskryeministre. E kam ngritur dhe kam thënë se ujësjellësi i Belshit, që po diskutohet që të furnizohet me energji elektrike nëpërmjet paneleve diellore, nuk ekzistonte në *Google*, edhe sipas koordinatave që ishte bërë tenderi. Jua kam thënë që edhe tenderi ishte me flamur të kuq, siç janë edhe tenderët e tjerë. E kam nxjerrë edhe këtu. Pak ditësh ka qenë zëvendëskryeministrja atje, sepse u denoncua këtu dhe e filluan tani. Jam i bindur që duhet të verifikohet nëse ai fond po zbatohet përsëri, se nuk ekzistonte as depoja, as panelet diellore. Kjo ishte e vërteta edhe në Bashkinë e Belshit. Të jeni të sigurt që kjo gjë ndodh për një arsye shumë të thjeshtë, sepse abuzohet në të gjitha bashkitë, të cilat gjatë këtyre 4 vjetëve, fatkeqësisht i kishit të gjitha ju dhe nuk kishte kush të bënte opozitë as në këshillin bashkiak.

Në vitin 2022 janë akorduar subvencione për nevojat e shoqërisë për të shlyer detyrimet e papaguara që kanë pasur shoqëritë përbërëse të shoqërive të reja rajonale të ujësjellës-kanalizimeve. Ndryshe nga viti paraardhës, ku ato ishin të identifikuar vetëm për kostot e energjisë elektrike, raportohet se nga vlera totale e subvencioneve 38,86% janë shpërndarë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të papaguara, 26,1% janë shpërndarë për kostot e energjisë elektrike, 13,56% janë për tatimet dhe taksat e papaguara, 4,81% për pagat e papaguara, ndërsa 16,67% janë shpërndarë për performancë të mirë vetëm për dy shoqëri, për ujësjellës-kanalizimet e Korçës dhe të Pogradecit, siç thuhet në raportin vjetor të ERRU-së.

E thashë edhe pak më sipër: ku shkojnë këto para? Jeni qeveria, e cila përgjatë këtyre 10 vjetëve, qëkur kemi ikëm nga pushteti në vitin 2013, në administratën publike, në tërësi kudo me të gjitha bashkitë ka pasur, në mos gaboj, 120 mijë të punësuar. Sot a e di sa e keni? A doni provë të pakontestueshme? Po ju them se përgjatë vitit 2022, me ato që bëni me kontrata, gjoja të përkohshme dy-tremujore, keni punësuar 2036 persona në administratën publike. A e dini se sa është numri i administratës, i të punësuarve në shtet?! 184 mijë e 396 persona. Kurse sektori privat, i cili duhet të punësojë më shumë, ka pësuar një tkurrje prej 10 mijë punëtorësh. Ma gjeni shpjegimin, ma gjeni logjikën! Atëherë, shteti këtu në Shqipëri është punëdhënësi më i madh, është ai që ka më shumë të punësuar, në një kohë kur gjithë këta të punësuar paguhen nëpërmjet taksave tona, që paguajnë qytetarët shqiptarë. Pse? Sepse janë persona militantë, njerëz që ju i futni në punë. Po ju them se në 7 bashkitë e qarkut të Elbasanit, nga Elbasani i pari dhe deri në bashkinë e fundit në Përrenjas apo në Gramsh, muajt e fundit kemi me dhjetëra, me qindra punëtorë të punësuar me kontrata individuale, gjoja për përmbushjen e detyrimeve në komunitet. Po pse në janar, shkurt dhe mars u kujtuat ju për pasur shërbimet e komunitetit? Nuk mund t'i kishit ato në vitin 2021, në vitin 2022? Ju pretendoni se çdo shërbim sot në administratë po bëhet *online*, po bëhen me shërbime digjitale, në një kohë që ju rrisni numrin e të punësuarve nëpër institucionet shtetërore, në ministri, në administratën qendrore dhe në institucionet shtetërore.

Prandaj, e nderuar zonja Zëvendëskryeministre, që nuk je këtu, apo anëtarë të qeverisë, jeni në një rrugë kryekëput të gabuar. Nuk do merrem më gjatë, por po ju them: keni vetëm një indikator matës për të gjithë qytetarët shqiptarë, për shtetin shqiptar, për shoqërinë shqiptare: mjafton të përmendet numri i të rinjve që ikin çdo ditë nga Shqipëria, çdo javë, çdo muaj, çdo vit, i të rejave, i familjeve të mesme dhe i të punësuarve që janë shtresa e mesme. Pyetja është: pse ikin nga Shqipëria? Se është vend i lumtur, janë mirë me paga, janë mirë me familjet e tyre, me ekonominë e tyre? Jo! Për një arsye shumë të thjeshtë, sepse këtu ka një moment, i cili është jashtëzakonisht kritik për veten e tyre, për familjet

e tyre. Të rinjtë dhe të rejtat, të cilët nuk kanë mundësi për të blerë një shtëpi...

Ermonela Felaj – Ju lutem, zoti Sula, përfundoni!

Dashnor Sula – Mbarova, e mbylla vetëm 20 sekonda.

Sipas Bankës Botërore apo të gjithë organizmave ndërkombëtarë, është e përlogaritur që një çift i ri, i cili sapo martohet, do 17- 20 vjet për të blerë një shtëpi për të futur kokën, pra imagjinoni pas 20 vjetësh, kur t'u jenë bërë fëmijët 20 vjeç. Ndërsa këtu ata që merren me trafikim apo me të gjitha gjërat e tjera, kanë 8-10 apartamente. Kjo është e vërteta. Të gjithë duhet të ulërijmë dhe t'i thërrasim mendjes, sepse është për të ardhur keq dhe për të vënë duart mbi kokë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Balla.

Taulant Balla – E kam kërkuar fjalën për procedurë. Unë e kuptoj që të gjithë anëtarët e kësaj sale kanë hyrë në ethet e zgjedhjeve vendore dhe foltorja e Kuvendit nuk do t'u shpëtojë këtyre etheve, edhe pse nga fjala e deputetit parafolës kuptova që opozita lexon raportin e “Dash Sulës”, jo raportin e DASH-it, por kjo është çështja juaj.

Zoti Sula, nëse ju keni prova për veprat penale që cituat gjatë fjalës suaj, unë kam mbajtur shënim, dhe bëhet fjalë për 8-9 vepra penale të kryera, sipas pretendimeve tuaja, edhe moskallëzimi i krimit është vepër penale. Merrini dhe shkoni pranë institucioneve të prokurorisë, sipas rastit, në prokurorinë në Elbasan apo në Prokurorinë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Sot kam pasur rastin të kem në gjykatë njërin prej jush, i cili përdori foltoren e Kuvendit për një akuzë që edhe ai vetë e di se nuk ka asnjë lidhje. Atje në gjykatë ju nuk vini.

E fundit që, lidhet me Belshin, Belshi i dashur zoti Sula, edhe ti bie dakord me mua, është një prej modeleve të transformimit rrënjësor që kanë pësuar fshatrat, qytezat dhe qytetet e Shqipërisë pas vitit 2013. Të dy e dimë fare mirë se si ishte Belshi në vitin 2013 dhe se çfarë transformimi mori Belshi pas vitit 2015, kur Edi Rama dhe Arif Tafani në krye të asaj bashkie filluan transformimin. Të vish këtu e të thuash që nuk ekziston ujësjellësi i Belshit! Shko dhe pyeti banorët e Belshit, të cilët nuk kishin ujë të pijshëm. A kemi arritur në 24 orë ujë të pijshëm?

Ndoshta nuk e kemi arritur kudo, por, nëse marrim një mesatare të Shqipërisë në vitin 2013, kishim më pak se 8 orë ujë të pijshëm, ndërsa sot kemi 18, 22 dhe 24 orë në një pjesë të bashkive.

Për procedurën që nisa: a keni prova? Shkoni dhe çojini në prokurori. Bëni detyrën, moskallëzimi i krimit është krim gjithashtu.

Ermonela Felaj – Zoti Sula, për replikë.

Dashnor Sula – Sigurisht, edhe të qenit prokuror për 15 vjet, më bën që të mos flas kurrë në “hava...”

(Ndërhyrje nga salla)

Ju lutem, ta mbaroj. Do ta nis me raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, meqë ishte raporti i “Dash Sulës”. Sigurisht, raporti i DASH-it fjalë për fjalë flet për vëllanë e zotit Balla dhe nuk flet për vëllanë tim, për ish-vëllanë...

E dyta, po, në Belsh është investuar, por atje janë vjedhur edhe shumë para. Dëmi ekonomik është 720 milionë dhe çështja së bashku me Arif Tafanin janë në SPAK prej 2 vjetësh, por ju e mbani peng, sepse do të kandidojë. Ma kundërshtoj diçka të tillë. A ka vendim pushimi? Jo. A ka vendim dërgimi në gjyq? Jo, është akoma duke u hetuar dhe ju po e rikandidoni. Kjo është e vërteta. Ma kundërshtoj. Merr Peqinin, Belshin, Cërrikun, Përrenjasin, Gramshin dhe Elbasanin, nëse nuk gjen një numër punonjësish me kontrata të përkohshme të punësuar 4 muajt e fundit, siç e ka ligji që nuk duhen të punësohen njerëz 4 muajt e fundit, përsëri të sfidoj publikisht se jap dorëheqjen si deputet.

(Ndërhyrje nga salla)

Provoje dhe shikoje që i ke të gjithë me kontratë.

Sa për investimet, po, zoti Balla, i bëtë në Belsh, edhe në Elbasan apo në vende të tjera, por Peqinin e keni lënë “mos o Zot”. Peqinin ju e keni harruar, e keni shkatërruar dhe keni fytyrë të kërkoni vota atje. Në darkë Peqini është pa drita dhe, nëse kalojnë dy njerëz pranë, i futen njëri-tjetrit sytë në sy. Kjo është e vërteta. M'i gjej dhe më sfido mua.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Viojmë me radhën e diskutantëve.

Fjalën e ka zonja Shpresa Marnoj. Të përgatiten zoti Fadil Nasufi dhe zoti Bledjon Nallbati.

Shpresa Marnoj – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,
Të dashur qytetarë,

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, në cilësinë e komisionit përgjegjës, e shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”. Projektligji i propozuar është në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës dhe nenit 17 të ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja e huas është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin numër 629, datë 28.09.2022, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Ky projektligj synon ratifikimin e kësaj marrëveshje huaje, e cila do të mbështesë programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, me qëllim akordimin e financimit prej 67,3 milionë eurosh për projektin e mësipërm. Natyrisht, nevoja që ka ky sektor për mbështetje të vazhdueshme me investime, është e papërballueshme me anë të buxhetit të shtetit, ndaj nevojitet marrja e një huaje të tillë për të përmbushur objektivat e programit kombëtar.

Tashmë në të gjithë vendin janë bërë ndërhyrje në disa ujësjellës, kryesisht në qytetet më të mëdha të vendit, aty ku edhe nevoja për investime është më e madhe, por dëshira dhe nevoja e madhe për të pasur ujë 24 orë mbetet një sfidë më vete. Ne nuk mund të harrojmë që vetëm para disa vjetësh cilësia dhe shpërndarja e ujit ishin një problematikë që prekte çdo familje shqiptare, me rrjete ujësjellësish tejet të amortizuar, e shoqëruar kjo edhe me problematikat e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, që vijnë edhe si rezultat i ndërtimeve dhe i zgjerimeve të zonave urbane dhe bregdetare, shpeshherë edhe si pasojë e abuzimeve dhe e punëve pa cilësi, duke mos marrë parasysh pasojat, të cilat janë shumëfish më të rënda dhe lidhen drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve, ku rreziku më i madh është sidomos në periudhën e reshjeve, ku shpeshherë ndodh që ujërat e zeza të prekin edhe sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm, duke e kontaminuar atë dhe duke shfaqur rrezik real për qytetarët. Kështu, në zbatim të përmbushjes së objektivave të qeverisë shqiptare për furnizimin 24 orë me ujë, programi kombëtar

i modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në Shqipëri, i financuar nga Banka Botërore, konsiderohet si një instrument i rëndësishëm financiar për përmirësimin në tërësi të situatës teknike dhe financiare të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve dhe për përmirësimin e qasjes në shërbimet e furnizimit me ujë në Shqipëri, i menaxhuar në mënyrë të sigurt.

Gjithashtu, ky projekt është në përputhje me objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm numër 6 të Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, si pjesë e një prej 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015. Objektivat kryesorë të zhvillimit të programit janë: përmirësimi i performancës operative dhe financiare të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, ku raporti kombëtar mesatar i rikuperimit të kostos operacionale pritët të përmirësohet me 10 për qind (nga 81 për qind në 91 për qind); rritja e aksesit të shërbimeve të ujit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Shqipëri për të marrë vazhdimësi të përmirësuar të furnizimit me ujë në 35 zona të reja urbane; furnizimi minimal prej 18 orësh, si dhe mbyllja e hendekut të mbulimit në nivel kombëtar në zonat rurale me rreth 3 për qind.

Programi është i strukturuar në 3 fusha rezultatesh me mbështetje financiare, që përfshijnë objektivat kryesorë. Realizimi me sukses i projekteve do të sjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë arritjen e treguesve të performancës së sektorit. Shtrirja gjeografike e programit është kombëtare, pasi në parim çdo ndërmarrje e ujësjellës-kanalizimeve të njësive të qeverisjes vendore mund të marrë pjesë nëse respekton kërkesat e programit. Huaja prej 67,3 milionë eurosh ofron financim dhe asistencë teknike për programet e drejtuara nga huamarrësit, duke përdorur sistemet e vendit. Disbursimet ndodhin kur arrihen dhe verifikohen rezultatet e rena dakord dhe fondet rrjedhin përmes llogarisë kombëtare të thesarit. Ajo fokusohet në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të procedurave të nevojshme që programet të arrijnë rezultatet e tyre të dëshiruara.

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Për sa i përket efektit financiar, projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të

Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Energjisë, konkretisht në programin e ujësjellës-kanalizimeve. Huaja që do të akordohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, ka termat e mëposhtëm financiarë: shuma 67,3 milionë euro; interesi i bazuar në normën e referencës plus marzhin e ndryshueshëm; komisioni i angazhimit 0,25 për qind, që përlogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas; maturimi 16 vjet, duke përfshirë periudhën prej 4 vjetësh pa pagesë principlali.

Në përfundim, duke vlerësuar rëndësinë jetike që ka kjo marrëveshje për përmirësimin në tërësi të situatës teknike dhe financiare të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe duke marrë shkas nga seanca e kaluar, në të cilën të gjitha projektligjet dhe projektvendimet u votuan si nga mazhoranca ashtu edhe nga opozita, ju ftoj që edhe këtë projektligj ta miratojmë të gjithë bashkë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Marnoji!

Fjalën e ka zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – E nderuar Nënkryetare e Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Kjo marrëveshje huaje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në shumën prej 67,3 milionë euro mbështet programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri. Qysh në formulim bëhet fjalë për modernizimin e një sektori jetik, të një shërbimi shumë problematik dhe me një trashëgimi, i cili jo vetëm ka krijuar kosto borxhesh nga keqmenaxhimi i ujësjellës-kanalizimeve, por na ka bashkëshoqëruar ndër vite me paradoksin se Shqipëria është një nga vendet më të pasura me burime ujore, por përballet ende me nevojën prioritare për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatrave dhe qyteteve të vendit. Ne duhet t'u jemi mirënjohës të gjithë donatorëve në këta 32 vjet, si Bankës Botërore, Bankës Gjermane (KfW), fondeve të adresuara nga BE-ja dhe nga koperacionet e shumë shteteve që kanë realizuar programe afatgjata dhe me buxhete të konsiderueshme për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri. Buxhetet qeveritare kanë qenë pothuajse të

pakursyer dhe me vëmendje të shtuar për furnizimin me ujë të qyteteve dhe fshatrave. E vërteta është se, krahas trendit në rritje për investime në ujësjellës dhe për përmirësimin e orarit të furnizimit me ujë, ka problematika që lidhen me cilësinë e dobët të investimeve, me fragmentarizmin dhe me keqmenaxhimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, me varësinë e funksionimit të ujësjellësve me konsum energjie dhe me sjelljen shpërdoruese të konsumatorëve ndaj përdorimit të ujit të pijshëm.

Ndaj, përpara se të shprehim dakordësinë për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, duhet të përshëndesim reformën e thellë të qeverisë “Rama” për politikën kombëtare, për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimit të ujërave të ndotur. Jemi futur në fazën e agregimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në 15 shoqëri rajonale, nga 58 të tilla që ishin në të gjithë Shqipërinë. Te shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve 51 për qind të aksioneve i zotëron qeveria dhe 49 për qind pushteti vendor. Kjo është zgjidhja efiçente për rritjen e performancës së ujësjellës-kanalizimeve dhe për dhënien fund të situatës së agravuar ndër vite. Po e konkretizoj me shembullin e shoqërisë rajonale Berat – Kuçovë, ku procesi i agregimit nisi që nga viti 2012 nën monitorimin e KfW-së, pra ka një shoqëri të vetme për ujësjellës-kanalizimet e Beratit, Poliçanit, Dimalit dhe Kuçovës. Njëpërmjet financimit të KfW-së, të filluar që nga viti 2005, janë realizuar katër komponentët e programit, të cilët janë përmbyllur me sukses dhe kanë të bëjnë me investimet në rrjetin kryesor të ujësjellësit të Bogovës, me lidhjen e Kuçovës për t'u furnizuar nga ujësjellësi i Bogovës, me instalimin e matësve, me investimet në rrjetin shpërndarës në Berat dhe Kuçovë, me reduktimin e humbjeve në rrjet dhe me përmirësimin e infrastrukturës bashkiake. Donatorët për vazhdimin e investimit kanë si kusht korrektesën në partneritetet dhe rritjen e performancës së ujësjellës-kanalizimeve. Po t'u referohemi disa treguesve të sh.a-së rajonale Berat dhe ndryshimeve që kanë ndodhur nga viti 2018 në vitin 2022, kemi këtë pamje: furnizimi me ujë si targeti kryesor është i tillë që sot Berati dhe Kuçova furnizohen 24 orë me ujë në ditë falë investimeve, por edhe mirëmenaxhimit të sektorit; në 3 vjetët e fundit shoqëria i ka shlyer 100 për qind këstet e kredisë; humbjet në rrjet dhe

uji pa të ardhura kanë pësuar rënie, nga 77 për qind në 54 për qind; borxhet e trashëguara nga 345 mijë e 449 lekë sot janë 187 mijë e 959 lekë; uji me matës nga 72,5 për qind, sot është 92 për qind; norma e arkëtimit nga 92,3 për qind, sot është 107,6 për qind; nga 4,66 punonjës për 1000 lidhje, që është norma kombëtare, sh.a-ja rajonale Berat-Kuçovë e ka 4,4 punonjës, ndërkohë që shoqëria rajonale ka marrë përsipër me plan biznesi të mbështetur edhe me buxhet për të shlyer faturat korrente në masën 100 për qind, si dhe ka marrë përsipër të gjitha detyrimet që vijnë nga ujësjellësit e tjerë që janë bashkuar në shoqërinë rajonale. Kjo performancë e shëndetshme dhe progresive po afron shansin që KfW-ja të financojë komponentin e pestë Berat-Kuçovë për programin e largimit dhe të përpunimit të ujërave të zeza me një impiant modern, që do të ndërtohet në fshatin Orizaj të njësisë Otlak.

I përmenda dhe solla referenca nga Berati si një e vërtetë që flet vetë, i bindur se shembuj suksesi ka edhe në Korçë, Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë. Kjo marrëveshje që miratojmë sot, synon ta përmirësojë në tërësi situatën tekniko-financiare të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, që ky shërbim të menaxhohet në mënyrë moderne e të sigurt dhe të garantojë arritjen e treguesve të performancës së sektorit. Në thelb kjo marrëveshje adresohet për një kuadër kombëtar të forcuar, duke nxitur vendimmarrje politike dhe marrjen e masave rregullatore dhe institucionale për të përmirësuar kornizën e qeverisjes, funksionet e mbikëqyrjes dhe monitorimit, si dhe forcimin e kapaciteteve të stafeve të shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve. Kredia do të shërbejë për përmirësimin e performancës operationale dhe financiare, duke parashikuar financime për një sistem të rishikuar të grantit të bazuar në qëndrueshmëri dhe performancë; për investime për eficiencën e energjisë në shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve me konsum të lartë energjie, si dhe për paketa stimuluese për proceset e rajonizimit. Financimet e kësaj kredie do të shkojnë edhe për investime për ujësjellës-kanalizimet në zonat rurale dhe do të mbulojnë rreth 12 mijë lidhje familjare për furnizimin me ujë të pijshëm. Edhe pse sektori i ujësjellës-kanalizimeve ka konsumuar ndër vite shumë fonde buxhetore dhe kredi, përsëri, krahas kësaj marrëveshje që miratojmë sot, duhet të gjenden mundësi financimi, jo vetëm për ujësjellës, por

sidomos për trajtimin e ujërave të ndotura që përbëjnë një prioritet dhe një sfidë emergjente.

Ndërkohë, në shumë zona urbane konsumatorët e mëdhenj të ujit të pijshëm janë zonat industriale, të cilat duhet të gjejnë burime alternative uji për proceset teknologjike, të cilat nuk e kanë të nevojshëm përdorimin e ujit të pijshëm. Ju ftoj ta miratojmë këtë marrëveshje, pasi ka një pritshmëri të lartë dhe efekte progresive për rritjen e performancës së sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Nasufi!

Fjalën e ka zoti Nallbati.

Ju lutem, të përgatiten kolegët Pranvera Resulaj dhe Luçiano Boçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegë, ju lutem, ka spostime në listë, por radha është duke u ndjekur dhe nuk është askush më parë. Pra, ka spostime ndërmjet kolegëve, por secili do të flasë në radhën dhe kohën që i vjen për të diskutuar. Ju lutem, ta evitojmë këtë lloj debati, sepse nuk ka vlerë, se e kanë bërë edhe kolegët e majtë, edhe kolegët e djathtë.

Zoti Nallbati, ndjesë, fjala për ju!

Bledjon Nallbati – Faleminderit!

Ja, pra, ku jemi përsëri, si çdo muaj, për të kërkuar borxhin e radhës. Në këta 10 vjet qeverisje janë marrë disa miliarda euro borxh, aq sa jo vetëm qytetarët shqiptarë nuk e dinë sa janë, por ka ardhur një moment që as vetë këta nuk e kalkulojnë dot se sa borxh kanë marrë. Një gjë është e sigurt: për të shlyer borxhet e marra në këto vite do të punojnë edhe katër brezat pas nesh. Sot merren 67 milionë euro për modernizimin e ujësjellës-kanalizimeve. Po për çfarë modernizimi flisni? Në këta 33 vjet pluralizëm keni qeverisur këtë vend dhe Bashkinë e Tiranës, kryeqytetin e vendit, për 20 vjet. Sot, për turpin tuaj që ju nuk e ndjeni aspak, 70 për qind të territorit të Bashkisë së Tiranës e keni të pambuluar me ujë të pijshëm, dhe ju thoni: “Modernizimi...”. A ka gjë më skandaloz se kryeqyteti evropian i të rinjve të mos ketë ujë të pijshëm, kur kjo bashki vetëm buxhetin e saj e ka 250 milionë euro, pa shtuar financimet që merr nga qeveria dhe financimet që merr nga aktorë dhe partnerët e tjerë financiarë?

Pika që nuk ju bie juve dhe modernizimit tuaj! A kanë nevojë shoqëritë e ujësjellës-

kanalizimeve për para? Po, kanë, por më shumë sesa për para, kanë nevojë për administrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, zoti Nallbati, vijojeni fjalën!

Bledjon Nallbati – Po boll ke marrë atje ku ishe. Nuk të mjaftojnë?

Nuk ke se çfarë i do më, mjaft i ke ato që ke marrë. Pra, siç ju thashë, ndërmarrjet nuk kanë nevojë vetëm për para, por kanë nevojë për administrim dhe për përgjegjshmëri. Ju, në vend të kësaj, keni emëruar 60 “lifterë” nëpër bashkitë e Shqipërisë dhe 60 sejmënë të “lifterëve” nëpër ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, të cilët kanë vjedhur si të babëzitur paratë e mbledhura nga faturat e ujit, po ashtu edhe financimet që kanë marrë nga qeveria. Ata e kanë mbushur borderonë me dyfishin e punonjësve që duhet të kenë këto shoqëri sipas normativës, me punonjës që nuk e kanë idenë se çfarë pune kanë dhe se cila është detyra e tyre, por që paraqiten përpara bankomatit ditën që u vjen mesazhi nga banka për të marrë rrogën. Ju bëni sikur nuk i dini, por, në fakt, i dini mirë, sepse vetë i keni instruktuar. Këtë bëni edhe në drejtoritë e qeverisjes qendrore. Këtë e bëni për të blerë dhe për të manipuluar disa shqiptarë në kurriz të një vendi dhe të një shoqërie të tërë. E bëni për të blerë votat e tyre dhe për të blerë pushtetin tuaj.

Pashë në draftmarrëveshje se paratë do t'i përfitojnë shoqëritë që kanë performancë. Ky për mua është një film i parë. Populli ynë ka një shprehje: “Nga e thëna në të bërë, na ndan një det i tërë”, por në fakt, ju ju ndan një oqean i tërë. E them këtë, sepse para disa vitesh, kur kam qenë në bashki, kam menaxhuar një ndërmarrje ujësjellësi, e cila jo vetëm nuk kishte asnjë detyrim ndaj të tretëve, por dilte me fitim dhe bënte investime me paratë e veta. Asokohe qeveria tha se secila prej ndërmarrjeve, që do të performojë, do të marrë investime dhe cila nuk performon, nuk do të marrë. Kur erdhi fundi, ne që kishim performancë, që nuk kishim borxhe dhe që kishim arritur të bënim investime me paratë e po kësaj ndërmarrjeje, jo që nuk morëm asnjë lek investim, por diku, nga viti 2017 apo viti 2018, këta dhanë një bonus për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, dhe unë po i referohem Devollit që ishte me fitim, të cilit i dhanë 30 milionë lekë të vjetër, ndërsa Maliqit, që ishte i zhytur në borxhe, i dhanë 300 milionë lekë, se i duheshin për të

shlyer borxhet. Ky është modernizimi që bëni ju; për këtë jeni specialistë, si kjo zonja këtu mbrapa!

Keni disa kohë që bëtë një reformë të rajonizimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve. Së pari, kjo bie ndesh me parimet e autonomisë vendore dhe me ligjin organik të pushtetit vendor, të cilin ju e votuat, por tashmë e shkelni me këmbë, sepse ky ligj e përcakton qartë si një detyrim, kompetencë dhe përgjegjësi të pushtetit vendor. Urdhëruat “lifterët” tuaj të vinin e të firmosnin dorëzimin dhe shkrijen e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në shoqëri rajonale. Ilir, pse duhej të shkrihej ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve në Devoll, kur dilte me fitim, dhe t'i shkojë Korçës, e cila, meqë ra fjala, sapo e mori, bëri propozimin për të rritur çmimin nga 30 lekë në 50 lekë pa TVSH? E frenuat tani, sepse keni zgjedhje, por pas zgjedhjeve e keni lënë ta miratoni. Çfarë kostosh shtesë kishte ndërmarrja e madhe nga ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve së Devollit, që ka 8900 lidhje?

Kjo zonja, që foli këtu për Bilishtin, nuk ka qenë ndonjëherë në Bilisht dhe nuk e ka idenë, del këtu dhe tregon përralla. Ajo ndërmarrje ka pasur dhe ka 8900 lidhje, nga të cilat 3000 me ngritje mekanike dhe pjesën tjetër e ka me vetërrjedhje. Kjo ndërmarrje është me një pagueshmëri 99 për qind të qytetarëve, del gjithmonë me fitim dhe nuk ka nevojë fare ta agregojë Korça, absolutisht. I vetmi agregim që i bën Korça, është që ia çon çmimin nga 30 lekë në 50 lekë. Ky është agregimi në mënyrë të menjëhershme. Pra, paratë që paguajnë sot qytetarët e Devollit për ujin, shkojnë në Korçë dhe administrohen nga Korça. Sigurisht, do të shkojnë për të mbushur gropat e Maliqit dhe të të tjerave që janë me detyrime dhe me borxhe. Këtë nuk jua kanë borxh qytetarët e Devollit.

Fort të nderuar bashkëqytetarë dhe në veçanti ju, devollinj, unë e kam thirrjen për ju, hiqni dorë nga “lifterët” atje dhe nga “kryelifterët” këtu, se këta nuk kanë mision tjetër përveçse vjedhjes. Këta e kanë mendjen te paratë.

Meqë erdhi zoti Balla, i cili nuk binte dakord me zotin Sula që ndërmarrjet e ujësjellësve kishin punonjës, të cilët nuk dihet ku janë dhe e marrin rrogën kot, po i them zotit Balla se këtë mjeshtër, që futi Taulanti në Bashkinë e Devollit duke shkallmuar derën, ja ku e keni në video, që e pranon me zë e me figurë se paguan nga 2-3 punonjës me rrogë nga bashkia, dhe del e mbron këtu e thotë: “Gjynah, o burrë, të marrë, pse të

mos marrë, të punojnë, pse të mos punojnë...” Ata paguhen me paratë e qytetarëve, jo me paratë e xhepit të tij. Dëgjojeni pak mjeshtrin!

(Vendos video nga telefoni.)

Ky zotëria thotë: “Gjynah! Pse të mos i japim nja dy rroga, se ka dy fëmijë në shkollë?”, por me paratë e devollinjve dhe jo të vetat. Është ky këtu, i kësaj zonjës këtu, që e keni përsëri kandidat.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka për replikë zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Nuk kisha ndër mend t’i përgjigjesha një personazhi krejtësisht të panjohur dhe butaforik këtu...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Nallbati, dëgjojeni deri në fund, ashtu siç u dëgjua edhe ju. Mos ndërhyuni, sepse folët. Zoti Nallbati, mos flisni nga vendi. Ju e mbajtët fjalën tuaj, tani dëgjoni. Dakord?

Elisa Spiropali – E nderuar drejtuese e seancës dhe kolegë,

Nuk kisha për t’u përgjigjur, sepse deputeti do të mbahet mend vetëm për një aksident madhor *Tik-Toku* dhe për paligjshmëri familjare të famshme në të gjithë familjen e tij. Jo vetëm Devolli, por i gjithë qarku i Korçës e di shumë mirë se në çfarë veprimtarie janë të përfshirë familjarisht, por nuk është kjo arsyeja pse e mora fjalën, se nuk kam ndër mend të merrem me të, sepse nuk jam as deputete e qarkut të Korçës dhe as drejtuese politike e Korçës.

Zotëria dhe të gjithë ata pak që e ndjekin, ta kenë të qartë se ka filluar të vishet si gjerman, që të duket si partizan aty në zonën e tij, se nuk ka as guximin të dalë hapur e të thotë se është me *non grata*-ën apo me Foltoren, sepse një herë nxjerr kandidatin këtej, pastaj del duke thënë se nuk e mbështet, sepse jam me ju. Pra, është si shumica e atyre që nuk kanë shtyllë kurrizore. Nuk di të mbajë qëndrime të sakta mbi çfarë përfaqëson në zonë, por së shpejti ai, ata që ka në shtëpi dhe të gjithë të zhyturit në batakun e paligjshmërisë atje, që merren me aktivitete nga më të shumëllojshmet, jo vetëm *Tik-Toku* dhe makinash, por edhe të tjera, do ta marrin përgjigjen më 14 maj nga Devolli, Korça, Tirana, Shkodra dhe ngado tjetër, sepse nuk ka më njerëz që mund ta ndjekin këtë lloj niveli të mungesës së burrnisë, qëndrimit dhe moralit.

Faleminderit shumë! Ishte replikë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Nallbati, mos e humbni qetësinë dhe kujtoni rregullin që ka Rregullorja, që nuk ka replikë mbi replikën. Jo vetëm që iu drejtuaat deputetes, ministres, por përdorët edhe një gjuhë të papranueshme sipas Kodit të Sjelljes. Nuk jua jap fjalën, sepse nuk keni asnjë të drejtë, as edhe për procedurë.

Fjalën e ka zonja Resulaj.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zoti Nallbati, ju tërheq vëmendjen!

Pranvera Resulaj – Të dashur qytetarë,

E nderuar drejtuese e seancës, këtu është me të vërtetë një çudi e madhe, që për një çështje kaq sensitive për të gjithë qytetarët, dëgjojmë: “Pika që nuk ju bie”. Do të merrem pak me këtë fjalinë “Pika që nuk ju bie”, por dua të them që në fillim se kjo shkon përtej një marrëveshjeje të thjeshtë huaje, sepse qëllimi...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Pikërisht se nuk ka ujë, ka kaluar fatura dhe është dashur që qeveria të marrë përsipër detyrimin, sepse ujësjellësi...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju dëgjova shumë mirë. Pika do të të bjerë ty, kur të ketë 24 orë ujë dhe të gjithë qytetarët të marrin shërbimin që u takon...

Ermonela Felaj – Zoti Nallbati, ju tërheq vëmendjen, do të më detyroni të marrë masë ndaj jush. Është e turpshme kjo që bëni, sidomos me koleget zonja. Zotëri, qetësohuni, dilni jashtë nga salla! Mos u ndërhyuni më kolegëve nga vendi.

Pranvera Resulaj – Shko merru votat dhe zgjidhet çështja.

Të dashur qytetarë,

Sigurisht, çështja nuk është thjesht një hua, sepse, po t’i referohemi të gjithë analizës që kanë bërë përfaqësuesit e qeverisë kur prezantuam projektligjin, nuk është se me 67,3 milionë euro do të zgjidhet problemi që kanë ujësjellësit, por këto shkojnë për programin kombëtar dhe për strategjinë kombëtare të vitit 2030. Hendeku financiar midis nevojës për të pasur një rrjet ujësjellës-kanalizimesh eficient, me nevojën për investime infrastrukturore dhe për të përmirësuar eficiencën, sigurisht që shkon më shumë sesa kjo shumë huaje, e cila është llogaritur në 324 milionë euro. Kjo do të thotë se për disa vjet rresht nuk do të sforcohemi për ta realizuar këtë detyrë. Ishte pikërisht arsyeja e amortizimit infrastrukturor të

rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve që solli detyrimin për të krijuar një ndryshim në statusin ligjor të të gjitha ndërmarrjeve të ujësjellësve, duke mos pasur performancën e duhur në njësitë e qeverisjes vendore dhe duke i kaluar tashmë tek Agjencia Kombëtare e Ujësjellës- Kanalizimeve dhe Mbetjeve.

Pse u bë kjo?! Sepse ishte e pamundur që të realizohej kjo lloj performance dhe do të duhej kohë, për të qenë të sinqertë dhe të vërtetë, për ta çuar atje ku duhet.

Qëllimi kryesor i kësaj qeverisjeje dhe i këtij programi kombëtar është pikërisht të sigurojë furnizimin 24 orë me ujë. E veçanta e këtij projekti është se parashikon jo vetëm kryerjen e investimeve në infrastrukturën fizike, por edhe riorganizimin e të gjitha strukturave të ujësjellës-kanalizimeve, duke u dhënë mbështetje financiare nga buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ka marrë përsipër, si pjesë e qeverisë, për të realizuar atë që në vite e ka agravuar situatën, performancën financiare dhe cilësinë e shërbimit të këtyre ndërmarrjeve. Ky program sjell, ashtu sikundër u tha edhe pak më parë, në vëmendje edhe çështjen e energjisë elektrike, duke synuar jo vetëm mirëmenaxhimin, por edhe investimet në parqet fotovoltaike, duke ulur kështu sasinë e energjisë elektrike të përdorur prej ujësjellësve.

Objektivi, ashtu siç shprehet në relacionin e projektligjit, është përmirësimi i performancës financiare dhe operacionale të sektorëve të ujësjellës-kanalizimeve që, për hir të së vërtetës, kanë eficiencë të ulët. Nuk ka nevojë që ju, kolegë të nderuar të opozitës, të na e tregoni këtë gjë, sepse pikërisht ne po e shfaqim dhe po e sjellim si argument për të provuar arsyet pse është dashur një riorganizim i këtyre strukturave, i rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve, pse duhet ky investim financiar dhe pse duhet e gjithë kjo mënyrë e re riorganizimi. Pyetjet na lindin (se ju jeni këtu për të na treguar se si duhet të na bjerë pika) në përpjekje për ta zgjidhur njëherë e mirë dhe në mënyrë definitive këtë problem, i cili shqetëson në radhë të parë qytetarët, prej të cilëve jemi këtu dhe përfaqësues të të cilëve jemi, por duhet të jemi me dinjitet, jo duke fyer dhe duke intimiduar njëri-tjetrin, që është bërë pak si rrugë e tepërt nga ana e opozitës.

Është shumë e çuditshme që, edhe pse për shumë pak do të ballafaqohemi me qytetarët, gjeni

këto rrugë intimiduese dhe fyese, kjo për të keqen tuaj dhe të performancës suaj. Ne i ngremë vetë pikëpyetjet tona. Nuk kemi nevojë që të na i përballni ju në fytyrë. Meraku që na shoqëron dhe na shqetëson, është: sa kohë do të duhet për të arritur targetin 18 orë furnizim me ujë në ditë për të bërë të mundur disbursimin e huas, si parakusht që ka vendosur Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim? Sikundër u tha këtu, përfituesit do të jenë në bazë të performancës së tyre. Kjo do të thotë se edhe nga ana e njërive të këtij rrjeti duhet të ketë një rritje të cilësisë dhe një angazhim shumë herë më të madh për të mundur këtë lloj performance. Ky targeti 18 orë në ditë supozohet të jetë për 35 zona dhe, ashtu sikundër u paraqit në Komisionin e Ekonomisë nga përfaqësuesit e ministrisë dhe të AKUM-it, deri më sot ky target është arritur në 33 zona dhe deri në fund të vitit parashikohet të shkojë në 44. Pra, nuk ka ndonjë risk që të kemi një mungesë disbursimi ose që të dështojë disbursimi i kësaj huaje për shkak të këtij targeti.

Sigurisht, problemi tjetër është se sa efektive do ta jetë kjo hua për përmirësimin e rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve dhe a do të mjaftojë. Unë iu përgjigja kësaj pyetjeje që në krye të herës, sepse e thashë që hendeku financiar është shumë më i madh se sa kjo hua dhe kjo do të tregojë që mbulimi financiar, që do të bëhet nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit dhe donatorëve në vitet në vijim, do të çojë drejt asaj që është zgjidhja definitive për ta çuar sektorin në eficiencë. Mënyra e re ligjore e organizimit nëpërmjet AKUM-it është, për hir të së vërtetës, edhe garancia që kemi se do të kalojë pak kohë, por sigurisht që do të jetë brenda realizimit të këtij objekti të programit kombëtar.

Po shkoj në disa detaje, që të kuptojmë se çfarë do të ofrojë në vetvete i gjithë programi kombëtar. Ky program mbështet krijimin e një hapësire të re financimi brenda AKUM-it për investime në ujësjellës-kanalizime për të rritur dhe për të përmirësuar aksesin në shërbimet e furnizimit me ujë në zonat që aktualisht nuk marrin shërbim, duke përfshirë këtu edhe zonat rurale. Pritet që programi të mund të sigurojë një financim për rreth 10 mijë deri në 12 mijë lidhje të reja familjare, duke bërë që të përfitojnë deri në 50 mijë njerëz, që do të thotë një ulje e hendekut aktual të mbulimit me shërbime ujësjellësi me rreth 3 %.

Sikundër e thashë pak më parë, parashikohet të ketë një përmirësim të situatës në zonat rurale. Sigurisht, në fund, të gjithë ne do të përballemi me qytetarët, dhe në fakt përballemi. Edhe pse e thashë në fillim që objektivi është përmirësimi i performancës operacionale dhe financiare, edhe vetes ia bëj pyetjen që, kur të shkoj në zonë dhe të ballafaqohem me qytetarët e mi, si do t'ua shpjegoj se sa rëndësi ka për ata ose si do të mund ta kuptojnë? Ne përballemi me vështirësitë që kanë qytetarët. Nuk është e thjeshtë që qytetarët të kenë mungesë të furnizimit me ujë, jo për shkak të mungesës së ujit, po për shkak të rrjetit të amortizuar infrastrukturor dhe për shkak të nevojës për investime.

Mjafton të kujtoj që vetëm për Bashkinë e Vlorës kemi investime në vlerën 5 miliardë lekë në periudhën 2014-2018, më tej investime në vlerën 5,4 miliardë lekë në periudhën 2019-2022 dhe investimet e pritshme për dy vjetët në vijim 2023-2025 në vlerën e 2,7 miliardë lekëve. Me këtë dua t'ua jap garanci të gjithë bashkëqytetarëve të mi, sidomos të zonave rurale dhe të Komunës Qendër, që unë përfaqësoj (të gjithë banorët e asaj zone problemin më të madh që kanë, sa herë kemi takime, është mungesa e furnizimit me ujë, faturimi kur nuk ka ujë e të gjitha këto probleme me radhë), se pikërisht në sajë të këtij programi kombëtar, jo vetëm të kësaj huaje të thjeshtë, por të gjitha...

(Bie gongu.)

Kjo është garancia që në një periudhë shumë të afërt, të gjithë ju, të nderuar qytetarë, të dashur qytetarë, do të merrni atë që sot është një mungesë jetike: furnizimin 24 orë me ujë. Pikërisht për këtë arsye, por mbi të gjitha për angazhimin e madh që qeveria shqiptare ka ndaj qytetarëve të vet, ju ftoj ta votojmë projektligjin, të nderuar kolegë, dhe ta ratifikojmë marrëveshjen.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Boçi!

Të përgatiten zonja Koliqi dhe zonja Bushka!

Luçiano Boçi – E nderuara drejtuese e seancës!

Të nderuar deputetë!

Të dashur qytetarë!

Kjo është fjala ime e fundit në këtë parlament, por sigurisht që ju premtoj se nuk do të jetë fjala e fundit në politikë, sepse ajo vazhdon.

Në këtë sallë, për shumë vite rresht, më ka sjellë mbështetja dhe vota e demokratëve, por edhe e qytetarëve pa parti të Elbasanit, të cilëve u jam mirënjohës e falënderues në jetë të jetëve.

Gjatë këtyre viteve jam përpjekur me sa kam mundur, me gjithë angazhimin tim, që të jem zëri i tyre. Jam përpjekur të jem mbështetja e tyre. Jam përpjekur të jem zgjidhësi i problemeve të tyre. Jam përpjekur të jem miku i tyre, pavarësisht krahut politik. Sigurisht, jam përpjekur që të jem vetvetja në këtë situatë, por jo gjithmonë ia kam arritur, dhe kjo është krejt njerëzore.

Ama, ka qenë nder për mua të përfaqësoj qytetin tim, shtëpinë time të përjetshme, familjen time të madhe, njerëzit e mi të Elbasanit në këtë foltore. Ka qenë besimi i tyre ai që e ka bërë me vlerë fjalën time. Ka qenë guximi i tyre ai që i ka dhënë frymë mendjes sime, që të flas e të them të vërtetat.

Po e dorëzoj sot këtë mandat, por vetëm me një kusht: që të jem dhe të shkoj akoma më pranë njerëzve të mi, pranë qytetarëve të Elbasanit. Politikën e kam parë dhe e kam gjykuar si një mjet dhe si një mekanizëm për të zgjidhur hallet dhe problemet ekonomike, problemet e arsimit, të shëndetësisë, për të zhvilluar artin dhe kulturën, për t'ua dhënë qytetarëve shërbimin e kërkuar, e jo si një mekanizëm shkrepës-goditës për të vlarë dhe eliminuar kundërshtarin politik, aq më keq si një mekanizëm që vret besimin dhe shpresën e qytetarëve për një jetë më të mirë.

Parlamentin e kam parë dhe konsideruar si vendin e betejës më të bukur, që Zoti na ka falur, si vendin e betejës së fjalës: të fjalës me mendim, të fjalës së mençur, të fjalës që respekton, të fjalës që godet, që polemizon, që thumbon, që madje bën edhe humor, por jo të fjalës sharëse, të fjalës shpifëse, fyese e tallëse ndaj qytetarëve, të fjalës banale ndaj njëri-tjetrit. Por të them të drejtën, jo gjithmonë e kam marrë shijen e duhur të fjalës. Këtu jam ballafaquar me kundërshtarë luftarakë dhe dinjitozë, e me kolegë të mi me oratori brilante, sikundër ndonjëherë kam provuar edhe në lëkurën time shpifje, fyerje dhe urrejtje frikacake, të cilat i kam falur me shpresën dhe besimin se e vërteta është gjithmonë më e fortë se gjithçka, dhe se falja është hyjnore.

Megjithatë, ky vend më ka pëlqyer për dinamikën dhe nervin që mbart brenda tij. Këtu, në këtë sallë, kam parë të ulur bashkë të vërtetën e gënjeshtërën, të mirën e të keqen, cinizmin e

dashamirësinë, të bukurën e politikës, por edhe të shëmtuarën e saj. Megjithatë, mos mendoni se po largohem për këtë arsye. Unë nuk jam nga ata që dorëzohen. Personalisht, më pëlqejnë betejat dhe sfidat, garat dhe protestat për të drejtën e të duhurën, sikurse më pëlqen të jem me njerëzit e vërtetë të këtij vendi, larg pompoziteteve, intervistave dhe protokolleve, të nxis një investim, të ndihmoj ndokënd dhe nëpërmjet politikës të bëj punë të mira.

Jam i bindur se edhe ju këtë dëshironi, pavarësisht detyrimeve dhe joshjeve politike. Por, ndryshe nga ju, mua më është dhënë një privilegj që dikush mund ta quajë edhe sakrificë, por që unë nuk e shoh aspak të tillë: privilegji për të qenë kandidat në bashkinë time të Elbasanit. Këtë privilegj e konsideroj si mundësinë e artë për t'i kthyer atij qyteti gjithë detyrimin e borxhit tim, për t'i kthyer atij gjithë shkëlqimin, meritën dhe lavdinë e dikurshme, jetën e mirë, mjedisin që meriton dhe zhvillimin e duhur. Fati i një qyteti mund të ngjajë i vogël, por është madhërisht i rëndë, si një gurë prehistorik në ndërëgjegjen e qytetarëve të tij. Nëse ka një pasqyrë ku dua të dukem mirë, të ngjaj mirë, kjo është vetëdija e qytetarëve të Elbasanit. Shkolla ime është atje, shtëpia ime është atje, familja ime është atje, tempujt e mi janë atje, të gjithë të lartë e të ndritshëm si ullinj të mbi kodrat e Zaranikës e të Shkumbinit.

Sot nuk dua të flas për mizorinë me të cilën e keni trajtuar nëpër dekada atë bashki, dhe se si gromësin nga të mirat që keni përfutur përgjatë këtyre viteve, ulur në kolltukët e parlamentit. Keni gjuhëzuar ata që popullojnë një prej vendeve më të begata të tokës, duke i prangosur me uri. I keni bindur se kjo është çfarë ata meritojnë. I keni bindur që janë të varfër dhe se të tillë do të vdesin. Ky padyshim që është krim. U keni helmuar tokën njerëzve më të butë të planetit dhe i keni poshtëruar me një gjysmë thesi miell, që të mbajnë gojën mbyllur. Ju doni që ata të ikin ose të vdesin në heshtje. U bënë 16 vjet që i mbani peng. U keni shkatërruar lumenjtë, dhe prapë sot po ua helmoni me plehurat që digjen buzë Shkumbinit. U keni vjedhur 27 milionë euro, me një gënjeshtër që edhe pse nuk djeg dot plehra, të jeni të bindur se ju do t'ju djegë me siguri.

Në Elbasan ka fëmijë që bëjnë çdo ditë dy orë rrugë për të ndjekur një shkollë, të mbetur pa mësues. Ka gra që u mungon një qendër

shëndetësore. Ka pleq të lënë në harresë, me fëmijët në mërgim, që nuk dëgjojnë as një mirëmëngjesi. Keni shkatërruar çdo infrastrukturë dhe keni braktisur lagje e fshatra në harresë mesjetare, pa rrugë, pa kanalizime, pa asnjë shërbim, veç presionit për t'u vjedhur votën. E keni bërë këtë në një vend, ku gjenialiteti njerëzor ka krijuar 38 lloj kostumesh të mrekullueshme për gratë dhe burrat, ka dizenuar dhe përdorur mbi 18 instrumente muzikore, tërësisht gjuene dhe të personalizuar. E keni bërë këtë pikërisht në shtëpinë e Lef Nosit, në shtëpinë e Xhuvanit, në shtëpinë e Kostandin Kristoforidhit, e cila, me që ra fjala, po rëzohet.

Megjithatë, unë po iki për t'u rikthyer atje, ku çdo gjë e vogël bën një diferencë të madhe, sepse kjo u vlen njerëzve të mi, sepse bashkë me ta, ne do ta bëjmë ndryshimin. Do ta rikthejmë Elbasanin aty ku e meriton: në zemër të Shqipërisë, në një pol të rëndësishëm ekonomik në trekëndëshin Tiranë-Elbasan-Durrës, ku sot prodhohet më shumë se 68 % e GDP-së. Do ta bëjmë Elbasanin një vend të dashur e të kërkuar, një vend ku mund të jetosh, pa menduar se si të ikësh, një vend ku përmasa njerëzore ruhet dhe trashëgohet bukur. Do ta bëjmë një adresë të dashur për turistët vendas dhe të huaj, një shtëpi që mikpret në kalá, në Gjinar, në Funar, në Byshek, në Labinot-Fushë, në Labinot-Mal, në Tregan, ku destinacionet e turizmit kulturor, natyror, tregtar, shëndetësor, kulinar, janë pa kufi. Kemi gjithçka, e sot kemi dhe vullnetin për ndryshim.

(Bie gongu.)

Do ta bëjmë Elbasanin. Do ta bëjmë një shembull për t'u ndjekur dhe një model të ekselencës shqiptare në teknologji, kërkim, zhvillim dhe në sipërmarrjen e ekonomisë së re. Do ta bëjmë qytetin e internetit të shpejtë dhe të laboratorëve të talentit. Do t'i tregojmë qeverisë se si qeveriset në një vend njerëzish të mirë.

(Bie gongu.)

Por këtë sfidë njerëzore e quaj edhe si një mundësi reflektimi për pushtetin e sotëm, që t'u japim qytetarëve të drejtën e plotë të shprehjes së vullnetit të tyre.

Prandaj, kam një kërkesë të fundit në këtë sallë, por jo të fundit në kuptimin politik: boll ua vratë votën dhe të ardhmen, duke ua blerë atë! Boll u kërcënuat jetën, duke i larguar nga puna për bindje politike! Boll u ndaluar fjalën dhe

mendimin e lirë! Boll i mashtruat me propagandë dhe premtime boshe, pa u dhënë një herë të vetme llogari gjatë këtyre viteve! Boll i detyruat t'ju pëlqejnë me zor nëpër rrjetet sociale! Bashkia nuk është as imja, as e kundërshtarëve. Ajo është e qytetarëve, dhe janë ata që do ta bëjnë ndryshimin.

Zoti i bekoftë shqiptarët! Zoti e bekoftë Elbasanin!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Boçi!

Për më të mirën e qytetarëve tanë, uroj që paraqitja e të gjithë kandidatëve në zgjedhje të jetë sa më dinjitoze. Mbase kjo do të ishte mënyra e vetme për t'u dhënë përmbajtjen e duhur zgjedhjeve.

Kalojmë te diskutanti tjetër. Fjalën e ka zonja Koliqi!

Të përgatiten zonja Bushka dhe zoti Leskaj!

Emilja Koliqi – Të nderuar kolegë!

Të nderuar qytetarë!

Pas reformës territoriale dhe zgjedhjeve lokale të vitit 2015, në vitin 2016 filloi edhe reforma në sektorin e ujit, e cila parashikonte riorganizimin e shoqërive të Ujësjellës - Kanalizimeve sipas parimit një shoqëri - një bashki. Pas gjashtë vjetësh, në fund të vitit 2021, rezultoi se kishin përfunduar riorganizimin dhe ishin licencuar nga Enti Rregullator i Ujit vetëm 42 nga 58 shoqëri Ujësjellës – Kanalizime, që operonin në sektor. Pa përfunduar reforma e 2016-ës, qeveria ndërmerri një reformë tjetër në këtë sektor. Pra, qeveria dështoi në reformën e ujit, të vitit 2016, dështoi në përmirësimin e furnizimit me ujë deri në 24 orë në ditë dhe në përmirësimin e performancës financiare të Ujësjellës – Kanalizimeve.

Në datën 11 maj 2022 qeveria miratoi vendimin “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, duke i përqendruar në 15 shoqëri UK, nga 58, që operonin deri në atë moment. Ky riorganizim ose kjo reformë pa asnjë bazë ligjore, ose me një bazë ligjore në cenim të pastër të autonomisë vendore, tregoi edhe një herë ndërhyrjen dhe centralizimin e funksioneve e të kompetencave të pushtetit vendor.

Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” është shtylla kryesore për zbatimin e reformave të decentralizimit të qeverisjes vendore, ku përcaktohet qartë funksioni i bashkive në fushën

e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ku ato janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Në mbledhjen e tetorit të vitit 2021, Kryeministri paralajmëroi këtë reformë, dhe ku i bëri për ujë të ftohte kryebashkiakët dhe drejtuesit e Ujësjellës - Kanalizimeve të të gjitha bashkive, si të zhytur në borxhe, por më 1 janar të vitit 2022 ai i zhyti edhe më thellë në borxhe, duke faturuar energjinë elektrike me tarifa të liberalizuara sipas tregut.

Gjatë vitit 2021 borxhi i ndërmarrjeve të ujësjellësve ndaj OSHEE-së, deri në fund të qershorit 2022, arriti në 22, 7 miliardë lekë ose 187 milionë euro. Rritja e çmimit të energjisë elektrike me 65% për sektorin e UK, nga 11, 5 lekë për kilovat-orë, në 18,8 lekë për kilovat-orë. Trefishimi i çmimit në rrjetin 35 kv për impiantet e trajtimit të ujërave të zeza çoi në një rritje të kostove të energjisë elektrike në rang sektori me rreth 38%. Si rrjedhojë, ka ndryshuar edhe raporti i kostove të shoqërive të Ujësjellës - Kanalizimeve.

Mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes për vitin 2022 ka rënë ndjeshëm, në 90,5%, nga 103,4% që ishte në vitin 2021, kjo për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe rritjes së çmimeve në përgjithësi. Gjatë vitit 2022, 26 shoqëri performojnë dobët, në nivelin 70% të këtij treguesi, kjo sipas raportit të Entit Rregullator të Ujit, të vitit 2022.

Cila është strategjia që do të implementojë Ministria e Energjetikës pas reformës? Si do të përmirësohet performanca e shoqërive? Si do të shlyhen faturat e larta të energjisë elektrike?

Procesi i agregimit të Shoqërive Ujësjellës - Kanalizime bazohej gjoja në principin: “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”.

Po si u soll qeveria me ndërmarrjet e ujësjellësve që nuk e zbatuan këtë VKM urdhëruese? Kush nuk bindet, ndëshkohet! Ky është mesazhi i Kryeministrit.

Subvencionin e vitit 2022 ishte vetëm për shoqëritë rajonale ose për ato që kishin lidhur kontratë. Të tjerat nuk përfituan asnjë lek, pavarësisht detyrimeve që kishin. Subvencionin e akorduar nga qeveria për vitin 2022 ishte në vlerën e 360 milion lekëve, 20 milionë më pak se

në vitin 2021. Rreth 40 % kanë shkuar për pagesën e sigurimeve shoqërore të punonjësve që penalizohen në bllok, duke rrezikuar daljen në pension për shkak të punësimeve gjatë fushatave zgjedhore.

Shtimi i patronazhistëve në ujësjellës shkakton edhe rritjen e borxheve. Në vend që të investojnë për të siguruar shërbimet publike bazë, si furnizimin me ujë apo kanalizimet, paratë shpenzohen duke shtuar të punësuarit për politikën famëkeqe të votave në këmbim të vendeve të punës.

A do të vazhdojë përsëri ndëshkimi edhe për investimet që parashikohen në këtë marrëveshje, ashtu siç ndëshkohet Shkodra, pavarësisht vlerësimeve të performancës së Ujësijellës – Kanalizimeve Shkodër? Buxheti i shtetit nuk akordon asnjë fond investimi për 5 projekte të miratuara edhe në Këshillin Teknik të AKUM-it. Një nga këto projekte lidhet drejtpërdrejt me uljen e humbjeve: projekti i linjës së re 3 km nga stacioni i ri Dobraq deri te puseta në Rus, një linjë e dëmtuar prej lidhjeve të paligjshme nga banorët e njësisë administrative Rrethina, që vuajnë nga mungesa e ujit të pijshëm, e që lidhet me investimin tjetër, projekti i furnizimit me ujë të pijshëm i fshatrave Bardhaj, Bleran dhe Kooperativë, përsëri të njësisë administrative Rrethina. Pa përmendur këtu edhe tre projekte të tjera: ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Trush; ndërtimi i linjës së re të transmetimit të ujit të pijshëm nga Stacioni i Pompimit Trush deri në depon Qafë -Shtiqen; projekti i rehabilitimit të godinës dhe të stacionit të vjetër Dobraq. Asnjë lek e asnjë financim për të gjitha këto projekte.

Nga fillimi i vitit, për 3 muaj, Shqipëria po merr miliona euro borxh në kuadër të sektorit të Ujësijellës-Kanalizimeve. Para një muaji, në parlament kaloi marrëveshja e huas për Ujësijellës - Kanalizimet Durrës, me vlerë prej 60 milionë eurosh, me Agjencinë Franceze për Zhvillim, me objektivin: furnizim me ujë 24 orë në ditë. Sot një tjetër hua me 67, 3 milionë euro, me objektivin: furnizim me ujë 18 orë në ditë.

Deri tani janë investuar mbi 900 milionë euro në këtë sektor, por impakti nuk është i pritshmi. Investimet me financim të huaj që kanë filluar qysh në 2014-ën e 2016-ën dhe vazhdojnë për periudhën 2023-2025, janë në vlerën 500 milionë euro.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Ujësijellës Kanalizimeve 2020-2030, për të realizuar qëllimin e politikës, objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimin për të gjithë të ujit të pastër dhe kanalizimeve, parashikohet një kosto prej 1, 5 miliardë eurosh, ku kostot kapitale zënë 92 % të totalit.

Shqipëria ka burime të mjaftueshme ujore, të barabarta me 8700 metra kub për frymë në vit, që është një nga më të lartat në Evropë, por problemi ynë kryesor, me gjithë miliardat e lekëve të shpenzuara, mbetet furnizimi i popullsisë me ujë të pastër dhe të mjaftueshëm, duke mos plotësuar kështu një nga të drejtat tona kushtetuese. Megjithëse rezervat totale të shfrytëzueshme të ujit janë shumë të mëdha, përsëri shkalla e shfrytëzimit është ende e vogël. Në ujë e kemi me orar nëpër çezmat tona. Tirana, për të cilën janë harxhuar miliarda, është e mbushur me depozita nëpër pallate. Pasiguria dhe ndotja e ujit i detyron qytetarët të blejnë ujë të ambalazhuar, duke rritur koston e jetesës.

Po cila është strategjia për mbulimin e gjithë kostove të parashikuara? Strategjia parashikon që deri në vitin 2030 tarifat e ujit të rriten me 75 % ose edhe më shumë, pasi ka rezerva. Gjithçka do të rëndojë mbi konsumatorin shqiptar, me taksat kombëtare dhe vendore, me pagesat e borxhit të qeverisë dhe duke rritur çmimin e ujit e të shërbimeve të kanalizimeve të ujërave të zeza. Qeverisë nuk i intereson furnizimi cilësor dhe i vazhdueshëm me ujë të pijshëm. Synimi mbetet rritja e çmimit për konsumatorët shqiptarë, duke i faturuar me çmim të lartë për një shërbim që nuk u ofrohet brenda standardeve.

(Bie gongu.)

Bazuar gjoja në principin e bazave vullnetare, të gjitha shoqëritë e reja do të bëjnë me VKM rishikimin e tarifave ekzistuese. Marrja nën kontroll e të gjitha shoqërive si aksioner me 51 %, tregon se qeveria nuk po u beson më as kryebashkiakëve të vet. Para zgjedhjeve lokale nuk po i mjaftojnë PPP-të, investimet strategjike, por tashmë i duhen edhe tenderët e ujësijellësve, si burim vjedhjeje e grabitjeje, si dhe punësimi i patronazhistëve para fushatave zgjedhore.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Koliqi!

Zonja Bushka, fjala për ju!

U lutem zotit Leskaj dhe zotit Xhelili, që të përgatiten.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja kryesuese e seancës!

E nderuar kolege parafolëse,

Meqë përmende Tiranën, sot Tirana ka 65 % furnizim me ujë në 24 orë. Në 2015-n unë kam qenë anëtare e këshillit bashkiak Tiranë, e kemi gjetur me 7 orë ujë furnizim. Sot kemi arritur mesatarisht në 17 orë. Nëse fillon në verë investimi, sipas një marrëveshjeje me Bankën Europiane të Investimeve, për unazat e presionit, brenda katër vjetëve Tirana ka 24 orë ujë në 24. Nga 2015-a deri më sot nuk ka qenë një proces i lehtë, por një proces të cilit i është dashur një strategji, një vizion dhe shumë punë. Kjo do të thotë që, së pari, do të duhej të priteshin lidhjet e paligjshme, do të duhej të rriteshin arkëtimet, të uleshin humbjet në rrjet, e më pas të mirëmenaxhohej shoqëria, që ato parà të investoheshin për të rritur eficiencën e menaxhimit të ndërmarrjes.

Pra, është një histori pune, një histori përgjegjshmërie e një ndërmarrjeje të bashkisë së Tiranës, e cila sot konkretisht ka këtë rezultat: nga 7 orë furnizim me ujë në ditë, që ishte në 2015-n, sot janë mesatarisht 17 orë në ditë. Kjo me synimin për të vajtur 24 orë pas katër vjetësh. Ndërkohë, 65 % e territorit të Tiranës është e mbuluar me 24 orë furnizim me ujë. Edhe njësia ku unë shërbej si deputete, njësia 3, ka një zonë që quhet Kodra e Priftit, një pjesë e të cilës ka 24 orë furnizim me ujë, Lapraka ka gjithashtu 24 orë furnizim me ujë, si dhe zona të tjera. Megjithatë, nuk është një proces apo një punë që bëhet me shkopin magjik, por kërkon punë, kërkon vizion, kërkon mirëmenaxhim, nuk kërkon paragjykim, nuk kërkon të mos jemi objektivë.

Patjetër ka probleme, ka sfida, se po të mos kishte sfida nuk do të ishim sot këtu, por qasja ka shumë rëndësi. Uji nuk duhet parë më si shërbim që duhet ta kemi patjetër dhe të mos kemi idenë se si realizohet ky shërbim. Është një shërbim që kushton, një shërbim që kërkon të merren masa të caktuara, një shërbim që kërkon monitorim, por mbi të gjitha kërkon vizion, një vizion të cilin në fakt, në projektligjin që kemi tani në diskutim e miratim, e shoh të realizuar. Është ai vizion, i cili ndërron qasjen se si do t'u ofrohet qytetarëve shërbimi i furnizimit me ujë.

Në fakt, marrëveshja e financimit, që përkon me një program kombëtar për gjithë sektorin e ujit, është sfida jo vetëm për Shqipërinë, po tashmë edhe për të gjithë rajonin e për të gjithë botën. Është një marrëveshje, e cila synon modernizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në Shqipëri, për të mbështetur në nivel kombëtar infrastrukturën ujore, duke pasur si objektiv përmirësimin e performancës operative e financiare të furnizimit me ujë e kanalizimeve të ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve, si dhe rritjen e aksesit për një menaxhim të sigurt të furnizimit me ujë në të gjithë Shqipërinë.

Kjo është qasja. Ne vërtetë marrim një financim nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, por një pjesë të madhe të fondit, të barabartë me këtë, e vë qeveria shqiptare, ashtu sikundër edhe qeveria zvicerane jep një grant prej 6, 3 milionë dollarësh. Ky është një projekt makro, që ka një vizion shumë të largët, i cili e ka qasjen të financimi i ndërmarrjeve që merren me furnizimin me ujë dhe kanalizime, duke u prirur dhe duke parë performancën e tyre dhe rezultatet në punë. Po, ka ndërmarrje të Ujësllës-Kanalizimeve, siç është ajo e bashkisë së Tiranës, por edhe ajo e Bilishtit, që përmendi qëparë kolegu Nallbati, që mund të kenë pasur performancë pozitive. Sigurisht, në kuadër të decentralizimit pati një reformë shumë të mirë, e cila vendosi të kishte një ujësllës për çdo bashki. Jo të gjitha bashkitë patën performancën e duhur. Sot, nëpërmjet një projekti të tillë strategjik, krijohet mundësia që të grupohen për të rritur eficiencën, për të bërë investime të përbashkëta, për të ulur humbjet në rrjet, për të rritur arkëtimet, për të bërë më shumë investime, për të siguruar atë që të gjithë kërkojnë: 24 orë ujë në 24 në çdo familje.

Nuk është një hap prapa, siç thotë ju, kolege e nderuar, por është një reflektim mbi baza studimore dhe mbi atë që konsiderohet në përputhje me parimin e decentralizimit. Ky lloj bashkimi është me vullnet. Ndërmarrjet nuk detyrohen të grupohen me njëra-tjetrën. Ndërmarrjet e kanë këtë të drejtë, po në kuadër të autonomisë vendore, me vullnet për t'u bashkuar ose jo. Pra, nuk janë të detyruara. Sepse e kam dëgjuar nga disa kolegë, që thonë se sot po detyrohen të bashkohen ndërmarrjet. Jo. Ndërmarrjet kanë mundësi të bashkëpunojnë me

njëra-tjetrën, nëse duan të rrisin rentabilitetin e vet. Gjithashtu, këtë e kanë si indikator. Sepse, po kjo marrëveshje granti do t'u japë mundësi të marrin financime, grante, për të cilat nuk do të kenë detyrimin të paguajnë ndonjë interes, pasi ato i merr përsipër qeveria, por me një kusht: kërkon rezultat, të jenë të orientuar drejt performancës pozitive. Nëse do të kenë performancë pozitive, do të marrin grant për të vijuar punën. Nëse nuk do ta kenë këtë performancë, atëherë do ta marrin grantin kur performanca të arrijë nivelin që kërkohet.

Këto janë modele, të cilat banka prestigjioze, siç është edhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, e ka aplikuar, në rastin konkret në këtë ligj. Vetë fakti se kjo bankë hyn dhe ndihmon këtë sektor duke besuar qeverinë shqiptare në këtë program kombëtar, tregon se qeveria shqiptare, autoritetet shqiptare kanë kapacitetet e duhura dhe besueshmërinë e bankave prestigjioze për t'u mbështetur në këtë drejtim. Kjo besueshmëri nuk vjen vetvetiu, por vjen sepse analizohen ca biznes-plane, analizohen ca rezultate, shihen ca modele suksesi, vihen ca piketa dhe objektiva se ku duhet të arrihet. Ky është rasti konkret.

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim nuk do t'ia jepte këtë mbështetje qeverisë shqiptare, nëse nuk do të ishin treguesit pozitivë në lidhje me realizimin e këtij programi kombëtar. Tre janë elementet kryesorë të kësaj marrëveshjeje, të cilët gjejnë mbështetjen e financimit: janë grantet për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ndërmarrjet e Ujësjetllës-Kanalizimeve, për të mbuluar mungesat e të ardhurave, në përgjigje të situatave emergjente nga Covid-19, grantet e Covid-it, grantet e bazuara në performancë, për mbulimin e shpenzimeve operative për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ndërmarrjet e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

Pika e dytë ka të bëjë me grante po për këto ndërmarrje, në lidhje me rritjen e eficiencës dhe përmirësimin e performancës, duke përfshirë infrastrukturën e furnizimit me ujë për vazhdimësinë e shërbimit, ngritjen e zonave me matës të qarkut, reduktimin e ujit pa të ardhura, matjen e vëllimeve të ujit, përmirësimet e tjera në zonat urbane e rurale, eficienta e energjisë së investimeve, e shpjegoi edhe zëvendëskryeministria rëndësinë e futjes së

inovacionit, ku vetë ndërmarrjet do të kenë edhe projekte për eficiencën e energjisë; grante për të stimuluar procesin e ristrukturimit të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe ndërmarrjeve të Ujësjetllës-Kanalizimeve; grante për të mbështetur investime në linjat e reja të furnizimit me ujë në zonat periferike, rurale, përfshirë dhe familjet në nevojë. Kjo sepse çdo shtet ka edhe një detyrim, që quhet "furnizimi universal". Jo të gjithë kanë mundësi ta paguajnë ujin. Një pjese të shoqërisë, e cila është në pamundësi, do të duhet që bashkitë, ato që kanë edhe kompetencën e furnizimit nëpërmjet ndërmarrjeve të veta, t'ua sigurojnë furnizimin me ujë me tarifa të reduktuara ose falas. Që të arrihet këtu, do të duhet të ketë një plan të mirëmenaxhimit, një plan të investimeve, një plan të eficiencës, mbi të gjitha përgjegjshmëri. Do edhe pak mirëkuptim. Do pak mirëkuptim që, kur flasim këtu, t'u referohemi ca shifrave dhe ca fakteve, jo perceptimeve, jo ta kthejmë në debat politik.

Sfida e furnizimit me ujë është sfidë për të gjithë ne, për qytetarët tanë. Nuk është gjë e lehtë. Ka vende që sot po vuajnë thatësisrën, ka vende që po planifikojnë inovacione, pasi në të ardhmen mund të përballen me thatësisrën. Ndërkohë, ne kemi mundësi që burimet tona hidrike t'i menaxhojmë dhe të planifikojmë përdorimin e tyre në një mënyrë optimale, sipas standardeve më të mira, që të kemi furnizim të vazhdueshëm me ujë, të kemi, gjithashtu, edhe një sistem kanalizimesh siç duhet.

(Bie gongu.)

Ajo që e bën këtë gjë të suksesshme, është të shkojmë tek standardet. Standardet i kanë realizuar vendet e tjera, të cilat, gjithashtu, janë partnere me bankën që është duke na financuar dhe mbështetur në këtë program kombëtar. Ne po ndjekim ato standarde. Duke ndjekur ato standarde, edhe monitorimi do të na bëhet në lidhje me ato standarde, edhe lëvrimi i parave do të na bëhet sipas arritjes së performancës në lidhje me ato standarde. Kësisoj, janë të gjitha garancitë që ky projekt të jetë i suksesshëm.

(Bie gongu.)

Unë do t'ju ftoja të gjithëve ta votoni këtë projektligj, pasi u shërben të gjithë qytetarëve. Nuk është projektligj për një grup të caktuar, por një projektligj që i shërben gjithë popullatës në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bushka!

Zoti Leskaj, fjala është për ju!

Përgatiten zoti Xhelili, zoti Dule, zonja Spahiu!

Bujar Leskaj – E nderuara zonja drejtuese e seancës!

I nderuar kolegu Braçe dhe të nderuar kolegë deputetë!

Në fakt, te relacioni i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese më tërhoqi vëmendjen pika 14/1. Me të drejtë deputetët kanë kërkuar sqarime në lidhje me kreditë e ndryshme që janë dhënë në këtë sektor.

Ja çfarë shkruhet në relacion:

“Lidhur me fondet që janë investuar nga buxheti i shtetit dhe fondet që janë përfituar në formë kredie nga donatorët nga viti 2013 e në vazhdim për këtë sektor, sot nuk e kemi këtë të dhënë”, deklarojnë përfaqësuesit e ministrisë dhe të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve, “pasi nuk ishim të përgatitur për këtë kërkesë, por do t’ua vëmë në dispozicion tabelën gjatë ditëve në vijim.”

Unë nuk dëgjova asnjë koleg të maxhorancës, as të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, as ministren e fushës, që të flasë për këto kredi e për këto fonde të vendosura në dispozicion nga buxheti i shtetit. Unë jam i qartë se këta nuk flasin dot, po pikërisht këtu te menaxhimi i keq i këtyre fondeve të buxhetit të shtetit dhe i kredive, është shkaku i kësaj gangrene të madhe në gjithë sistemin e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

Unë për veten time, në kushte të tjera, do ta kisha përshëndetur dhe mbështetur projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve në Shqipëri”, pasi kreditë e zhvillimit me terma të butë janë një shans për vendin tonë, për reformimin dhe modernizimin e shërbimeve të tilla publike, si Ujësjetllës-Kanalizimet. Për fat të keq, gjykoj se programi kombëtar i modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri, financiar nga Banka Botërore në kredi të butë, në nivel 67, 3 milionë euro, që po diskutojmë sot, është i destinuar të dështojë, dhe unë uroj ta kem shumë gabim, për shkak të gjendjes së

mjerueshme financiare dhe keqadministrimit të ndërmarrjeve të Ujësjetllës-Kanalizimeve në vendin tonë. Si pasojë e klientelizmit, keqpërdorimit politik të ndërmarrjeve të Ujësjetllës-Kanalizimeve, gjë për të cilën të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm, dhe mbushjes së stafit të tyre me militantë të partisë në pushtet apo me ata që i mashtronin për vota, për një periudhë të shkurtër kohore, sidomos gjatë periudhës zgjedhore, si dhe paaftësisë së drejtuesve të këtyre ndërmarrjeve, të emëruar nga qeveria përmes këshillave mbikëqyrës, ky sektor i shërbimeve jetike për popullatën ka tregues financiarë tej mase të përkeqësuar dhe ndodhet në prag të falimentimit. Do të bëja një korigjim: jo të emëruar nga qeveria, por të emëruar nga partia. Madje, akoma më keq, jo të emëruar nga partia, por nga spektri që qeveris.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë raportoi se stoku i borxhit të ndërsjellë ndërmjet ndërmarrjeve dhe enteve publike në sektorin e energjisë e ujësjetllësve, në fund të qershorit të vitit 2022, arriti në rreth 1, 3 miliardë euro. Ky borxh kaq i madh, që shkon duke u rritur gjithnjë e më shumë, është krijuar nga pamundësia paguese e ndërmarrjeve publike, ndër to edhe e ndërmarrjeve të Ujësjetllës-Kanalizimeve sh. a., që s’kanë mundësi t’ia shlyejnë faturat e energjisë elektrike OSHEE-së.

Trendi i borxheve të ndërmarrjeve të Ujësjetllës-Kanalizimeve ndaj OSHEE-së është rritur ndjeshëm. Nga rreth 18 miliardë, që ishte në vitin 2020, ka shkuar në 22 miliardë lekë në fund të qershorit të vitit 2022. Sipas bilanceve kontabël të vitit 2021, janë 55 ndërmarrje publike të sektorit të Ujësjetllës-Kanalizimeve që rezultojnë me humbje, ndërkohë që vetëm tri ndërmarrje rezultojnë me fitim. Kolegët e mi të opozitës dhanë shembuj shumë domethënës. Përveç detyrimeve të energjisë elektrike, sektori i Ujësjetllës-Kanalizimeve mbart edhe detyrime të tjera të mëdha, të prapambetura, të cilat janë krijuar si pasojë e moslikuidimit të kontratave të lidhura për ndërtimin e infrastrukturës së Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe mbetjeve, si nga AKUM-i, ashtu edhe nga pushteti vendor, bashkitë, të cilat kontrollohen tërësisht nga PS.

Këta indikatorë dëshmojnë një përkeqësim të vazhdueshëm të gjendjes ekonomike e financiare në ndërmarrjet e Ujësjetllës-

Kanalizimeve, e cila vjen nga humbja e aftësisë paguese për të shlyer faturat e energjisë dhe detyrimet e tjera të prapambetura, kjo për shkak të keqmenaxhimit në mbledhjen e të ardhurave nga tarifa e ujit. Për hir të së vërtetës, ky sektor jetik përmban rritje të lartë të menaxhimit që, siç e theksova më parë, vijnë nga emërimet klienteliste dhe paaftësia e strukturave drejtuese të ndërmarrjeve të Ujësjiellës-Kanalizimeve, si më poshtë:

1-Risku i rritjes së kostos së prodhimit të ujit, për pasojë i rritjes së çmimit të shitjes së ujit për abonentët familjarë dhe biznesin, si dhe rritja e kostos së shërbimeve të kanalizimeve e mbetjeve urbane.

2-Risku i falimentimit të ndërmarrjeve publike të Ujësjiellës-Kanalizimeve.

3-Risku i mospërdorimit brenda afateve të kontratave për përmirësimin e infrastrukturës së Ujësjiellës-Kanalizimeve.

4-Risku i falimentimit të subjekteve private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e Ujësjiellës-Kanalizimeve, që mund të vijë për shkak të detyrimeve fiskale të papaguara, në lidhje me punime të kryera, por të pushyera nga buxheti i shtetit, AKUM-i dhe bashkitë.

Do të ndalem edhe në një çështje tjetër, meqenëse i kam edhe disa minuta: eksperiencia e trishtë e financimeve të mëparshme me kredi të buta. Eksperiencia e performancës së kredive të mëparshme të buta, nga institucionet donatore për sektorin publik të ujësjiellës-kanalizimeve është e trishtë. Mjafton të përmendim mosdisbursimin e plotë të kredisë për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”, e financuar nga Banka Japoneze për Zhvillim në shumën 100 milionë euro.

Kontrata e sipërmarrjes për zbatimin e punimeve është lidhur në vitin 2014 me një vlerë rreth 81 milionë euro me afat punimesh 30 muaj. Kjo kontratë është ndërprerë nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës vite më parë dhe deri në këtë muaj punimet, rreth 70% e kontratës me vlerë 56 milionë euro, janë kryer nga shoqëria kontraktuese. Kujtoj këtu që kjo kredi e butë është dhënë nga qeveria japoneze nëpërmjet Bankës Japoneze për Zhvillim.

Ndërprerja dhe zgjidhja e kësaj kontrate është bërë në mënyrë të njëanshme nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, sepse ne

kështu dimë t’i bëjmë gjërat dhe kujtojmë se të gjithë janë si “Prestige Resort”, të cilit i jeni vërsulur ju tani. Për këtë shoqëria kontraktuese, së cilës nuk po ia citoj emrin për të mos u përdorur ky diskutim imi në një sallë tjetër, ka depozituar kërkesën në Arbitrazh pranë Dhomës Kombëtare të Tregtisë në Londër. Kjo gjykatë në datën 19.12.2018 e ka njoftuar zyrtarisht ministrinë tonë dhe kontaktorin për hapjen e çështjes. Çështja vazhdon të jetë në proces arbitrazhi, ndërkohë që punimet kanë rreth 5 vjet që janë lënë në mes të katër rrugëve, janë braktisur totalisht, ndërkohë që strukturat e ndërtuara ose në ndërtim e sipër po degradohen nga dita në ditë. Përveç humbjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit dhe funksionit të punimeve të kryera me vlerë 56 milionë euro, buxheti i shtetit vazhdon të paguajë edhe interesat e kredisë, sado që janë të buta, për disbursimin e kësaj shume dhe më e rëndësishmja është që do të humbasë edhe vlera të tjera të konsiderueshme në rastin e humbjes së gjyqit në Arbitrazhin ndërkombëtar.

Përsëri, edhe pse këtu po flas me tone të Kasandrës, uroj nga thellësia e zemrës sime të mos jem i saktë në parashikimin tim. Në këto kushte, pavarësisht qëllimeve të mira të Bankës Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim, gjykoj (në fakt, si qytetar dhe si deputet uroj ta kem shumë gabim) se kredia e butë prej 67,3 milionë eurosh do të ndjekë fatin e kredisë së Bankës Japoneze për Zhvillim prej 100 milionë eurosh dhe kjo ndihmë do të përfundojë në keqmenaxhim për shkak të mungesës së përgjegjshmërisë së strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve, si dhe të situatës së pamundur financiare, ku gjenden sot ndërmarrjet publike të ujësjiellës-kanalizimeve, që ju do t’i fusni edhe në një proces konkurrimi, siç e keni theksuar që do të jetë konkurrim përmes projektsh, që do të shtoni edhe më shumë klientelizmin.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Leskaj!

Fjalën e ka zoti Xhelili.

Alban Xhelili – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të them të drejtën unë kisha përgatitur një diskutim, por duke dëgjuar të gjithë parafolësit u çorientova pak, sepse këtu, në pjesën më të

madhe, nuk u trajtua fare aktmarrëveshja, por u bë thjesht politikë. Mua nuk më pëlqen pjesa që disa, qoftë nga ne, qoftë nga opozitës, të bardhën e bëjnë të zezë dhe disa të zezën e bëjnë të bardhë. Mua do të më kishte pëlqyer të flisnim për termat e aktmarrëveshjes dhe nëse kjo është një aktmarrëveshje e drejtë dhe e saktë dhe jo të analizojmë dhe të aludojmë lidhur me sjelljen e njerëzve në të ardhmen qoftë për këtë apo qoftë për diçka tjetër. Të paktën për këtë gjë nuk na e përjashton askush të drejtën që të aludojmë për këdo. Unë do të fokusohem pak tek aktmarrëveshja.

Projekti që shënon ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe akordimin e financimit prej 67 milionë eurosh është me një maturim prej 16 vjetësh, duke përfshirë edhe periudhën 4-veçare pa pagesë principali.

Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve të Shqipërisë synon të arrijë qëllimet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të këtij sektori për furnizimin me ujë për 24 orë.

Objektivat kryesorë të zhvillimit të programit janë: përmirësimi i performancës operative dhe financiare të shoqërive ujësjellës-kanalizimeve; rikuperimi i kostove operacionale pritet të përmirësohet me 10% (nga 81% në 91%); rritja e aksesit në shërbimet e ujit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Shqipëri, si dhe vazhdimësia e përmirësuar e furnizimit me ujë në 35 zona të reja urbane për të marrë minimalisht 18 orë ujë, që është edhe një nga kushtet e grantit për t'u zbatuar.

Programi është strukturuar në 3 fusha rezultatesh:

Fusha e parë ka të bëjë me kuadrin kombëtar të forcuar. Kjo fushë rezultatesh do të mbështesë ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve nga pushteti vendor dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizimeve.

Rezultatet priten në dy fusha: instrumentet kryesore të financimit të sektorit dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe sistemeve të informacionit.

Fusha e dytë ka të bëjë me një element që realisht, të themi të drejtën, mund të ketë munguar prej shumë kohësh ose mund të jetë përmirësuar tani, por nuk është se ka arritur në nivelet optimale, që është përmirësimi i performancës

operacionale dhe financiare të shërbimeve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.

Kjo fushë rezultatesh synon të mbështesë arritjen e rezultateve në nivelin vendor, duke mbështetur tre kategori aktivitetshe: një sistem i rishikuar i grantit të bazuar në performancë për qëndrueshmërinë financiare; projekte për përmirësimin e efikasitetit dhe performancës, pra infrastruktura e furnizimit me ujë 24/7, si dhe paketa stimuluese për proceset e rajonizimit të shërbimeve të ofruara nga ujësjellës-kanalizime.

Fusha e tretë ka të bëjë me përmirësimin i aksesit në shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve në nënzonat e shërbimit. Kjo fushë e rezultateve do të mbështesë krijimin e një hapësire të re financimi brenda AKUM-it për investime në ujësjellës-kanalizime sh.a., për të rritur dhe përmirësuar aksesin në shërbimet e furnizimit me ujë, ku pritet të japë një efekt te pothuajse 10 mijë deri në 12 mijë familje, që po të ecim me një projektion i bie diku te 40 apo 50 mijë banorë.

Programi do të përqendrohet në këto fusha: përmirësimi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë në zonat urbane, konkretisht në të gjitha zonat bregdetare; përmirësimi i performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., duke përfshirë uljen e sasisë së ujit pa të ardhura, që është një nga problematikat më të mëdha; zgjerimi i rrjetit/shërbimit të kanalizimeve në zonat urbane; përmirësimi i efikasitetit të energjisë, si një nga elementet që duhet të ishte përmendur me shumë forcë, sepse është një pikë kyçe që do të sjellë edhe uljen e kostos së ujit që do t'i faturohet të gjithë qytetarëve shqiptarë; rritja e aksesit në furnizimin me ujë në zonat rurale dhe periferike; sigurimi i mbështetjes së likuiditetit për shoqëritë ujësjellës-kanalizimeve të lidhura me krizën Covid-19.

Masa të tjera që do të mbështeten nga ky program përfshijnë: përmirësimin e cilësisë, saktësisë dhe qëndrueshmërisë së të dhënave të sektorit të ujit; forcimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit, si dhe përmirësimin e qeverisjes dhe aktet rregullatore të sektorit.

Nuk dua të zgjatëm më shumë me pjesë të tjera të aktmarrëveshjes, sepse në vija të përgjithshme këto janë, por dua të them diçka që u përmend këtu.

E përmenda edhe në hapjen e diskutimit tim: a mendoni se qytetarët arrijnë ta marrin ashtu siç e thoni ju, pra me ngjyime shumë ekstremiste

politike, duke thënë se bashkitë e PD-së kanë pasur një performancë super pozitive dhe bashkitë e PS-së kanë pasur një performancë super negative dhe se tek ujësjellës-kanalizimet, që menaxhohen brenda bashkive të PS-së, efekti i rritjes së çmimit të energjisë elektrike ka ndikuar në koston e ujit që u faturohet qytetarëve kurse tek ato të PD-së nuk ka ndikuar?! Pra, ose ndikon tek të gjitha ose nuk ndikon tek asnjëra. Kështu që nëse ka performancë, ka performancë tek të gjitha dhe nëse nuk ka, nuk ka tek asnjëra, por unë mendoj se ka një performancë të lartë.

Për sa i përket Bashkisë së Durrësit, ku edhe unë jam deputet, aktualisht 33 zona urbane furnizohen me ujë 24 orë. Siç e thashë edhe më sipër, sipas Bankës Botërore, duhet të jenë të mbuluara minimalisht 35 zona me 18 orë furnizim me ujë dhe deri në fund të vitit 2023 pritet që 44 zona urbane të mbulohen me ujë 24 orë.

Për të dhënë edhe një përgjigje dhe çfarë është bërë me fondet e përfituara, po ju them se investimet e përfunduara në Bashkinë e Durrësit nga viti 2014 deri në vitin 2018 janë me vlerë 9,5 miliardë lekë. Investimet për periudhën 2019-2022 janë afërsisht 4 miliardë lekë dhe investimet e pritshme 2023-2025 janë me vlerë 252 milionë lekë. Mbulimi me ujësjellës është në nivelet e 96,99% dhe për sa u përket investimeve, që unë përmenda, në këtë periudhë dua të bëj një ndërhyrje.

Të gjithë e mbajnë mend, të paktën qytetarët e Durrësit, që para 10 vjetësh në të gjitha mediet flitej se plazhet e Durrësit ishin më të ndoturat. A e dini pse ishin plazhet më të ndotura? Sepse nuk kishte kanalizime ujërash të zeza dhe të gjitha derdhjet bëheshin në det, kurse sot nuk ka më asnjë derdhje në det. Nëse mendoni se eliminimet e derdhjeve në det janë natyrale dhe jo si rezultat i investimeve, e keni gabim? Pra, unë ju përmenda vetëm një fakt për t'ju treguar se investimet janë në terren dhe nuk keni nevojë të aludoni.

Aktualisht qyteti i Durrësit furnizohet me ujë 12,5 orë në ditë, ndërkohë që fshatrat furnizohen me ujë 14,6 orë në ditë, pra i bie një mesatare prej 13,08 orë në ditë. Ne pretendojmë, të paktën me këto investime, të arrijmë në atë nivel që t'u japim qytetarëve të Durrësit 24 orë ujë në ditë. Unë ju ftoj që ta miratojmë këtë aktmarrëveshje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhelili!

Zoti Dule nuk ndodhet në sallë, kështu që konsiderohet se ka hequr dorë nga fjala.

Fjala është për zonjën Spahiu.

Të përgatiten, duke të parë edhe prezencën në sallë, zoti Tritan Shehu, zonja Bardeli dhe më pas zoti Këllëçi.

Klodiana Spahiu – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Nuk ka gjë më të rëndësishme sesa tematika e sotme: uji në jetën e përditshme. Po të kujtojmë takimet tona të pafundme me qytetarët, me elektoratin, pa dyshim, në çdo takim ka pasur shumë qytetarë, të cilët janë ankuar për investimet apo për mungesën e vazhdueshme të ujit. Megjithatë, vjen një moment që ne duhet të falënderojmë dikë për ato çfarë ka bërë ndër vite. Pa dyshim, të gjitha investimet që janë bërë në këtë sektor kanë pasur mbështetje të vazhdueshme nëpërmjet marrëveshjeve, kryesisht të Bankës Botërore, ndaj është momenti ta falënderojmë atë për gjithë mbështetjen që na ka dhënë ndër vite për këtë sektor! Pa dyshim, falënderoj edhe një grup shumë të madh njerëzish, punonjës të këtij sektori, të cilët sakrifikojnë vazhdimisht, sepse sektori i ujësjellës-kanalizimeve nuk është një sektor i thjeshtë për t'u përballuar!

Unë dua të përmend shkurtimisht disa investime të kryera, kolegu Xhelili përmendi disa që janë kryer brenda në qytet, megjithatë unë dua të përmend disa që janë kryer nga viti 2013 e këtej. Në shumë zona apo në njësi administrative ku kemi pasur takime me qytetarët ata ankoheshin hapur për mungesën e ujit, madje në disa zona, mund të përmend këtu Sukthin, Manzën, Rrashbullin, Ishmin, Katundin e Ri, furnizimi me ujë bëhet një herë në dy ditë, ndërsa sot shumica prej këtyre fshatrave kanë ujë 24 orë. Nëse do të krahasojmë të paktën numrin e kontratave me 2013-ën, ne kemi 25% më shumë kontrata të realizuara. Në zonat turistike, si plazhi i Gjirit të Lalzit, janë shtuar rrjete për kanalizimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm për të përballuar sezonin turistik me ujë nga 12 deri në 24 orë.

E përmendi edhe kolegu Xhelili pak më parë, por ne nuk duhet të harrojmë se investimet e Bankës Botërore me qeverinë shqiptare kanë qenë edhe në sektorin e kanalizimeve, sidomos në zonat turistike. Është e vërtetë ajo që tha Albani, që zona e plazhit më parë ka qenë me puseta dhe,

pa dyshim, asnjë turist nuk ka dëshirë të vijë në një zonë turistike që ka puseta. Ndaj, ai investim i kryer pak vite më parë në të gjithë zonën e plazhit, duke filluar nga Ura e Dajlanit deri në Përroin e Agait (është një investim ku kanë përfutur jo pak, por 200 mijë banorë) bëri të mundur pikërisht eliminimin e gropave septike dhe dërgimin e ujërave të zeza në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Vërri. Përveç kësaj kemi edhe investime të tjera, siç është ndarja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha nga ujërat e ndotura, duke shmangur kështu derdhjen e tyre në det, si dhe grumbullimin dhe dërgimin e tyre në këtë impiant, ku përpunohen ujërat e ndotura.

Ne nuk duhet të harrojmë edhe investimet që janë bërë brenda në qytetin e Durrësit. Njësia Operative e Ujësjiellës Kanalizimeve Durrës furnizon me ujë Bashkinë e Shijakut dhe Bashkinë e Durrësit. Nga viti 2013 deri në vitin 2022 sasia e ujit është shtuar më shumë, sepse nga 27 milionë metra kub ujë, që furnizonte më parë Njësia Operative e Ujësjiellës Kanalizimeve Durrës, sot furnizon afërsisht me 44 milionë metra kub ujë, duke rritur në këtë mënyrë me 56% kapacitetet prodhuese. Nuk dua të përmend me detaje si ka ndryshuar kjo gjë, sidomos për zonat turistike, sepse vërtet ne kemi pasur zona, siç ju përmenda, ku uji shkonte një herë në dy ditë dhe sot këto zona kanë ujë 24 orë.

Dua të fokusohem pak se çfarë po ndodh sot në qytetin e Durrësit. Pikërisht dy javë më parë është miratuar një marrëveshje, të cilën ne nuk patëm mundësi që ta ndajmë me qytetarët durrsakë, se çfarë do të ndodhë realisht me rehabilitimin e shpërndarjes së furnizimit me ujë në qytetin e Durrësit. Ky projekt do t'u sigurojë zonave në qendër të Durrësit furnizim me ujë dhe, pa dyshim, do të jetë një faktor i rëndësishëm në reduktimin e humbjeve. E përmend këtë, sepse sot rrjeti i shpërndarjes së ujit është tepër i amortizuar. Vërtet ne kemi tre burime të rëndësishme që mund të furnizojnë me ujë 24 orë qytetin e Durrësit, por rrjeti i shpërndarjes është i 70 vjetëve më parë dhe nuk është e mundur për shkak të humbjeve të realizohet furnizimi me ujë. Kështu, me anë të kësaj marrëveshjeje të miratuar, por edhe të një masterpalni të hartuar për ujërat e ndotuara, pa dyshim që ne do të kemi komplet një qasje tjetër të qendrës së qytetit të Durrësit në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm.

Unë nuk dua të krahasoj se çfarë ka ndodhur më parë, por besoj se të gjithë kolegët duhet të bëhemi bashkë kur bëhet fjalë për projekte shumë të rëndësishme për qytetarët. I përmend këto projekte, sepse vërtet, kur vjen fjala te furnizimi me ujë të pijshëm, ne nuk mund t'i ndajmë kurrësi qytetarët në demokratë dhe socialistë, por duhet të jenë bashkë për të marrë atë çfarë u takon, gjithashtu edhe duke e paguar atë çfarë ata përdorin.

Kjo marrëveshje është shumë e rëndësishme, por unë dua të dal pak minuta jashtë temës. Pa dyshim, edhe me lejen e kolegëve, dua të përmend një ngjarje të rëndësishme për të gjithë ne deputetët që vijmë nga fusha e shëndetësisë.

Dje në Tiranë u bë inaugurimi i një prej spitaleve më të mëdha, një investim që nuk ishte kryer pothuajse në 3 dekadat e fundit, një investim prej 17 milionë eurosh, që është Spitali i ri Qendror i QSUT-së me një sipërfaqe 24 mijë metra katrorë. Vërtet është përmbyllur një nga veprat më të mëdha të tri dekadave të fundit dhe nuk ka qenë aspak e lehtë t'i shkohet deri në fund një veprë të tillë. Spitali i ri ka 345 shtretër dhe ka një kapacitet punonjësish prej 612 mjekësh, infermierësh, teknikësh, koordinatorësh dhe 14 shërbime universitare. Është vërtet një shteg i ri për edukimin dhe formimin e gjeneratës së re të mjekëve.

QSUT-ja, pa dyshim, është një bazë mësimore dhe praktike profesionale me rendësi shumë të madhe, me rendësi jetike si për edukimin, ashtu edhe për formimin e gjeneratave të reja të mjekëve që do të shërbejnë në vitet dhe në dekadat e ardhshme. Pa dyshim, kjo strukturë e re do të shërbejë për zgjerimin e kapaciteteve të bazës praktike, por edhe për rritjen e kuotave të studimit. Unë do të thosha me bindje se ky investim që është bërë në QSUT, të paktën 5 vjetët e fundit pas zbatimit të masterpalnit të QSUT-së, nuk është bërë kurrë ndonjëherë më parë. Dy vjet më parë ne kemi parë inaugurimin e Spitalit Kirurgjikal "Frederik Shiroka" me të gjitha sallat e reja të kirurgjisë, kemi parë Spitalin e ri të Pediatriisë, rikonstruksionin e Spitalit Infektiv, i cili nga mënyra se si është rikonstruktuar do ta quaja një spital tërësisht të ri në koncept dhe në mënyrën e shfrytëzimit.

Gjithashtu, investime të reja kanë filluar tashmë të kryhen në Spitalin e Kardiokirurgjisë, në Spitalin e Psikiatriisë, në Spitalin e Djegie-

Plastikës, të cilat janë të gjitha investime bazuar në masterplanin 5-vjeçar dhe që tregojnë se ky sektor ka qenë në qendër të vëmendjes sidomos në vitet e fundit, sepse kurrë më parë nuk janë parë investime kaq të rëndësishme në QSUT.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Pa dyshim, mbështetja që ne do të marrim në këtë marrëveshje, unë besoj se do të jetë nga të gjithë kolegët, sepse uji, në fakt, nuk ka ngjyrë politike. Unë besoj se do të jetë dëshira e secilit prej nesh këtu që, kur të përballemi me votuesit dhe me qytetarët të arrijmë që ata të kenë në shtëpitë e tyre 24 orë ujë të pijshëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Spahiu!

Zoti Shehu.

Tritan Shehu – “Uji nuk ka ngjyrë politike”, tha kolegja më parë, por uji nuk ka fare ngjyrë, por është jetësisht i nevojshëm dhe i domosdoshëm për njeriun. Prandaj, të them të drejtën, kur ju premtuat në vitin 2013, në mos gaboj, që brenda 3 vjetësh Shqipëria do të ketë 24 orë të rrjedhshëm në shtëpi, thashë: shumë mirë. Sot jemi në vitin 2023, pra kanë kaluar 10 vjet dhe ju kërkonte 75 milionë kredi për të pasur, sipas jush, 18 orë ujë. Çfarë aritmetike është kjo, ju lutem, të nderuar kolegë të së majtës?! Atëherë, si mund të besoj unë se këto para që keni marrë, sepse deri tani janë marrë me qindra miliona për ujësjellës-kanalizimet, do të shfrytëzohen për të realizuar këtë gjë? Unë ju siguroj se nuk do të ketë as 18 orë ujë, por shumë herë më pak, dhe kjo vetëm për qytetet e mëdha, nuk flas për fshatrat.

Pra, ku është rentabiliteti i këtij investimi dhe i kësaj kredie? Ne vetëm po shtojmë borxhet kështu dhe po arrijmë në nivelet e kolapsit të shtetit si pasojë e borxheve. Ku është besueshmëria juaj, se besueshmëria, pa dyshim, bazohet në realizime dhe premtime të kaluara? Askund!

Unë dua t’ju them vetëm pak gjëra. Ju i investoni kuturu, pa cilësi, pa kontroll dhe pa rentabilitet ato para që merrni. Pra, po flas për ato para që ju i investoni, se një pjesë ndahen ndryshe.

Në Lazarat, për shembull, u investuan 2,8 milionë euro për ujësjellësin e ri dhe gjendja është më keq se me ujësjellësin e vjetër. Katastrofë, nuk ka ujë.

Nga ana tjetër, ishte parashikuar se fshati Dropull do të merrte ujë burimi nga Nepravishta,

që është 23 litra në sekondë, por ju këtë ia keni kaluar një kompanie private dhe thoni se Dropulli do të marrë ujë të përpunuar lumi. Pra, kjo është e vërteta dhe këtë po e bëni ju.

Shikoni Gjirokastrën në verë, sa orë ujë ka? A ka 4 orë ujë në ditë? Nuk e besoj, ka shumë herë më pak. Pra, ku është ai 24-orëshi i premtuar nga ju, apo doni të merrni edhe 75 milionë të tjera tani? Ku do t’i çoni?

Po ndërtoni një ujësjellës në Libohovën e sipërme. Po ju them që tani se është jashtë standardeve, qoftë në depo, qoftë në sistemin e pompimit, qoftë në strukturën tjetër. Nuk ka filluar ende, unë nuk e di nëse do të fillojë apo jo në gjendjen teknike që është, por të jeni të bindur që, edhe sikur të fillojë, shumë shpejt do të mbyllet. Kështu po ndodh kudo.

Ju ndërtuat një ujësjellës nga Fratari në depon e Këlcyrës, që kushtoi 1 milion euro. A e dini se atje në depo nuk shkon uji fare ose shkon me disa mbeturina të qelbura?! Pra, ky është rentabiliteti i investimeve tuaja, që e ka lënë qarkun e Gjirokastrës pa ujë, si dhe ka lënë të gjitha fshatrat dhe të gjitha ish-komunat pa ujë, të cilët e marrin ujin vetëm me anë të puseve apo me tuba individualë, të marrë nga majat e malit. Sa për qytetet pastaj, uji shkon në ato orare që ju thashë pak më parë.

Po e përsëris: si mund të besoj dhe të votoj unë, se me këtë kredi kaq të madhe që do të merrni, ju do të zgjidhni problemin dhe do të realizoni premtimin? Premtimi i bërë në vitin 2016 ishte që ne do të kishim 24 orë ujë në Shqipëri, madje u tha se do të hiqnin edhe depozitat nga pallatet, sepse ishin rrezik në rast tërmeti. Pse nuk i keni hequr depozitat? Nëse do të heqësh depozitat, duhet t’u sigurosh qytetarëve ujë 24 orë në 24. A e keni siguruar ju këtë gjë? Jo vetëm nuk e keni siguruar, por jeni kaq larg sa tregoni pikërisht se të gjitha premtimet tuaja ishin premtime krejtësisht elektorale dhe të gjitha paratë që janë marrë deri tani janë keqpërdorur dhe nuk janë keqpërdorur vetëm në qarkun e Gjirokastrës, por në të gjithë Shqipërinë.

Para pak ditësh Kryeministri e shpalli Vjosën “Park Kombëtar” dhe shumë e duartrokitën. A e dini ju se në Vjosë dhe në të gjitha degët ushqyese të saj derdhen të gjitha ujërat e zeza të qarkut të Gjirokastrës? Pra, një Park Kombëtar i mbushur me feçe. A mund të ekzistojë një gjë e tillë? A mund të ekzistojë një

Park Kombëtar në këtë gjendje? Më thoni një element përpunimi real që është bërë në qarkun e Gjirokastrës. Nuk ka. Edhe gropat septike, të cilat i kanë bërë vetë njerëzit, mbushen dhe stërmushen sa derdhen në përrrenjtë aty afër dhe që andej shkojnë në Vjosë. Kjo ndodh në të gjithë qarkun e Gjirokastrës, duke filluar nga Përmeti, Dropulli, Libohova deri në Memaliaj. Kjo është gjendja, pastaj flasin për Park Kombëtar! Po çfarë Parku Kombëtar është ky, të nderuar kolegë? Si mund të ketë një Park Kombëtar të tillë? Me vite po e ngremë këtë çështje dhe asnjëherë nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Dëgjova deputeten që tha se do të shpenzoni 80 milionë euro për ujërat e zeza të qarkut të Gjirokastrës. Ku janë? Çfarë projekti keni? Ju nuk keni asnjë projekt, nuk keni asgjë, nuk keni as burime financimi, sepse ju financimet i harxhoni për të ribërë një rrugë prej 1,2 kilometrash në hyrje të Tepelenës me një vlerë 22 milionë euro.

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Sikur ta kishit shtruar me flori atë rrugë, nuk do të shkente kaq shumë, Erion!

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Atje ishte rruga! Pra, ja ku shkojnë paratë! Atëherë, ku ta di unë se ku do të shkojë edhe këto 75 milionë euro që ju kërkoni të merrni për të bërë kanalizimet për ujësjellësit? Gjendja është tragjike, ndërkohë ju talleni me njerëzit! Pa dyshim, këtu nuk e kam fjalën për ju, deputetët, por për Kryeministrin dhe për ata që qeverisin. Ata tallen me njerëzit dhe kujtojnë se njerëzit janë budallenj, kujtojnë se njerëzit mund të gënjejn, duke bërë pikërisht këtë gjë: një park kombëtar me ujëra të zeza. Të gjitha ujërat e zeza të qarkut të Gjirokastrës derdhen brenda në Vjosë dhe ai kujton se po gënjehem. Pastaj kërkon të bëjë terror mbi medien, pikërisht për t'u mbyllur gojën njerëzve. Ai eksperimenti dhe sulmi i bërë mbi "Prestig Resort" në Durrës është pikërisht terrori që kërkon të bëjë qeveria dhe Kryeministri me njerëzit, është një simptomë shumë e rrezikshme e diktaturës që po lind në Shqipëri. Me anë të terrorit ju doni t'u tregoni njerëzve që kur terrorizoni investitorët, kur terrorizonin drejtuesit e mëdhenj të medie, imagjinoni pastaj se çfarë mund t'u bëni qytetarëve të thjeshtë.

Psikologjia dhe mentaliteti juaj është: lëri njerëzit në varfëri, lëri njerëzit pa bukë, lëri pa kanalizime, lëri pa ujë, goditi me kamxhik që të të puthin dorën. Ky është mentaliteti i vërtetë oriental

i sulltanateve, i pashallëqeve, të cilat realisht nuk kanë asgjë të përbashkët me demokracinë, nuk kanë asgjë të përbashkët me mentalitetin perëndimor dhe pikërisht për këtë arsye ju kërkoni t'i përdorni për të mbajtur një popull të shtypur. Prandaj ju i godisni edhe ata që flasin, edhe ata që japin të vërtetën në medie, siç është rasti i resortit në Durrës, pikërisht për të kërkuar në këtë mënyrë të mbuloni të vërtetën, të mbuloni, pra atë që thashë pak më parë, se çfarë është bërë me gjithë këto investime deri tani në ujësjellës-kanalizime. Ku ka në shkuar ato, se nuk ka asgjë? Qarku i Gjirokastrës është më keq se ç'ka qenë. Ujërat e zeza janë kudo dhe kudo që të shkosh vetëm era e qelbur të mbyt.

Prandaj, për çfarë po flasim këtu? Unë mendoj se kemi arritur në një moment që njerëzit duhet të gjykojnë dhe duhet të vendosin. Unë besoj se shumë shpejt ata do të vendosin për ndryshimet që kërkon ky vend, pikërisht për të shpëtuar jo thjesht nga shtypja, por për t'i hapur rrugën zhvillimit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehu! Fjalën e ka zonja Bardeli.

Greta Bardeli – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Në fakt, unë doja ta filloja fjalën time, duke i dhënë një informacion deputetit të Partisë Socialiste, zotit Xhelili. Bashkia e Shkodrës ka një tregues në performancë, që është më i larti nga të gjitha bashkitë e tjera. Ky informacion vjen pikërisht nga një mbledhje e liderit tuaj botëror me kryetarët e bashkive në tetor të vitit 2021.

Zonja dhe zotërinj të mazhorancës,

Sot, ju po i kërkoni Kuvendit të Shqipërisë të miratojë projektligjin që synon të ratifikojë një marrëveshje huaje ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim, në kuadër të Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri.

Ju po na kërkoni neve, deputetëve të opozitës, që ta mbështesim me votë vlerën e huas prej 67,3 milionë euro, e cila nuk është as më shumë dhe as më pak veçse kapaku që doni t'i vendosni gropës së madhe të korrupsionit që po grabit paratë publike për të mbuluar kështu abuzimet tuaja, ndërkohë që ujësjellësit u kthyen në xhepat e hajdutërisë së drejtorëve dhe të ish-drejtorëve të këtyre institucioneve, që sot i keni pronarë biznesesh të mëdha.

Me urgjencën e hajdutit, që vjedh dhe largohet me nxitim nga vendi i ngjarjes, e sollët në Komisionin e Jashtëm, ku dukshëm ky projektligj nuk plotësonte as afatet sipas pikës 3 të nenit 69 të Rregullores së Kuvendit, dhe nuk u prezantua as sipas pikës 3, të nenit 28, të Rregullores së Kuvendit, procedurës së përshpejtuar, ndërkohë që nismat tona, si deputetë të opozitës, ngelen ende në sirtarët e Kuvendit.

Pyetjet që kanë sot shqiptarët, teksa na dëgjojnë ne sot duke debatuar për këtë projektligj, janë: pse gjithë ky nxitim? Si do të përdoren këto 67,3 milionë euro, ndërkohë që mungon transparenca për sa i përket përmbajtjes dhe ka një mungesë të transparencës në ndarjen e buxhetit zë për zë?

Qytetarët e dinë se ju keni një aftësi që jo vetëm ua faturoni borxhin shqiptarëve, por mburreni si dreqi se po e bëni për ta.

Referuar raportit të performancës së Entit Rregullator të Ujit, rezulton se për vitin 2021 kostot që mbulohen mesatarisht nga ujësjellës-kanalizimet në Shqipëri kanë qenë në masën 73,9%, pra një përkeqësim me vitin e mëparshëm.

Ky projektligj ngjan më tepër si një premtime elektoral sesa objektiv i realizueshëm, ku ujësjellës-kanalizimet parashikojnë furnizimin minimal me 18 orë ujë në ditë dhe nëse i referohemi raportit të Entit Rregullator të Ujit për 2021-in, mesatarja e furnizimit me ujë është 13 orë në ditë, e njëjtë me vitin 2020.

Brenda një afati kohor shumë të shkurtër Shqipëria po merr plot dy borxhe për ujësjellës-kanalizime, ku njëri është 67,3 milionë euro dhe tjetri 60 milionë euro. Në këtë mënyrë thellohet borxhi publik, ndërkohë që në 10 vjet qeverisje, ujësjellësit falimentuan dhe thelluan gropën nën hundën e kësaj qeverie, e cila e kishte mendjen te kanabizimi dhe jo te progresi i vendit.

Të nderuar qytetarë,

Ky nxitim mbetet i pajustificueshëm, por në kontekstin aktual politik, kur pak ditë na ndajnë nga zgjedhjet lokale dhe duke parë që nuk është objektivizuar në mënyrë të qartë përdorimi i tyre, krijon dyshim se do të jetë suport i buxhetit të shtetit për të mbështetur, në një mënyrë apo në një tjetër, politika të ndryshme jashtë programit të qeverisë, duke rritur shpenzimet buxhetore për zgjedhjet lokale.

Këto borxhe dhe kjo keqqeverisje po i bën shqiptarët të largohen çdo ditë nga vendi. Vetëm

nga qarku i Shkodrës janë larguar brenda një viti mbi 17% e popullatës. Nëse ecim me këtë ritëm, gjysma e këtij rajoni do të zhduket për faj të strukturave shtetërore jofunksionale, për shkak të krimit të organizuar, korrupsionit skandaloz në zyrat e qeverisjes, papunësisë, si dhe mungesës së shpresës për një jetë të ndërtuar me dinjitet.

Duke u kthyer edhe një herë te projektligji, kujtoj këtu se kjo mazhorancë ka nisur prej 2014-s të ashtuquajturën “reforma e ujit”. Sot pas 10 vjetësh jemi në një situatë, ku performanca financiare mesatare e ujësjellës-kanalizimeve mbulohet vetëm nga 12 shoqëri aksionere, ndërsa 46 të tjera performojnë dobët, nën mesatare dhe ende nuk kemi një bilanc sesa para nga buxheti i shtetit janë investuar nga 2013-ta e në vazhdim në këtë sektor.

Së fundi, apeli im është për shqiptarët dhe opinionin ndërkombëtar që të kuptojnë se njerëzit që qeverisin këtë vend janë hajdutë ordinerë, që nuk e meritojnë atë karrige ku janë ulur me kohë duke vjedhur votat e shqiptarëve, këtë nuk e thotë opozita, por edhe Departamenti i Shtetit. Tashmë vendi i tyre është pranë kolegëve të tyre të korruptuar, ish-ministra dhe ish-deputetë, që sot janë pas hekurave.

Ndërsa po godisni sipërmarrësit e medieve harroni që po projekttoni fundin tuaj. E vetmja gjë që ju ka mbetur është të numëroni, duke e përqeshur, personazhin e radhës që pret prangat, atë që dikur e keni pasur në krah, por harroni se mund ta keni radhën ju. Ndaj kujdes ku hidhni firmat, sepse nuk ka Kryeministër që ju mbron pas këtij që keni tani.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bardeli!

Fjalën e ka zoti Këlliçi.

Belind Këlliçi – Të nderuar qytetarë,

Të dashur kolegë,

Kur hyra për herë të parë në këtë sallë, në shtatorin e vitit 2021, pata një emocion të fortë. E kisha ngarkuar veten me pritshmëri të mëdha, pasi nuk besoj se ka privilegj më të madh për një njeri politik, për një djalë të ri, se sa të marrë besimin e njerëzve që t'i përfaqësojë dhe të betohet si deputet i Republikës.

I thosha vetes se po futem në aulën ku janë bërë ndryshime të mëdha e ku janë marrë vendime historike për vendin tim. Do të kem edhe një karrige aty ku dikur ka qenë Azem Hajdari, Pjetër Arbëri, Gramoz Pashko, Sokol Ollashi, aty ku

sot vijon të qëndrojë Sali Berisha, por edhe ku kanë qenë personalitete të shquara të së majtës, si Presidenti Rexhep Mejdani dhe Kryeministri i luftës së Kosovës, zoti Pandeli Majko. Me këtë trysni emocionale dhe me idenë se po bëhem pjesë e një trupe të rëndësishme që udhëheq vendin hyra në Kuvendin e Shqipërisë.

Shpejt vura re se shenjtëri jo vetëm që nuk gjeta, por ishte edhe më keq, profania, spekulimi, gënjeshtria, sulmi, urrejtja, vulgu, qenë tiparet e pandashme të parlamentit. Nuk dallova pothuajse asgjë që ka të bëjë me jetën e qytetarëve dhe me shqetësimet e tyre, por kishte një rendje të çmendur pas interesit personal, një makutëri për pushtet dhe një lakmi për privilegje. Nuk hasa në asnjë moment dhe nuk pashë në këto dy vjet, atë që njihet si boja, përmasa e njeriut, të atij dhe asaj që na kanë votuar, që na kanë sjellë këtu të jemi besnikët e tyre, për t'ua mbrojtur interesat, ëndrrat dhe aspiratat.

Kolegë, ju e keni shitur shpirtin. Më vjen keq ta them këtë për pjesën tuaj dërmuese, por nuk ka konkluzion dhe emërtim tjetër, kur bëni pabesinë dhe tradhtinë më të madhe duke u kthyer kurrizin atyre që ju kanë dhënë këtë privilegj, këtë bekim, atyre që ju sollën në këtë sallë, pra votuesit dhe qytetarit tuaj.

Shumë rrallë, pashë një debat, një ngritje të fuqishme zëri, një qëndrim pa kompromis për diçka që ka të bëjë me mirëqenien dhe jetën e përditshme të njerëzve. Kam parë shumë kacafytje për mirëqenien dhe interesat e Rilindjes, të grupit kryesor të saj, që qëndrojnë të ulur këtu pas meje. Më duhet të them se lakmia, babëzia, errësimi i arsyes e logjikës së shëndoshë para pasurimit, nuk vlen njëlloj për të gjithë kolegët socialistë.

Me shumë kolegë të Partisë Demokratike jemi munduar të qëndrojmë fort në mbrojtje të interesit publik, të ngremë kauza, të luftojmë korrupsionin me denoncimet që kemi bërë, siç ishte rasti konkret i ngritjes së komisionit hetimor për aferën e inceneratorëve, por nuk mund të them se ia kemi dalë aq sa duhet, nuk kemi shkëlqyer, pasi edhe në mesin tonë, në një moment, nxori krye një përplasje e brendshme që na mori shumë kohë dhe shumë energji. Pra, edhe pse kemi u qëndruar disa parimeve e vlerave, nuk mund të them se u kemi shërbyer qytetarëve me sherrnajën tonë dhe as kemi mbrojtur më së miri interesin e tyre dhe interesin publik.

Sot, pas kësaj seance, do të dorëzoj mandatin e deputetit, sepse me besim të plotë i kam hyrë një projekti shumë të madh politik. Me besimin që më ka dhënë anëtarësia e Partisë Demokratike në të parin proces të primareve, jam zgjedhur si kandidat i opozitës për Bashkinë e Tiranës. Pra, që nesër unë do të jem kandidati i të gjithë qytetarëve të Tiranës.

Unë mendoj se kisha dhe kam ende shumë për të dhënë në këtë sallë, ndaj nuk mund ta fsheh se po largohem i pezmatuar kur mendoj se Kryeministri i vendit tim ka lëshuar këtu fyerjet dhe etiketimet më të rënda ndaj opozitës, i cili asnjë ditë nuk e ushtroi atë që njihet si themeli i vlerave europiane, pra mbajtjen e përgjegjësisë. Ai kurrë nuk mbajti përgjegjësi për punët që shkuan gjithnjë keq e më keq në vendin tonë, për braktisjen masive dhe shpopullimin e vendit nga të rinjtë; për rastet flagrante të korrupsionit e abuzimit të detyrës nga njerëzit më të afërt e më të pushtetshëm në këta 10 vjet qeverisje; për thellimin e keqqeverisjes; për cenimin e votës; për varfërimin e skajshëm të qytetarëve tanë; për ngushtimin e hapësirave të lirisë; për kapjen e drejtësisë dhe të medias. Kryeministri i vendit tim nuk mbajti kurrë asnjë përgjegjësi dhe nuk e tha një herë të vetme: “Po, ky është faji im edhe unë gaboj”, por sulmoi duke përdorur edhe instrumente ekstraligjore, siç tregon skandali “McGonigal”, kundër kundërshtarit të tij politik, me përpjekje primitive, parapolitike, për ta asgjësuar opozitën.

Unë kam ende shumë për të mësuar, sepse për fat jam ende i ri, por, një gjë e di mirë, se modelin politik që keni ofruar ju nga kjo sallë, që është ofruar nga ky Kryeministër dhe nga kjo qeveri, nuk do të jetë kurrë modeli që do të ndjek, por do ta luftoj me sa fuqi që do të kem.

Po hyj në garë për bashkinë e qytetit tim, të cilin e dua shumë, sepse këtu u linda dhe u rrita dhe nesër dua të rris fëmijët e mi. Nuk ka dyshim se Tirana e ndjen nevojën për ndryshim, ashtu si e gjithë Shqipëria, por këtë radhë e keni shumë të thjeshtë, të dashur qytetarë, sepse ndryshimi është në duart tuaja. Unë jam i bindur se Tirana do t'i prijë ndryshimit, sepse në shpirtin dhe në vlerat e saj që përfaqëson e ka forcën për të mos qëndruar nën zgjedhë dhe nën tutelë.

Unë jam tërësisht për një model tjetër, për një marrëdhënie të hapur, të ndershme deri në fund me qytetarin; për një kontratë që bazohet në

të vërtetën; për një kurs të ri, që e përjashton një herë e mirë gënjeshtrën, shtirjen dhe mashtrimin elektoral; për një model e alternativë, që krijon një qeverisje, e cila shihet çdo ditë në dritë të diellit, kontrollohet çdo ditë prej qytetarëve, ku vendimet merren me konsensusin e tyre; për një model ku nuk do të bie më asnjë një tullë e vetme në këtë qytet nga shkatërrimet e pabesa në errësirë apo shembjet e banesave, për një model ku nuk do të vihet më asnjë tullë e vetme në këtë qytet për interesa të kryetarit, Kryeministrit apo miqve e klientelës së tyre.

Interesi publik, interesi i qytetarëve, i të rinjve e të rejave, i familjeve dhe e ardhmja e fëmijëve të këtij qyteti, do të jetë e vetmja busull dhe i vetmi orientim imi dhe për këtë nuk ka fuqi në botë që më ndalon. Për mua nuk është asgjë më e shenjtë se fjala e dhënë, besimi i marrë, premtimi, fytyra dhe emri im. Unë nuk do ta shes kurrë shpirtin për një privilegj dhe nuk do ta bëj kurrë atë që kundërshtari im po bën prej 8 vjetësh, e për fat të keq, shumë kolegë në këtë sallë e bëjnë çdo ditë.

Do të shihemi sërish, por si fillim do të shihemi me 15 maj në qytetin e dalë nga vargonjtë e korrupsionit, tutelës së kullave e betonit, gjobave dhe taksave të shtuara të kryetarit. Ky qytet do të jetë më miqësor dhe më i jetueshëm, edhe për ju, të dashur kolegë socialistë. Unë jam i bindur se edhe ju kërkonin ndryshim për veten dhe familjen tuaj. Ndaj shumë prej jush, që e kanë të drejtën e votës në Tiranë, jam i sigurt se do ta ushtroni këtë tagër në fshehtësi dhe do ta kapni këtë shans, këtë orë, që po i vjen kryeqytetit.

Mos qëndroni prapa qytetarëve as në shije dhe as në zgjedhje, por është rasti që të hyni në mendjen e tyre, në përmasat, në lëkurën, në këpucën e atyre që na kanë sjellë këtu. Pra, 14 maji është një mundësi të artë për të bërë atë ndryshim që prej shumë e shumë kohësh pritet nga qytetarët tanë. Se sa kohë ka që presin ndryshimin, mjafton t'ju lexoj këtë bashkëbisedim të ndodhur në tetor të vitit 1921, në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, që është marrë nga Arkivat e Shtetit.

Deputeti i drejtohet ministrit të Financave: “Prandaj dua të pyes ministrin e Financave përse veç rrogave i ka pague ma se 11 mijë franga ar këtyre nëpunësve? Në këtë mënyrë kanë veprue edhe ministrat e tjerë, kshuqë për shpërblime janë harxhue ma se 10 mijë napolona. Këto pare janë

harxhue kot, në vend që t'u përdorshin për ndonji shkollë, për spitale, për rrugë e tjera...”

Këto fjalë janë thënë në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, në tetor 1921, nga deputeti i Tiranës Masar Këlliçi, stërgjyshi im, në parlamentin e parë. Është e pafalshme për klasën tonë politike, për të gjithë ata që kanë hyrë e kanë dalë nga kjo sallë, që këto fjalë të tingëllojnë sot më aktuale se kurrë.

Para se ta mbyll fjalën time dua t'u bëj një apel të gjithë kolegëve majtas e djathtas, me bindje apo pa bindje politike, që të paktën në këtë sallë të mos i gënjejnë qytetarët dhe këto fjalë të mos tingëllojnë kaq aktuale si para 102 vjetësh, ku qytetarët dhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë kërkonin spitale, rrugë, shkolla, ujë dhe drita.

Ajo që na u tha pak më parë nga një kolege e nderuar, edhe pse është në kampin tjetër politik, është e pafalshme. Një kolege socialiste, për të cilën kam shumë respekt, pak minuta më parë, na tha se Tirana ka mesatarisht 17 orë ujë në ditë dhe 65% e territorit ka 24 orë ujë në ditë. Unë nuk e di se si ndihen qytetarët kur e dëgjojnë këtë gjë, por ata mijëra që kam takuar çdo ditë, në këta tre muaj që kam qenë në terren, thonë se nuk kanë më shumë se një apo dy orë maksimalisht ujë në ditë, sigurisht këtë e marrin për fyerje.

Meqenëse kjo është fjala ime e fundit, dua ta mbyll me nota pozitive, duke bërë një urim për të gjithë vëllezërit dhe motrat tona të besimit islam, sepse sot nis muaji i madhërisëm i Ramazanit. Kjo është një mundësi e madhe reflektimi dhe shprese në të gjitha dimensionet e jetës, gjithashtu, një mundësi e madhe e shtimit të veprave të mira.

Nga zemra ju uroj të gjithëve një Ramazan të mbarë! Zoti jua pranofte agjërimin në këtë muaj të bekuar!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Këlliçi!

Këtu mbyllen diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai”.

Fjalën e ka ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi. Koha për ju është pa kufizim. Të përgatiten kolegët Kollçaku, Çela, Velu dhe Metaliaj.

Niko Peleshi – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Sot po diskutojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai”.

Sot Shqipëria merr pjesë në 8 misione ndërkombëtare në të gjithë globin. Vetëm para pak ditësh forcat detare nën komandën e NATO-s morën pjesë në një mision, i cili ka për qëllim njohjen e situatës detare dhe ndalimin e aktivitetit të paligjshëm në detin Mesdhe. Ky është misioni i tetë ku ne marrim pjesë. Pra, nuk është vetëm aleanca jonë në NATO, por edhe misionet e Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Europian, ku Shqipëria është prej vitesh aktive dhe kontribuon për ta merituar pozicionin e artë që ka në këtë kohë të tronditjes së sigurisë dhe paqes, si anëtare e aleancës më të fuqishme ushtarake dhe politike në botë, NATO-s.

Me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje ne shtojmë prezencën tonë edhe në një tjetër rajon delikat siç është kufiri Egjipt-Izrael. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës Shumëkombëshe Vëzhguese synon pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me misionin e saj në Sinai të Republikës Arabe të Egjiptit.

Nga këndvështrimi politik, dislokimi i efektivëve të Forcave të Armatosura në këtë mision konsiderohet si një kontribut tejet i veçantë për sa i përket bashkëpunimit strategjik në fushën e mbrojtjes me aleatin tonë strategjik special, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në këtë mision parashikohet të marrin pjesë 4 efektivë të Policisë Ushtarake. Në momentin e dislokimit të efektivëve pranë shtabit të forcës, ata do të kalojnë kontrollin operacional të komandatit të Forcës Shumëkombëshe Vëzhguese, e cila drejtohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Falë angazhimit të kësaj force në rajonin e Sinai, rrjedhimisht edhe të efektivëve të Policisë Ushtarake, si pjesë e Forcave të Armatosura,

synohet monitorimi i kufirit mes Egjiptit dhe Izraelit, ku fokusi dhe objektivi kryesor është mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të sigurisë të traktatit të paqes Egjipt – Izrael dhe parandalimin e shkeljes së kushteve të këtij traktati.

Dëshiroj të theksoj se nënshkrimi i këtij akti është në përputhje me politikat e Ministrisë së Mbrojtjes, në kuadër të mbështetjes së aleatëve dhe partnerëve strategjikë të Shqipërisë dhe në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë në luftë kundër terrorizmit.

Forcat e Armatosura janë angazhuar të marrin pjesë aktive, siç e thashë më lart, në operacionet ndërkombëtare, në misione të ndryshme jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjikë.

Forca Shumëkombëshe Vëzhguese është një organizatë paqeruajtëse ndërkombëtare, e krijuar me marrëveshje me Republikën Arabe të Egjiptit dhe shtetit të Izraelit. Kjo forcë operon ligjërisht dhe merr kompetenca nga traktati i paqes i vitit 1979 mes Egjiptit dhe Izraelit, në të cilin palët e traktatit morën përsipër t’u kërkonin Kombeve të Bashkuara sigurimin e një forcë vëzhguese për të mbikëqyruar zbatimin e traktatit. Shtetet themeluese të kësaj organizate janë Egjipti, Izraeli, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa shtetet e tjera si Australia, Kanadaja, Kolumbia, Republika Çeke, Fixhi, Franca, Italia, Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Uruguai, aktualisht i ofrojnë kësaj force personel ushtarak, që përbëjnë forcën, (si kompozohet forca) dhe kryejnë detyra specifike të specializuara.

Duke konsideruar këtë angazhim mjaft të rëndësishëm dhe strategjik dhe me dëshirën për të vazhduar angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione prestigjioze, si dhe për të gjitha arsyet e mësipërme, Ministria e Mbrojtjes propozon, mbështet dhe ju kërkon ta miratoni këtë projektligj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Kollçaku, fjala për ju.

Bardhyl Kollçaku – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Kjo nismë ligjore e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e qeverisë shqiptare meriton vëmendje dhe mbështetje. Unë jam i sigurt se ashtu siç ndodhi në Komisionin e Sigurisë, në Komisionin e Ligjeve dhe në atë të Marrëdhënieve me Jashtë, ku të gjithë kolegët e opozitës dhe të mazhorancës e dakordësuan këtë projektligj, mendoj se edhe sot do të ketë mbështetje të plotë.

Unë e dëgjova me vëmendje fjalën e ministrit të Mbrojtjes, ndaj më bëhet qejfi pasi me këtë nismë bëhet misioni i 9-të, pasi i 8-ti ishte në detin Egje me Forcat Detare. Uroj dhe shpresoj që në të ardhmen harta gjeografike me kontributin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shërbim të paqes dhe sigurisë, të zgjerohet, pra jo vetëm në kuadër të NATO-s, por edhe të Bashkimit Europian, të Kombeve të Bashkuara apo të koalicionit të vullnetit, siç është edhe rasti specifik. Kontributi që Forcat e Armatosura kanë dhënë në procesin e integritimit, si në NATO, ashtu edhe në procesin e tanishëm në Bashkimin Europian, meriton mbështetje dhe vlerësim!

Nëse i hedhim një vështrim të shkurtër historikut të pjesëmarrjeve në misione dhe operacione paqeruajtëse, të cilat datojnë nga viti 1994, gati 3 dekada më parë, janë mbi 8 mijë ushtarakë shqiptarë që kanë marrë pjesë në operacionet luftarake, paqeruajtëse apo në mbështetje të paqes, pothuajse në të pestë kontinentet. Kjo tregon se Shqipëria nuk është më konsumuese e sigurisë, por është eksportuese dhe është krah për krah aleatëve të saj në NATO, por edhe atje ku synon të shkojë, në Bashkimin Europian, për të qenë eksportuese dhe kontribuese e sigurisë.

Miratimi i këtij projektligji, siç e tha edhe ministri, është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 9363, të vitit 2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Ky projektligj është në përputhje me angazhimet e vendit tonë në luftën kundër terrorizmit, kontributin aktiv në misionet dhe operacionet e aleancës apo edhe me partnerët strategjikë, siç është edhe rasti konkret me Shtetet

e Bashkuara të Amerikës, partneri ynë i veçantë, të cilat kanë kryesimin dhe janë garantuesit e kësaj marrëveshje prej më shumë se katër dekada. Por kjo është edhe tregues i miqësisë që ka Shqipëria me Republikën Arabe të Egjiptit dhe me shtetin e Izraelit. Ky kontribut është certifikim dhe dëshmi e kapaciteteve ushtarake që kanë Forcat e Armatosura jo vetëm në këtë mision. Për shembull, mund t’ju kujtoj se vitin e kaluar Forcat e Armatosura dhe Ministria e Mbrojtjes ishin të parat që kontribuan me personel për përforcimin e Krahut Lindor të Aleancës, në Bullgari, në Kosovë apo kudo ku është kërkuar. Pra, konstatojmë me kënaqësi se ka një angazhim që ky kontribut të rritet më tej në vitet në vijim.

Pjesëmarrja e kontingjentit tonë në Forcën Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, krah për krah me kolegët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Franca, Italia, Republika Çeke, Norvegjia, Japonia, Uruguai dhe vende të tjera, do të ketë edhe përfitime të drejtpërdrejta për Forcat e Armatosura (kam parasysh 4 efektivet e Policisë Ushtarake), duke shkëmbyer dhe ndarë eksperiencat, taktikat dhe teknikat më të mira ushtarake, mësimet e nxjerra, por edhe shkëmbimin e vlerave historike kulturore me kolegët e tyre. Këtë e them edhe nga eksperiencia ime personale, pasi kam marrë pjesë në vitin 1996 në misionin në Gjeorgji.

Policia Ushtarake është një strukturë elitare e Forcave të Armatosura, e pajisur, trajnuar, vlerësuar dhe certifikuar sipas standardeve të NATO-s, me përvojë të gjerë në operacionet paqeruajtëse luftarake në Irak, në Afganistan, në Detin Egje dhe së fundmi në Kosovë. Ajo është trajnuar me standardet e NATO-s, me kolegët e tyre italianë, amerikanë dhe turq.

Nuk po zgjatëm në përmbajtjen e marrëveshjes, sepse është e mirëpërcaktuar në katër kapitujt e saj, qoftë në termat financiarë të administrimit apo dhe të zinxhirit të komandim-kontrollit, pra i plotëson të gjitha kushtet e një marrëveshjeje për pjesëmarrjen e trupave tona në këtë mision.

Jam i sigurt se pjesëmarrja në këtë mision me këtë kast ushtarak do të jetë një mundësi e mirë që flamuri ynë kuq e zi të shpaloset krah vendeve pjesëmarrëse dhe djemtë e vajzat e Policisë Ushtarake do të demonstrojnë profesionalizëm, trimëri dhe korrektësi në

kryerjen e këtij misioni të rëndësishëm, ashtu siç e kanë treguar Forcat e Armatosura në dhjetëra misione nën ombrellën e NATO-s, BE-s, OKB-së apo në koalicion me partnerët tanë strategjikë.

Për sa më sipër, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë këtë projektligj.

Gjithashtu, përfitoj nga rasti t'i uroj të gjithë besimtarët myslimanë në këtë muaj të madhërueshëm dhe të bekuar të Ramazanit, agjërim të lehtë dhe të pranuar!

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Isuf Çela. Të përgatitet zoti Denis Deliu.

Isuf Çela – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Sot është paraqitur për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai”.

Në relacionin bashkëshoqërues thuhet se nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet pjesëmarrja e efektivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë mision, i cili konsiderohet si një kontribut i veçantë për sa i përket bashkëpunimit strategjik në fushën e mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pjesëmarrja në këtë mision parashikohet të jetë prej 4 efektivësh të Policisë Ushtarake. Falë angazhimit në Forcave Shumëkombëshe Vëzhguese në rajonin e Sinait synohet kontrolli dhe monitorimi i kufirit ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, ku fokusi dhe objektivi kryesor është mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të sigurisë të traktatit të paqes mes Egjiptit dhe Izraelit dhe parandalimi i çdo shkeljeje të kushteve të këtij traktati.

Nisur nga prezantimi i kësaj marrëveshjeje, Shqipëria bëhet për herë të parë kontribuese në një forcë shumëkombëshe dhe vëzhguese, me një qëllim specifik, ku kontribuesit kryesorë janë partnerët tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, në këtë kontekst, pjesëmarrja e Shqipërisë në një mision të tillë merr vlerësime dhe mbështetje nga ana e Partisë Demokratike, duke e pasur aleancën strategjike me Shtetet e

Bashkuara të Amerikës jo vetëm në ADN-në e rrugëtimit të saj politik, por edhe në kontekstin e zhvillimeve aktuale globale, ndaj vota ime do të jetë pro miratimit të kësaj marrëveshjeje.

Ajo që kërkohet nga Ministria e Mbrojtjes është që personeli i përzgjedhur të jetë i përgatitur nga ana profesionale, por të jetë edhe i vetuar nga ana pastërtisë së figurës, pra të mos jenë persona që kanë pasur dhe kanë probleme me ligjin dhe me drejtësinë. Gjithashtu, do të ishte mirë që ky personel, pjesë e Policisë Ushtarake, që do të dërgohet në këtë mision, të kenë pasur edhe eksperiencën të mëparshme në misione të ngjashme me partnerët eruoatlantikë.

Megjithëse ka një bashkëpunimin dhe partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në shumë fusha të sigurisë dhe të ekonomisë, ajo çfarë thuhet në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për Shqipërinë është realiteti i hidhur shqiptar. Në këtë raport, ku bëhet fjalë për veprimtarinë tuaj qeverisëse, si mazhorancë, thuhet: “Mangësitë në pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit, mungesa e medieve të pavarura dhe korrupsioni i vazhdueshëm në qeverisje nga organet e zbatimit të ligjit dhe në institucionet lokale, ishin problemet kryesore në Shqipëri gjatë vitit të kaluar”.

Kolegët e mi të opozitës i trajtuan specifikisht disa nga shqetësimet e ngritura në raport, ndaj dua të përmend disa nga pikat që kanë të bëjnë me pavarësinë e gjyqësorit dhe ato të zgjedhjeve të vitit 2021 kur thuhet: “Ndonëse Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, presioni politik, frikësimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan gjyqësorin të funksiononte tërësisht në mënyrë të pavarur dhe efikase”.

Duke iu referuar zgjedhjeve në prill të vitit 2021 në raport thuhet: “Sipas misionit ndërkombëtar të vëzhguese, megjithëse zgjedhjet në përgjithësi ishin të organizuara mirë, partia në pushtet siguroi avantazhe të rëndësishme nga fakti i të qenit pushteti i saj, nga kontrolli i administratës vendore dhe nga keqpërdorimi i burimeve të administratës”. Ndaj, meqenëse pothuajse kemi hyrë në fushatë për zgjedhjet lokale të datës 14 maj, këto problematika të evidentuara nga raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit janë aktivizuar shumë më fuqishëm se në zgjedhjet e vitit 2021, si në nivel qendror, ashtu dhe në atë lokal. Veprimet abuzive, shkeljet e

ligjit, si dhe shtimi i numrit të administratës, kryesisht me militantë, në bashki si punëtorë sezonal dhe në ndërmarrje të ndryshme, në funksion të zgjedhjeve, intimidimi i administratës me presione nga më të ndryshmet, siç është platforma “Aktivisti”, me *like*-t e detyrueshme për postimet e shefave rilindas qendrorë dhe atyre lokalë, procedurat tenderuese abuzuese dhe kompromentuese dhe spotet elektorale, edhe pse buxhetet e bashkive janë të falimentuara, janë evidente në administratën e Bashkisë së qarkut Kukës, të cilin unë e përfaqësoj.

Qytetarët janë të lodhur nga keqqeverisja juaj, këtë e thonë edhe raportet ndërkombëtare, ata janë të vendosur të mos shiten dhe as të mos blihen, me gjithë nivelin e lartë të varfërisë dhe më 14 Maj do t’ju ndëshkojnë me votë.

Sot ndoqa me vëmendje zëvendëskryeminstren, njëherazi edhe ministren e Energjetikës, zonjën Balluku, për arritjet imagjinare të kësaj qeverie në fushën e energjisë, dhe për një moment m’u duk se po fliste për Francën apo Finlandën, të cilat janë superfuqi energjetike në Europë.

Unë kam parasysh situatën e furnizimit me energji elektrike në zonën time, në përgjithësi, por edhe në veçanti zonën turistikë, perlën e Alpeve shqiptare, luginën mahnitëse të Valbonës, që përfshin fshatrat: Klësyr, Dragoni, Valbonë, Rragam i Shalës, ku gjendja e furnizimit me energji elektrike është shumë e keqe. Edhe pse këtë luginë e vizitojnë një numër shumë i madh turistësh të huaj dhe vendas, bizneset modeste të bujtinave e restoranteve të ngritura me shumë mund dhe sakrificë nga banorët e këtyre fshatrave e kanë të pamundur të vazhdojnë përballimin e mungesës së furnizimit me energji elektrike me gjeneratorë, përveç çmimeve të larta të karburantit, si dhe vështirësive të tjera që kanë të bëjnë me ndotjen e ambientit.

Një nga biznesmenët e suksesshëm tropojan, Avni Ponari, ka investuar miliona euro në ngritjen e një hoteli modern me 5 yje. Ky shqetësim është ngritur edhe nga ana e tij, sepse deri tani nuk e ka vendosur në punë hotelin pasi mungon furnizimi me energji, facilitet, i cili duhej plotësuar në momentin që i është miratuar leja e zhvillimit dhe e ndërtimit. Për këtë problem kam folur disa herë në këtë sallë, kam ndërhyrë me dhjetëra herë te institucioni përgjegjës OSHEE, i cili dy herë ka shpallur procedurat e tenderit për projektin e

rehabilitimit të linjës të transmetimit dhe ngritjen e një nënstacioni në Valbonë dhe të dyja rastet janë anuluar, gjoja për mungesë fondesh. Pra, edhe pse Tropoja është rrethi i dytë në shkallë vendi për sa i takon prodhimin të energjisë elektrike, nuk ka energji, pasi ju si qeveri, në shenjë hakmarrjeje politike ndaj banorëve, e keni lënë në harresë dhe e keni zhytur në errësirë dhe varfëri, duke i detyruar banorët e saj ta braktisin atë vend, që Zoti e ka bekuar me bukuri natyrore, por e ka mallkuar me këtë qeverisje.

Zonja zëvendëskryeminstre, thirrja ime është: vendosni dorën në zemër dhe bëni të mundur financimin e këtij projekti, si e treta e vërteta. Ata banorë e meritojnë kujdesin e shtetit të tyre, sepse i paguajnë rregullisht taksat dhe faturat e energjisë elektrike, të cilat duhet të kthehen në investime për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre. Pra, nuk duhen diskriminuar për bindjet politike, pasi po kërkojnë diçka bazike, të cilën bota e emancipuar ka mbi 2 shekuj që e ka zgjidhur.

Përfitoj nga rasti të bëj një urim për të gjithë besimtarët myslimanë, me fillimin e muajit të madhërisëm të Ramazanit: Zoti ua pranofte agjërimin dhe sakrificat e tyre! Shëndet, mbarësi paçin gjithmonë në familjet e tyre!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Deliu. Të përgatitet zonja Metaliaj.

Denis Deliu – E nderuar Zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë,
Të nderuar qytetarë,

Përpara se të nis fjalën time dua të bëj një urim me gjithë zemër për të gjithë besimtarët myslimanë: ju uroj një muaj të mbarë të Ramazanit dhe agjërim sa më të lehtë!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai”, rregullon pjesëmarrjen e Forcave tona të Armatosura në misionin në Sinai të Republikës Arabe të Egjiptit.

Për sa u përket implikimeve politike, ligjore dhe diplomatike nuk ka pengesa objektive, ndaj konsiderohet si një kontribut i veçantë për bashkëpunimin strategjik në fushën e mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pjesëmarrja në këtë mision parashikohet të jetë prej 4 efektivësh të Policisë Ushtarake, të cilët do të kalojnë në kontrollin operacional të komandantit të Forcës Shumëkombëshe Vëzhguese, që drejtohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Sinai, me të cilin synohet kontrollimi dhe monitorimi i kufirit ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, ku objektivi kryesor është mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të sigurisë së traktatit të paqes mes Egjiptit dhe Izraelit. Nënshkrimi i këtij projektligji është në përputhje me politikën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe me programin për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare të qeverisë shqiptare.

Nisur nga bashkëpunimi i vazhdueshëm, i konsoliduar, në fushën e mbrojtjes dhe nga aleanca e ngushtë që Republika e Shqipërisë gëzon me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ndërmarrë nisma për ndjekjen e procedurave ligjore në mbështetje të pjesëmarrjes së personelit ushtarak në misionin e drejtuar nga Forca Shumëkombëshe Vëzhguese në Sinai.

Bazuar në misionin që do të kryejë ky kontingjent, rajoni dhe zona e përgjegjësisë ku do të operojë, si dhe rrezikshmëria për të kryer detyrat specifike, brenda zonës së përgjegjësisë ose brenda zonës së operacionit, vlerësohet se niveli i rrezikshmërisë është i shkallës së mesme.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe me ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Forca Shumëkombëshe Vëzhguese është një organizatë paqeruajtëse ndërkombëtare, e krijuar me marrëveshje ndërmjet Republikës Arabe të Egjiptit dhe Shtetit të Izraelit. Shtetet themeluese të kësaj organizate janë Egjipti, Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa shtetet e tjera, si Australia, Kanadaja, Kolumbia, Republika Çeke, Fixhi, Franca, Italia, Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Uruguai, aktualisht u ofrojnë Forcave Shumëkombëshe Vëzhguese personel ushtarak që përbëjnë “forcën” dhe kryejnë detyra specifike të specializuara.

Kjo marrëveshje e përbërë prej 4 pjesësh përfshin: misionin, rregullimet financiare,

administrimin e menaxhimin, si dhe klauzolat përfundimtare, të cilat ezaurojnë të gjitha pikëpamjet ligjore, administrative dhe logjistike për përmbushjen e angazhimit të forcave shqiptare në operacionin e Forcave Shumëkombëshe, si dhe mirëpërcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve, që rrjedhin nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje.

Pjesa e parë parashikon angazhimin që Shqipëria do të marrë përsipër, duke siguruar pjesëmarrjen e personelit me pajisje, për të shërbyer në Forcat Shumëkombëshe. Personeli do të vendoset në Forcat Shumëkombëshe në Sinai të Republikës Arabe të Egjiptit dhe fillimisht do të përbëhet nga një oficer, komandanti i kontingjentit, nga dy personel shtesë, që do jenë të caktuar si oficerë dhe një hetues, të cilët do të shërbejë për një periudhë njëvjeçare në njësinë e Policisë Ushtarake të Forcave Shumëkombëshe. Përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe, personeli i caktuar do të shërbejë një turn njëvjeçar, të pashoqëruar. Palët do të konsultohen dhe do të përcaktojnë reciprokisht planin e rotacionit të personelit të caktuar për të siguruar një mbivendosje të përshtatshme të personelit me rotacion, për qëllime trajnimi dhe vazhdimësie.

Pjesa e dytë parashikon angazhimin financiar që Shqipëria do të kryejë duke marrë përsipër të gjitha pagesat e pagave, shtesat dhe përfitimet të tjera për personelin e caktuar, të cilat i paguhen personelit ushtarak shqiptar në rastet kur ata dislokohen jashtë vendit. Forcat Shumëkombëshe do t'i paguajnë Shqipërisë, Ministrisë së Mbrojtjes, për personelin e caktuar, shumën standarde prej 1000 dollarësh amerikanë për person në muaj. Për secilin personel të caktuar në Sinai do të ketë një pagesë ditore prej 2,56 dollarësh në ditë. Forcat Shumëkombëshe do të sigurojnë pa kosto për Republikën e Shqipërisë, ushqim, akomodim dhe mbështetje për personelin e caktuar në Sinai, brenda zonave të Forcave Shumëkombëshe, si dhe jashtë tyre.

Pjesa e tretë parashikon se personeli i caktuar do të vendoset nën kontrollin operacional të Komandantit të Forcave Shumëkombëshe, si të gjitha të dhënat në lidhje me menaxhimin e personelit të Forcave të Armatosura në Forcat Shumëkombëshe, si dhe lloji i administrimit, i cili do të vihet në fuqi nga Forcat Shumëkombëshe në lidhje me përkujdesjen mjekësore, masat disiplinore, si dhe shërbime aksesore, të cilat

parashikohen për efektivët e Forcave të Armatosura në këtë mision.

Pjesa e katërt parashikon hapat e mëtejshëm, në përputhje me ligjin shqiptar, për të zbatuar privilegjet dhe imunitetet e organizatës ndërkombëtare, që u janë dhënë Forcave Shumëkombëshe nga protokollin i Traktatit të Paqes në Republikën e Shqipërisë, çështjet e interpretimit dhe zbatimit të marrëveshjes, si dhe hyrjen në fuqi të saj.

Duke vlerësuar anët pozitive të kësaj marrëveshjeje, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zonjën Metaliaj.

Lindita Metaliaj – Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Po diskutojmë sot projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai”.

Duke qenë se Shqipëria bëhet për herë të parë kontribuese në një forcë të tillë, me një qëllim specifik, që, në fakt, është një vlerësim i lartë, me rëndësi politike, ku Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë kontribueset kryesore në këtë njësi historike, pjesëmarrja e saj në parim duhet të marrë vlerësimin dhe mbështetjen nga Partia Demokratike, duke e pasur jo vetëm në ADN-në e rrugëtimit të saj politik aleancën strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe në kontekstin e zhvillimeve aktuale globale.

Meqenëse jemi duke folur për çështjet e sigurisë kombëtare, nuk mund të jem indiferente dhe të mos ndalem te raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, sipas të cilit për të drejtat e njeriut nënvizohen: korrupsion në pavarësinë e gjyqësorit dhe mungesë integriteti në drejtësi; mungesë e medieve të pavarura; korrupsion i vazhdueshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes, në organet e zbatimit të ligjit dhe në institucionet lokale; shitblerje e votës; përdorim i pushtetit, përfshirë administratën dhe asetet publike në zgjedhje.

“Ndonëse Kushtetuta parashikon qartë një gjyqësor të pavarur, presioni politik, frikësimi, korrupsioni dhe burimet e kufizuara e penguan

gjyqësorin të funksiononte plotësisht, në mënyrë të pavarur dhe efikase”, thuhet në raport.

Në raport theksohet: “Korrupsioni ishte i pranishëm në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë edhe prokurimet publike, partneritetin publik-privat”. Këtu është fjala pikërisht për inceneratorët fantazmë dhe vjedhjen galopante të plot 430 milionë eurove.

Një nga problemet kryesore të përmendura në raport është edhe gjendja e medias dhe trysnia ndaj saj. Sipas raportit, vëzhguesit pohojnë se qeveria, partitë politike, bizneset dhe grupet kriminale u përpoqën të ndikonin në medie në mënyrë të papërshtatshme dhe jotransparente, dhe janë të pakta mediet e pavarura, pasi shumica e medieve janë në pronësi të biznesmenëve me peshë, që kanë interesa të mëdhenj dhe përdorin mediet e tyre pikërisht për të avancuar interesat e tyre, përfshirë përfitimin dhe nxitjen e interesave që kanë me partitë politike.

Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, raporti i Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, pas zgjedhjeve parlamentare të muajit prill të vitit 2021, vlerësoi se gazetarët mbeten të pambrojtur ndaj presionit dhe korrupsionit. Partia në pushtet siguroi avantazhe të rëndësishme nga fakti i të qenit pushteti i saj, nga kontrolli i administratës vendore dhe nga keqpërdorimi i burimeve administrative.

Gjithashtu, raporti përmend përfitimin që shumica siguroi nga mbulimi pozitiv i institucioneve shtetërore në medie, si dhe pretendimet e besueshme për blerje të përhapura të votave nga partitë politike dhe nxjerrjen e përdorimit të paligjshëm të të dhënave të ndjeshme personale.

Në raport jepet si shembull mbyllja me forcë e një mjedisi biznesi të një deputeti të opozitës, kompania e të cilit ishte vënë në shënjestër, pasi ai kishte akuzuar vazhdimisht dhe publikisht zyrtarët e lartë të qeverisë për korrupsion.

Gjithashtu, përmendet edhe shembja në muajin dhjetor e godinës së *Prestige Resort* nga Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit është një pasqyrim i saktë i realitetit në Shqipëri.

Si në të gjithë Shqipërinë, ngjarjet kriminale mbeten një problem më vete edhe në Lezhë. Shumë qytetarë janë ndierë dhe ndihen të kërcënuar, duke rënë pre e kriminelëve, pasi shumë prej tyre kanë mburojë shtetin rilindas dhe

segmentet e tij. Në jo pak raste është cenuar edhe prona private, ku vjedhjet dhe kërcënimet kanë qenë pjesë e jetës së përditshme të familjeve të ndryshme. Pak ditë më parë u vendos tritol në shtëpinë e një funksionari lokal të Partisë Demokratike, në një zonë të Kashnjetit në Lezhë. Policia lokale u mjaftua në pak rreshta të sfumonte një ngjarje që mund të shuante një familje të tërë, anëtarët e së cilës, fatmirësisht, i shpëtuan shpërthimit me tritol të vendosur në verandën e shtëpisë.

Ne si opozitë kemi denoncimin, reagimin dhe fjalën, duke kërkuar hetim të ngjarjes, duke u dhënë kurajë njerëzve të denoncojnë, por, fatkeqësisht, në krahun tuaj ndodh e kundërta.

Kryetari juaj, i emëruari i Ramës në krye të Bashkisë së Lezhës, që është votuar nga vetëm 6% e lezhjanëve dhe po bëhet gati të ikë nga erdhi, jo vetëm që nuk e dënon aktin kriminal, por përdor një gjuhë ordinere ndaj faktorëve opozitarë, një gjuhë që i shkon për shtat partisë që përfaqëson dhe parisë suaj. Gjuha e urrejtjes ka dëshmuar se nxit konflikt, por kujt t'ia themi?! Pikërisht juve, që mjet fitoreje keni presionin, konfliktin dhe dhunën, gjë që nuk do t'ju funksionojë, aq më pak në Lezhë, ku qytetarët, me zgjuarsinë dhe dinjitetin e tyre do t'ju ndëshkojnë me votë më 14 maj.

Është e patolerueshme se si Policia e Shtetit, normalisht, edhe policia e Lezhës përditë me radhë po luftojnë me kamerat e vendosura cep më cep. Ku ishit gjithë këto vite? Cila ishte arsyeja që i kishit lejuar? Nga kush kishit frikë? Ku e morët guximin tani? Luftë që ngjan me mullinjtë e erës, ngjan njësoj e neveritshme, pasi qytetarët nuk i vlerësoni si të tillë, për t'u siguruar jetën, por i shikoni si spektatorë, dhe do të jenë pikërisht ata që ju i nënvlerësoni, bashkë me ne të gjithë, që do t'ju largojnë, duke u bërë sërish bashkë për t'ju shkukur nga karrigia që e shikoni si pronë private. Policia e Shtetit është e shqiptarëve dhe duhet të mbrojë e të sigurojë jetën e të gjithëve, por kjo nuk arrihet kurrë kur zbatohen urdhrat politikë të rilindjes. Shpresoj që kjo të mos përsëritet kurrë më!

Jemi vetëm disa javë para zgjedhjeve lokale dhe unë kam një thirrje pikërisht për policinë e Lezhës, për atë pjesë të ndershme, që bën punën dhe zbaton ligjin: mos lejoni të bëheni patericë politike e Ramës dhe aq më pak e të emëruarve të tij; mos zbatoni urdhra politikë që i bien ndesh

ligjit, pasi një ditë do të përballeni me ligjin dhe me të gjithë forcën e tij, sepse paguheni nga taksat tona për të mbrojtur jetën, shëndetin, pronën e lezhjanëve dhe të mbarë shqiptarëve!

Meqenëse jemi te pagat, dua të ndaj me ju, kolegë, një shqetësim që vjen pikërisht nga 117 punonjës të portit të Shëngjinit, të cilët janë kryefamiljarë dhe kanë plot 3 muaj pa marrë pagat e tyre. Ata protestuan para dy ditësh, siç protestuan edhe para 1 muaji e gjysmë për kërkesat e tyre, për të marrë pagën, mundin dhe djersën e tyre, por të gjitha këto kanë rënë në vesh të shurdhër.

“Jemi të persekutuar”- është shprehur një punonjës; “Jemi kryefamiljarë dhe na kanë prerë energjinë elektrike”, thotë një punonjës tjetër; “Kemi kredi për të paguar dhe kemi plot 1001 halle e shqetësime në familjet tona”, thotë një tjetër.

Në këto kushte, në emër të 117 punonjësve të portit të Shëngjinit, por edhe të plot 500 familjarëve të tyre, i kërkoj ministres së Infrastrukturës të marrë masa urgjente që këta punonjës të marrin tri pagat e prapambetura, të cilët nuk janë paguar ende për vitin 2023. Është e turpshme që në vitin 2023 të diskutojmë ende për mosmarrje pagash! Turp për këtë qeveri hajdute, që mban të ardhurat minimale të 400 anëtarëve të këtyre familjeve! Kjo tregon qartë fytyrën e vërtetë të qeverisë së inceneratorëve dhe se qytetarët nuk kanë qenë dhe nuk janë prioritet i kësaj qeverie. Pa dyshim, më 14 maj do të merrni përgjigjen e merituar nga Lezha dhe nga lezhjanët.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në projektligjin “Për kontrollin e tregimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”.

Fillojmë me diskutimin, me paraqitjen e projektligjit nga nismëtari, zoti Peleshi.

Fjala për ju, me kohë të pakufizuar.

Niko Peleshi – Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Projektligji i dytë i propozuar nga Ministria e Mbrojtjes ka për qëllim rregullimin e tregimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Deri tani tregtimi i këtyre produkteve nuk ka qenë i rregulluar siç duhej dhe në këtë mënyrë krijon hapësira për importin, eksportin dhe prodhimin e tyre në tregun shqiptar. Rregullimet e propozuara në këtë projektligji e kufizojnë këtë treg dhe e rregullojnë atë, duke kushtëzuar tregtimin e këtyre produkteve me një regjim autorizimesh, që do të lëshohet nga AKSHE-ja pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Produktet që përfshihen në fushën e veprimit të këtij projektligji janë të llojeve të ndryshme dhe kategorizohen në dy grupime, për efektin e regjimit që ndiqet për çdo kategori.

Në kategorinë e parë gjenden produktet që nuk kanë përdorim tjetër përveç ushtrimit të trajtimeve mizore, çnjerëzore apo poshtëruese. Këto sende nuk lejohen të prodhohen, të eksportohen apo të importohen në vendin tonë, përveç rasteve të ekspozimeve në muze.

Në kategorinë e dytë gjenden produktet që kanë edhe përdorime të tjera, por që mund të përdoren edhe për trajtime mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese. Këto produkte mund të prodhohen, të importohen ose të eksportohen me autorizim të lëshuar nga Autoriteti përgjegjës për Kontrollin Shtetëror të Eksporteve.

Gjithashtu, ky projektligj synon të rregullojë edhe furnizimin me shërbime të ndërmjetësimit, ndihmës teknike, trajtimin dhe reklamën për produktet e sipërpërmendura. Këto shërbime do të jenë të grupuara sipas kategorive të produkteve të cilave u referohen dhe do të ndjekin të njëjtin regjim me to. Pra, shërbimet për produktet që nuk kanë përdorim tjetër praktik, janë të ndaluara kategorikisht, ndërsa produktet që janë subjekt autorizimi nga AKSHE-ja dhe shërbimet për to do të jenë subjekt autorizimi. Pra, do të lejohen vetëm me autorizim nga AKSHE-ja.

Ky projektligj do të normojë procedurën e kërkesës për t'u pajisur me autorizim, afatet dhe masat administrative për shkëljen e dispozitave të projektligjit.

Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me detyrimet e Republikës së Shqipërisë si anëtare e Këshillit të Europës dhe veçanërisht me rekomandimin e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare, për masat kundër tregtisë së mallrave që përdoren për dënime me vdekje, torturë, trajtime apo ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Marrja parasyshe e këtij rekomandimi gjatë përgatitjes së paketës ligjore, është këshilluar edhe nga shërbimet e Komisionit Europian gjatë konsultimeve paraprake të projektligjit.

Projektligji synon përafrimin e legjislacionit komunitar, konkretisht me rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16.01.2019, "Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturë apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese".

Përafrimi do të jetë i pjesshëm dhe do të realizohet i plotë, me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji. Vendimi i Këshillit të Ministrave do të miratojë edhe listat e produkteve për secilën kategori. Këto do të jenë lista nominale, siç parashikohet në ligj. Një rregullim i tillë është menduar për të garantuar elasticitetin në përditësimin e listave, sidomos sipas përditësimeve që lista mund të pësojë me vendimmarrjen e organeve të Bashkimit Europian, për të garantuar një transpozim sa më të shpejtë, me procedura më të thjeshtuara në krahasim me miratimin e listave me ligj. Pra, kjo është arsyeja pse është lënë me VKM.

Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zonjën Zheni Gjergji.

Zheni Gjergji – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot po diskutojmë projektligjin "Për kontrollin e tregimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë, ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese", i cili vjen në kuadër të përafrimit të legjislacioni tonë me atë të vendeve të Bashkimit Europian.

Gjatë diskutimeve tona në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, si komision për dhënie mendimi, edhe pas paraqitjes së këtij projektligji nga specialistët e Ministrisë së Mbrojtjes, sërish mbetën të paqarta disa aspekte, sepse në Shqipëri, që nga viti 2000, dënimi me vdekje u shfuqizua. Gjatë diskutimit në komision më çuditi më tepër se deri më tani tregtimi i këtyre produkteve ka qenë i parregulluar dhe i pakontrolluar, duke krijuar hapësira për importin, eksportin dhe prodhimin e tyre në tregun shqiptar.

Natyrisht, kjo lë vend për dyshime, që këto lëndë edhe mund të jenë përdorur në popullatë.

Kombet e Bashkuara e kanë ndaluar në formë absolute torturën, nëpërmjet rezolutës së OKB-së, të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme më 18 dhjetor të vitit 2019 dhe, gjithashtu, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian e ka ndaluar dënimin me vdekje, nënshtrimin ndaj torturave, trajtimet çnjerëzore ose poshtëruese. Atëherë, pse nuk kemi nxituar më parë t'i përafrojmë legjislacionet, duke i thirrur kujtesës sonë për pasojat e periudhës së komunizmit në Shqipëri, ku mbi 6 mijë persona janë ekzekutuar me ose pa urdhër gjykatë, midis tyre 450 gra dhe mijëra të tjerë u janë nënshtruar torturave çnjerëzore për motive politike, në veçanti intelektualë, politikanë, tregtarë, pronarë tokash dhe klerikë? Rregullimi dhe përafrimi i këtij ligji me Bashkimin Europian duhet të kishte qenë i menjëhershëm dhe jo të zvarritej për t'u lënë vend abuzimeve.

A kemi trashëguar ne lëndë të tilla nga regjimi komunist? A janë eliminuar këto lëndë? Po ushtria dhe policia shqiptare, a kanë lëndë të tilla sot, të cilat mund të përdoren në popullatë? Nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga organet dhe institucionet referuese për këto pyetje.

(Diskutime pa mikrofon në sallë)

Lindita Nikolla – Ju lutem, kolegë, mbani qetësi, që të dëgjojmë!

Zheni Gjergji – Gjithashtu, sot në rendin e ditës kemi edhe projektligjin “Për nxitjen dhe përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme”, për të cilin dua të them dy fjalë, duke u rikujtuar qytetarëve tanë se Shqipëria renditet e treta në Europë për përqindjen më të lartë të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, ndërkohë që për përdorimin e kësaj energjie për transport, për ngrohje e ftohje Shqipëria renditet në 5 vendet e fundit, nën mesataren e Bashkimit Europian, për shkak të çmimit të lartë të energjisë për konsumatorët familjarë. Edhe pse të bekuar nga natyra për burime të tilla energjie, ne ishim në presionin e vazhdueshëm të qeverisë për përdorimin e energjisë në familje për shkak të të ashtuquajturës krizë globale, e cila, në fakt, për vendin tonë ishte betejë vjedhjesh galoponte nga KESH-i dhe qeveria. U fol për krizë dhe për shpëtimtarë të mëdhenj, për heronj që na sollën dy TEC-e lundruese 1 vit më parë, që mbërritën

nëpërmjet ceremonive intriguese në gjirin e Vlorës. Çfarë u bë me këto dy TEC-e gjatë këtij viti? A prodhuan energji “bajlozët e detit”? Nuk morëm asnjë përgjigje, as sot. Dy “bajlozët e detit” janë atje, por nuk janë vënë asnjë ditë në punë, sepse Korporata Elektroenergjetike Shqiptare ende nuk e ka marrë licencën e prodhimit nga Enti Rregullator i Energjisë. KESH-it i mungon sasia e lëndëve djegëse që u nevojitet dy TEC-eve për t'u vënë në punë. Ajo që dihet me siguri, por nuk thuhet me zë të lartë, madje u harrua fare, është fatura prej 68 milionë dollarësh, që shqiptarët po paguajnë për qiranë e këtyre dy TEC-eve lundruese, që, me sa duket, nuk do t'i ndezin kurrë motorët e tyre për të prodhuar energji.

Të nderuar qytetarë,

Prej dy ditësh Departamenti Amerikan i Shtetit zbardhi raportin për Shqipërinë, në të cilin tregohet realiteti korruptiv dhe pasqyrohet pasiguria e shqiptarëve për të jetuar në vend, realitet që e prekim çdo ditë dhe e pamë sërish dje, me dhunimin e një resorti turistik, që opozita prej ditësh e vitesh e ka denoncuar.

Natyrisht, për një vend ku të drejtat themelore të njeriut shkelen dhe dhunohen, së pari, nga vetë pushtetarët, nga qeveria dhe nga Kryeministri i vendit, elemente këto të cituara në këtë raport, Departamenti i Shtetit Amerikan thekson se Edi Rama dhe qeveria e tij e PPP-ve janë të mbytur nga korrupsioni, që mediet e shkruara dhe vizive nuk janë të lira, por të kapura nga pushteti dhe krimi, që drejtësia nuk ka pavarësi, që administrata është përdorur gjatë zgjedhjeve të fundit në vitin 2021 dhe po përdoret edhe sot hapur për të vjedhur votat më 14 maj. Ne nuk mund të hiqemi sikur gjithçka në jetën tonë politike, fatkeqësisht, jopluraliste, po shkon sipas rekomandimeve për integrimin e vendit në Bashkimin Europian.

Të nderuar qytetarë,

Qeveria “Rama”, pas këtij raporti, nuk mund të ketë asnjë moral për të kërkuar votëbesimin tuaj më 14 maj. Dënimi me vdekje po i ndodh çdo ditë këtij populli, jo nga përdorimi i substancave vdekjeprurëse, por nga largimi masiv i të rinjve, për shkak të mungesës së sigurisë së vendeve të punës, krimin dhe korrupsionit madhor, që po çojnë në shuarjen e jetës në vend.

Ju lutem, të nderuar qytetarë, mendohuni mirë kur të vijnë dhe t'ju kërkojnë votën! Jeta nuk blihet, por jetohet me dinjitet dhe ndershëri.

Së fundi, u uroj nga zemra të gjithë besimtarëve myslimane: agjërim të mbarë, të lehtë dhe të pranuar!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, të ndryshuar”.

Fillojmë me paraqitjen nga nismëtari.

Zoti Braçe, fjala për ju, me kohë të pakufizuar.

Erion Braçe – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Sot në fshat kemi dy realitete: i pari, prodhim fushe, serrash, pemësh, të gjitha në rritje; i dyti, ky prodhim nuk kthehet në të ardhura në kohë përmes çmimeve të drejta, transparente, që shpërblejnë punën, mundin dhe sakrificën e bujqve.

Çfarë pason kjo gjë? Informalitet pothuajse absolut; zero fatura tatimore në transaksione nga bujku te grumbulluesi; fiskalizimi, që ne insistuam me forcë ta quanim një reformë të rëndësishme, nuk funksionon në një prej degëve më të rëndësishme të ekonomisë, siç është bujqësia; një sistem borxhesh i kthyer në biznes (shqip); grumbullues që hyjnë në treg, punojnë, rriten, pasurohen me punën e bujkut, me mallin e bujkut, me paratë e bujkut; bujq të varur nga ky sistem, në të cilin, që të marrësh paratë e mallit të dorëzuar më parë, muaj më parë, duhet të dorëzosh mall sërish, i detyruar nga grumbulluesi dhe nga nevoja për të marrë paratë e mallit që e kishe dorëzuar më herët.

Ndodh kështu: bujku shkon te grumbulluesi, shet mallin e tij, ndërkohë që, në fakt, thjesht lë mallin e tij, thjesht e peshon, nuk ka çmim. “Lëre aty, se çmimi del më vonë”, i thotë grumbulluesi. Faturë, në kuptimin e ligjit, nuk ka. Për pasojë, as cilësi të vlerësuar, as firo, asgjë. Më e rëndësishmja, nuk ka para as me dorëzimin e mallit, as 1 javë më pas, as 2, 4 javë më pas, as 2 muaj më pas, madje as 10 muaj më pas, si sot në Divjakë, ku një pjesë e bujqve nuk kanë marrë ende paratë e shalqirit të muajve qershor dhe korrik të vjetshëm. Ndërkohë, kanë prodhuar

lakër, kanë prodhuar lule, kanë prodhuar brokoli, kanë prodhuar karotë, kanë prodhuar qepë, kanë prodhuar patate, që të marrin paratë e shalqirit, dhe kur vjen koha e grumbulluesit për të paguar paratë, nis kthimi pas: cilësia nuk ishte e para; sasia zbritet, sepse në destinacionin malli nuk ishte i gjithi i freskët; çmimi nuk ishte ai i ditës në të cilën bujku dorëzoi mallin te grumbulluesi, dhe në fund, vlera e mallit e paguar nga grumbulluesi pas disa muajsh, është qesharake.

Natyrisht, nuk janë të gjithë të tillë. Të tillë janë disa që janë bërë të mëdhenj; madje janë bërë të mëdhenj edhe me ndihmë buxhetore. Të tillë janë edhe disa të tjerë, që vijnë kur nis “loja” me çmimet, dhe kur nuk paguan paratë, s’e ke problem ta vendosësh çmimin sa të duash për disa produkte në radhë, sepse ndaj bujkut nuk paguan as pas 1 viti. Ka të tjerë që janë të drejtë, janë korrektë e të ndershëm në marrëdhënie me bujkun, që paguajnë në kohë dhe e paguajnë vlerën e mallit me çmimin e tregut ditën kur malli dorëzohet, grumbullohet për t’u eksportuar apo për t’u përpunuar. Por të gjithë këta nuk konkurrojnë dot, edhe pse të tillë, dhe ky është problemi i dytë i madh që kemi.

Ndërkohë, bujqësia e madhe është bujqësia që financohet; vetëfinancohet nga bujqit, me para mundi, djerse, sakrifice në emigrim, që vijnë dhe financojnë bujqësinë e madhe, të vogël për sa u takon bujqve në këtë vend, financojnë prodhimin bujqësor dhe, kur kanë fat, marrin të ardhura e me to jetojnë, por, mbi të gjitha, me to prodhojnë, nisnin një cikël të ri prodhimi. Çdo vonesë në pagesa për ta, është dëm i madh për prodhimin. Kini parasysh se ai popull në fshat punon, prodhon për vete, doemos, por edhe për gjysmën tjetër të popullsisë së vendit dhe për eksportet. Kaq rëndësi ka! Pikërisht për këto arsye, çdo vonesë në pagesat e tyre duhet kuptuar si vonesë në ciklet e prodhimit. Ciklet e prodhimit kanë kohën e tyre, janë të varura patjetër nga moti, ashtu siç janë të varura tashmë edhe nga pagesat e vonuara.

Një zinxhir i madh borxhesh midis bujqve dhe grumbulluesve po e vë në vështirësi bujqësinë, sepse po detyron një zinxhir edhe më të madh borxhesh, nga bujqit te furnizuesit e inputeve bujqësore. Fletoret e famshme janë edhe atje, dhe këto janë fletore pune, këto nuk janë fletore mbijetese. Këto janë fletore që duhet të shqetësojnë cilindo që jeton, në fshat po e po, por

edhe cilindo që jeton në qytet. Në fund të fundit, të gjithë bashkë ushqehemi në qytet nga puna, nga mundi, nga sakrifica dhe nga prodhimi i bujqve.

Pikërisht për këtë arsye, në këtë shtrat real atje në fshat, por edhe mbi një shtrat ligjor, që ka rregulluar marrëdhëniet kontraktore e tregtare në pjesën tjetër të ekonomisë së vendit, në degë të tjera të ekonomisë së vendit, jam detyruar të paraqes këtë projektligj, që adreson pikërisht pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, pra përfshin këtë degë të ekonomisë, bujqësinë, pikërisht në ligjin “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”.

Çfarë kuptojmë me pagesa të vonuara, në kuptimin e ligjit? Pagesat që nuk kryhen brenda afatit të përcaktuar, me kontrata me ligj nga ana e sipërmarrjeve tregtare dhe autoriteteve publike, kur janë përmbushur kushtet e nenit 4.

Çfarë thuhet në nenin 4? “Kreditori i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit, dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin”.

Së dyti: “Kreditori nuk e ka arkëtuar shumën për t’u paguar brenda afatit, me përjashtim kur për vonesën nuk është fajtor debitori”.

Cila është shumë për t’u paguar? Principali, që duhet të ishte paguar brenda afatit ligjor ose kontraktor të pagesës, duke përfshirë tatimet, taksat, tarifatat dhe detyrimet e tjera të zbatueshme ose në kërkesën e njëvlershme për pagesë.

Çfarë shtohet tjetër? Dua ta dëgjojnë edhe bujqit: shtohet kamatëvonesa ligjore për pagesën me vonesë. Është kamatëvonesë e parashikuar nga ligji për pagesën me vonesë, me normë interesi të barabartë me shumën e normës bazë të interesit për lekun ose normës bazë të interesit për zonën euro, apo normës bazë të interesit në monedhë të huaj dhe të paktën tetë pikë përqindje plus, që llogaritet sipas nenit 5.

Çfarë vjen më pas? Vjen afati. Kur fillon të llogaritet kjo kamatëvonesë dhe kur lind detyrimi për t’u paguar? Në ligj është e përcaktuar shumë qartë: 30 ditë kalendrike pas datë së marrjes nga debitori, nga grumbulluesi, të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme; 30 ditë kalendrike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme. Nëse ka arsye të qenësishme, ky afat mund të shkojë deri në 60 ditë, por pa e kaluar 60-ditëshin. Në fund, e gjitha bëhet titull ekzekutiv, që, në rast refuzimi nga kreditori, pa diskutim, do ta zbatojë përmbaruesi.

Ky është ligji që kemi propozuar, i cili synon, së pari, të formalizojë marrëdhëniet midis bujkut dhe grumbulluesit në fshat, që më në fund të ketë kontrata dhe më në fund të ketë faturë tatimore.

Çfarë kërkohet nga bujqit? Të kenë numrin e tyre të identifikimit, siç e ka përcaktuar shumë qartë ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Natyrisht, ky numër identifikimi të bëhet pjesë e faturës tatimore, mbi bazë të të cilit bujku do të kërkojë paratë e tij.

Çfarë shtohet tjetër? Kamatëvonesa për çdo ditë.

Çfarë vendoset tjetër? Afati brenda 30 ditësh, deri në 60 ditë, nëse ka arsye të qenësishme.

Në fund kemi titullin ekzekutiv, që më në fund bujqit të kenë garanci për mallin që kanë dorëzuar dhe për paratë që rrjedhin pikërisht nga ky mall.

Kjo është e gjitha. Kaq ka nisma dhe unë mendoj se kaq duhet të bënim në këtë moment për të vendosur një raport të ri dhe një marrëdhënie të re midis bujqve, grumbulluesve, përpunuesve, eksportuesve në degën më të rëndësishme të ekonomisë së vendit, që është ekonomia bujqësore, për t’i dhënë më në fund një garanci edhe popullit të bujqësisë, që ka instrumente ligjore që e mbrojnë edhe prodhimin e tyre, që i garantojnë në marrëdhënien e tyre me tregtarët, me grumbulluesit, me përpunuesit dhe me eksportuesit.

Është momenti ta votojmë këtë nismë, për t’i dhënë fund një praktike abuzive, që tashmë kundërshtohet edhe nga vetë ata që merren me këto marrëdhënie e me këto transaksione, pra jo nga vetëm bujqit, por nga të gjithë përpunuesit, grumbulluesit, eksportuesit e drejtë e të ndershëm, që ndihen të sfiduar, të konkurrar padrejtësisht, pikërisht nga të tjerë abuzues që sot janë në treg, që operojnë në treg, që zmadhohen, rriten, pasurohen me paratë e bujqve dhe që e kanë problem të madh t’u japin bujqve atë që u takon: paratë e tyre.

Si në çdo segment tjetër të ekonomisë kombëtare, si në çdo segment tjetër të tregut, natyrisht, edhe bujqit meritojnë të marrin paratë e tyre, por edhe të garantohen e të mbrohen për këtë gjë. Unë mendoj se ky ligj e bën më së miri këtë. Më në fund secili prej tyre do të ketë mbrojtje ligjore për atë prodhim që i ka kushtuar shumë

dhe, natyrisht, në krahun tjetër, duhet paguar me çmime të drejta, duhet paguar pa i zhvatur, pa i grabitur, pa i futur në zinxhirin që ju përmenda më lart, që është zinxhiri i varësisë së bujqve nga disa grumbullues, pa i bërë pjesë të këtij shfrytëzimi, që, të them të drejtën, është barbar.

Thënë këtë, pa diskutim që situata aktuale, “fotografia” aktuale që ju paraqita, kërkon një angazhim shumë të madh të të gjitha strukturave ligjzbatuese për sa i takon fiskut, sepse vlera e borxheve, që të gjithë e dëgjojmë kur shkojmë në fshat, tashmë duhet kontabilizuar. Kjo vlerë borxhesh duhet vendosur në një kalendar, që e detyron secilën prej këtyre kompanive të paguajë, të kthejë paratë te bujqit. Kjo është përtej ligjit. Ligji fillon nga dita e hyrjes në fuqi e tutje, por sot që flasim duhet të adresojmë problemin e madh të borxheve.

Shikojeni, po ju paralajmëroj sot, kanë filluar të ndajnë kompanitë! Kishin një, po i bëjnë dy: njëra që mban borxhet dhe tjetra që vazhdon aktivitetin apo e nis aktivitetin nga e para. Natyrisht, nuk është madhësia e kompanive piramidale, harrojeni këtë gjë, por edhe aq para sa janë, 2-3 milionë euro, janë shumë sa i takon bujqut, punës së tij dhe çmimeve që aplikohen në fushën e bujqësisë.

Dua të bëj një thirrje (ministrja e Financave nuk është sot këtu): organet fiskale, organet tatimore duhet të merren tani, që të mos shkaktohet një dëm akoma më i madh te bujqit me të gjitha paratë e pamarra dhe mallin e pashlyer gjatë të gjithë këtyre viteve të fundit!

Së dyti, është shumë i rëndësishëm apeli që kam për bujqit: duhet të regjistroheni. Ata duhet të identifikohen patjetër përmes një NIPT-i, që të jenë të mbrojtur nga ligji që kemi sot. Duhet patjetër ta shesin mallin e tyre me faturë. Ka marrë fund koha kur e linin mallin atje dhe çmimi dilte pas 9 muajsh. Ky instrument i ka vjedhur deri më tani bujqit. Instrumenti i formalizimit i mbron dhe i fut në një regjim të ri, ku do të ndihen të mbrojtur dhe të garantuar.

Së treti, është shumë e rëndësishme, pa diskutim, të formalizohen tregjet që shesin produkte bujqësore dhe blegtorale. Këtu, në Tiranë, ka një treg që operon në kushte monopoli, ka një treg të kthyer në zërin më të madh të bujqësisë në të gjithë zonën e Myzeqesë, por edhe në të gjithë Shqipërinë. Tirana nuk është vetëm Tirana; Tirana është tregu i madh që furnizon çdo

pjesë të Shqipërisë, nga Veriu deri në Jug. Të gjithë vijnë në Tiranë për të marrë mallin që vjen nga Lushnja, nga Divjaka, nga Fieri, nga Berati, nga Mallakastri, ndaj është shumë i rëndësishëm kontrolli në tregjet bujqësore.

Këtë javë, më në fund, monopoli u thyë. Më në fund!

Dua ta falënderoj publikisht kryetarin e Bashkisë së Tiranës, sepse tani kemi një treg të dytë të produkteve bujqësore në Tiranë, i cili do të thyejë monopolin e një tregu thellësisht abuziv, thellësisht informal dhe thellësisht zhatës! Natyrisht, njerëzit do të kenë një mundësi komplet tjetër, duke filluar nga bujqit e Divjakës, të Lushnjës, të Fierit, të të gjithë Myzeqesë, të Beratit, të cilët do të kenë një mundësi të dytë në Tiranë, duke thyer një monopol, që deri tani i ka zhvatur të gjithë, edhe qytetarët; edhe ju, zonja Ačka, ju ka zhvatur.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fillojmë me diskutimet.

Fjala për zonjën Anila Denaj.

Të përgatitet zonja Antoneta Dhima.

Anila Denaj – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht, diskutimet mund të vijnë, por unë dua ta nis diskutimin tim me një falënderim për kolegun Braçe, pasi mendoj se, përveçse ka harruar syzet këtu, ka sjellë një nismë shumë të mirë në mbrojtje të fermerëve! E falënderoj për këmbënguljen e tij, sepse është koha të mendojmë në të gjitha dimensionet: së pari, të mendojmë për vlerën e punës, që duhet të paguhet në kohë, dhe për formalizimin e asaj pune!

Për çfarë ofron kjo nismë u shpreh nismëtari dhe unë nuk dua të përsëris, por dua të nxjerr dy probleme kryesore, të cilat vijnë dhe qasen në përditshmërinë tonë.

Ky projektligj përcakton detyrimin brenda 60 ditëve për të gjitha pagesave për produktet e shitura nga fermerët dhe, sigurisht, në bazë të dokumenteve fiskale. Zgjidhja që i është dhënë sot, e cila nuk është e vogël, është e pamjaftueshme për të kaluar nga zvarritja, do të thosha (nga zinxhiri i varfërisë, e kuotoi kolegu Braçe), e për të shkuar në zhvillimin ekonomik të domosdoshëm.

Sot në ekonomi sektori i bujqësisë kontribuon me gati 19,3%. Ndërkohë, sektori i bujqësisë vuan në mënyrë të padiskutueshme nga:

informaliteti shumë i lartë; pagesat e cinguara; kreditimi shumë i ulët, ku dua t'ju kujtoj që prej kohësh sektori bankar nuk e ka tejkaluar stokun e kredisë 5% në sektorin e bujqësisë, pavarësisht mbështetjes me shumë fonde garancie; probleme të lidhura me pronësinë e tokës, ku hera-herës nuk mungojnë edhe zaptimet në sipërfaqe të caktuara; rritja e fondeve, si të skemave nacionale, ashtu edhe të mbështetjes së fondeve të BE-së, por njëkohësisht edhe nga burime njerëzore jo shumë të kualifikuara dhe të kufizuara.

Po flasim për një vend si Shqipëria, që në të gjitha standardet dhe raportet ndërkombëtare kualifikohet në nivelin më të lartë për cilësinë e tokës; për mjaftueshmërinë e furnizimit me ujë në zonat rurale; për klimën ekselente, që lejon mbjelljen me shumë se një herë përgjatë vitit; për fuqinë punëtore të re dhe për shpirtin e tregtarit, dhe ende bujqësia, në gjykimin tim personal, por edhe profesional, është shumë larg nga aty ku duhet të përfaqësojë jo vetëm produktin e brendshëm bruto, por edhe pagesën dhe vlerën e bujku.

Edhe pse rritja e eksporteve është fakt në vitet e fundit, edhe pse rritja e cilësisë së produkteve “*Made in Albania*” është e garantuar, edhe pse rritja e fondeve të garancisë sot është e prekshme, dhe të gjitha këto garantojnë një vëmendje të qeverisë drejt sektorit të bujqësisë, bujqësia është ende duke u zvarritur, sepse segmentimi i madh i tokës është një nga problemet shumë të mëdha, që nuk i lejon fermerët t'i rrisin shkallët.

Unë nuk dua të flas për termin që përmendi kolegu Braçe, sepse gjithmonë e shoh gotën gjysmë plot, nuk dua të flas për zvarritjen e varfërisë, por dua të flas për perspektivën, të cilën, sidomos në raport me problemin e segmentimit, e kanë në dorë vetë fermerët. Nuk mundet që me 1,1 hektarë për fermer të ketë ekonomi shkalle, nuk mund të ketë automatizim, nuk mund të ketë prodhim. Çfarë e pengon fermerin të bashkohet në një zinxhir vlerash, i cili, shumicës prej nesh këtu, i kujton atë fjalën, që shpesh përpiqemi ta themi me zë të ulët, “kooperativa”?

Në fakt, edhe pse nuk dua t'u bëj eko kooperativave, nuk është koha për të eliminuar benefitet e produkteve që ka sjellë grumbullimi në struktura të caktuara, dhe ai i shkallës. E kam fjalën për grumbullimin në zinxhirin e vlerave, jo për zinxhirin e varfërisë, kolegu Braçe, në atë

grupim, ku të gjithë aktorët privatë dhe publikë (e ritheksoj, publikë) të bëhen bashkë për të realizuar një interes: për të sjellë prodhuesin, furnizuesin me inpute bujqësore, investimin në teknologjinë moderne, bashkimin e më shumë se 1,1 hektarëve (minimumi 5 deri në 10 hektarë), më tej, shpërndarësit e produktit nga ata në nivelin më të vogël deri tek ata në nivel ndërkombëtar, shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë. Ky zinxhir vlerash nuk është një eko e kooperativave, por është një grupim, i cili do të bënte të mundur lidhjen e interesave dhe bashkimin e tyre, duke përfshirë edhe interesat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Të gjithë, të lidhur në një kontratë bashkëpunimi, bëhen më të fuqishëm, zgjidhin përfundimisht çështjen e informalitetit, mundësojnë kreditim më të mirë, një produkt më cilësor dhe shitje në tregjet ndërkombëtare të garantuara.

Të flasësh për zinxhirin e vlerave duket si një paradoks me problemet e përditshmërisë. Shtetet e tjera e kanë realizuar këtë, dhe këtë objektiv nuk e kam parë vetëm në vendet e tjera ku kam punuar, si banka “ProCredit”, por edhe te fondi i garancisë, që ky parlament i nderuar e miratoi në vitin 2016, ku qeveria shqiptare është e angazhuar bashkë me bankat e nivelit të dytë në gati 180 milionë euro financim me skemë garancie, së bashku me BERZH-in. Megjithatë, aksesin në financë mungon.

Sot, e përmenda edhe pak më parë, jo më shumë se 5% e stokut të kredisë është në sektorin bujqësor. Si mendoni? Kjo vjen se nuk ka interesa për të rritur investimet në bujqësi? Mendoni se nuk ka plane biznesi të prezantuara në bankat e nivelit të dytë për të marrë kreditim? Mendoni se ka mbështetje për garancitë dhe për skemat e garancisë për të realizuar financimin?

Sigurisht që të gjithë aktorët do të kishin interes të rrisnin stokun e kredisë, por a është kjo e mundur sot, nëse fermerët mbeten të kufizuar te produkti i një skeme minimaliste, te një produkti i cili realizohet me mjete të paautomatizuara dhe me produkte jociësore?

Projektligji që po diskutohet sot ndihmon jo vetëm formalizimin, por edhe aksesin në financë, sepse fermeri është i detyruar të shkojë në institucionet e mikrokredisë dhe jo gjithmonë interesi është ai që ia mundëson aksesin në kosto optimale.

Nuk dua të flas këtu për tregun bankar, ata kanë punën e tyre dhe është tregu i tyre, por të marrësh parën që të takon në momentin kur shet produktin është legjitime dhe, për të shkuar më tej, është e rëndësishme që sot në zonat rurale aksesin në financë të mundësohet me një formalizim më të rritur, me një element të shtuar të mbështetjes që sistemi bankar duhet t'ua japë fermerëve. Nuk është vetëm fondi i garancisë prej 180 milionë eurosh, i aprovuar në këtë parlament në vitin 2016, ka edhe forma të tjera të skemave të garancisë, që sot janë në dispozicion të fermerëve nga sektori bankar, por jo të gjitha janë aktive. Çelësi i suksesit do të ishte dhënia e një alternative me një risk më të ulët, dhe vetëm bashkimi në zinxhirin e vlerave mund të sjellë një ekonomi e cila e mitigon riskun dhe e bën aksesin në financë më të mundur.

Unë vij këtu edhe si përfaqësuese e një zone rurale, që zinxhirit të vlerave ia ka parë hairin (më falni për fjalorin), po flas për Konispolin. Që prej vitit 1991, me mbështetjen e USAID-it, fermat bujqësore kanë qenë grupet e para të krijuara dhe sot nuk besoj se ka fermer në Konispol që të ketë probleme si me aksesin në financë, ashtu dhe me çështjet e tregjeve. Sigurisht, kanë nevoja për zhvillimin e energjisë, për të realizuar fuqinë e rrymës, por duke marrë shembullin e Konsipolit dhe duke e sjellë atë me afër të gjitha tregjeve të tjera, do t'ua bëj thirrje kryebashkiakëve që, pas zgjedhjeve të 14 majit, të fokusohen në zonat e tyre rurale dhe të marrin pjesë në këtë zinxhir vlerash, sepse zinxhiri i vlerave nuk është një bashkim vetëm i aktorëve privatë. I përgëzoj të pestë kryebashkiakët që, në skemën kombëtare të vitit të kaluar, e kanë parë këtë mundësi dhe kanë aplikuar për të realizuar pikërisht këtë kontribut të rëndësishëm, si dhe për të dhënë shembullin e tyre kryesor në grumbullim!

Edhe një herë, shumë faleminderit për këtë nismë, zoti Braçe, por nuk mjafton, sepse mendoj se kemi shumë punë përpara, për t'i grumbulluar më tepër fermerët në atë që është "kooperativë" në formatin modern!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Antoneta Dhima.

Të përgatitet zonja Lindita Buxheli.

Antoneta Dhima – E nderuar, zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Gjej rastin të falënderoj kolegun Braçe për ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, të cilat orientojnë për zgjidhje një nga problemet dhe shqetësimet e vazhdueshme të fermerëve në lidhje me pagesën e detyrimeve për shitjen e produkteve dhe, njëkohësisht, shërbime të ndryshme!

Në fakt, problematika e mosshlyerjes në kohë e detyrimeve për prodhuesit bujqësorë, ka krijuar jo vetëm një zinxhir në pagesa, por ka ndikuar drejtpërdrejt në disa raste, në ngadalësimin e deri në pamundësinë e fermerëve për ta vijuar aktivitetin e tyre bujqësor dhe blegtoral.

Bujqësia ka qenë dhe do të mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm, i cili ka dhënë kontributin e vet në ekonominë shqiptare dhe ka zënë një fokus gjithnjë e më të madh tek institucionet, si INSTAT-i, që është prodhuesi i statistikave.

Rritja e cilësisë dhe shtimi i treguesve të kësaj fushe u kanë dhënë mundësi politikëbërësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të hartojnë strategjitë e duhura për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve në sektorët e bujqësisë.

Duhet theksuar fakti se sipërfaqet e mbjella me drithëra, perime dhe fruta nga viti në vit kanë pasur rritje si në përqindje, ashtu edhe në sipërfaqe.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 22% të prodhimit në total të perimeve, nga ku 52% e këtij prodhimi i përket qarkut të Fierit.

Eksportet e produkteve bujqësore kanë shënuar një rritje të theksuar gjatë periudhës 2020-2022, ku eksporti i drithërave shënoi një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2021. Po kështu, edhe produktet e bulmetit, vezët dhe mjalti shënuan rritje krahasuar me vitin 2021.

Gjatë vitit 2023 sektori i bujqësisë është fokusuar dhe po fokusohet kryesisht në mbajtjen e qëndrueshmërisë së prodhimit, në rritjen e eksporteve, në sigurinë ushqimore, në zhvillimin rural dhe në peshkim.

Për një zhvillim sa më të mirë dhe të qëndrueshëm të bujqësisë dhe të zonave rurale, vit pas viti qeveria shqiptare ka rritur ndjeshëm financimet me grante nëpërmjet skemave kombëtare të mbështetjes, ku qarku i Fierit ka qenë një nga përfituesit e skemave, kryesisht:

mbështetje për fara/fidanë dhe inpute të tjera; për ndërtimin e serrave diellore; për prodhimin e perimeve; mbështetje për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike; për fermat organike; për tufën bazë të matrikulluar; për mbarështimin e bletarisë; mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë aksionare me kapital 100% publik; mbështetje për automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve të punës në fermë; mbështetje me naftë për kryerje e punimeve të mekanizuara në bujqësi.

Gjithashtu, edhe nëpërmjet programeve të IPARD-it, kanë përfituar një numër i konsiderueshëm fermerësh të qarkut të Fierit, të cilët, nëpërmjet këtyre investimeve, jo vetëm kanë rritur ekonominë e tyre familjare e kombëtare, por kanë ofruar dhe siguruar mundësi punësimi për të gjithë njerëzit në aktivitetet e tyre. Investimet e realizuara nëpërmjet programit IPARD janë fokusuar kryesisht në ndërtimin e magazinave të grumbullimit, në përpunimin e prodhimeve bujqësore, në ndërtimin e dhomave për ruajtjen frigoriferike, në blerjen e pajisjeve dhe makinerive linjë për prodhimin e verës, në ndërtimin e fermave blegtorale, në ndërtimin e thertoreve dhe në blerjen e pajisjeve për përpunimin e mishit, në ndërtimin e serrave për prodhimin e fidanëve dhe prodhimin e perimeve të ndryshme, në blerjen e makinerive për prodhimin e ushqimit për kafshët, në ndërtimin dhe rikonstruksionin e ambienteve për turizëm rural, në blerjen e linjave të ndryshme të prodhimit e të tjera si këto.

Kanë qenë institucionet e vetëqeverisjes vendore, të cilat, përveç agropikave dhe zyrave të ekstensionit bujqësor, kanë asistuar dhe kanë mbështetur aplikuesit, si dhe çdo fermer të interesuar për aplikimin në skemat kombëtare të mbështetjes.

Me zbatimin e reformës së re administrativo-territoriale, që prej vitit 2015, sistemi i ujëtjes dhe kullimit është një nga funksionet e transferuara pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, dhe në gjithë këto vite nga ana e tyre është bërë një punë shumë e mirë në drejtim të pastrimit dhe sistemimit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, punë e cila nuk është bërë në 20 vjet të marrë së bashku. Po kështu, krahas mirëmbajtjes së sistemit të ujëtjes dhe kullimit, është ndërhyrë me investime të konsiderueshme

edhe në ndërtimin e rrjetin ujëtës, duke rritur kështu ndjeshëm sipërfaqen e tokave që mbuloohen me ujë. Gjithashtu, janë rehabilituar dhe mirëmbajtur infrastrukturën rurale (urat dhe rrugët e parcelave) në një sipërfaqe të konsiderueshme, duke i ndihmuar dhe lehtësuar fermerët për zhvillimin e aktivitetit të tyre bujqësor. Po kështu, njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të stimuluar zhvillimit e fermave të vogla familjare, si bujqësore, ashtu edhe blegtorale, kanë financuar grante të vogla në ndihmë të grave fermere, si dhe të rinjve, të cilët kanë vullnet dhe dëshirë të investojnë dhe të kontribuojnë në këta sektorë.

Të dashur qytetarë dhe ju, fermerë,

Këto janë disa nga arsytet pse Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Kryeministri Rama më 14 maj do të fitojnë shumicën në drejtimin e bashkive në vend.

Ka ikur koha kur në qeverisjen tuaj projektet në bujqësi dhe blegtori ishin thjesht në letër dhe kudo në territore nuk kishte asgjë konkrete. Ky është ndryshimi midis juve dhe, dhe neve sot.

Falënderoj ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe stafin e kësaj ministrie, të cilët dakordësuan dhe mbështetën miratimin e nismës së zotit Braçe, si një nismë shumë e rëndësishme, që do të vendosë një marrëdhënie juridike e ligjore midis bujkut dhe kompanive tregtare të grumbullimit dhe të përpunimit, duke bërë kështu një hap tjetër cilësor drejt formalizimit të këtij tregu dhe disiplinimit të këtyre raporteve.

Ajo që duhet theksuar është fakti se formalizimi i këtij sektori do ta shtyjë bujkun drejt lidhjes së kontratës me pikat e grumbullimit për prodhimin e tij, paraprakisht duke krijuar siguri për destinacionin e prodhimit, por edhe stabilitet financiar, gjë që më pas do të sjellë zhvillimin normal të ciklit të aktivitetit bujqësor dhe blegtoral në sezonet vijuese, si pasojë e lehtësirave që vlerësohet se do të krijohen me vjeljen dhe kryerjen në kohë të pagesave.

Ndryshimet ligjore do t'i detyrojnë palët të paguajnë brenda 30-60 ditëve, që është dhe afati maksimal, duke nënshkruar edhe detyrime të tjera, që kanë të bëjnë me kamatat pas këtij afati dhe me interesa të cilët duhet të paguhet.

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare, por kërkon angazhimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij.

Për sa theksova më lart, dhe në kushtet kur ky ndryshim ligjor do të sjellë një hap tjetër cilësor drejt formalizimit të bujqësisë dhe disiplinimit të raporteve fermer-grumbullues, të ndëruara kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë.

Meqë sot është dita e parë e Ramazanit, dëshiroj t'i uroj të gjithë besimtarët myslimanë: agjërime të lehtë, pranim të lutjeve të tyre dhe lumturi në familjet e kujtdo që i përket komunitetit mysliman! Qoftë ky një muaj reflektimi për të gjithë ne, duke u solidarizuar me ata që kanë më shumë nevojë dhe që kërkojnë mbështetje!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Lindita Buxheli.

Të përgatitet zoti Baftjar Zeqaj.

Lindita Buxheli – Në fakt, u diskutua shumë për këtë ligj, por unë do të doja të falënderoja, në radhë të parë, deputetin Erion Braçe, sepse pas miratimit të kësaj nisme na e bën shumë më të lehtë komunikimin me fermerët!

Edhe pse unë mbuloj një zonë urbane, përsëri doja të theksoja se një pjesë e mirë e qytetit (rajoni nr.5) është e lidhur totalisht me bujqësinë. Aty janë rreth 1800 hektarë tokë, që disponohen nga rreth 1500 familje dhe zgjidhja e këtij problemi për fermerin është mjaft e rëndësishme.

Ndërkohë, nuk duhet t'i harrojmë të gjitha investimet e bëra në këto vite në sektorin e bujqësisë. Nëse e kthejmë kokën pas, do të theksoja fort se janë rreth 28 milionë euro të investuara vetëm në sektorin e ujitjes.

Të dashur miq,

Mos harroni se vite më parë fermerët tanë ujitnin si në mesjetë, nuk flitej fare për sistem ujitjeje, por sot kemi këtë investim të rëndësishëm dhe plot investime të tjera. Theksoj se vetëm në Lushnjë janë bërë rreth 25% e investimeve nga Ministria e Bujqësisë, që kanë bërë të mundur eksportimin drejt vendeve të BE-së me rreth 160 mijë tonë produkte bujqësore.

Miratimi i këtij projektligji merr një rëndësi të veçantë, duke e ditur që kriza ekonomike botërore ka rritur plehurat kimike dhe pesticidet, dhe ndërhyrja këtu ia lehtëson sadopak fermerit këtë situatë.

Nga ana tjetër, nuk duhet të nënvlerësojmë moskoordinimin e fermerëve mes njëri-tjetrit, për të mos mbjellë të njëjtën kulturë. Fermerët e kanë

vuajtur këtë, por edhe ne, sepse kanë mbjellë të njëjtën kulturë dhe malli u ka ngelur stok. Specialistët e Ministrisë së Bujqësisë, agronomët duhet të jenë më shpesh të pranishëm mes fermerëve për t'i orientuar për sasinë e pesticideve, për bimët e mbjella, për llojin e fidanëve, pasi shpeshherë fermerët humbasin për shkak të kësaj mospranie. Shumë fermerë gjenden shpesh në vështirësi ekonomike në këtë sezon të ri mbjellësh, për shkak të kësaj mospagese nga grumbulluesit. Prandaj miratimi i këtij projektligji merr një rëndësi të jashtëzakonshme në këto momente.

Nisur nga faktet e mësipërme dhe nga shumë të tjera, që kolegët i përmendën, nuk është e nevojshme t'i rendis, do t'i ftoja kolegët myzeqarë të opozitës ta miratonin fuqishëm projektvendimin e zotit Braçe, sepse ky ndryshim i mbron fermerët përballë grumbulluesve dhe eksportuesve, por njëkohësisht nuk e denigron figurën e grumbulluesve, përkundrazi, u jep palëve një besim reciprok.

Me miratimin e këtij projektligji ne e shikojmë me kujdes fermerin, duke u dhënë fund vonësive në likuidimin e tyre dhe garantojmë një konkurrencë të ndershme mes 26 pikave në qytetin e Lushnjës, që operojnë në të gjithë Myzeqenë.

Ashtu sikurse e përmendi edhe zoti Braçe, formalizimi nëpërmjet kontratës dhe ligjërimit nëpërmjet faturës janë shtysat që do t'i detyrojnë palët të mos gabojnë ndaj njëra-tjetrës dhe shlyerja e pagesës të bëhet 30 deri në 60 ditë, sikurse u përmend.

Unë besoj se ka ardhur koha të mendojmë dhe të punojmë bashkërisht për krijimin e një burse bujqësore. Këtë gjë e kanë kërkuar dhe e kërkojnë fermerët lushnjarë. Kështu, me krijimin e një *database* me çmimet ditore të prodhimeve bujqësore, të gjithë fermerët, prodhuesit, grumbulluesit dhe eksportuesit do të kenë njohuri për ecurinë e të ardhurave të pritshme nga shitjet. Bursa duhet të përmbledhë të dhëna për çmimet me shumicë dhe pakicë në tregun tonë.

Vetëm duke punuar të gjithë bashkë, deputetët e zonës së Myzeqesë dhe të gjithë deputetët e Kuvendit, do të arrijmë ta bëjmë Lushnjën tonë një motor të bujqësisë shqiptare.

Edhe një herë, i ftoj të gjithë deputetët ta miratojnë nismën e zotit Braçe.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Zeqaj.

Baftjar Zeqaj – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar deputetë,

Edhe unë dua ta përhëndes që në fillim zotin Braçe për projektin shumë të rëndësishëm të paraqitur sot në Kuvend për miratim! Pavarësisht se janë vetëm 4 nene, efektet do të ndihen pothuajse tek të gjithë fermerët e prodhuesit dhe sidomos tek ata që eksportojnë prodhime bujqësore dhe blegtorale.

Në pamje të parë duket sikur ky projekt favorizon vetëm fermerët, por ai u vjen në ndihmë edhe pikave të grumbullimit, të cilat kërkojnë një konkurrencë të ndershme. Nga komunikimet që kam pasur me grumbulluesit apo me eksportuesit seriozë të prodhimeve bujqësore, ata theksojnë se me këtë ndërhyrje sigurohet konkurrenca e ndershme dhe vendosen në binarë apo ndëshkohen pikat e grumbullimit që kanë vite pa i shlyer fermerët. Fermerët e zakonshëm, nëse nuk shlyhen në afat apo, më keq, kur nuk shlyhen fare, janë të detyruar të falimentojnë, duke vuajtur pasoja të rënda financiare dhe familjare.

Sipas disa grumbulluesve dhe eksportuesve, vetëm 50% e pikave të grumbullimit që funksionojnë, të paktën në zonën time, i shlyejnë në mënyrë të rregullt fermerët; pjesa tjetër u detyrohet plotësisht. Ky projekt ka bërë që sidomos fermerët e serrave, që në zonat e Samaticit dhe Roskovecit përfshijnë 400 hektarë, të ndihen më të respektuar. Ju e dini që serrat duan çdo vit investime specifike, ndërrim linjash, ndërrim plastmase e të tjera. Mendojeni për një moment që atyre, për shkak të mospagesave, u shkon dëm gjithçka, madje edhe investimi i mëparshëm!

E kam theksuar edhe herët e tjera që pikat e grumbullimit, për uljen e çmimit të prodhimeve bujqësore, bëjnë ndërprerje të eksporteve, gjë që bie në kurrizin e fermerit, sepse prodhimet bujqësore nuk mund të presin gjatë.

Projekti në fjalë e bën më të plotë zinxhirin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, çka do të thotë se, edhe në këtë zinxhir, secili ka pozicionin e vet të respektuar. Me këtë propozim, bujqit dhe grumbulluesit janë partnerë dhe jo siç kanë qenë deri sot, ku një pjesë e grumbulluesve ishin fati i fermerëve dhe fermerët ishin viktima. Kontratat që do të lidhen i nxisin prodhuesit, duke i motivuar që të prodhojnë, se sa do të prodhojnë dhe për kë do të prodhojnë. Jo vetëm kaq, por

prodhuesi e di tashmë edhe kur e merr mbrapsht pagesën, dhe mbi këtë bazë investon për të ardhmen.

Ky projektligj ka kaluar në Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Mjedisin dhe Tregtinë, i cili vlerësoi situatën aktuale dhe problematikat që ekzistojnë sot në sektorin e bujqësisë.

Ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Po, zoti Braçe.

Erion Braçe - E nderuar Kryetare, unë do të doja t'i falënderoja të gjithë kolegët deputetë, që e morën fjalën këtu, të cilët e vlerësuan dhe e mbështetën nismën! Kam vetëm dy gjëra për të shtuar.

E dëgjova pak më parë kolegen Denaj, e cila foli për një sektor me risk. Patjetër që bujqësia është një sektor me risk, sepse cilido që e ushtron aktivitetin në natyrë, nën qiell dhe në kushte klimatike të përkeqësuar, që nuk përshtaten me ciklet tona të prodhimit dhe ndaj të cilave duhet të përshtaten bujqit, patjetër që ka risk. Bujqësia është quajtur gjatë gjithë kohës një sektor pa çati; edhe për bankat, pa më të voglin diskutim, është një sektor me risk. Ama, kjo nuk mund të shërbejë për të ndalur kreditimin apo për ta lënë bujkun dhe fshatin në përgjithësi në duart e disa institucioneve financiare, që më tepër janë institucione fajdesh, për shkak të përqindjes që aplikojnë mbi bujqit, sesa institucione që financojnë bujqësinë.

E dyta, ka një obsesion shumë të madh gjithandej se u dashka të bashkohen dhe të bëhen të mëdhenj bujqit e të tjera me radhë! Unë po ju them që 90% e bujqësisë sot bëhet nga të vegjlit, jo nga të mëdhenjtë. Nëse ne vijmë këtu në parlament dhe mburremi me 13 miliardë eksporte të fruta-perimeve, pastaj me 52 apo me 55 miliardë (sa të doni) eksporte ushqimore, duhet ta dini që shumica dërrmuese e këtyre eksporteve vijnë nga këta që janë me 2, 3, 4 apo 5 dynym serrë.

Në fund fare kam një pyetje për të gjithë këta që thonë se duhet të jemi me 1, 2, 5 apo 10 hektarë: a i keni rënë ndonjëherë lapsit se cila është sipërfaqja që e nxjerr ekonomikisht mirë bujkun dhe e ndihmon bujqësinë? Sepse duke pasur të dhënë e eksporteve, që vijnë në rritje, si dhe duke pasur parasysh se si është ndarë toka me ligjin nr.7501, sa ka rënë për frymë, zhvillimet që

ka fshati e të tjera me radhë, e kemi provuar për 33 vjet me radhë dhe nuk ia kemi dalë t'i bashkojmë. Atëherë, në momentin kur kemi dështuar në bërjen e kësaj gjëje, sa do të vazhdojmë, edhe 33 vjet të tjerë? Jo, duhet të gjejmë instrumentet që ekonominë e vogël të bujqve, që sot bën ekonominë e madhe bujqësore të këtij vendi, ta mbështesin në një formë që, natyrisht, vlen. Nëse ka një formë që vlen, është që ne të mos gjëmojmë më sipërfaqen, por të paguajmë për njësinë e prodhimit. Ne kemi nevojë për çdo gram prodhim, ndërkohë që financojmë çdo centimetër sipërfaqe. Nëse do të ndjekësh rendimentin, cilësinë dhe produktivitetin. Prandaj duhet të ndryshojmë ne dhe jo bujqit, dhe të financojmë prodhimin, jo sipërfaqet.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”” dhe te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme””. Këto dy projektligje kanë të njëjtin nismëtar, zotin Petrit Vasili, dhe objekti i tyre është i përafërt, ndaj do të diskutohen bashkë.

Referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, a ka pyetje? Nuk ka.

Fillojmë me diskutimin e projektligjit nga nismëtari, zoti Petrit Vasili, pa kufizim të kohës.

Petrit Vasili – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kushdo që na ndjek do të pyeste në mënyrë të logjikshme: “Çfarë ka ndodhur që parlamenti u hap sot që në mëngjes me një projektligj të qeverisë lidhur me energjinë e rinovueshme?”. Është i njëjti objekt për të cilin unë jam këtu për të bërë mbrojtjen e projektligjeve. Projektligjet e propozuara nga unë, si deputet i opozitës, janë ndër të fundit që diskutohen në seancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të pyesin, se opinionin nuk është monopol vetëm i kësaj sale, se jashtë sallës ka mjaft njerëz që kanë të drejtën e tyre, mendimin e tyre dhe nuk ua qeveris dot njeri mendimin, çfarëdo që të thonë: si ka mundësi që këto projektligjet e depozituar nga një deputet i opozitës kohë më parë çohen në fund të rendit të ditës dhe diskutohen të parat ato të qeverisë? Është shumë

e thjeshtë për ta kuptuar: asnjë hapje mendjeje dhe asnjë lloj forme mbështetjeje nuk ekziston nga mazhoranca për çdo ide apo nismë që vjen nga opozita.

Gjithashtu, e njëjta gjë vihet re edhe në mënyrën e trajtimit të këtyre nismave, ku gjithmonë qëndrimi është vetëm një: të bëjmë sikur po i kalojmë në procedurë, sa për të larë gojën, ndonëse ka disa projektligje të tjera që po bëjnë vitin që janë depozituar.

Praktikisht, ndryshimet që ne sjellim janë shumë të thjeshta, shumë të qarta, efektive dhe ndihmojnë, në radhë të parë, një sektor, përfaqësuesit e të cilit kanë qenë të pranishëm në këtë sallë dhjetëra herë, ose si objekt i marrjes së qindra e miliona eurove...

Zonja Kryetare, a ka mundësi të vendosni qetësinë në këtë sallë?

Lindita Nikolla – Ju lutem, pak qetësi, kolegë deputetë! Të dëgjojmë zotin Vasili!

Petrit Vasili – Pra, janë marrë kredi e borxhe të shumta financiare, kemi dëgjuar debate mjaft të mëdha për zgjidhje të caktuara për krizën energjetike.

Pyetja për të gjitha këto është një: cilat janë zgjidhjet efektive, afatgjata, që ndihmojnë qytetarin dhe biznesin?

Pavarësia në energjinë elektrike, duke e prodhuar të gjithën në vend, pra me një çmim shumë të favorshëm, është një mbështetje e madhe për biznesin; ka të bëjë shumë në ndikimin e saj në çmime, që afektohen nga energjia elektrike dhe nga çmimi i rritur i saj, i cili ndikohet, mbi të gjitha, nga importi. Ndërkohë, kontrasti i fortë është se ekzistojnë të gjitha mundësitë për ta siguruar energjinë elektrike në vend.

Tema është shumë delikate, se e afekton krejt ekonominë në çdo element të saj, e afekton në shërbime e deri te buka e gojës dhe, si e tillë, qëndrimi ynë duhet të jetë patjetër i përgjegjshëm, shumë i fortë dhe, mbi të gjitha, afatgjatë.

Asnjëra prej këtyre nuk ka ndodhur. Sot qeveria erdhi të ndryshonte një ligj, duke pasur një ligj tjetër, atë të vitit 2017, dhe nuk i shpjegoi askujt pse dështoi dhe si dështoi. A ka përgjegjës për dështimin? Është e njëjta mazhorancë! Kujt do t'ia kërkojmë këtë?

Kështu që kjo mënyrë do të ishte përgjigja më korrekte ndaj qytetarëve. Si do t'ua shpjegojmë qytetarëve që i kemi të gjitha

kapacitetet për ta prodhuar të gjithë energjinë në vend, por ndërkohë detyrohem të blejmë energji, duke shpenzuar qindra e miliona euro?

Ndryshimet e sjella janë shumë të thjeshta: zgjerohet mundësia që kapacitetet deri në 2 megavat për instalimin e fotovoltaiikut dhe të atyre që e sigurojnë energjinë nga era të trajtohen nga agjencia përkatëse, duke hequr varësinë e drejtpërdrejtë të miratimit nga qeveria të këtyre kapaciteteve. Cili është përkthimi? Zhdërvjelltësi, lehtësi, kryerje në kohën më të shkurtër të mundshme dhe inkurajim për ata që duan të investojnë në këtë sektor. Nga ana praktike jepet përsëri një zgjidhje, që Operatori i Shpërndarjes t'u miratojë atyre pikën e lidhjes në mënyrë konkrete. Kjo do të thotë që, pasi ta instalojnë, do të kenë mundësinë ta injektojnë të gjithë energjinë e tepërt në rrjet. Me fjalë të thjeshta, do të thotë që një energji e pastër dhe me çmim të lirë u vihet në dispozicion qytetarëve të Shqipërisë, që ata të mos marrin më energjinë e importit, e cila blihet në mënyrë paradoksale, në një kohë kur ka energji në vend. Pra, ka burime të tjera alternative, që injektohen në rrjet dhe e diversifikojnë energjinë, ofrojnë energji me çmim më të mirë, por, në fund, ne jemi gjithmonë e më të suficientë me burimet tona.

Gjithashtu, propozohet që edhe bilanci i këtyre instalimeve të bëhet në baza vjetore, i cili qartëson e sqaron se gjithçka që këta investitorë privatë bëjnë dhe shpenzojnë, e bëjnë për ta përdorur vetë, por ama garanton që të gjitha tepricat të hidhen në rrjet, të kenë mundësi të blihen nga furnizuesi i shërbimit universal, duke i mundësuar këtij sistemi që të likuidojë veten dhe të jetë sa më parë rentabël.

Kjo skemë është në kontrast të fortë me stimulimin dhe me ligjin që ka sjellë qeveria, me të cilin, siç e keni parë, vazhdohet të shkohet te centralizimi, sepse qeveria vazhdon t'i mbajë kompetencat në grusht. Të gjitha elementet, që kanë të bëjnë me centralizime të tepruara, kanë vetëm një faturë të jashtëzakonshme, të cilën e vuajmë të gjithë: korrupsionin e madh dhe të pashmangshëm, si dhe dekurajimin e madh të sektorit. Dekurajimi i këtyre burimeve të prodhimeve me energji alternative ka vetëm një shumatorë: mundësimi për të vazhduar blerjet abuzive të energjisë, për të vazhduar shkëmbimet e pafavorshme të energjisë, me diferenca çmimi të jashtëzakonshme, gjë që bie e tëra në kurriz të

sektorit, i cili tashmë është në një krizë permanente, është kthyer në një të sëmurë elektoral pa shërim, që gllabëron financa pa fund dhe rentabiliteti i tij është aq larg pritshmërive, sa nuk ka ku të shkojë më!

Të gjithë treguesit kryesorë, si humbjet teknike, në vend që të ulen sipas objektivave të kësaj qeverie (jo të miat), vazhdojnë të thellohen, duke mbetur të larta; borxhet e ndërsjella vazhdojnë të jenë në nivele të frikshme; borxhet e ndërmarrjeve të mëdha (përfshi edhe ujësjellësit, për të cilët u fol këtu) shkojnë në qindra e miliona euro. Pra, është një sektor, i cili vuan nga të gjitha pikëpamjet dhe menaxhimi shkon jo më shumë se 24 orë; kaq është vizioni!

Njëkohësisht, dëmet që i vijnë ekonomisë janë të pallogaritshme. Njëherazi jam i detyruar t'ju kujtoj se qeveria, që është këtu, kur bëri programin e saj për 4 vjet, pra për periudhën 2021-2025, premtoi publikisht se brenda shkurtit të vitit 2022 bursa e energjisë do të ishte operative. Ky është premtimi zyrtar i bërë në programin e qeverisë në këtë sallë. Tani jemi në mars, ka kaluar një vit e ca. Ndokush këtu, me shumë të drejtë, mund të thotë me nënqeshje: "Ne e kemi zakon të gënjejmë, dhe një vit është një gënjeshtëri shumë e vogël, se ne jemi mësuar të gënjejmë me 10-vjeçarë", por është një gënjeshtëri që rëndon shumë, sepse mban gjallë gjithë atë akrobllëk të poshtër dhe shpërdorues të një energjie prej qindra e miliona eurosh. Por mazhoranca nuk është e shqetësuar për këtë, pasi e ngjyen gishtin nga pak atje, kurse qytetarët e vuajnë çdo çmim të rritur që shikojnë, dëgjojnë se është rritur energjia dhe, edhe me ato të ardhura të pakta që kanë, detyrohen të mbajnë ngarkesën e energjisë. Në vend të gjoksrrahjes së jashtëzakonshme, që "ne e kemi mbrojtur popullin"... Unë i përbuz këto metafora, si: mburoja, pancirë, helmeta, se këto janë për ata që nuk duan të punojnë, kurse atyre që punojnë u flet puna me vepra. Nga çfarë e kanë mbrojtur popullin, kur vendi e kishte energjinë brenda dhe e blenë me qindra e milionë, duke i thënë: "Të mbrojtëm"?! E shisnin energjinë me 50 euro dhe ua jepnin ndërmjetësuesve, të cilët e shisnin 3-fish dhe ua kthenin sërish ose prokurorin tenderë me 270 euro për megavat, ndërkohë që 180 euro është çmimi tavan që vendoset në Europë. Kjo është mburoja që kanë vënë?! Jo, kjo nuk është mburojë, por shqyerje e grykës së thesit, që ta

mbushin për vete. Po të ishte ndryshe, këto pyetje kaq të thjeshta do ta kishin përgjigjen dhe sektori nuk do të administrohej me vizionin e dy javëve, sepse pasi u shpall një krizë apokaliptike, që do të shkatërronte themelet, dhe pasi u përcaktuan edhe fashat, u çuan edhe në ERE për t'u miratuar, papritmas ra një ditë shi dhe e tërë strategjia ndryshoi! Kaq qenka strategjia?! Një ditë me shi?! Kjo është strategji kusarësh, jo qeveritarësh, se nuk mund të ndryshojë strategjia me një ditë shi. "Ranë dy ditë shi dhe tani jemi mirë. Iku fasha. Po ra shi prapë, nuk do ta vendosim; po nuk ka ra, do ta vendosim". Ky është sektori i një vendi që i ka të gjitha mundësitë dhe është thënë haptas se mund të kthehet në një eksportues neto të energjisë. Po çfarë e pengon këtë? Asgjë tjetër përveç korrupsionit, se zgjidhjet që ne propozojmë nuk janë as çudira e as mrekullitë e botës, por janë zgjidhje të thjeshta. Kushdo që është i prirur për t'i bërë mirë vendit, patjetër që do t'i shikonte dhe do të mendonte për të gjitha gjërat, ashtu siç bën çdo familje në ditë të vështira, e cila përpiqet të ekonomizojë gjithçka që të kalojë javët e muajt e të mbahet gjallë. Edhe populli shqiptar është një familje e madhe dhe ka marrë "dikë" për ta administruar, që është qeveria. Kur i kemi të gjitha këto mundësi, pse nuk i kemi shfrytëzuar? Pse energjia e prodhuar nga dielli nuk është as në nivelin 0,7%? Në objektivat e kësaj qeverie duhet të ishte minimumi 30 apo 40-fish.

Përpara se të na sjellin ligjin tjetër, kur nuk ka funksionuar ende i pari, se këtu është bërë zakon që pa funksionuar ende ligji fillojnë të sjellin tjetrin, të na thonë: Çfarë ndodhi?! Ku iku kjo kohë?! Pse nuk prodhoi asgjë?! Si nuk bëmë asgjë?! Edhe pse e kishim ligjin, Shqipëria bëri vetëm 0,7% energji elektrike, vetëm 2 ditë! Ç'kanë ata të tjerët në Maqedoninë e Veriut që kanë kapacitete shumë më të mëdha nga ne?! Asgjë nuk kanë! Kanë qeverisje tjetër, e cila do ta qeverisë vendin më mirë, do ta qeverisë në mënyrë efektive dhe pikërisht këtu qëndron diferenca e madhe. Kuptohet që kjo diferencë dhemb dhe nuk pranohet, prandaj, në funksion të kësaj, ju shikoni se edhe nisma, e cila ka fatin e keq të jetë nisma e opozitës, qoftë edhe më e drejta në botë, sepse urdhri i marrë (këtu po, vlejné ato helmetat, empatitë dhe mburojat) është vënë si mburojë që ndan krahët, edhe sikur të vijë ideja më e mirë, kur në fund të fundit ne kemi

shumatoren e një ideje të specialistëve dhe të profesionistëve shumë të zotë dhe shumë të mirë të këtij sektori, refuzohet, sepse ka vetëm një të keqe, një të metë: vjen nga opozita. Flasim për mendjehapje, flasim për dialog, flasim për lloj-lloj demagogjish! Ata flasin për mungesë bashkëpunimi dhe thonë se opozita nuk do të bashkëpunojë me mazhorancën. Po ku e keni bashkëpunimin?! Nëse një deputet i mazhorancës propozon një nismë, ajo i ka shanset maksimale të miratohet. Kjo tjetra është dënuar që në hyrje, sepse është e opozitës. Por, a përfaqëson shqiptarët?! A përfaqëson interesa të dobishme?! A flasim për një situatë, ku njëra palë ka falimentuar dhe kujtohemi pas 6 vjetësh që na e paskësh fajin ligji dhe jo ne?! Po kush jua mbajti dorën vite me radhë ta bënit këtë punë?!

Kështu që, të nderuar kolegë deputetë, tallja dhe shpërdorimi korruptiv elektoral me energjinë elektrike i ka tejkaluar të gjithë kufijtë dhe shqiptarët kanë paguar një faturë tmerrsisht të rëndë, totalisht të pamërituar, vetëm dhe vetëm se mungesa e dëshirës ka qenë në mënyrë absolute, sepse priset konvenjeri korruptiv që funksionon me energjinë. Thatësira e motit nuk i shqetëson, por është një lajm i gëzuar, sepse do të kenë mundësinë të blejnë dhe të grijnë para të tjera.

Kështu që, sigurisht, në fund të këtij kalvari të kësaj nisme, e cila është shqyrtuar nga disa komisione, që, siç e thashë edhe në fjalën time paradite, pashë 3 relacione, të cilat nuk i ngjanin njëra-tjetrës qoftë në formë, qoftë në përmbajtje, por edhe si procedurë, unë patjetër do ta përsërisja ftesën time për të mbështetur atë që nuk është nismë e opozitës, por është një nismë në të mirë të sistemit energjetik, në të mirë të shqiptarëve, që të marrin një energji të pastër dhe me një çmim shumë të favorshëm, me qëllim që Shqipëria të mos blejë më kurrë energji.

Pra, po jua përsëris ftesën time për ta votuar, pa pasur as më të voglin iluzion se, qysh nga momenti që e vendosni pas nismës së qeverisë dhe e vendosni në fund, ju ia parashikoni fatin çdo gjëje, megjithatë mendjembyllja, logjika e drunjtë, kokëfortësia gjithmonë ia kanë ngrënë kokën të zotit dhe asnjëherë atij që ka pasur qëndrim tjetër.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet diskutimet për të dyja projektligjet.

Në rendin e ditës janë edhe 2 projektvendime: projektvendimi “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr.86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”” dhe projektvendimi “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr.65/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës në Komisionin e Prokurimit Publik””. Këtu projektvendime janë pa diskutime. Këtu mbyllet debati për çështjet e sotme.

Ju lutem, bëhuni gati për votim!

(Debate në sallë)

Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi për prezencën.

Janë prezentë 86 deputetë.

Vazhdojmë me votimin e projektligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, 9 kundër, 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nenet nga 2 deri te neni 32 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 75 vota pro, 9 kundër, 2 abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve në Shqipëri”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 80 vota pro, 4 kundër, 1 abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Zoti Leskaj, keni votuar?

Mbyllet votimi.

Janë 81 vota pro, 4 kundër, 1 abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 85 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 85 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektligji në tërësi.

Vazhdojmë me projektligjin “Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 79 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nenet nga 2 deri te neni 34 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 80 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Miratohet projektligji.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.48/ 2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të ndryshuar””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 77 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 77 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Miratohet projektligji.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 8 vota pro, 75 kundër, asnjë abstenim.

Projektligji nuk miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme””. Ky akt kërkon shumicë të

thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 8 vota pro, 75 kundër, asnjë abstenim.

Projektligji nuk miratohet.

Zoti Vasili ka fjalën për shpjegimin e votës.

Petril Vasili – Doja t’ju bëja një pyetje.

(Debate në salla)

Lindita Nikolla – Ju keni votuar pro, zoti Vasili. Fjala për shpjegimin e votës merret për votën kundër.

Petril Vasili – Dua t’ju shpjegoj tjetër gjë. Duhet të bëni votimin nen për nen!

Lindita Nikolla – Ju lutem, përderisa rrëzohet në parim, nuk vijon më votimi.

Petril Vasili – Zonja Kryetare, projektligji trajtohet si i tërë. Këto janë rregulla që vendosen brenda natës! Ju të njëjtën gjë thatë edhe për nismën e zonjës Kryemadhi, të cilën e rrëzoi komisioni special...

Lindita Nikolla – Edhe një herë, në momentin kur projektligji nuk miratohet në parim, nuk kalohet në votimin nen për nen.

Petril Vasili – Parlamenti nuk ka gjëra të nënkuptuara. Për secilën nismë votohen nenet njëri pas tjetrit.

Lindita Nikolla – Edhe një herë, në momentin kur nuk miratohet në parim, projektligji nuk miratohet dhe nuk ka diskutime më pas.

Petril Vasili – Zonjë, kjo është rregullorja e këtyre, nuk është e parlamentit. Në Rregulloren e parlamentit thuhet se votohet i gjithë ligji, ka votim në parim, nen për nen e në tërësi, shprehet “kundër” në të gjitha dhe mbyllet procedura. Nuk ka asnjë të keqe këtu! Bëjeni!

Lindita Nikolla – Edhe një herë, zotëri, në Rregullore thuhet pikërisht se në momentin kur ligji nuk miratohet në parim, nuk kalohet në votimin nen për nen.

Petril Vasili – Ku? Në cilën pikë? Ma lexoni! Në cilën pikë?

Lindita Nikolla – Mund ta lexoni edhe ju vetë apo dikush tjetër që ka interes.

Vazhdojmë me projektvendimin “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr.86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë

votash për miratim. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr.65/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës në Komisionin e Prokurimit Publik”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Miratohet projektvendimi.

Këtu mbyllet procesi i votimit.

Ju njoftoj se kemi një seancë ditën e hënë, në orën 13:20, ku do të përshëndesë Presidenti i Austrisë.

Ndërkohë, vazhdojmë me çështjet jashtë rendit të ditës.

(Debate pa mikrofon në sallë)

Fjala është për zotin Zef Hila. Keni 5 minuta në dispozicion.

(Debate pa mikrofon në sallë)

Ju lutem, kolegë, mbani qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi kaluar te çështjet jashtë rendit të ditës.

Zoti Hila, ju lutem, prisni 1 minutë, sepse fjalën e ka marrë zonja Aça!

Flutura Aça – Dua të bëj vetëm një korigjim të vogël. Fjala “huas” duhet të jetë “huasë”, nëse mund ta përcillni këtë vërejtje.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit juve!

Zef Hila – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të dashur qytetarë të Bashkisë së Vaut të Dejës,

Të nderuar kolegë,

Në radhë të parë, dua t’i uroj të gjithë besimtarët myslimanë, që të kenë një agjërëm sa më të lehtë! Zoti jua pranofte!

Të dashur qytetarë të Bashkisë së Vaut të Dejës,

Gjatë këtyre ditëve ne kemi pasur disa herë takime të ndryshme, kryesisht lidhur me rritjen e taksave. Në raport me vitet 2015-2019, në Bashkinë e Vaut të Dejës taksat janë rritur mbi

40%. Por ku ka shkuar rritja e taksave dhe çfarë pasqyrojnë ato në Bashkinë e Vaut të Dejës? Nga viti 2019 dhe deri tani fondi i pagave është rritur me mbi 65 milionë lekë më shumë në muaj në krahasim me vitet 2015-2019 ose, e thënë ndryshe, 780 milionë lekë të vjetër në vit për 4 vjet. Vetëm për pagat e punonjësve janë shpenzuar më shumë se 3 miliardë e 120 milionë vetëm në Bashkinë e Vaut të Dejës, vetëm për rritjen e pagave të tyre.

Çfarë ndodh në vazhdimësi të kësaj? Lidhur me shkeljet dhe abuzimet e kryera kryesisht nga punonjësit, unë po përmend vetëm një aspekt. Në komunalen sh.a. në Bushat, tërësisht në pronësi të Bashkisë së Vaut të Dejës, e cila administron *landfill*-in e Bushatit, në organikën e saj ka të punësuar, të cilët e marrin pagën, pavarësisht se nuk paraqiten asnjë ditë të vetme në punë. Ka persona, të cilët, pavarësisht se janë të punësuar në kompani private, e marrin pagën e tyre nga taksat e qytetarëve të Bashkisë së Vaut të Dejës. Ka persona, siç është rasti flagrant i shtetasit Lorenc Pjetra, i cili është zgjedhur në këshillin bashkiak të Bashkisë së Vaut të Dejës në vitin 2019, si përfaqësues i Partisë Socialdemokrate dhe sipas listës së këshillit bashkiak, ai rezultoi i punësuar pranë komunales sh.a. në Bushat. Sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 47 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, pra ligji është shumë i qartë për këshilltarin e Partisë Socialdemokrate, Lorenc Pjetra. Ligji nuk zbatohet nga administratori i komunales Agron Ceka dhe ai merr 2 paga nga taksat e qytetarëve të Bashkisë së Vaut të Dejës.

Po në listëpagesën e kësaj sh.a.-je ka edhe persona të tjerë, të cilët nuk janë banorë të kësaj zone, por janë me vendbanim në qytetin e Gjirokastrës, për shembull, që paguhen me pagë në ndërmarrjen e sh.a.-së së Bashkisë së Vaut të Dejës. Kjo shkelje mban firmën e administratorit të papërgjegjshëm të kësaj sh.a.-je. Si mundet një qytetar të vijë çdo ditë nga Gjirokastra dhe të kthehet brenda ditës?! Kjo është e pashpjegueshme, përveç faktit që kemi të bëjmë me një punësim krejtësisht fiktiv, me qëllim vetëm shpërblimin me pagë, për shkak të besnikërisë ndaj partisë në pushtet.

Në listëpagesën e kësaj sh.a.-je ka edhe persona të tjerë, të cilët nuk paraqiten asnjë ditë të vetme në punë dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme, sepse *landfill*-i është i pajisur me kamera.

Të dashur qytetarë,

Në Bashkinë e Vaut të Dejës paguhen 12 shoferë dhe fadromistë. Pra, paguhen persona, të cilët nuk kanë as patentë dhe as mjete. Të gjitha këto paguhen me taksat e qytetarëve të Bashkisë së Vaut të Dejës.

Të gjitha këto që thashë më lart janë lehtësisht të verifikueshme për këdo që ka interes t'i kontrollojë dhe jam i bindur se do të gjejë jo vetëm kaq, por edhe më shumë, do të gjejë paligjshmëri, të cilat jam i bindur që qytetarët e Vaut të Dejës i dinë mjaft mirë. Këtu unë kam një listëpagesë, në të cilën janë pasqyruar të gjithë personat që marrin pagë të sh.a.-ja e *landfill*-it të Bushatit, të cilët jo vetëm nuk janë banorë të Bashkisë, por as të qarkut të Shkodrës.

Paligjshmëritë vazhdojnë dhe unë po marr vetëm 2 shembuj. Për periudhën 2015-2019, vetëm në zërin "kancelari" janë shpenzuar 141 milionë lekë, ndërsa gjatë periudhës 2019-2023 janë 209 milionë lekë. Llogarinë e bëjnë vetë qytetarët. Në zërin "pjesë këmbimi" për 4 vjet, 2015-2019, janë shpenzuar 100 milionë lekë nga taksat e qytetarëve, ndërsa gjatë qeverisjes së Partisë Socialiste për periudhën 2019-2023 mbi 200 milionë lekë. Këto janë shifra zyrtare, të pashmangshme dhe të gjitha të dokumentuara.

Të dashur qytetarë të Bashkisë së Vaut të Dejës,

Lënia e mandatit tim si deputet, për të kandiduar si kryetar i Bashkisë së Vaut të Dejës, më vendos akoma më shumë përballë përgjegjësive. Askush më mirë se banorët e Bashkisë së Vaut të Dejës nuk është dëshmitar i një realiteti kaq të hidhur të qeverisjes së këtyre 4 vjetëve, ndaj jam sot këtu për ta dorëzuar mandatin dhe për t'u përballur me vështirësitë dhe me betejat që na presin.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala është për zotin Bujar Leskaj.

Bujar Leskaj – Së pari, edhe në emër të kolegëve demokratë që janë në këtë sallë, më lejoni t'i uroj suksese zotit Zef Hila. Të gjithë jemi të bindur për fitoren e tij, të këtij burri të nderuar

të Bashkisë së Vaut të Dejës, të këtij zyrtari të provuar dhe të këtij deputeti të përkushtuar.

Në fakt, ne vlonjatët sot kemi një ditë të shënuar, pasi është 100-vjetori i klubit "Flamurtari" dhe kam gjetur mirëkuptimin e deputetëve të së majtës së qytetit apo të qarkut të Vlorës, me origjinë vlonjate, apo edhe të deputetëve të tjerë, për të përcjellë një përshëndetje modeste.

E nderuar zonja Kryetare, faleminderit që ma dhatë fjalën!

E nderuar, zonja Resulaj, deputete e Vlorës,

Të nderuar deputetë të Partisë Demokratike, Do ta filloj përshëndetjen time me një thënie apo citat të mjeshtrit të madh, nderit të qytetit të Vlorës, të futbollistit dhe të njeriut të veçantë, të personalitetit të padiskutueshëm të Vlorës, Mexhit Haxhiu, i cili shkruan se në Vlorën pranë detit kanë lindur poetë dhe piktorë, politikanë dhe burra shteti, pranë detit kanë lindur shkrimtarë dhe futbollistë.

Sa për një kronologji të shkurtër, shkrimi i parë për futbollin dhe për sportet në Vlorë daton në vitin 1910 dhe është i patriotit Tol Arapi, "Lodrat kombëtare të Shqipërisë". Me këtë shkrim ai ka marrë një çmim nga Lidhja Kombëtare Verore, ndërsa në një shkrim tjetër për ekipet dhe kampionatet e harruara citohet se në një kampionat kombëtar shqiptar, në një nga veprimtaritë e para shqiptare, zhvilluar në vitin 1911 në qytetin e Fierit, e cila është ende e panjohur nga Federata Shqiptare e Futbollit, pra në këtë turne morën pjesë ekipet e Vlorës, të Tiranës, të Elbasanit, të Kavajës, të Beratit dhe të Peqinit. Kampionatin e fitoi ekipi i Tiranës, i cili mundi në finale ekipin e Peqinit. Lajmin e dha gazeta "Zgjimi i Shqipërisë" e datës 21 prill 1911. Pra, Vlorë ka pasur ekip futbollit qysh në prillin e vitit 1911.

Në fakt, në librin e tij të vitit 2000, "Fillimet e sportit në Vlorë" (ky njihet si më zyrtar), një kuadër i sportit në Vlorë, Kristaq Moçka, thekson se qysh prej vitit 1915 njohja dhe zhvillimi i lojës së futbollit në Vlorë filloi kur ekuipazhi i një anijeje luante në bregun ranor të qytetit. Viti 1915 mbahet si viti i lojës së parë të futbollit në Vlorë, ku edhe këtu sporti filloi me futbollin.

Do t'i them edhe burimet nga i kam marrë këto informacione, sepse nuk po i nxjerr nga mendja ime.

Shoqëria e parë sportive në Vlorë u formua në vitin 1921. Rreth 30 të rinj u grumbulluan në shoqërinë sportive “Jeronim de Rada”. Grumbullimi i lojtarëve u krye nga Sezai Nota. Më vonë shoqërisë iu shtua edhe një trupë artistike kulturore. Kristaq Moçka, në botimin, që e citova pak më parë, “Fillimet e sportit në Vlorë”, shkruan se në vitin 1921 Sezai Nota, Kudret Kokoshi, Mitat Mustafaraj, Nani Sallata, Sezai Qemali dhe Nasi Nikolla u bënë nismëtarë të shoqërisë sportive “Jeronim de Rada” dhe, si nismëtar, Sezai Nota u zgjodh në krye të shoqërisë.

Në vitin 1981, në një artikull të revistës “Ylli”, nëse nuk gaboj, Vizhdar Rushiti konfirmoi se më 23 mars 1923 u formua shoqëria sportive “Jeronim de Rada”, së cilës më vonë iu dha emri “Ismail Qemali”. Kristaq Moçka në librin e tij shkruan se në mënyrë origjinale në këto vite u shtrua si kërkesë formimi zyrtar i një shoqërie sportive, me anëtarësi të të rinjve që jetonin në qytet. Më 27.3.1923 u krijua shoqëria sportive “Vlora”. Kryetar u zgjodh Milto Korçari, sekretar Malo Ismaili dhe arkëtar Faslli Zoga. Pra, si gjithmonë në Shqipëri vazhdojmë me 2 data, kemi edhe datën 23 mars, edhe datën 27 mars, por për fat nuk kemi shumë në antagonizëm.

Në kampionatin e parë kombëtar shqiptar, të zhvilluar në vitin 1930, ka marrë pjesë edhe ekipi i Vlorës, i cili është renditur në vendin e gjashtë dhe për herë të parë fanella me të cilën u prezantua ishte këmishë e bardhë me 2 vija në ngjyrë të zezë e të kuqe dhe çorape të zeza. Në raste ceremonie kjo fanellë përdoret nga ekipi “Flamurtari”, por shpërndahet edhe si dhuratë.

Formacioni i parë i ekipit “Flamurtari” në vitin 1930, si shoqëria sportive “Vlora”, përbëhej nga (do të më lejoni t’ua lexoj emrat) Apostol Malo, Neshat Agolli, Xhevdet Pustina, Jani Kosta, Pavlo Qiroko, Vasil Koço, Hasbi Tepelena, Zeko Koka, Syrja Gabrani, Remzi Verzivolli, Vasfi Samimi, Abedin Bozhegu, Xhevdet Fishta, Hamdi Zoga. Nga “Jeronim de Rada” në vitin 1921, shoqëria sportive mori emrin “Vlora” më 27 mars 1923 ose më 23 mars 1923, për të kaluar në vitin 1935 me emrin “Ismail Qemali”. Me emrin “Flamurtari” ekipi prezantohet në qershor të vitit 1946. Në vitet 1950-1957 ekipi i Vlorës mori emrin “Puna”, si një sëmundje e të gjitha ekipeve shqiptare, për t’u

kthyer përsëri dhe për të vazhduar me lavdi në vitin 1958 me emrin “Flamurtari”.

Të them të drejtën, këto të dhëna i kam marrë nga libri i gazetarit sportiv Moisi Dalipi, “Yje në fushën time”, nga libri i studiuesit dhe gazetarit Ergys Alushi “Flamurtari, bashkë një shekull” që promovohet ditën e shtunë, nëse nuk gaboj, nga Bashkia e Vlorës dhe nga klubi “Flamurtari”, dhe të dhënat e tjera i kam marrë nga historiani, personalitet i padiskutueshëm i Vlorës, një zë autoritar dhe i veçantë në historinë e Shqipërisë, profesor Bardhosh Gaçe.

Zonja Kryetare, duke ju falënderuar, pasi për herë të parë nuk më thatë që mbaroi koha, do të më lejoni të shpreh respektin tim të thellë, si qytetar vlonjat, për yjet e futbollit vlonjat. Në fakt, më 27 apo 23 mars 1923 njihet krijimi i ekipit të futbollit, por feston edhe klubi shumësportësh “Flamurtari”. Po përmend yjet e ekipit të futbollit në vite, kryesisht të madhin Mexhit Haxhiu, Shemsi Zilja, Uran Xhafa, Edmond Liçaj, Ben Nelaj, Aqif Sulo, Krenar Shakaj, Cane Ahmeti e të tjerë. Në vlonjatët krenohemi me ekipin “Flamurtari” të viteve ’80-’90. Do të më lejoni t’i lexoj të gjithë emrat dhe njëherazi të kërkoj ndjesë nëse harroj ndonjë emër.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dashi, mund t’i them edhe pozicionet, por kuptohet që ato njihen nga të gjithë.

Do ta filloj me portierët Luan Birçe, Anesti Arapi, Aleko Berberi, për të vazhduar me lojtarët Petro Ruci, Rrapo Taho, Përparim Lushaj, Roland Iljadh, Esat Shabani, Alfred Ferko, Alfred Zijai, i cili është edhe themeluesi i Partisë Demokratike (i paharruar qoftë), Lato Gjondeda, Egerem Memushi, Vasil Bifsha, Sokol Kushta, Agim Bubeqi, Vasil Ruci, Vasil Ziu, Viron Daullja, Gramoz Murataj, Agim Canaj dhe profesorët e tyre, trajnerët e mirënjohur, Skënder Elmazi, Bejkush Birçe, Agron Sulo (i paharruar), Fatmir Gjebrea dhe Leonidha Çuri.

Këto ishin disa të dhëna dhe, për të shmangur çdo keqkuptim, po e përsëris se i kam marrë nga këta 2 libra, kryesisht nga libri i Ergysit.

Ju ftoj në datën 25, nuk kam ndonjë autorizim, por kuptohet që është ftesë e Bashkisë dhe e klubit “Flamurtari”, dhe në veçanti në datën 26, kur shoqata “Flamurtari”, shoqatë e krijuar nga mjeshtrit e mëdhenj Vasil Ruci, Kreshnik Çipi, Rrapo Taho e të tjerë, do të organizojë

aktivitete të veçanta. Në orën 11:00 do të ketë ndeshje me skuadrën kombëtare të futbollit të viteve '80-'90 në stadiumin "Flamurtari" dhe në orën 13:00 në pallatin e sportit do të ketë një aktivitet të veçantë, koncert, dokumentar që shfaq këta lojtarë të lavdishëm.

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoreshë e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**

Ju faleminderit për vëmendjen dhe përcjell respektin e të gjithë vlonjatëve për këto minuta që na kushtuat, në veçanti për zonjën Kryetare, Lindita Nikolla!

Lindita Nikolla – Faleminderit, zoti Leskaj, edhe për të gjithë kujtesën!
Faleminderit edhe për ftesën!
Këtu mbyllet seanca për sot.
Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 21:30)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla